# Një ulëse në tryezë

Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese



# Një ulëse në tryezë

Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes
në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese

© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2021

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky botim mund të kopjohet dhe të shpërndahet, për sa kohë që deklarohet burimi.

Autorë: Majlinda Behrami, José Carpintero Molina dhe Nicole Farnsworth.

Dizajnuar nga: Jeta Dobranja

Ky botim është hartuar me mbështetjen financiare të UN Women. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women.

# MIRËNJOHJE

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) shprehë mirënjohje për të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim, duke përfshirë aktivistet për të drejtat e grave, politikanet dhe përfaqësuesit e institucioneve që i kanë rrëfyer historitë e tyre. Ekipi hulumtues i RrGK-së, i përbërë nga Majlinda Behramin, José Carpintero Molina dhe Besarta Breznicën punuan pareshtur për të realizuar, transkriptuar dhe analizuar intervistat, fokus grupet dhe të dhënat e pyetësorëve. Nicole Farnsworth mbështeti ekipin dhe ndihmoi në shkrimin e raportit. Tijana Simić LaValley realizoi fokus grupet në gjuhën serbe dhe ofroi këshilla për raportin. Lauren Hanna ndihmoi në lektorim. Loreta Suka ndihmoi me përkthimin. Autorët falënderojnë Drejtoren Ekzekutive të RrGK-së Igballe Rogova, Menaxheren e Financave Besa Shehu, Menaxheren e Projektit Zana Rudi dhe Koordinatoren e Projektit Etleva Malushaj për përkrahjen e tyre të vazhdueshme. Ky publikim u rishikua nga Yllka Soba, Lorenta Kadriu, Tijana Simic LaValley, Vetone Veliu, përfaqësuese të UN Women, dhe përfaqësues të tjerë të KB-së. RrGK posaqërisht falënderon UN Women në Kosovë për besimin dhe mbështetjen e RrGK-së gjatë realizimit të këtij hulumtimi. Raporti është financuar nga UN Women me një kontribut të konsiderueshëm pa pagesë nga stafi i RrGK.

# AKRONIMET DHE SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| ABGJ | Agjencia për Barazi Gjinore |
| CBM | Ndërtimi i Komunitetit në Mitrovicë |
| KMDLNJ | Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut |
| CEDAW | Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave |
| QMGF | Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve |
| OSHC | Organizatë e Shoqërisë Civile |
| BE | Bashkimi Evropian |
| FDH | Fondi për të Drejtën Humanitare |
| ICITAP | Programi Ndërkombëtar i Ndihmës për Trajnime në Hetimet Penale |
| ICRC | Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq |
| Konventa e Stambollit | Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje |
| ASK | Agjencia e Statistikave e Kosovës |
| QKSS | Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë |
| KFOR | Forca e Kosovës |
| UÇK | Ushtria Çlirimtare e Kosovës |
| QKSGJ | Qendra Kosovare për Studime Gjinore |
| PK | Policia e Kosovës |
| TMK | Trupat Mbrojtëse të Kosovës |
| SHPK | Shërbimi Policor i Kosovës |
| QKRMT | Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës |
| FSK | Forca e Sigurisë së Kosovës |
| Kvinna till Kvinna | Fondacioni Kvinna till Kvinna |
| LGK | Lobi i Grave të Kosovës |
| RrGK | Rrjeti i Grave të Kosovës |
| LBGJ | Ligji për Barazinë Gjinore |
| LGBTQIA+ | Lesbian, Gay, Biseksual, Trans*, Queer/Questioning, Interseksual, Aseksual dhe identitete të tjera |
| DK | Deputet i Kuvendit |
| MWAHR | Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut |
| MWMN | Rrjeti Mesdhetar i Grave Ndërmjetëse |
| NATO | Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut |
| NDI | Instituti Demokratik Kombëtar |
| OJQ | Organizatë Joqeveritare |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian |
| PBSO | Zyra e Përkrahjes për Ndërtimin e Paqes |
| RECOM | Komisioni Rajonal për Vërtetimin e Fakteve rreth krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë |
| RWLSEE | Lobi Rajonal i Grave në Evropën Juglindore |
| RYCO | Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor |
| SZHQ | Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm |

| | |
|---|---|
| KKS | Këshilli Kombëtar i Serbëve |
| PSSP | Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| UNIFEM | Fondi Zhvillimor për Gratë i Kombeve të Bashkuara |
| UNICEF | Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara |
| UNFPA | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë |
| UNMIK | Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë |
| SHBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |
| USAID | Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar |
| USIS | Zyra e Shërbimit të Informacionit të Shteteve të Bashkuara |
| KSKB | Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara |
| RKSKB | Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara |
| OSHCV | Organizatë e shoqërisë civile për të drejtat e grave |
| GPS | Gra, paqe dhe siguri |
| RPS | Rini, paqe dhe siguri |
| YIHR | Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut |

# PËRMBAJTJA


Përmbledhje ekzekutive 5
Hyrje 7
Kapitulli I. Si E përkufizojnë gratë në Kosovë paqen dhe sigurinë? 12
Përkufizimi i paqes 12
Përkufizimi i sigurisë 17
Çfarë do ta bënte Kosovën më paqësore dhe më të sigurt? 20
Konkluzion 21
Kapitulli II. Rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri 23
Rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri gjatë konfliktit dhe luftës 24
Rolet dhe kontributet e grave pas luftës 47
Konkluzion 98
Kapitulli III. Sfidat për përfshirjen e grave në proceset e paqes 99
Konflikti dhe kërcënimet ndëretnike 99
Aktorët ndërkombëtarë fillimisht forcojnë pabarazitë gjinore 102
Vazhdimi i partive politike të odave dhe të demokratizuara dobët 104
Patriarkalizmi 107
Përfundim 112
Rekomandime 113
Punimet e Cituara 118
Shtojcat 128
Shtojca 1. Detaje metodologjike 128
Shtojca 2. Udhëzuesi për intervistë 130
Shtojca 3. Pyetësori 132
Shtojca 4. Udhëzuesi për Fokus Grupe 134
Shtojca 5. Korniza përkatëse ligjore dhe e politikave për gratë, të rinjtë, paqen dhe sigurinë 135

# Përmbledhje ekzekutive

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, dhe rezolutat "simotra" të saj që pasuan, kanë bërë thirrje për rritje të pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarrjes në lidhje me paqen dhe sigurinë. RKSKB 1325, e miratuar në vitin 2000, në vitin 2020 shënoi 20-vjetorin e saj. Ndërkohë, miratimi i kësaj rezolute përkoi me përfundimin e luftës në Kosovë (1999) dhe kështu viti 2020 shënoi edhe 20-vjetorin e shfrytëzimit të Rezolutës 1325 nga ana e aktivisteve për të drejtat e grave në mënyrë që zëri i tyre të dëgjohet në drejtim të sigurimit të një ulëseje në tryezë gjatë proceseve të ndërtimit të paqes.

Ky raport shqyrton rolet, kontributet dhe nevojat e grave përkitazi me proceset e paqes dhe sigurisë në Kosovë, duke përfshirë rolin specifik të organizatave për të drejtat e grave në ndërtimin e paqes. Ky hulumtim ka pasur për synim të dokumentojë perspektivat dhe përvojat e ndryshme të aktivisteve, politikaneve, organizatave të shoqërisë civile dhe të grave të ndryshme, veçanërisht të vajzave. I realizuar në vitin 2020, ky hulumtim ka ndërthurur metoda të përziera, duke përfshirë hulumtimin dokumentar, një anketë përmes interneti, intervista, vëzhgimin e pjesëmarrësve dhe grupe të fokusit. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë gjithsej 483 persona të ndryshëm, duke përfshirë 266 gra dhe vajza dhe pesë burra.

Kapitulli i parë shqyrton pikëpamjet se si gratë e përkufizojnë dhe përjetojnë paqen dhe sigurinë. Gjetjet sugjerojnë që paqja dhe siguria kanë kuptime të ndryshme për gra të ndryshme, bazuar në përvojat e tyre. Gratë të cilat e kanë përjetuar personalisht luftën kishin prirje ta përkufizojnë paqen si mungesë lufte, ndërsa vajzat që kanë lindur pas luftës kishin prirje ta përkufizojnë paqen më gjerësisht, në përputhje me përkufizimet e autorëve feministë për paqen dhe sigurinë. Derisa disa pjesëmarrëse në hulumtim ndiheshin të sigurta në Kosovë, të tjerat nuk ndiheshin të sigurta. Këto të fundit ia atribuonin pasigurinë arsimit të dobët, rënies së ekonomisë, dhunës me bazë gjinore, reagimit të dobët institucional dhe mungesës së infrastrukturës. Gjithashtu gratë i shqetësonin edhe konfrontimet ndëretnike midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Drejt paqes dhe sigurisë, gratë kanë përmendur angazhimin e tyre në politikë dhe në dialogun Kosovë-Serbi, arsimimin më të mirë, mundësitë për punësim, angazhimin e më shumë grave në sektorin e sigurisë dhe rrugët e sigurta, veçanërisht pa kërcënime të ngacmimit seksual.

Kapitulli i dytë shtjellon rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri. Në kohë konflikti, këto varionin nga përfshirja në politikë për një zgjidhje paqësore deri te konflikti midis njerëzve në Kosovë dhe Serbi; mbrojtja e sigurisë së njerëzve përmes arsimimit, kujdesit shëndetësor dhe ndihmës humanitare; ndërtimi i paqes përtej kufijve; dokumentimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut, udhëheqja e demonstratave paqësore dhe diplomacia ndërkombëtare, ndërhyrja paqësore dhe përfundimi i luftës; organizimi i sigurisë për personat e zhvendosur. Të anketuarat shprehën shqetësimin se kontributet e grave para luftës janë harruar. Pas luftës së vitit 1999, gjetjet sugjerojnë se gratë kanë kontribuar për paqe dhe siguri përmes ndërtimit të paqes ndëretnike, rrjetëzimit, avancimit të sigurisë së njerëzve, sektorit të sigurisë, politikës dhe negociatave e dialogut. Nën-pjesa e fundit shtjellon gjithashtu prioritetet e grave për negociata dhe dialog në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kur gratë u përjashtuan në pjesën më të madhe nga proceset zyrtare të paqes, sikurse janë negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë, organizatat për të drejtat e grave kishin kontribuar dukshëm në avancimin e paqes dhe sigurisë përmes rrjetëzimit përtej kufijve të ndryshëm, protestave paqësore, negociatave alternative, shkrimit të letrave dhe angazhimit në media në mënyrë që të dëgjohet zëri i grave dhe prioritet e tyre.

Kapitulli i tretë shtjellon sfidat kryesore për pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes, duke përfshirë konfliktin e vazhdueshëm ndëretnik dhe kërcënimet ndaj aktivisteve gra të të drejtave të njeriut të angazhuara në ndërtimin e paqes; supozimet e aktorëve ndërkombëtarë se Kosova ishte një shoqëri patriarkale, që do të thoshte se gratë u përjashtuan nga proceset e vendimmarrjes menjëherë pas luftës; qasjet e udhëheqësve politikë burra dhe

demokratizimi i dobët i partive politike; si dhe patriarkalizmi në përgjithësi.

Ky raport përmban rekomandime për aktorë të ndryshëm për avancimin e paqes dhe sigurisë në Kosovë, si dhe për rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset e paqes e veçanërisht për angazhimin e vajzave. Një shtojcë përmbledh kornizën përkatëse ligjore.

# Hyrje

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë,[1] dhe rezolutat "simotra" të saj që pasuan[2], kanë bërë thirrje për rritje të pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarrjes përkitazi me paqen dhe sigurinë. RKSKB 1325 shpreh shqetësimin se gratë janë ndër më të prekurat nga pasojat e konfliktit të armatosur. Pra, kjo rezolutë thekson rëndësinë e njohjes së rolit të grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit si dhe në konsolidimin e paqes. Kjo rezolutë u bën thirrje shteteve të rrisin përfaqësimin e grave në të gjitha sferat e vendimmarrjes, nga niveli lokal deri në atë ndërkombëtar. Ajo gjithashtu thekson nevojën që operacionet e paqes dhe negociatat e paqes të përvetësojnë një perspektivë gjinore dhe që gratë të përfaqësohen në mënyrë të duhur në to. Disa nga rezolutat "simotra" të RKSKB 1325 kanë theksuar në mënyrë të qartë rolin e organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHCG-ve) në avancimin e paqes dhe sigurisë, dhe rrjedhimisht edhe rëndësinë e angazhimit dhe mbështetjes së tyre. Ndërkohë, përmes RKSKB 2535 (2020), OKB së fundmi ka njohur rolet kyç që rinia, e posaçërisht vajzat, mund të luajnë në zgjidhjen e konflikteve, parandalimin e tyre dhe në ndërtimin e paqes, duke bërë thirrje për angazhimin e shtuar të tyre në këto procese.[3]

Përkundër miratimit të RKSKB 1325 dhe rezolutave pasuese të KB për gratë, paqen dhe sigurinë, si dhe njohjen ndërkombëtare të roleve, kontributeve dhe nevojave të veçanta të grave dhe të rinjve në konflikt,[4] si gratë edhe të rinjtë mbeten të përjashtuar në pjesën më të madhe nga proceset e bërjes së paqes dhe ndërtimit të paqes në të gjithë globin.[5] Mesatarisht, në nivel global, gratë kanë përbërë vetëm 13% të negociatorëve dhe 6% të nënshkruesve në proceset kryesore të paqes midis vitit 1990 dhe 2019.[6] Ndërkohë, përkundër njohjes së rolit të rëndësishëm që OSHCG-të mund të luajnë në avancimin e paqes, historikisht, kur negociatat për paqe kanë përfshirë OSHC-të, ato rrallëherë kanë përfshirë OSHCG-të lokale ose adresuar nevojat e anëtareve të tyre.

Studiuesit kanë identifikuar disa arsye për përfshirjen e grave në proceset e paqes.[7] Studimet e tyre konfirmojnë se ekziston një korrelacion pozitiv midis barazisë gjinore në proceset e paqes dhe qëndrueshmërisë së paqes; suksesi i operacioneve paqësore mund të jetë më i madh kur gratë e ngrisin zërin dhe shprehin përvojat e tyre.[8] Megjithëse gratë nuk janë një grup homogjen dhe ekzistojnë agjenda dhe interpretime të ndryshme për paqen, ato mund të shërbejnë si një lidhje midis nivelit lokal dhe proceseve të negociatave.[9] Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e përvojave që kanë pasur gratë në situata konflikti dhe pas-konflikti, përfshirja e grave mund të kontribuojë në kuptimin më të mirë të faktorëve që çojnë në konflikt dhe mënyrat për të arritur llogaridhënien për krimet.[10] Vështrimi i tyre për ndikimin e luftës në jetën e individëve dhe të fëmijëve mund të identifikojë nevojat prioritare drejt mbështetjes së "sigurisë për të gjithë qytetarët".[11] Gratë që janë nënshkruese mund të forcojnë lidhjet

[1] RKSKB 1325, 31 tetor 2000.

[2] Nëntë rezolutat shtesë të Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë janë 1820 (2009), 1888 (2009), 1889 (2010), 1960 (2011), 2106 (2013), 2122 (2013), 2242 (2015), 2467 (2019) dhe 2493 (2019) Për përshkrimet, ju lutem shihni Shtojcën 5.

[3] RKSKB 2535, 14 korrik 2020.

[4] Shih Shtojcën 5.

[5] UN Women, *Gratë e reja në paqe dhe siguri:Në kryqëzimin e Agjendave të RPS dhe GPS*, 2018; dhe Norville, V., "Roli i grave në sigurinë globale", 2011, f. 2

[6] Këshilli për Marrëdhëniet e Jashtme, Pjesëmarrja e grave në proceset e paqes, n.d.

[7] Krause, J., Krause, W., dhe Bränfors, P., "Pjesëmarrja e grave në negociatat e paqes dhe qëndrueshmëria e paqes", *Ndërveprimet ndërkombëtare*, 2018; dhe Gizelis, T-I., *Fuqizimi gjinor dhe ndërtimi i paqes nga Kombet e Bashkuara*, 2009.

[8] Gizelis, 2009, cituar nga Krause et al., f. 6.

[9] Krause et al., f. 6.

[10] Fondacioni Kvinna till Kvinna, *E drejtë, jo dhuratë*, 2020, f. 58.

[11] Hunt, Swanee dhe Cristina Posa, "Gratë që bëjnë paqen", *Foreign Policy*, Nr. 124 (Maj-Qer., 2001) f. 38-47.

me OSHCG-të që kanë lidhje të forta me bazën.[12] Lidhjet midis grave në negociata dhe OSHCG-ve të ndryshme jo vetëm që zgjerojnë mbështetjen shoqërore për proceset e paqes, por mund të sigurojnë informata për çështje specifike gjatë negociatave.[13] Gratë pjesëmarrëse në negociata gjithashtu mund të kenë mbështetjen e OSHCG-ve, të cilat mund të forcojnë pozitën e tyre.

Mungesa e grave në proceset e paqes zvogëlon gjasat e përfshirjes së dispozitave për barazinë gjinore dhe zhvillimin socio-ekonomik, çështje këto të rëndësishme për sigurinë njerëzore që gratë zakonisht i mbrojnë.[14] Marrëveshjet që nuk përfshijnë gratë përqendrohen kryesisht në reforma ushtarake, ndërsa ato të nënshkruara nga gratë priren të kenë më shumë dispozita që lidhen me paqen shoqërore, përfshirë "reformën politike, shoqërore dhe ekonomike".[15] Në të vërtetë, në proceset e çmobilizimit, çarmatimit dhe ri-integrimit, të lidhura ngushtë me reformën e sundimin e ligjit, sigurisë dhe drejtësisë, duhet të merren parasysh nevojat e grave dhe vajzave.[16]

Si gratë edhe të rinjtë luajnë një rol themelor në promovimin e paqes dhe sigurisë; nëse nuk përfshihen në pranimin e marrëveshjeve të paqes, proceseve të tilla iu mungon legjitimiteti dhe qëndrueshmëria.[17] Marrëveshjet në të cilat gratë negociatore kanë përfaqësim më të lartë kanë një shkallë më të lartë të zbatueshmërisë. Në përgjithësi, ekziston një marrëdhënie e fortë midis përfshirjes së grave në marrëveshjet e paqes dhe qëndrueshmërisë së tyre.[18] Për shembull, hulumtimi nga Krause et al. ka treguar se në Republikën Demokratike të Kongos, El Salvadorit, Guatemalës, Liberisë, Papua Guinesë së Re dhe Irlandës së Veriut, angazhimi i më shumë grave në marrëveshjet e paqes korrespondon me "një qëndrueshmëri më të gjatë dhe më cilësore të marrëveshjeve të paqes".[19]

Ngjashëm, ndërsa shpesh homogjenizohen si viktima të konflikteve, gratë dhe burrat e rinj kanë luajtur rol kyç në veprimet për arritjen e paqes. Në nivel global, ekzistojnë disa shembuj siç janë: Deklarata e Rinisë së Amanit, ku shprehet përkushtimi dhe veprimi i të rinjve për të jetuar në një shoqëri globale paqësore, duke përdorur një qasje të ndjeshme gjinore;[20] Plani i Veprimit Rajonal i Paqësorit, që avancon lidershipin e grave dhe vajzave në parandalimin e konflikteve dhe ndërtimin e paqes, integrimin e gjinisë në hartimin e politikave të sigurisë dhe sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave;[21] dhe Karta e Rinisë Afrikane, e cila siguroi një kornizë për pjesëmarrjen e të rinjve në të gjitha sferat e shoqërisë, si dhe njohu veprimin e tyre për paqe.[22] Të gjitha këto i paraprinë RKSKB 2250 dhe ofruan informata për miratimin e saj, pasi ato dëshmuan potencialin e kontributit të të rinjve, përfshirë gratë e reja, në paqe dhe në proceset e sigurisë.[23] Përkundër këtyre kontributeve dhe potencialit të vajzave, pak vajza angazhohen në procese paqësore, vendimmarrje ose politikë.[24]

Duke marrë parasysh rëndësinë e përcaktuar të angazhimit të grave, përfshirë vajzat, në proceset e paqes, ky raport shqyrton rolet, kontributet dhe nevojat e grave në lidhje me proceset e paqes dhe sigurisë në Kosovë. Në të vërtetë, miratimi i Rezolutës 1325 gati përkoi me përfundimin e luftës në Kosovë (1999). Prandaj, derisa po

---

[12] Krause et al., f. 7.

[13] Ibid.

[14] El Jack, A., *Gjinia dhe konflikti i armatosur: Raport i mbikëqyrjes*, 2003, f. 8.

[15] Krause et al.

[16] Norville, V., f. 4.

[17] Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Zyra Mbështetëse për Ndërtimin e Paqes (PBSO), "Paqja që mungon", 2018, f. 70

[18] Krause et al.

[19] Ibid.

[20] Deklarata e Rinisë së Amanit, "Për rininë, paqen dhe sigurinë", 2015.

[21] Sekretariati i Forumit të Ishujve Paqësor, *Plani i veprimit rajonal i Paqësorit 2012-2015*, 2015.

[22] Komisioni i Unionit Afrikan, *Karta e Rinisë Afrikane*, 2006.

[23] UN Women, "Gratë e reja në paqe dhe siguri: Në kryqëzimin e Agjendave të RPS dhe GPS", f. 5-6.

[24] Ibid, f. 5.

përkujtohej 20-vjetori i Rezolutës 1325, viti 2020 shënoi edhe 20-vjetorin e shfrytëzimit të Rezolutës 1325 nga ana e aktivisteve për të drejtat e grave që të dëgjohet zëri i tyre në drejtim të sigurimit të një ulëseje në tryezë gjatë proceseve të ndërtimit të paqes në Kosovë. Dokumentimi i punës së tyre mund të ofrojë njohuri për aktivistet e të drejtave të grave në vende të tjera në botë, duke evidentuar gjithashtu kontributet e rëndësishme që gratë mund të kenë dhënë dhe kanë dhënë për paqen dhe sigurinë në Kosovë gjatë tri dekadave të fundit. Një histori dhe kontekst i tillë është i rëndësishëm për të njohur punën dhe potencialin e tyre për të kontribuar në të ardhmen, veçanërisht në kontekstin e dialogut që është duke vazhduar në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe në proceset e vazhdueshme të paqes.

## Metodologjia

Sikurse në të gjitha hulumtimet sociale, autorët e konsiderojnë të dobishme të fillohet duke u ofruar lexuesve përkufizimet e koncepteve dhe termave kryesorë të përdorur. Raporti u kushton vëmendje të veçantë grave të reja, ku "të rinjtë" përkufizohen si persona të moshës 15 deri në 29 vjeç.[25] Termi "grua e re", përkatësisht "vajzë", u referohet të rejave të moshës 15 deri 29 vjeç. Termi "të ndryshme" përdoret për të theksuar dallimet midis grave, duke përfshirë kryqëzimet e moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes gjeografike (përfshirë vendet rurale dhe urbane), aftësisë, identitetit gjinor, seksualitetit dhe statusit socio-ekonomik, ndër të tjera, që mund të nënkuptojë se gratë kanë përvoja të ndryshme, qasje të ndryshme në burime, dhe rrjedhimisht edhe nevoja të ndryshme. Për qëllimet e këtij hulumtimi, periudha e "konfliktit" u definua periudha 1989-1998; lufta ndodhi gjatë viteve 1998-1999; ndërsa periudha e "pasluftës" nga 1999 e këtej. Ekipi është i vetëdijshëm që konflikti ka ekzistuar shumë më herët, dhe që, për disa, edhe sot vazhdojnë forma të ndryshme të konfliktit.[26] Të gjitha referencat për "shqiptar" ose "serb" i referohen përkatësisë etnike të personave që jetojnë në zonën gjeografike të Kosovës dhe jo shtetësisë së Shqipërisë ose Serbisë, përveç nëse theksohet ndryshe. "Shtetas i Serbisë" i referohet qytetarëve të Serbisë. "Patriarkalizëm", sipas Lerner, do të thotë "manifestimi dhe institucionalizimi i mbizotërimit mashkullor mbi gratë dhe fëmijët në familje dhe shtrirja e dominimit mashkullor mbi gratë në shoqëri në përgjithësi. Kjo do të thotë që burrat e mbajnë pushtetin në të gjitha institucionet e rëndësishme të shoqërisë dhe që gratë janë të privuara nga qasja në një pushtet të tillë."[27]

Ky hulumtim ka për qëllim t'i përgjigjej pyetjes së përgjithshme të hulumtimit: cilat kanë qenë rolet, kontributet dhe nevojat e grave, veçanërisht të vajzave, në lidhje me paqen dhe sigurinë gjatë proceseve të konfliktit, luftës dhe pasluftës në Kosovë? Kjo përfshinte përgjigjen ndaj nën-pyetjeve në vijim:

- Çfarë do të thotë "paqe" dhe "siguri" për gratë e ndryshme?
- Çfarë rolesh kanë luajtur OSHCG-të në përfshirjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së grave të reja në proceset e paqes dhe sigurisë?
- Cilat kanë qenë sfidat e përfshirjes së grave dhe vajzave në proceset e paqes dhe sigurisë, përfshirë proceset e negociatave dhe dialogut?
- Si ka kontribuar në rezultate deri më tani përfshirja ose mos përfshirja e grave dhe vajzave në dialogun Kosovë-Serbi?

---

[25] Eurostat, "Rinia - Pasqyrë". Koncepti i rinisë lidhet me kalimin nga fëmijëria në moshën madhore, kështu që është e vështirë të përcaktohet një moshë specifike. Ky proces ndryshon bazuar në faktorë kulturorë, psiko-socialë, politikë, ekonomikë dhe zhvillimorë (Singerman, 2007, Navtej dhe Yousef, 2009, cituar në UN Women, "Vajzat në paqe dhe siguri: Në kryqëzimin e Agjendave të RPS dhe GPS", f. 10-11.

[26] Shihni, për shembull, Malcolm, N., *Kosova: Një histori e shkurtër*, 1998.

[27] Lerner, G., *Krijimi i patriarkalizmit,* Vëll. 1, SHBA: Oxford University Press, 1986, f. 239.

- Si mund të angazhohen më shumë vajza në dialog dhe negociata në të ardhmen?

Hulumtimi ka përfshirë metoda të përziera, duke përfshirë rishikimin e të dhënave ekzistuese dhe literaturës; intervista ballë për ballë me burra dhe gra të ndryshme nga institucionet, politika dhe shoqëria civile; një anketë të grave përmes internetit, veçanërisht të vajzave; grupe fokusi me vajza në gjashtë komuna të Kosovës; dhe vëzhgimin e pjesëmarrëseve. Në hulumtim kanë marrë pjesë 266 vajza (mosha 15-29), 189 gra (mosha 30 e lart) dhe pesë burra, duke arritur në gjithsej 483 pjesëmarrës në hulumtim.[28]

Fillimisht, ekipi i ka shqyrtuar rezolutat më relevante të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS) dhe rininë, paqen dhe sigurinë (RPS), si dhe ligjet e Kosovës që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, paqen dhe sigurinë. Ekipi gjithashtu ka shqyrtuar literaturën akademike të disponueshme në internet në lidhje me agjendat e GPS-së dhe RPS-së. Shqyrtimi i literaturës dhe hulumtimi dokumentar ka përfshirë ekzaminimin e dokumenteve qeveritare, arkivave historikë, librave, artikujve akademikë, mbulimin mediatik, arkivat e historisë gojore dhe burime të tjera digjitale. Për tregimet e grave përkitazi me kontributin e tyre në paqe dhe siguri, ekipi u plotësua kryesisht nga puna ekzistuese e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) në *Histori është edhe tregimi i saj*, që ka përdorur metodologjinë e historisë gojore feministe për të dokumentuar tregimet e kontributit të grave në politika, shoqëri dhe ekonomi. Hulumtuesit gjithashtu morën materiale nga arkivat e Historisë Gojore të Kosovës.

Së dyti, ekipi përdori mostrimin e variacionit për të zgjedhur 53 të anketuar kryesorë të ndryshëm për intervista gjysmë të strukturuara.[29] U intervistuan burra dhe gra të ndryshme të moshave dhe etnive të ndryshme. Në mesin e pjesëmarrësve të hulumtimit kishte aktiviste për të drejtat e grave, gra në politikë, gra të prekura nga konflikti dhe përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ), të organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe të OSHC-ve. Mostra përfshinte gra që jetojnë në rajonet më të prekura nga konflikti. Dy anëtare të ekipit hulumtues zhvilluan secilën intervistë, ku njëra hulumtuese udhëhiqte intervistën ndërsa tjetra mbante shënime. Intervistat u regjistruan me pëlqimin gojor të të intervistuarve. Intervistat në gjuhën serbe u kryen nga një folëse që gjuhën serbe e kishte gjuhë amtare.

Së treti, hulumtueset përdorën "Survey Monkey" për administrimin e anketës elektronike në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Përmes kësaj është synuar që të mblidheshin pikëpamjet e grave të ndryshme nga të gjitha grupet etnike në lidhje me paqen dhe sigurinë, si dhe nevojat dhe pritjet e tyre nga dialogu në vazhdim e sipër midis Kosovës dhe Serbisë.[30] Anketa u promovua gjerësisht, duke përfshirë përmes mediave sociale dhe postës elektronike. Ajo ishte e hapur nga 6 shkurti deri më 3 mars 2020. Anketa kishte 221 femra të anketuara. Si një anketë në internet, gjetjet nuk janë statistikisht domethënëse ose përfaqësuese të pikëpamjeve të popullsisë. Prandaj, këto gjetje janë përfshirë si të dhëna cilësore.

Së katërti, hulumtuesit organizuan grupe fokusi me 130 vajza të ndryshme në nëntë komuna: Prishtinë, Fushë Kosovë, Gjakovë, Deçan, Skenderaj, Prizren, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, dhe Mitrovicë e Jugut. Grupet e fokusit u përpoqën të kuptonin më mirë pikëpamjet e grave të reja për paqen; si mund të kontribuojnë ato për paqen; dhe pritjet e tyre nga proceset e paqes.[31] Grupet e fokusit përfshinin vajza të përkatësive etnike të ndryshme: shqiptare, serbe, rome, ashkali, dhe egjiptiane. Grupet e fokusit në gjuhën serbe u udhëhoqën nga një folëse që gjuhë amtare e kishte gjuhën serbe.

Së pesti, organizatat anëtare të RrGK-së realizuan 79 intervista të shkurtra me gra (> 50) dhe vajza (> 10)

[28] 23 pjesëmarrës refuzuan të ndanin moshën e tyre.Shtojca 1 përmban informata demografike shtesë rreth pjesëmarrësve në hulumtim.

[29] Shih Shtojcën 2 për një shabllon të përgjithshëm të Udhëzuesit për Intervistë.

[30] Shih Shtojcën 3 për Anketën.

[31] Shih Shtojcën 4 për Udhëzuesin e Grupit të Fokusit.

me të cilat punojnë.[32] Këto intervista synonin të mblidhnin kontributin e grave në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ato u pyetën: Deri në çfarë mase mendoni se janë adresuar nevojat tuaja gjatë negociatave dhe dialogut; dhe nëse do të ishit ulur në tryezën e dialogut, për çfarë do të dëshironit të diskutohej?

Së gjashti, duke pasur parasysh që aktivistet dhe hulumtueset e RrGK-së kanë punuar në këtë fushë që nga miratimi i Rezolutës 1325, duke përfshirë pjesëmarrjen në një mori takimesh, konferencash dhe ngjarjesh mbi tema të ndryshme në lidhje me agjendat e GPS-së dhe RPS-së gjatë viteve, autoret janë bazuar në përvojat e tyre personale dhe në vëzhgimin e pjesëmarrësve, aty ku ka qenë e përshtatshme.

Ekipi hulumtues ka analizuar të dhënat e mbledhura në lidhje me pyetjet e hulumtimit. Të dhënat cilësore janë koduar për analizë, me qëllim të identifikimit të prirjeve dhe dallimeve. Të dhënat sasiore nga anketa në internet u analizuan duke përdorur "Survey Monkey" dhe "Microsoft Excel", por janë paraqitur si të dhëna cilësore. Sikurse te hulumtimi i bazuar, nën-seksionet në kuadër të kapitujve përqendrohen në temat dhe dimensionet kryesore që dolën nga hulumtimi.

Ekipi hulumtues kishte për synim të rrisë vlefshmërinë e gjetjeve përmes triangulimit të metodave, burimeve të të dhënave dhe hulumtueseve. Fakti që anëtaret e ekipit hulumtues përfshinin aktiviste të të drejtat e grave, si dhe gra dhe burra të rinj, ekipi solli përvoja, njohuri dhe kuptime të ndryshme në hulumtim. Kjo përfshinte njohuri të dorës së parë të përvojave dhe nevojave të vajzave, që potencialisht e ka rritur vlefshmërinë. Dallimet në perceptime ose përvoja, si dhe potenciali për gabime, janë raportuar. Kontrollet e pjesëmarrësve gjithashtu synonin të identifikojnë dhe të korrigjojnë çdo gabim të mundshëm para publikimit.

Lidhur me kufizimet e hulumtimit, sipas pyetjeve të hulumtimit, ky hulumtim u përqendrua tek gratë, rolet, kontributet dhe nevojat e tyre, prandaj ekipi kryesisht bisedoi me gratë. Pikëpamjet e burrave për këtë temë gjithashtu janë të rëndësishme dhe disa intervista kyçe u zhvilluan me burra të përfshirë në këto procese për të mbledhur përshtypjet e tyre; informacioni në lidhje me pikëpamjet e burrave gjithashtu është marrë nga literatura tashmë ekzistuese. Duke pasur parasysh kufizimet në burime dhe faktin që kontributet e grave gjatë viteve 1990-ta tashmë janë dokumentuar diku tjetër,[33] hulumtimi përmbledh, por nuk shtjellon kontributet kryesore gjatë viteve 1990-ta. Ndërsa janë bërë përpjekje për të përmendur me emër kontributet e grave të ndryshme në paqe dhe siguri, autorët pranojnë se shumë gra të tjera mund të kenë kontribuar, emrat e të cilave nuk u identifikuan përmes këtij hulumtimi. Atyre, autorët u kërkojnë falje përzemërsisht. Përkundër përpjekjeve, edhe disa ngjarje që kanë ndodhur mund të mos përfshihen për shkak të mungesës së informacionit.

## Pasqyra e përmbajtjes së raportit

Kapitulli i parë shqyrton pikëpamjet se si gratë e ndryshme e përkufizojnë dhe përjetojnë paqen dhe sigurinë. Kapitulli i dytë paraqet rolet dhe kontributet e grave për paqen dhe sigurinë. Nën-pjesët e kapitullit të dytë u referohen dimensioneve kryesore të kontributeve të tyre që kanë dalë nga hulumtimi. Kapitulli i tretë shtjellon sfidat për pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes, me nën-pjesët që korrespondojnë gjithashtu me çështjet kryesore që kanë dalë nga hulumtimi. Raporti përfundon me rekomandime specifike për aktorët përkatës drejt rritjes së pjesëmarrjes së grave, dhe veçanërisht të vajzave, në proceset e paqes. Shtojcat 1-4 ofrojnë informata të mëtejshme në lidhje me metodologjinë, ndërsa Shtojca 5 përshkruan kornizën përkatëse ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare përkitazi me pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes dhe sigurisë në Kosovë.

[32] 19 të anketuar shtesë preferuan të mos e japin moshën e tyre.

[33] Për një histori më gjithëpërfshirëse të kontributeve të grave, shih Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), *Histori është edhe tregimi i saj: Historia e grave në shoqërinë civile në Kosovë 1980-2004*, 2008.

# Kapitulli I. Si e përkufizojnë gratë në Kosovë paqen dhe sigurinë?

Ky kapitull i përgjigjet pyetjes nën-hulumtuese: çfarë do të thotë "paqe" dhe "siguri" për gratë e ndryshme? Konceptualizimet dhe interpretimet e "paqes" dhe "sigurisë" ndryshojnë. Në varësi të kontekstit dhe personit, këto terme mund të kenë një larmi kuptimesh. Është e rëndësishme të kuptohet se çfarë domethënie kanë këto terme për njerëzit e prekur nga proceset e paqes, veçanërisht kur diskutohen hapat e kërkuar për të vendosur paqen dhe sigurinë e qëndrueshme. Kështu, ky kapitull rishikon literaturën ekzistuese në lidhje me këto koncepte kryesore dhe pastaj diskuton se çfarë do të thotë paqe dhe siguri për gratë e ndryshme në Kosovë, përfshirë vajzat në mënyrë specifike. Pjesa e parë diskuton paqen, pjesa e dytë sigurinë dhe pjesa e tretë opinionet e ndryshme të grave në lidhje me atë që do ta bënte Kosovën më paqësore dhe të sigurt.

## Përkufizimi i paqes

Kjo pjesë shtjellon përkufizimet e ndryshme të grave për paqen në Kosovë, duke e kontekstualizuar këtë brenda kornizës së hulumtimeve dhe mendimeve më të gjera mbi këtë term, përfshirë pikëpamjet feministe për paqen. Paqja përjetohet nga njerëzit dhe prandaj mund të përjetohet ndryshe dhe subjektivisht. Individët, familjet, grupet, komunitetet dhe kombet përjetojnë dhe krijojnë paqe në mënyra të ndryshme, me marrëdhënie të ndryshme ndërsektoriale. Në një sistem shoqëror, sipas Anderson, ky fenomen varion nga një paqe ekologjike në makro-nivel deri te paqja personale, e brendshme në mikro-nivel individual (Figura 1).[34]

**Figura 1. Kontekstet e Paqes**




Burimi: Anderson

[34] Anderson, R., "A Definition of Peace" (Një Përkufizim i Paqes), *Peace and Conflict: Journal of Peace Psychology*, 10 (2), 2004, f. 101–116.

Sipas Galtung dhe Fischer, koncepti i paqes përfshin mungesën e të gjitha dimensioneve të dhunës, përfshirë dhunën e drejtpërdrejtë, strukturore dhe kulturore.[35] Ata i referohen mungesës së këtyre formave të dhunës si "paqe negative", një situatë në të cilën nuk ekziston as dhuna dhe as "paqja pozitive". Koncepti i paqes negative nënkupton mungesën e dhunës së drejtpërdrejtë, siç janë vrasjet masive; dhuna strukturore, siç është dhuna që rezulton nga pabarazitë; dhe dhuna kulturore, siç është justifikimi i formave të tjera të dhunës.[36] Ndërkohë, sipas Galtung dhe Fischer, "paqja pozitive" kërkon "praninë e bashkëpunimit, paanësisë, barazisë, kulturës së paqes dhe dialogut". Prandaj, koncepti i paqes mund të kuptohet si shumë e paqes negative dhe pozitive.[37] Confortini i ka lidhur këto koncepte të dhunës kulturore dhe të drejtpërdrejtë me patriarkalizmin dhe seksizmin; në shumë kultura, dominimi i burrave mbi gratë legjitimohet, përfshirë përmes dhunës së drejtpërdrejtë, dhe "burrat, në vend se gratë, kryejnë shumicën dërrmuese të veprimeve të drejtpërdrejta të dhunshme".[38] Në të vërtetë, disa akte dhune, si dhuna në familje që kryhet kryesisht nga burrat, ndodhin edhe në situata që disa njerëz mund t'i konsiderojnë paqësore, nëse e përcaktojnë paqen thjesht si mungesë lufte.

Kështu, teoricienët feministë kanë kritikuar nocionet tradicionale të paqes si mungesa e konfliktit të armatosur ose luftës, duke argumentuar se ky përkufizim rrjedh nga një perspektivë mashkullore e paqes.[39] Chinkin dhe Charlesworth kanë vërejtur se e ashtuquajtura paqe pas luftës nuk mund të përfshijë domosdoshmërisht paqe për gratë; edhe mes armëpushimeve, dhuna ndaj grave vazhdon.[40] Termi i Fanon "shkelje paqësore", sipas Shroff, "mund të kuptohet si rregullimi dhe normalizimi i dhunës", në vend të mungesës së dhunës.[41] Kështu që, koha e paqes nuk përfshin domosdoshmërisht fundin e dhunës, por kontroll më të mirë të saj përmes ligjeve, rregulloreve dhe programeve që kërkojnë të adresojnë dhunën.[42] Për më tepër, konflikti ekziston në çdo shoqëri dhe ndodh kur njerëzit ose grupet shoqërore kërkojnë ose perceptojnë qëllime të kundërta, pohojnë vlera kontradiktore ose kanë interesa të ndryshme.[43] Kështu, përfundimi i një konflikti ose lufte të veçantë nuk do të thotë domosdoshmërisht mbërritje të paqes; shpesh mbetet një mungesë e konsensusit politik dhe besimit dhe shkaqet kryesore të konfliktit mund të vazhdojnë. Mund të ketë gjithashtu tensione të rritura ndërsa njerëzit kthehen në shtëpitë e shkatërruara ose të okupuara.

Fondacioni Kvinna till Kvinna ("Kvinna till Kvinna", ose Gruaja për Gruan në Shqip), një organizatë suedeze feministe për paqen, zbuloi në raportin e saj të fundit mbi zbatimin e RKSKB 1325 se pjesëmarrësit përgjithësisht e kuptonin paqen në përputhje me këto koncepte më të gjera të paqes, dhe Agjendën e GPS. Ata menduan se paqja përfshinte liritë e shumta, siç janë liria e zgjedhjes, komunikimit dhe lëvizjes.[44] Në një studim global të UNFPA dhe PBSO, përtej mungesës së dhunës, përkufizimi i paqes përfshiu zgjidhjen e shkaqeve të mundshme themelore të dhunës, si korrupsioni, pabarazia dhe mungesa e drejtësisë.[45]

---

[35] Galtung, J. dhe Fischer, D., "Positive and Negative Peace" (Paqja pozitive dhe negative), *SpringerBriefs on Pioneers in Science and Practice*, Vëllimi 5, Berlin, Heidelberg: 2013, f. 173

[36] Po aty.

[37] Po aty, f. 173-174.

[38] Confortini, C.C.,"Galtung, Violence, and Gender: The Case for a Peace Studies/Feminism Alliance" (Galtung, Dhuna dhe Gjinia: Rasti për një Aleancë Studimesh të Paqes/Feminizmit", *Peace Change*, 31 (3), 2006, f. 340

[39] Reardon, B.A., "Key Texts in Gender and Peace" (Tekstet kryesore në gjini dhe paqe), f. 65

[40] Chinkin, C., dhe Charlesworth, H., "Building Women into Peace: the international legal framework" (Ndërtimi i Grave në Paqe: korniza ligjore ndërkombëtare), *Third World Quarterly*, Vëllimi 27, Numër 5, korrik 2006, f. 941.

[41] Shroff, S., citon Fanon, *The Wretched on Earth* in "The Peace Professor, Decolonial, Feminist, and Queer Futurities" në Groarke, EBM, dhe Welty, E., *Peace and Justice Studies: Critical Pedagogy* (*Studime për Paqen dhe Drejtësinë: Pedagogjia Kritike)* (Ed. 1), 2018.

[42] Për shembull, shihni RrGK raportet në lidhje me dhunën ndaj grave në Kosovë.

[43] Mesa, M., CEIPAZ, Fondacioni Kultura e Paqes, "Paqja dhe siguria", n.d., f. 1

[44] Fondacioni Kvinna till Kvinna, *E drejtë jo dhuratë*, 2020, f. 23

[45] UNFPA dhe PBSO, "Paqja që mungon", 2018, f. 35-36.

# Reflektimet e grave mbi paqen

"Unë isha fëmijë kur ishim pjesë e Jugosllavisë. Më vonë, ndihesha e kërcënuar gjatë gjithë kohës vetëm sepse isha një grua shqiptare. Në fund të luftës, kuptova që jeta ime në Kosovë nuk kishte qenë kurrë e qetë për shkak të dhunës policore ose politikës."

**Grua shqiptare, Prishtinë**

"Paqja për mua është liria e fjalës, liria e lëvizjes, qasja në arsim. Nuk mund të ketë një përparim në shoqëri pa këto gjëra."

**Grua serbe, Novobërdë**

"Paqja për mua është kur të gjithë janë në gjendje të flasin lirshëm, ku të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta, pavarësisht nga gjinia."

**Vajzë rome, Prizren**

"Gjithçka ka të bëjë me lirinë. Nëse jeni të lirë do të keni paqe dhe siguri."

**Vajzë shqiptare, Deçan**

"Për një kohë shumë të gjatë ishte mungesa e luftës. Nuk e kam ndjenjën se mbaroi. Ne kemi Serbinë, e cila nuk na njeh, por gjithashtu po lobon kundër nesh."

**Grua shqiptare, Prishtinë**

"Paqja nuk është vetëm mungesë e luftës. Unë do ta përkufizoja paqen si paqe sociale; nuk mund të kesh paqe pa përfshirje."

**Vajzë shqiptare, Prishtinë**

"Kur nuk keni paqe të brendshme, nuk mund të kërkoni paqe ndërkombëtare."

**Vajzë shqiptare, Prishtinë**

"Paqja është një gjendje shoqërore e grave dhe burrave që ndihen rehat, të padisiplinuar dhe të pakontrolluar për të shprehur mendimin e tyre, për të ekzistuar."

**Grua shqiptare, Prishtinë**

Në Kosovë, siç ilustrohet nga “Reflektimet e Grave mbi Paqen”, koncepti i paqes ndryshonte për ata që kishin përjetuar luftën dhe dhunë masive personalisht, dhe për ato që nuk kishin përjetuar luftën, veçanërisht vajzat që kanë lindur pas luftës. Gratë që kishin provuar luftën personalisht kishin më shumë të ngjarë ta përcaktonin paqen si mungesën e luftës. Ato folën për paqen në kontekstin e Andersonit të paqes së brendshme dhe ndërkombëtare, si paqe midis Kosovës dhe Serbisë. Vajzat kanë prirjen të përcaktojnë paqen më gjerësisht dhe ngjashëm me përkufizimet feministe të lartpërmendura të paqes si paqja personale, e brendshme dhe paqja midis individëve. Gratë e të gjitha brezave e lidhën paqen me respektimin e të drejtave të njeriut, lirinë e lëvizjes, lirinë e fjalës dhe të drejtat gjuhësore, ndër të tjera, të cilat lidhen me paqen shoqërore, ndërkulturore të Andersonit, ndër të tjera.

Ndërsa të gjitha gratë pjesëmarrëse në hulumtim kishin tendencë të lidhnin paqen me paqen midis Kosovës dhe Serbisë, vajzat, veçanërisht në komuna multi-etnike si Mitrovica Veriore, Mitrovica Jugore, Graçanica dhe Prizreni, diskutuan për paqen në lidhje me marrëdhëniet e lokalizuara ndëretnike. Një e re serbe në Mitrovicën e Veriut komentoi, “Ne, të rinjtë, ndërveprojmë me njëri-tjetrin... Njerëzit janë njerëz”.[46] Një grua e re shqiptare në Skenderaj në mënyrë të ngjashme komentoi, “Duke qenë të vetëdijshme për faktin se jetojmë në një vend pas konfliktit, ne tashmë duhet ti kapërcejmë pengesat serbo-shqiptare. Për mua, pengesa e vetme me komunitetin serb është gjuha e tyre, të cilën unë nuk di ta flas. Sidoqoftë, ne kemi të gjitha gjërat e tjera të përbashkëta”.[47] Kësisoj, lidhur me kontekstet e paqes së Andersonit, përtej paqes kombëtare dhe ndërkombëtare, vajzat iu referuan paqes lokale, civile brenda komunitetit të tyre; paqes sociale, ndërkulturore midis grupeve shoqërore si serbët, shqiptarët dhe grupet e tjera etnike; dhe paqes ndërnjerëzore midis individëve.

Pjesëmarrësit e hulumtimit kanë prirjen të mos e përcaktojnë paqen në një kontekst ekologjik, siç është koncepti i lartpërmendur i Andersonit për “paqen Gaia” dhe marrëdhëniet njerëzore me natyrën. Përjashtimisht, një profesoreshë në Universitetin e Prishtinës e përcaktoi paqen si një ekuilibër dhe harmoni midis njerëzve dhe natyrës. Sipas saj, paqja lidhet me qasjen në ujë, ajër dhe kushtet themelore të jetesës. Paqja është një filozofi për të jetuar në harmoni me njëri-tjetrin dhe natyrën, tha ajo.[48]

Duke marrë parasysh që përkufizimet e grave për atë që përbën paqen ndryshuan, gratë u pyetën nëse paqja ekziston sot në Kosovë. Ndërsa gratë kishin perceptime të ndryshme, një temë e përsëritur në mesin e pjesëmarrësve në hulumtim ishte se në Kosovë ende nuk ka paqe. Sipas gjetjeve ilustruese, megjithëse jo të përgjithësueshme, 24% e 221 grave të anketuara nuk mendonin se Kosova është paqësore. Ndërkohë, mungesa e paqes në Kosovë gjithashtu ishte një temë e përsëritur në mesin e pjesëmarrësve në grupe të fokusit dhe të intervistave (shih “A ekziston paqja në Kosovë?”).

[46] Grupi i fokusit me gra të reja në Mitrovicë.

[47] Grupi i fokusit me gra të reja në Skenderaj.

[48] Intervistë e RrGK-së me një profesoreshë në Universitetin e Prishtinës, 2020.

# A ekziston paqja në Kosovë?

"Ne nuk mund të themi se jemi në paqe, pasi kemi mungesë të zbatimit të ligjeve. Institucionet publike nuk po sigurojnë paqe"

**Vajzë shqiptare me shikim të dëmtuar, Prishtinë**

"Mendoj se nuk është paqësore sepse i nënshtrohem një mentaliteti patriarkal ku përballem me paragjykime në lidhje me zgjedhjet e mia pasi ato lidhen me gjininë time. Unë nuk shoh paqe këtu, pasi Kosova gjithashtu karakterizohet nga pabarazia sociale. Nuk ka paqe sepse nuk ka mundësi të mjaftueshme për të rinjtë për të punuar. Kjo çon në depresion dhe probleme serioze të shëndetit mendor."

**Vajzë shqiptare, Prishtinë**

"Kur them paqe, mendoj për qetësinë. Do të doja të zgjohesha në mëngjes pa menduar se çfarë do të ndodhë sapo të largohem nga shtëpia, të mos shqetësohem nëse do të ketë ndonjë lloj incidenti apo diçka të tillë."

**Vajzë serbe, Graçanicë**

Në mesin e grave, vajzat serbe kanë tendencë të mos ndjejnë se Kosova është paqësore për shkak të asaj që u është thënë të besojnë shoqërisht. Një vajze e anketuar në sondazh shkruajti: "Nuk ndihem shumë e sigurt të shkoj në Prishtinë ose më tej [në jug]. Unë ende ndiej urrejtje për [atë që ndodhi] në vitin '99. Ka përjashtime natyrisht, por unë ende nuk do të rrezikoja të largohesha nga [veriu]."Disa gra serbe, posaçërisht nga veriu i Kosovës dhe Graçanica, kishin frikë për sigurinë e tyre në zonat jugore të Kosovës. Gjithashtu, situata politike nuk kontribuoi në ndjenjat e paqes, thanë ato, sepse gjithçka që ato dëgjojnë sillet rreth politikës së lartë, por jo nevojave të tyre reale. "Politikanët vazhdimisht alarmojnë publikun me deklaratat e tyre [...] veçanërisht deklarata që janë të pasakta si nga pala serbe ashtu edhe nga ajo shqiptare", shkroi një tjetër grua e re. Mungesa e sundimit të ligjit gjithashtu kontribuoi në një atmosferë jo paqësore, thanë të anketuarat. Disa përmendën gjithashtu qasjen e dobët në arsim dhe lirinë e pamjaftueshme të lëvizjes si çështje që dëmtojnë paqen.

Bisedat në grupe fokusi konfirmuan gjetjet e sondazhit. Pjesëmarrësit thanë se nuk kishte paqe në Kosovë për shkak të: korrupsionit; pasigurisë për shqiptarët për të udhëtuar dhe jetuar në Mitrovicën e Veriut; niveleve të larta të papunësisë; sistemit të dobët të kujdesit shëndetësor; marrëdhënieve të tensionuara ndëretnike; dhe tensioneve të përgjithshme të vazhdueshme midis Kosovës dhe Serbisë. Ato gjithashtu përmendën të drejtat e pabarabarta të trashëgimisë, ngacmimet seksuale në rrugë, ngacmimet seksuale në punë, drogën dhe alkoolin në shkollë, dhe ngacmimet në shkollë si arsye pse ato nuk mendojnë se paqja ekziston në Kosovë. Veçanërisht gratë e reja thanë se shqetësime të tilla të përditshme minojnë paqen.

Për vajzat, mungesa e tyre e "paqes së brendshme" rrjedh nga "mendësia patriarkale" në Kosovë, e cila, siç thanë ato, i shtyn gratë të bëjnë zgjedhje me të cilat nuk pajtohen. Pjesëmarrësit e hulumtimit deklaruan se u është dashur të bëjnë zgjedhje bazuar në pritjet shoqërore, sesa në bazë të përparësive të tyre personale. Kjo ka çuar në çështje të shëndetit emocional dhe mendor, thanë ato. Për këto vajza, pa paqe të brendshme që buron nga autonomia e tyre, Kosova nuk mund të jetë paqësore, thanë ato.

Si përfundim, përkufizimet dhe përvojat e grave për paqen ndryshojnë, veçanërisht në lidhje me moshën, etninë dhe përvojat personale të konfliktit. Në Kosovë, në lidhje me konceptimin e paqes nga Anderson, gratë e përcaktojnë paqen në terma të paqes personale, ndërpersonale, shoqërore, lokale, kombëtare, ndërkombëtare dhe, në një rast, ekologjike. Fakti që përkufizimet e tyre për paqen ndryshojnë do të thotë se kanë mendime të ndryshme nëse ekziston paqja në Kosovë. U morën disa shembuj të mungesës së paqes.

## Përkufizimi i sigurisë

> "Siguria e vërtetë nuk mund të arrihet derisa strukturat e pabarabarta të pushtetit të gjinisë, racës dhe klasës të eliminohen ose të paktën të zvogëlohen."
>
> **Tickner, 1992**

Kjo pjesë shqyrton përkufizimet e grave për sigurinë, duke i kontekstualizuar këto brenda diskutimeve më të gjera ndërkombëtare dhe feministe mbi sigurinë. Ekzistojnë përkufizime të ndryshme të "sigurisë". Tradicionalisht, sipas Tickner, "siguria" është kuptuar në "terma politik/ushtarak, si mbrojtja e kufijve dhe integritetit të shtetit dhe vlerave të tij kundër rreziqeve të një mjedisi armiqësor ndërkombëtar".[49] Ky nocion "neoliberal" i sigurisë u përqendrua në sigurinë kombëtare, duke përfshirë mbrojtjen ushtarake të sovranitetit dhe integritetit

[49] Tickner, J. A., "You Just Don't Understand: Troubled Engagements between Feminists and IR Theorists", International Studies Quarterly, Vëllimi 41, Nr. 4., 1997, f. 624.

territorial të shtetit kundër agresionit të jashtëm.[50] Duke filluar nga vitet 1970, ky përkufizim i sigurisë u përball me kritika në rritje. Së pari, u mblodhën provat se siguria nuk mund të përcaktohej vetëm në kushtet e sovranitetit të shtetit; kërcënimet e sigurisë që nuk kanë lidhje me shtetet ekzistojnë brenda shteteve dhe rreziqet e sigurisë transnacionale morën vëmendje në rritje, të tilla si kërcënimet mjedisore, krimi i organizuar dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.[51] Së dyti, një qasje e përqendruar te shteti për sigurinë nuk siguronte domosdoshmërisht siguri, ose mirëqenie, për të gjithë qytetarët e ndryshëm të një shteti. Në fund të viteve 1980, studiuesit feministë po përkufizonin paqen dhe sigurinë përmes një pikëpamjeje gjinore.[52]

"Gratë do të ishin më të sigurta nëse do të punësoheshin."

**Aktiviste, Prishtinë**

Në vitin 1994, duke nxjerr mësime nga puna e Amartya Sen, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) miratoi konceptin e "sigurisë njerëzore".[53] Përtej sigurisë kombëtare, siguria njerëzore përfshin sigurinë e punës, sigurinë e të ardhurave, sigurinë shëndetësore, sigurinë mjedisore dhe sigurinë nga krimet.[54] Aktivistët e të drejtave të grave në mënyrë të ngjashme kanë përcaktuar sigurinë në drejtim të sigurisë njerëzore, duke përfshirë drejtësinë gjinore.[55]

Në Kosovë, përkufizimet e grave për sigurinë ndryshuan, veçanërisht kur krahasohen gratë që kanë përjetuar luftë dhe vajzat që nuk e kanë përjetuar atë drejtpërdrejt. Dallime ekzistuan gjithashtu midis grave të reja me aftësi të ndryshme dhe grave nga grupe të ndryshme etnike. Aktivistet krahasimisht më të moshuara për të drejtat e grave në shoqërinë civile dhe politikë tentuan të përkufizojnë sigurinë si mungesë dhune, duke e lidhur sigurinë me lirinë: lirinë e fjalës dhe lirinë e lëvizjes. Në përputhje me përkufizimet e sigurisë njerëzore, ato gjithashtu folën për sigurinë financiare, sigurinë e ushqimit dhe kontrollin mbi burimet natyrore si uji dhe mineralet. Kjo, thanë ato, do të rriste sigurinë e grave.

Përtej këtyre, vajzat kishin tendencë të lidhnin sigurinë me sigurinë fizike gjithashtu.[56] "Ne nuk kemi as drita të rrugëve. Është terr i zi si kur shkojmë në shkollë ashtu edhe kur kthehemi në shtëpi nga shkolla", thanë shumë të reja nga Gjakova, Mitrovica Veriore, Prizreni dhe Graçanica.[57] Për to, siguria nënkuptonte të ndiheshin të sigurta kur udhëtonin në shtëpi natën. Ato i atribuuan ngacmimet seksuale ndriçimit të dobët të rrugës, duke deklaruar se kjo i pengonte ato të dilnin jashtë pasi të errësohej. Ato thanë se thirrjet ngacmuese seksuale, ngacmimet seksuale dhe frika e përdhunimit nëse dilnin natën i kanë bërë të ndjehen të pasigurta. Një grua e re serbe nga Graçanica komentoi:

Ne jetojmë në një shoqëri ku është e pamundur të ndihesh 100% e sigurt. Burrat shqiptarë nuk janë problemi i vetëm. Shumë burra serbë të dehur na bëjnë thirrje ngacmuese seksuale, dhe ne kurrë nuk e dimë nëse do të na përdhunojnë, sepse ata munden. Pra, ne nuk e kemi atë problem vetëm me shqiptarët, por edhe me njerëzit e fesë dhe etnisë sonë.

Ky ishte një shqetësim i përsëritur për vajzat në Kosovë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike ose

---

[50] Mesa, M., CEIPAZ, Fondacioni Kultura e Paqes," Paqja dhe siguria", n.d., f. 2-3.

[51] Po aty.

[52] Tickner, J. A., "Peace and Security from a Feminist Perspective" (Paqja dhe siguria nga një perspektivë feministë), *The Oxford Handbook of Women, Peace, and Security,* 2018, f. 13

[53] UNDP, *Raporti i Zhvillimit Njerëzor*, 1994

[54] Po aty.

[55] Fondacioni Kvinna till Kvinna, *E drejtë, jo dhuratë*, 2020, f. 23

[56] Grupi i fokusit me gra të reja nga Gjakova, Mitrovica Veriore, Prizreni dhe Graçanica.

[57] Po aty.

vendndodhja gjeografike. Edhe kur rrethohen nga rrezet e diellit, ekspozimi ndaj thirrjeve ngacmuese seksuale bën që vajzat të ndjehen të kërcënuara çdo ditë, thanë ato. "Ju nuk mund të ecni lirshëm në rrugë pa u thirrur me fjalë ngacmuese seksuale", komentoi një vajzë rome nga Prizreni. Gratë rome në Fushë Kosovë thanë se përballeshin me vështirësi të ngjashme: "[Burrat] ndaluan veturën e tyre para meje dy herë, duke u përpjekur të më fusnin brenda," tha një vajzë. "Kisha frikë t'i tregoja babait tim për këtë pasi ai kurrë nuk do të më linte të dilja përsëri. Dhe kjo ndodhi gjatë ditës." Një ngacmim i tillë seksual, si dhe dhuna, kontribuan në pasiguri të shumta për vajzat rome. Nëse përballen me thirrje ngacmuese seksuale, zakonisht fajësohen ato, në vend se të fajësohen autorët; kjo, nga ana tjetër, mund të çojë në martesë të hershme të nxitur nga prindërit e tyre dhe mohim të së drejtës së tyre për të marrë një arsimim, thanë ato.[58] Megjithëse Ligji për Familje ndalon martesën e personave nën moshën 18 vjeç,[59] martesa e hershme vazhdon të paraqesë një rrezik sigurie, veçanërisht për vajzat rome, ashkali dhe egjiptiane.

Disa vajza gjithashtu lidhnin pasigurinë me dallimet gjuhësore, ku shqiptarët dhe serbët e Kosovës mund të mos e kuptojnë njëri-tjetrin. "Nuk e di se çfarë po thotë kur po më bën thirrje ngacmuese seksuale. Unë nuk e kuptoj gjuhën", tha një vajzë serbe nga Graçanica. Kjo mungesë mirëkuptimi kontribuoi në frikë dhe pasiguri, ajo vazhdoi: "Ndoshta ai dëshiron të më tërheqë në veturën e tij dhe të më çojë zoti e di se ku." Kësisoj, mosnjohja e gjuhës, për disa, ishin burim i pasigurisë, veçanërisht kur shoqëroheshin me ngacmime seksuale.

Ndërkohë, gratë që përkufizonin sigurinë si liri të lëvizjes prireshin të ishin gra serbe që jetonin në fshatra me shumicë të popullsisë serbe. Mungesa e transportit publik të qasshëm preku veçanërisht vajzat serbe, pasi ato përballeshin me ngacmime seksuale ndërsa ecnin disa orë për në shkollë. Kjo i ekspozoi ato ndaj rrezikut nga autorët e mundshëm të ngacmimeve. Diskutimet me vajzat serbe sugjeruan që këto dhe fenomene të tjera që i bëjnë ato të ndjehen të pasigurta nuk kanë lidhje me përkatësinë etnike të autorit të krimit: "Kur bëhet fjalë për rrëmbim dhe përdhunim, kjo mund të ndodhë edhe në Beograd ashtu si mund të ndodhë këtu," tha një vajzë serbe nga Graçanica.

Vajzat me aftësi të ndryshme diskutuan gjithashtu pasiguritë në lidhje me lëvizjen, veçanërisht për njerëzit që përdorin karrocat invalidore. Trotuaret janë të panivelizuar, mungon trotuari ose janë të mbushur me mbeturina, ndërsa rruga është e mbushur me trafik, thanë ato. Lëvizja e penguar paraqet një pengesë për angazhimin e tyre në shoqëri dhe qasjen në proceset e vendimmarrjes, duke kontribuar në pasiguri. Zbatimi i dobët i ligjeve ekzistuese dhe mungesa e mbështetjes nga institucionet publike gjithashtu kontribuojnë në pasiguri, thanë ato.

Në lidhje me sigurinë njerëzore, vajzat iu referuan shkallës së lartë të papunësisë dhe mungesës së mundësive për të rinjtë. Në të vërtetë, shumë të rinj po emigrojnë, veçanërisht për shkak të standardeve të ulëta të jetesës në Kosovë dhe mungesës së mundësive për punëtorë me kualifikim të lartë.[60] Në vitin 2019, rreth 34,911 persona nga Kosova emigruan legalisht ose ilegalisht.[61] Disa pjesëmarrës në hulumtim shprehën shqetësimin se njerëzit nga Kosova që kanë studiuar mjekësi po emigrojnë, gjë që mund të rrezikojë sigurinë e ardhshme të personave që ende jetojnë në Kosovë: "Shkalla e lartë e papunësisë dhe fakti që njerëzit po largohen nga Kosova më bën të pyes veten nëse do të kemi mjekë 30 vjet e ardhshme. Kjo më bën të ndihem e pasigurt", tha një vajzë rome nga Prizreni.

Në përgjigje të anketës jo-përfaqësuese në internet, 39% e grave nuk ndjeheshin se në Kosovë ka siguri. Të anketuarat shqiptare dhanë disa arsye politike dhe sociale se pse ndiheshin të pasigurta. Arsyet politike përfshinin: përgjegjësinë e pamjaftueshme nga institucionet publike; funksionimin e dobët të organeve të sigurisë; mos zbatimin e ligjeve ekzistuese; korrupsionin dhe nepotizmin; dhe performancën e dobët të gjyqësorit. Gratë shqiptare

[58] Grupi i fokusit me gratë e reja rome, ashkali dhe egjiptiane në Prizren.

[59] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Familjen Nr. 2004/32, Neni 15.2

[60] UNDP, Analiza e Pulsit Publik: Korrelacioni ndërmjet tregut të punës në Kosovë dhe migrimit jashtë, 2020, f. 1

[61] Agjencia e Statistikave të Kosovës," Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës në 2019", Prishtinë: qershor, 2020.

shprehën shqetësimin se Kosova mund të sulmohet nga Serbia, gjë që i bëri ato të ndihen të pasigurta. Të anketuarit përshkruan gjithashtu disa pasiguri sociale: arsimi me cilësi të dobët; pasiguria ekonomike; rreziqet me të cilat përballen gratë nëse dalin jashtë shtëpive të tyre natën; dhuna ndaj grave, e tillë si burrat që vrasin gratë e tyre (dhe mostrajtimi i duhur i këtyre rasteve nga institucionet); dhe ngacmimet dhe sulmet ndaj LGBTQIA dhe personave me identitete të tjera (LGBTQIA +).

Vajzat shtjelluan çështjen e mungesës së mbrojtjes nga institucionet e sigurisë si minim të sigurisë së tyre. Vajzat thanë se përballeshin me sfida në raportimin e ngacmimeve seksuale në polici. Kur raportonin një krim në stacionin e policisë, vajzat thanë se ato shpesh pyeteshin se çfarë kishin veshur në atë kohë. Për shembull, një vajzë nga Mitrovica e Jugut tha se kur raportoi një burrë që e ndiqte atë në rrugë për një kohë të gjatë, zyrtari i policisë tha: "Ndoshta ai është personi me të cilin do mund të ishe!" Për më tepër, policia kërkoi prova të ngacmimit seksual dhe ato është e vështirë të sigurohen, thanë ato. Vajzat serbe në Mitrovicë Veriore në mënyrë të ngjashme thanë se policia zakonisht nuk reagojnë menjëherë ndaj rasteve që ato i raportojnë, dhe nuk besojnë se policia do t'i ndihmojë nëse diçka ndodh. Policia, thanë ato, madje mund të jetë dëshmitare e thirrjeve ngacmuese seksuale ose ngacmimit seksual, por ata i injorojnë. "Nëse do të sulmohesha në publik nesër, policia vetëm do ta vëzhgonte", tha një grua e re nga Mitrovica e Veriut. Ato ndjenin se institucionet e sigurisë nuk dinë si të merren me dhunën në familje ose me ngacmimet seksuale.

Vajzat në të gjithë Kosovën ngritën shqetësime në lidhje me nepotizmin në institucionet publike. Kryesit e veprave mund të gjejnë dikë që njohin në institucion dhe të shmangin dënimin, thanë ato. "Ne nuk u besojmë institucioneve", tha një grua e re nga Graçanica. "Çdo gjë në institucione bazohet me lidhje personale. Nëse raportojmë [ngacmim seksual dhe dhunë seksuale], ato raportime mund të na bëjnë të dukemi fajtore. Ka shumë tepër raste të pazgjidhura që ne t'u besojmë institucioneve. "Kësisoj, mungesa e besimit në institucione kontribuoi në pasiguritë shtesë për gratë e reja të të gjitha etnive në të gjithë Kosovën; ato nuk besuan se duke raportuar krimet ose kërcënime ndaj sigurisë së tyre do të pranonin ndonjë ndihmë.

Si përfundim, ndërsa përkufizimet e ndryshme të grave për sigurinë ndryshonin, ekzistonte një tendencë për të diskutuar mbi sigurinë në drejtim të sigurisë njerëzore, veçanërisht te gratë e reja. Gratë shtjelluan disa arsye pse nuk besojnë se Kosova është e sigurt, disa prej të cilave kishin të bënin me pasigurinë ekonomike, dhunën me bazë gjinore, institucionet e dobëta dhe infrastrukturën e dobët.

## Çfarë do ta bënte Kosovën më paqësore dhe më të sigurt?

Kjo pjesë paraqet gjetje se çfarë besojnë gratë që mund ta bëjnë Kosovën më paqësore dhe më të sigurt. Një temë e përsëritur ishte trajtimi i së kaluarës, drejt paqes së qëndrueshme. Vajzat, veçanërisht shqiptare, thanë se do ta shtronin këtë çështje, ndër të tjera, gjatë dialogut midis Kosovës dhe Serbisë.[62] Gratë serbe dëshironin stabilitet politik, të drejta gjuhësore dhe të bënin një jetë të qetë dhe të sigurt në Kosovë. Ato gjithashtu dëshironin hapësirë për t'u angazhuar në dialogun Kosovë-Serbi dhe një vend në tryezën e vendimmarrjes. Ato shpresojnë të përfundojë dialogu sa më shpejt të jetë e mundur, drejt vendosjes së paqes dhe sigurisë në Kosovë.

Më gjerë, dhe në përputhje me reflektimet e grave për sigurinë njerëzore, gratë folën për zhvendosjen e normave gjinore të socializuara. "Ekziston një nevojë për të punuar në rritjen e ndërgjegjësimit të burrave për të respektuar gratë," tha një vajzë.[63] Në mënyrë që të plotësojnë nevojat e vajzave, duhet të përfshihen edhe djemtë.

[62] Për informacion të mëtejshëm në lidhje me prioritetet e vajzave për dialog, ju lutem shikoni nën-pjesën e Kapitullit 2 mbi "Kontributet e grave në negociata dhe dialog, dhe nevojat".

[63] Intervistë me një gazetare të re shqiptare, Prishtinë, 2020.

Për ta bërë këtë, gratë thanë që rolet gjinore duhet të adresohen duke integruar perspektivën e barazisë gjinore në shkollat fillore dhe të mesme.

Vajzat thanë se në partitë politike duhet të përfshihen më shumë gra në vendimmarrje brenda partive; kjo do të mund të çonte që më shumë gra të shërbejnë në poste më të larta në qeveri dhe institucione të tjera, duke përfaqësuar kështu më mirë nevojat e grave drejt paqes dhe sigurisë. Partitë politike duhet të kenë përqendrim më të madh në platformat e tyre politike në çështje si punësimi, arsimi dhe pjesëmarrja e barabartë në vendimmarrje, thanë ato. Vajzat serbe u kërkuan partive politike me shumicë shqiptare të plotësojnë dhe adresojnë nevojat e komunitetit serb në Kosovë, pasi partia politike Lista Serbe nuk merret me problemet me të cilat përballen dhe as nuk i përfaqëson ata, thanë ato.[64]

> "Nuk ndjehet sikur ne i përkasim Kosovës, as Serbisë. Ne trajtohemi në Beograd në të njëjtën mënyrë siç trajtohemi në Kosovë, si pakicë".
>
> **Vajzë serbe, Mitrovica e Veriut**

Liria e lëvizjes ndërkombëtarisht gjithashtu do të kontribuonte në paqe dhe siguri, thanë vajzat e të gjitha etnive. Meqenëse Kosova ende nuk ka liberalizim të vizave për udhëtime në zonën Shengen, gratë e reja nuk mund të marrin pjesë në shumë trajnime dhe konferenca ndërkombëtare. Ato humbin mundësitë për të mësuar më shumë rreth kulturave të tjera dhe për të takuar koleget e tyre. Megjithëse gratë serbe në Kosovë kanë pasaporta serbe, ato identifikohen se jetojnë në Kosovë, që do të thotë se atyre u duhet vizë për të hyrë edhe në zonën Shengen. Për më tepër, vajzat në Kosovë nuk mund të takohen lehtë me koleget nga grupet e tjera etnike në Kosovë për shkak të stigmës dhe presionit familjar. Vajzat kërkuan të mësonin gjuhët e njëra-tjetrës, gjë për të cilën besonin se do t'i ndihmonte të krijonin një urë që do të lidhte komunitete të ndryshme dhe do t'i ndihmonte të kuptonin nevojat e njëra-tjetrës.

Vajzat kërkuan gjithashtu instalimin e dritave nëpër rrugë dhe të ketë më shumë patrulla policore gjatë natës. Ato do të ndiheshin më të sigurta nëse do t'i besonin policisë. Gratë e reja besonin se përfshirja e më shumë grave në institucionet e sigurisë do të përmirësonte sigurinë e tyre. Gratë kanë tendencë t'u besojnë policeve më shumë sesa policëve; e kishin më të lehtë të flisnin me to.[65] Një police gjithashtu vuri re, "Çdo grua në Kosovë ndihet më e sigurt kur raporton një rast në polici dhe atë rast e merr përsipër një grua."[66] Pjesëmarrësit e hulumtimit ranë dakord që gratë do të raportonin krimet më shpesh nëse do të kishte më shumë gra police. Kjo mund të kontribuojë për paqen dhe sigurinë, pasi angazhimi i më shumë grave në sektorin e sigurisë do t'i bënte gratë, veçanërisht vajzat, të ndiheshin më të sigurta.[67]

## Konkluzion

Përkufizimet e ndryshme të grave për paqen dhe sigurinë ndryshojnë, veçanërisht në lidhje me moshën, etninë dhe përvojat personale të konfliktit. Gratë që kishin përjetuar luftën personalisht kishin prirjen ta përcaktonin paqen si mungesë lufte, veçanërisht në kontekstin e paqes kombëtare dhe ndërkombëtare. Vajzat kanë tendencën të përcaktojnë paqen më gjerësisht dhe ngjashëm me përkufizimet feministe të paqes, duke përfshirë paqen personale dhe paqen midis individëve. Gratë e të gjitha brezave e lidhën paqen me respektimin e të drejtave të njeriut, lirinë e

---

[64] Përgjigjet e anketës së RrGK-së për vajzat serbe, 2020.

[65] Grupi i fokusit me gra të reja në Mitrovicë Veriore

[66] Intervistë e RrGK me zyrtarin policor, Mbikëqyrës në Zyrën për të Drejtat e Njeriut dhe Diversitetin, Prishtinë: 2020

[67] Për diskutime të mëtejshme mbi gratë në sektorin e sigurisë, shihni Kapitullin II nën-pjesa mbi "Kontributet e Grave për Sigurinë përmes Sektorit të Sigurisë"

lëvizjes, lirinë e fjalës dhe të drejtat gjuhësore, ndër të tjera. Në lidhje me konceptimin e paqes nga Anderson, gratë në Kosovë përcaktonin paqen në terma të paqes personale, ndërpersonale, sociale, lokale, kombëtare, ndërkombëtare dhe, në një rast, ekologjike. Gratë pjesëmarrëse në hulumtim kishin tendencë ta konsideronin Kosovën mesatarisht paqësore, megjithëse mungesa e paqes ishte një temë e përsëritur.

Përtej mungesës së luftës, gratë prireshin ta përcaktonin sigurinë gjerësisht, si siguri njerëzore. Disa pasiguri u regjistruan, përfshirë ato në lidhje me arsimin e dobët, pasiguritë ekonomike, dhunën me bazë gjinore, institucionet e dobëta dhe infrastrukturën e dobët. Veçanërisht vajzat nuk kishin besim se policia ose institucionet e tjera do tu ofronin sigurinë e tyre.

Zhvendosja e normave gjinore përmes programeve arsimore, adresimit të çështjeve të rëndësishme për gratë në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, garantimi i vendit në tryezë për gra të ndryshme, përfshirja e më shumë grave në vendimmarrje dhe në sektorin e sigurisë, rritja e sigurisë në rrugë përmes ndriçimit dhe trotuareve të sigurta, përmirësimi i lirisë së lëvizjes brenda dhe jashtë Kosovës, dhe ofrimi i mësimit të gjuhëve mund të kontribuojnë në paqe dhe siguri për gratë e ndryshme në Kosovë.

# Kapitulli II. Rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri

Historikisht, gratë dhe fëmijët shpesh janë portretizuar në mënyrë homogjene si viktima të luftës. Sipas Tickner, siguria ka qenë e lidhur me një formë të fortë mashkullorësie të militarizuar, dhe paqja me një lloj të feminitetit, ku gratë shihen vetëm si viktima që kanë nevojë për mbrojtje.[68] Autorët feministë i kanë rezistuar nocionit se gratë janë thjesht viktima të konfliktit, duke argumentuar se gratë gjithashtu janë agjente të ndryshimit. Mertus argumenton se gratë nuk kanë qenë vetëm viktima të luftës; ato gjithashtu kanë qenë "motorë të rezistencës dhe zgjidhëse kyçe të problemeve në komunitetet e tyre".[69] Parafrazimi i Sara Ruddick, sipas Tickner, "ndërtimi i paqes dhe jo dhuna kërkojnë guxim, mundim dhe rezistencë dhe refuzim për të pranuar viktimizimin", dhe këto janë "tipare që shohim te gratë aktiviste në zonat e konfliktit sot".[70] Në të vërtetë, literatura në rritje dëshmon se gratë mund të jenë agjente të ndryshimit, drejt paqes dhe sigurisë.

Gratë mund të kenë disa role dhe identitete të ndryshme në kohë konfliktesh. Në disa situata, ndërtimi shoqëror i grave si "nëna" dhe "mbrojtëse të kulturës" brenda lëvizjeve nacionaliste çlirimtare ka kufizuar aktivizmin e grave në konflikt dhe në proceset e rindërtimit pas konfliktit.[71] Në disa situata, gratë janë mobilizuar për të siguruar mbështetje, punë dhe shërbime për përpjekjet e luftës, duke i bërë ato pjesëmarrëse aktive në konflikt, siç ndodhi në Kosovë. Gratë kanë qenë të përfshira drejtpërdrejt në luftë, duke iu bashkuar grupeve të armatosura; në të vërtetë, gratë iu bashkuan Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për dallim, disa gra kanë insistuar në zgjidhjen paqësore të konflikteve, gjë që ndodhi edhe në Kosovë, siç përshkruhet në këtë kapitull. Disa gra, përfshirë aktivistet, kanë qenë viktima të luftës, pas humbjes së të dashurëve, shkatërrimit të pronës dhe dhunës seksuale. Duke pasur parasysh shumë role dhe identitete të mundshme të grave, pozicioni i grave në lidhje me konfliktin nuk mund të homogjenizohet, as si paqësor dhe as i dhunshëm, as aktiv apo as pasiv. Ndërkohë, një mori mënyrash në të cilat gratë mund të përfshihen më shumë në mënyrë sociale dhe politike në kohë konfliktesh mund të kontribuojë në ndryshimet e roleve tradicionale sociale të grave, ndonjëherë duke e përmirësuar statusin e tyre social.[72] Sidoqoftë, sapo të ketë mbaruar konflikti, gratë mund të humbin statusin që kishin fituar, pasi shoqëria kthehet në normat tradicionale gjinore të socializuara.

Sipas pyetjes kryesore të hulumtimit, ky kapitull shqyrton rolet dhe kontributet e ndryshme të grave, veçanërisht të vajzave, për paqen dhe sigurinë gjatë konfliktit (1989-1998), luftës (1998-1999) dhe proceseve të pasluftës (1999-2020) në Kosovë.[73] Më konkretisht, sipas nën-pyetjeve hulumtuese, kapitulli dokumenton rolet që OSHCG-të kanë luajtur në kontributin për paqen, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në proceset e paqes dhe sigurisë; si ka kontribuar në ndonjë rezultat deri më tani përfshirja e vajzave në dialogun Kosovë-Serbi? Gjatë shqyrtimit të praktikave më të mira, kapitulli gjithashtu ofron shembuj që i përgjigjen nën-pyetjes: si mund të përfshihen vajzat në dialog dhe negociata në të ardhmen? Kapitulli është i ndarë në dy pjesë, duke shqyrtuar përkatësisht

---

[68] Tickner, J. A., "Peace and Security from a Feminist Perspective" (Paqja dhe siguria nga një perspektivë feminist), *The Oxford Handbook of Women, Peace, and Security*, 2018, f. 3.

[69] Mertus, *War's Offensive on Women (Ofensiva e Luftës ndaj Grave)*, 2000, f. 11.

[70] Po aty, f. 8.

[71] El Jack, A., *Overview Report on Gender and Armed Conflict* (*Raporti i Përgjithshëm mbi Gjininë dhe Konfliktet e Armatosura*), 2003, f. 11.

[72] Në Kosovë, Julie Mertus reflekton në një ndryshim të tillë në pozicionimin shoqëror, duke iu referuar, për shembull, grave të fshatit Krushë e Vogël, të cilave iu desh të rindërtonin jetën e tyre pas luftës Mertus, "Improving the Status of Women in the Wake of War: Overcoming Structural Obstacles" (Përmirësimi i statusit të grave pas luftës: Kapërcimi i pengesave strukturale), *Columbia Journal of Transitional Law*, 2003, f. 542-3).

[73] Siç shpjegohet në Hyrje, ekipi pranon që konflikti ekzistonte shumë para vitit 1989 dhe, siç ilustroi kapitulli i fundit, për shumë gra në Kosovë, konflikti vazhdon edhe sot; ato ende ndiejnë mungesën e paqes dhe disa pasiguri.

periudhat e "konfliktit" dhe luftës, si dhe "pasluftës", për shkak të rrethanave mjaft të ndryshme të secilës periudhë kohore. Sidoqoftë, siç diskutohet në fund të kapitulli, autorët pranojnë që konflikti shpesh ndodh përgjatë një vazhdimësie dhe konfliktet vazhdojnë mes njerëzve dhe grupeve të veçanta shoqërore në Kosovë sot. Çdo pjesë ka nën-pjesët që diskutojnë dimensionet përmes të cilave gratë kontribuan për paqe dhe siguri, bazuar në temat e përsëritura që dolën nga hulumtimi.

## Rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri gjatë konfliktit dhe luftës

Përderisa jeta në Kosovë mund të karakterizohet me dekada, ndoshta edhe me shekuj, të konfliktit të vazhdueshëm, ky hulumtim shqyrtoi konfliktin që u intensifikua që nga viti 1989.[74] Ishte atëherë kur Sllobodan Millosheviq, President i Republikës Socialiste të Serbisë dhe President i Presidencës së Republikës Socialiste të Jugosllavisë, suprimoi autonominë e Kosovës brenda Jugosllavisë dhe filloi një fushatë të shtypjes kulturore dhe ekonomike kundër shqiptarëve etnikë.[75] Human Rights Watch e ka përshkruar dhunën e kryer ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve 1990 dhe veçanërisht në 1998-1999 si "spastrim etnik" sistematik.[76] Gjatë shumicës së viteve 1990, shqiptarët nuk kishin të drejtë për arsimim, festime në gjuhën e tyre ose liri të lëvizjes. Duke filluar nga 1990 dhe 1991, 90% e shqiptarëve u pushuan nga puna e tyre shtetërore në institucionet e kujdesit shëndetësor, shkolla, media dhe qeveri.[77]

Si përgjigje, shumica e shqiptarëve u përfshinë në një lëvizje paqësore të rezistencës civile, e cila përfshinte organizimin e një sistemi nëntokësor, paralel arsimor, sistemi të kujdesit shëndetësor dhe sistemi politik, të financuar kryesisht përmes donacioneve nga diaspora. Lëvizja e rezistencës paqësore ndër synimet e saj kryesore kishte vendosjen e paqes në Kosovë dhe sigurisë për njerëzit që jetojnë atje. Në këtë kontekst, sipas pyetjes kryesore të hulumtimit, kjo pjesë diskuton kontributet e ndryshme që gratë në Kosovë kanë dhanë për paqen dhe sigurinë gjatë kësaj kohe. Nën-pjesët shqyrtojnë kontributet e grave për paqen dhe sigurinë në lidhje me secilin prej dimensioneve që dolën nga hulumtimi si: politika, arsimi, kujdesi shëndetësor, paqja përtej kufijve, dokumentimi i abuzimeve të të drejtave të njeriut, demonstrata paqësore, diplomacia dhe organizimi i sigurisë për personat e zhvendosur. Duke pasur parasysh natyrën e situatës dhe gjetjet e hulumtimit,[78] kjo pjesë përqendrohet në aktivitetet drejt paqes dhe sigurisë të ndërmarra nga gratë shqiptare, veçanërisht vajzat. Sidoqoftë, gjithashtu përmenden aktivitetet drejt paqes dhe sigurisë nga gratë e etnive të tjera.

### Rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri gjatë konfliktit dhe luftës

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri përmes politikës gjatë viteve 1990. Por siç shkruajti Mertus për vitet 1990 në Kosovë, megjithëse burrat mbanin pozicione drejtuese në rezistencën e shqiptarëve të Kosovës," gratë gjithashtu luajtën një rol aktiv".[79] Aktivistët shqiptarë për të drejtat e grave kanë re-

---

[74] Për një histori të plotë, shih: Malcolm, N., *Kosova: Një histori e shkurtër* dhe Clark, H., *Rezistenca Civile në Kosovë*.

[75] Clark, H., *Rezistenca Civile në Kosovë*; Rogel, C., "Kosova: Atje ku filloi gjithçka", *International Journal of Politics, Culture, and Society*, Vëll. 17, Nr. 1, shtator 2003: 167–182.

[76] Human Rights Watch, *Humanitarian Law Violations in Kosovo*, (*Shkeljet e së Drejtës Humanitare në Kosovë*), SHBA: Human Rights Watch, 1998.

[77] Clark, f. 74-77.

[78] Një temë e përsëritur në mesin e grave serbe të intervistuara për këtë hulumtim ishte se ato nuk ishin të angazhuara drejtpërdrejt në ndërtimin e paqes gjatë kësaj periudhe, me përjashtim të njërës që përmendi shpërndarjen e ndihmës humanitare, të shtjelluar më vonë në këtë pjesë.

[79] Mertus, *Ofensiva e Luftës ndaj Grave*, 2000, f. 38.

flektuar se, në atë kohë, burrat shqiptarë ishin në rrezik abuzimi fizik ose të burgosjes nga forcat e policisë serbe nëse dilnin në rrugë.[80] Për dallim, gratë shqiptare mund të udhëtonin më lehtë, thanë aktivistët, veçanërisht nëpër pikat e shumta të policisë serbe që ekzistonin në të gjithë Kosovën në atë kohë. Aktivistët për të drejtat e grave kanë vërejtur se vetë fakti që ato ishin "thjesht gra" do të thoshte që policia serbe tentonte t'i perceptojë ato si "të padëmshme". Duke pasur parasysh aftësinë e tyre për të udhëtuar së bashku me motivimin e tyre, shumë gra shqiptare, përfshirë vajzat, u angazhuan më shumë në jetën publike. Siç reflektoi aktivistja Flora Macula, "Ndonjëherë personi krijon mundësi dhe ndonjëherë vetë konteksti krijon aktivistë".[81]

"Gratë u bashkuan menjëherë me lëvizjen përmes pjesëmarrjes në procese politike, në shoqërinë civile, në protesta, diplomaci, në procese paqësore. Ne kemi qenë të angazhuara në këto fusha të rëndësishme për të kontribuar në zgjidhjen e konfliktit, ndalimin e luftës dhe gjenocidit, dhe për t'i sjellë paqe dhe liri popullit tonë."

**Edita Tahiri, politikane shqiptare**

Gratë tashmë ishin të njohura për promovimin e paqes midis familjeve shqiptare, të tilla si gjatë Fushatës së Pajtimit të Gjaqeve. Fushata mjaft politike për nga natyra filloi pas pajtimit të gjakut të parë më 2 shkurt 1990.[82] Në vitin 1989, thuhet se 15 persona kishin vdekur si rezultat i gjakmarrjeve, duke përfshirë studentë, dhe kjo bëri që studentët të kërkonin ndihmë për t'i dhënë fund gjakmarrjes nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) në Prishtinë.[83] Dy aktiviste të reja ishin në mesin e studentëve: Hava Shala dhe Myrvete Dreshaj.[84] Gratë ishin shumë të angazhuara në Fushatë gjatë viteve 1990, pasi ajo synonte t'i jepte fund konflikteve dhe të ndërtonte paqen midis familjeve shqiptare, por edhe të përmirësonte imazhin e përgjithshëm publik të shqiptarëve brenda ish-Jugosllavisë, drejt paqes ndër-kulturore.

Media serbe gjatë viteve 1980 dhe 1990 portretizuan gratë shqiptare të Kosovës si makina rrobalarëse ose riprodhuese të "minjve", duke iu referuar foshnjave shqiptare si "bomba biologjike".[85] Media ndërkombëtare gjithashtu portretizonin gratë shqiptare si fundamentaliste myslimane ose viktima të pafuqishme.[86] Në përgjithësi, Reardon ka sugjeruar që "tjetërsimi" i tillë, si "ato që ndryshojnë nga ne, që na kërcënojnë" mund të kontribuojë në "nocionin e armikut, dhe në fund të fundit praktikën e luftës".[87] Nga kjo rrjedh se gjetja e mënyrave paqësore për të kundërshtuar imazhe dhe supozime të tilla mund të kontribuojë në paqe.

"Për ne nuk ishte asgjë shtesë. Ishte shumë e zakonshme që thamë, 'Prit një minutë. - Ku jemi ne? Çfarë ndodhi me ne? […]
A nuk mund ta bëjmë? Ne duhet ta bëjmë atë. Mund ta bëjmë.

**Sevdije Ahmeti, grua shqiptare aktiviste për të drejtat e njeriut, Prishtinë[88]**

Ndërkohë, të zemëruar nga historitë e mediave

[80] Intervistat e RrGK, 2020 dhe bisedat e mëparshme me aktivistë.

[81] Intervista e RrGK me Flora Macula, 2020.

[82] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 43.

[83] Clark. f. 61.

[84] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 42-43.

[85] Human Rights Watch, "Dhuna me bazë Gjinore Kundër Grave Shqiptare të Kosovës", *Kosovë: Përdhunimi si një armë e spastrimit etnik* 2000, duke cituar Mertus, J., "Gratë në Kosovë: Terrenet e Kontestuara", në Ramet, ed., *Politika gjinore në Ballkanin Perëndimor: Gratë dhe Shoqëria në Jugosllavi dhe Shtetet Pasuese Jugosllave,* 2010, f. 178.

[86] Intervistat e RrGK-së dhe bisedat paraprake me gratë aktiviste.

[87] Reardon, B., *Tekstet kyçe për gjini dhe paqe*, f. 57.

[88] Cituar në QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 61.

serbe që portretizonin gratë shqiptare si ”skllave të zbathura dhe makina lindjeje, vetëm në gjendje të riprodhonin si minjtë”,[89] gratë intelektuale që punonin në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, në krye me Sevdije Ahmetin, Lavdrije Domin, Violeta Selimin dhe Batishahe Islamin, filluan të diskutojnë mundësinë se si ato mund të përmirësojnë imazhin e grave shqiptare. Gjithashtu, ato nuk mendonin se gratë ishin mjaft të përfaqësuara në mesin e partive politike të kohës. Prandaj, ato hartuan një deklaratë, duke themeluar Shoqatën e parë të Pavarur të Grave në Kosovë, duke deklaruar: "Ne gratë, pa dallim race, feje apo kombësie, bëhemi bashkë për lëvizjen e grave të pavarura të Kosovës, jashtë Partisë Komuniste të Kosovës".[90] Më shumë se 25 gra filluan takimet në tetor 1989 për të diskutuar dhe themeluar më tej Shoqatën,[91] e cila përfundimisht do të bëhej shoqatë politike.

Ndërkohë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) u themelua më 23 dhjetor 1989.[92] Shumica, megjithëse jo të gjithë, shqiptarët do të bashkoheshin së shpejti në këtë parti politike, e cila vazhdoi të drejtojë lëvizjen e rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës për shumicën e viteve 1990. Fillimisht, partia përfshiu pak gra, siç kujtoi politikania Edita Tahiri:

> Kur u themelua LDK, këshilli nismëtar ishte kryesisht me burra intelektualë. Kishte pak gra. Por pas themelimit të LDK-së në Prishtinë dhe zgjerimit në komuna të tjera, numri i grave [në LDK] filloi të rritet.... Për shembull, në vitin '90 deri në '91, unë organizova protestën e 5,000 grave në Prizren, ku ne deklaruam se bashkohemi në LDK për liri dhe pavarësi dhe kundërshtojmë pushtimin dhe komunizmin serb.[93]

Pas shumë diskutimesh dhe shqyrtimesh, gratë anëtare të Shoqatës së Grave të Pavarura të lartpërmendur votuan për t'u bashkuar me LDK-në, duke u bërë Forumi i Grave brenda LDK-së.[94] Disa gra drejtuan këtë Forum të partisë politike gjatë viteve nëntëdhjetë, në fillim me Luljeta Pula-Beqiri, Flora Brovina, Milajete Shala, Naxhije Buçinca dhe Edi Shukriu. Sidoqoftë, si forumi i grave socialiste që i parapriu atij, Forumi i Grave i LDK-së nuk iu ofrua grave as një vend në tryezë; burrat udhëheqës politikë brenda LDK-së morën shumicën e vendimeve.[95]

Sidoqoftë, gratë u organizuan jashtë tryezës, shpesh prapa skenave, duke hedhur themelin që mbështeste dhe përkrahte strukturat politike paralele të shqiptarëve. Më 30 shtator 1991, shqiptarët në Kosovë organizuan një referendum të fshehtë për të shpallur Kosovën shtet sovran dhe të pavarur me të drejtën për të marrë pjesë në çdo asociacion eventual të shteteve sovrane brenda Jugosllavisë.[96] Meqenëse burrat vëzhgoheshin vazhdimisht nga policia serbe, siç u përmend, gratë me guxim shpërndanin fletushkat për referendumin dhe transportonin referendumin përreth Kosovës për t'u nënshkruar. Vitin tjetër gratë dolën përsëri në rrugë, duke reklamuar dhe orkestruar zgjedhjet e fshehta.[97] Pas referendumit dhe zgjedhjeve, shqiptarët krijuan një qeveri dhe shërbime që do të funksiononin "paralelisht me qeverinë serbe".[98] Kjo u bë e njohur si sistemi paralel, të cilin shqiptarët e orkestruan si një formë të rezistencës paqësore ndaj asaj që ata e konsideruan si okupim serb për gati një dekadë. Duke pranuar se ata nuk kishin burime për të luftuar me sukses ushtrinë serbe për një autonomi të plotë, në fillim të viteve 1990

[89] Sevdije Ahmeti, cituar në QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 59.

[90] Cituar në QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 59-61.

[91] Po aty, f. 61 Libri përfshin emrat e grave pjesëmarrëse.

[92] Clark, f. 56.

[93] Intervista e RrGK me Edita Tahirin, 2020.

[94] Për një diskutim të plotë, shih QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 62-68.

[95] Shih QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*.

[96] Clark, f. 82; dhe QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 49.

[97] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 50.

[98] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 49.

shqiptarët e Kosovës zgjodhën me qëllim qasjen e rezistencës paqësore, jo të dhunshme për të zgjidhur konfliktin, duke shpresuar se përpjekjet e tyre do të tërheqin vëmendjen e aktorëve ndërkombëtarë që mund të ndërhyjnë për të mbështetur kauzën e tyre.[99]

Lidhur me pjesëmarrjen e grave serbe në politikë dhe diplomaci në Kosovë gjatë viteve 1990, një pjesëmarrëse në hulumtimin e grave serbe reflektoi: "Burrat ishin ata që merrnin të gjitha vendimet. Ne thjesht qëndronim ulur të heshtura me frikë, jo vetëm për jetën tonë, por më shumë për jetën e fëmijëve tanë. Nuk kishte hapësirë për të vepruar ".[100] Një grua tjetër serbe pranoi: "Serbët nuk luajtën një rol të madh; të gjitha familjet qëndruan brenda, në mënyrë që të mos preken nga ato probleme. Ne i lamë burrat të merreshin me këto gjëra, gjë që ishte gabimi ynë".[101] Në përgjithësi, gratë serbe të intervistuara ranë dakord që burrat serbë mbizotëronin skenën politike gjatë kësaj periudhe dhe, sipas shpërndarjes së punës brenda familjeve të tyre dhe shoqërisë, gratë u përqendruan në mbledhjen dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare. Ndërsa burrat merrnin vendime gjatë kësaj periudhe, gratë serbe thanë se kishin pak hapësirë për të ndikuar në politikë. Rolet tradicionale gjinore dhe ndarja e punës brenda familjes penguan aftësinë e grave serbe për t'u angazhuar politikisht.

Një vëzhgim i përsëritur në literaturën ekzistuese në lidhje me këtë periudhë ishte se gratë gjithashtu mbetën kryesisht të lëna jashtë strukturave vendimmarrëse "zyrtare" të LDK-së. Siç shkruajti Howard Clark, "gratë dhe të rinjtë, ku secili grup përbënte më shumë se gjysmën e popullsisë, jo vetëm që ishin të nënpërfaqësuara por perspektivat dhe shqetësimet e tyre nuk u reflektuan në mënyrë adekuate brenda udhëheqjes".[102] Një nga gratë e pakta që mori pjesë në udhëheqjen e partisë ishte Edita Tahiri, e cila u bë anëtare e Kryesisë së LDK-së duke filluar nga viti 1991. Siç duket, kjo do të mbështeste qasjen e saj në proceset zyrtare të paqes më vonë, ku gratë e tjera nuk ishin të angazhuara.

Në përgjithësi, aktivistja për të drejtat e njeriut të grave dhe ambasadorja e pasluftës, Vjosa Dobruna më vonë reflektoi, duke shkruar në vitin 1996:

> Në fillim të "lëvizjes alternative" ose "sistemit paralel", gratë ishin shumë aktive dhe të përfshira në një numër të madh, por ndërsa sistemi u rrit në një mënyrë të themeluar të jetesës, përfshirja e grave në pozicionet vendimmarrëse në lëvizje ka rënë. Gratë përfaqësojnë gjysmën e punës në sistemin arsimor, më shumë se gjysmën e sistemit shëndetësor alternativ dhe shumicën e shërbimeve sociale, por punojnë pak a shumë në role të nënshtruara për dallim që të kenë një zë aktiv në zhvillimin e shoqërisë.[103]

Shkrimet e saj, ndër të tjera, ilustrojnë se gratë luajtën rol të rëndësishëm brenda lëvizjes së rezistencës paqësore në drejtim të ruajtjes së sigurisë dhe mirëqenies së njerëzve në Kosovë mes rrethanave të vështira, siç përshkruhet më tej në nën-pjesët vijuese. Sidoqoftë, gratë e të gjitha etnive ishin më pak të angazhuara sesa burrat në udhëheqjen politike dhe pozitat e vendimmarrjes së kohës.[104]

---

[99] Për një përshkrim të plotë, shihni Clark.

[100] Intervista e RrGK me një aktiviste serbe për të drejtat e grave, Prishtinë, 2020.

[101] Intervista e RrGK me një aktiviste serbe për të drejtat e grave, Gjilan, 2020.

[102] Clark, *Rezistenca Civile në Kosovë*, f. 121-135.

[103] Cituar në Clark, f. 146.

[104] Kjo ishte një temë e përsëritur në intervistat e RrGK-së (2020).

## Kontributi i grave në arsim

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri përmes arsimit gjatë viteve 1990. Arsimi lidhet me sigurinë, pasi që pa arsimim, siguria ekonomike e fëmijëve mund të kufizohet më vonë gjatë jetës. Gratë luajtën një rol jetësor në avancimin e qasjes në arsimim gjatë viteve 1990.[105] Siç përshkruhet nga QKSGJ, "pasi autoritetet serbe mbyllën shkollat shqipe, Komisioni i Arsimit i Forumit të Grave të LDK-së ndihmoi në organizimin e dy orëve të arsimit çdo ditë në një përpjekje për të vazhduar arsimin".[106] Qindra gra dhe disa burra u mobilizuan për të dhënë mësim në sistemin shkollor të fshehtë në gjuhën shqipe.[107] Disa të tjerë hapën shtëpitë e tyre për të vazhduar mësimin. Vetë sigurimi i shkollimit në këtë situatë jashtëzakonisht të vështirë ishte një kontribut në sigurinë e ardhshme ekonomike të fëmijëve. Nxënëset dhe studentet e reja u rezistuan pasigurive të lidhura me një jetë pa arsim duke ndërmarrë rreziqe për mirëqenien e tyre fizike vetëm për të ndjekur shkollën:

"Në kohën kur mësuesit dhe profesorët ishin në rrezik, gratë luajtën një rol vendimtar në avancimin e pozitës së grave në arsim."

**Burrë shqiptar, Prishtinë**

"Në atë kohë, Serbia mbylli shkollat, universitetet e të gjitha niveleve. Gratë ishin ato që filluan së pari idenë që nënat të mësojnë fëmijët e tyre për dy orë në shtëpi. Kështu filloi ndjekja e mësimit në shkollat-shtëpi."

**Edita Tahiri**

> Në atë kohë kishte momente të frikshme. Kur shkonit në shkollë, nuk e dinit nëse do të ktheheshit të gjallë në shtëpi. Kishte raste kur kisha një çizme [oficeri] mbi kokë, ata më rrëzonin librat, etj. Ky ka qenë një kontribut i vajzave, të cilat rezistuan me trupat e tyre. Falë kësaj rezistence, ne jemi këtu sot.[108]

Aktivistet e të drejtave të grave të intervistuara thanë që vajzat kontribuan në sigurinë duke këmbëngulur për të ndjekur arsimin dhe duke "rezistuar" ndaj kërcënimeve për sigurinë e tyre, përmes trupave dhe veprimeve të tyre. Në të vërtetë, autorë të tjerë feministë, të tillë si Wendy Harcourt, e kanë vëzhguar vetë trupin si "vendi i parë për rezistencë":

> Trupat janë zona të normalizimit dhe rezistencës, pasi që normat shoqërore të gjinisë dhe seksualitetit janë të gdhendura në trup. ... Kuptimi i trupit si vend nënvizon se trupat nuk janë të jashtëm ndaj proceseve politike, por më tepër ngërthehen në to, edhe nëse ata nuk janë gjithmonë vendi përcaktues për veprim. Përvoja e jetuar e trupit, dhe identiteti dhe përkufizimet e bashkëngjitura në trupa, informojnë dhe janë të lidhura me të gjitha luftërat politike të vendosura historikisht dhe gjeografikisht.[109]

[105] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 79.

[106] Po aty, f. 80.

[107] Po aty, f. 84.

[108] Intervista e RrGK me një grua shqiptare, Prishtinë.

[109] Harcourt, W., *Trupat në Rezistencë. Gjinia dhe politika seksuale në epokën e neoliberalizmit*, 2017.

Feministet në të gjithë botën kanë përdorur trupat e tyre si një subjekt politik dhe vend të rezistencës.[110] Sipas Virginia Vargas, "kjo shkon së bashku me një ritheksim të rëndësisë së hapësirës publike nga përvetësimi i rrugëve si një vend ku ndërtohen identitetet dhe ku ndodh lufta e mishëruar politike".[111] Në mënyrë të veçantë, në Ballkanin Perëndimor, aktivistet, të tillë si ata të angazhuara në Gratë në të Zeza, rregullisht kanë përdorur trupat e tyre në demonstrata publike, si një formë proteste paqësore dhe rezistencë fizike ndaj dhunës, siç diskutohet në pjesët e mëvonshme.[112] Në mënyrë të ngjashme, gratë pjesëmarrëse në hulumtim thanë se vetë akti i tyre për të ndjekur në mënyrë të paligjshme arsimin si vajza, duke vendosur trupat e tyre në rrezik fizik për shkak të proceseve më të gjera politike në fjalë, ishte vetvetiu një formë e rezistencës aktive, paqësore kundër shkeljeve të së drejtës së tyre për arsim.

"Gjatë mesit të viteve të 90-ta, aktivistet e Grave në të Zeza kanë protestuar me trupin e tyre në heshtje, duke qëndruar pa lëvizur. Reagimet e qytetarëve ishin kryesisht negative. Nuk do ta harroj asnjëherë një protestë kur një prej tyre pështyu në fytyrën e aktivistes Lepa Mllagjenoviqit. Ajo e vazhdoi protestën në qetësi me trupin e saj dhe nuk lëvizi as për ta pastruar fytyrën. Pas asaj proteste iu afrova dhe e pyeta: 'Si munde të qëndrosh në heshtje dhe të mos lëvizësh, të paktën për të pastruar futurën?' Ajo ma ktheu: Veprimi im i protestës ishte të mos lëvizja, në mënyrë që t'i përçoja atij mesazhin: 'ti nuk ekziston'."

**Igballe Rogova**

Ndërkohë, më herët, në vitin 1989, kur ishte e re Igballe Rogova dhe motra e saj, aktorja Safete Rogova, mbështetur nga burri i Safetes, Nuredin Loxha, themeluan Shoqatën Motrat Qiriazi për të mësuar shkrim-leximin grave dhe vajzave që kishin ndërprerë shkollën, veçanërisht te gratë në zona rurale. Një moto kryesore e Shoqatës ishte rezistenca paqësore dhe jo-dhuna. Siç do të thoshte aktivisti Nuredin Loxha në takimet me burra dhe para turmave që numëronin mijëra pjesëmarrës, "Drejt Evropës me laps! Arsimoni më shumë vajza dhe djem!". Shpejt më pas, në vitin 1990, Sanije Gashi, redaktore e revistës së popullarizuar në gjuhën shqipe *Kosovarja*, shtypi një histori për punën dhe aktivitetin e tyre. Disa gra mësuan për këtë iniciativë dhe filluan organizata të ngjashme për të ofruar kurse shkrim-leximi për gratë në komunitetet e tyre.

Më 24 maj 1993, Naxhije Buçinca themeloi shoqatën Gratë Artiste dhe Veterane të Arsimit në Vushtrri, duke punuar ngushtë me vajzën e saj Xheraldina Buçinca-Vula dhe Shukrije Gashi, midis mësueseve, piktoreve, poeteve, shkrimtareve dhe kompozitoreve të tjera.[113] Ato, së bashku me disa gra të reja artiste si Zake Prelvukaj dhe Miradije Ramiqi, organizuan ekspozita, promovime të librave, lexime poezish dhe ngjarje të tjera kulturore. Fillimisht në Prishtinë, në vitin 1997, Nazlije Bala filloi organizatën Elena, për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe veçanërisht të grave, më vonë e lëvizi organizatën në Gjilan dhe bëri riemërtimin e saj në Liria.[114] Në vitin 1995, u themelua organizata Legjenda në Viti, me angazhimin e Melihate Osmanit, Habibe Nezirit, Latife Nezirit, Ganimete Hazirit, Haxhere Ymerit, Drita Xheladinit dhe Barbara Ukajt. Marte Prenkpalaj si e re u angazhua me Motrat Qiriazi në rajonin e Hasit, dhe aktivistet e reja Ilirijana Loxha dhe Nexhmije Fetahu u angazhuan për mbajtjen e kurseve

---

[110] Po aty.

[111] Vargas, V., "Disa mendime mbi epistemologjitë e reja në feminizmin e Amerikës Latine", në Harcourt, W., *Trupat në Rezistencë. Gjinia dhe politika seksuale në epokën e neoliberalizmit*, 2017, f. 299-300.

[112] Shihni nën-pjesët në Kontributet e grave për paqen përtej kufijve.

[113] Po aty.

[114] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 78.

të shkrim-leximit. Në vitin 1996, Sanije Grajçevci filloi organizatën Aureola në Obiliq, së bashku me Vlora Mjekiqi, Xhevahire Mjekiqi dhe Xhevrije Restelica. Dega e shoqatës Motrat Qiriazi në Gjilan, e udhëhequr nga Gjylije Ramizi, funksionoi si një shoqatë e pavarur gjithashtu e quajtur Motrat Qiriazi; në vitin 1999 do të bëhej Elena Peshkopia.[115] Të gjitha këto OSHCG, në të cilat morën pjesë disa vajza, organizuan shkrim, lexim dhe mësime të tjera për gratë.[116] Ndërsa shkalla e analfabetizmit në zonat rurale ishte e lartë (11.5%), gratë gjetën mënyra për të sjellë arsimim edhe në zonat më të izoluara dhe malore të Kosovës.[117] Së bashku, pesë nga këto OSHCG themeluan Rrjetin e Grave Rurale në vitin 1995 (Aureola, Motrat Qiriazi në Gjilan, Legjenda, Elena dhe Motrat Qiriazi në Has).[118]

Aktivistet e Motrat Qiriazi gjithashtu mobilizuan komunitetet dhe diasporën, mes rrethanave mjaft të vështira ekonomike për të mbledhur fonde për të ndërtuar shkolla në rajonin e Hasit, kështu që fëmijët të mund të vazhdonin arsimin e tyre pa pasur nevojë të udhëtonin në Prizren me rrezik të madh të sigurisë; si rezultat, Hasi është një nga zonat e pakta rurale me shumë shkolla fillore dhe të mesme.[119] Në mënyrë të ngjashme, Zahrije Podrimçaku punoi për të mbledhur fonde për të ndërtuar shkolla në Drenas.[120] Aktivistet e Motrat Qiriazi, Safete Rogova dhe Igballe Rogova, gjithashtu transportuan libra në gjuhën shqipe, të paligjshme në atë kohë, duke hapur shumë biblioteka të fshehta në Has gjatë viteve 1990.

Disa vajza të angazhuara në Projektin e Medias, të hapur nga Afërdita Saraçini-Kelmendi dhe Xheraldina Buçinca-Vula në vitin 1995 pasi u frymëzuan nga puna e “gazetareve luftarake” ndërsa morën pjesë në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë në Pekin, Kinë. Ato angazhuan afërsisht 200 të reja në një program të mësuar nga gazetarë vendas dhe ndërkombëtarë, i cili u përqendrua në zgjidhjen e konflikteve dhe gazetarinë, siç dokumentohet nga QKSGJ:

> Në vend që të përdornin gazetari “konfrontuese”, vajzat u mësuan se kishin përgjegjësinë për të minimizuar konfrontimin dhe për të inkurajuar arsimimin dhe bashkëpunimin me shpërndarjen e informacionit. Zvogëlimi i konfrontimit ishte veçanërisht i rëndësishëm në Kosovë, ku mësuan se emocionet mes njerëzve u rritën për shkak të situatës.[121]

Gratë drejtuese të Projektit të Medias përfundimisht u bënë pronare dhe menaxhere e mediave kryesore të Kosovës Radio Televizioni 21 (RTV21), dhe shumë vajza të trajnuara përmes programit punuan për këtë media. Disa vajza pasi ishin të fuqizuara nga programet; ato vazhduan më tej arsimimin e tyre dhe u bënë ndër udhëheqëset e ardhshme të Kosovës.

Vajzat gjithashtu ishin të përfshira në Post-pesimistët, një nga organizatat e para të drejtuara nga të rinjtë, e cila kontribuoi në një formë të edukimit alternativ në diplomaci.[122] E themeluar me iniciativën e të rinjve nga Kosova, Serbia dhe Kroacia, organizata kishte parimin: “nëse nuk do të mund të ishin miq, të paktën ata nuk dëshironin të ishin armiq”.[123] Ata organizuan koncerte, ekspozita, punëtori dhe botimin e një gazete mujore për të rinjtë. Ndërsa gazetarja e njohur tani Jeta Xharra kujtoi për QKSGJ:

---

[115] Po aty f. 76

[116] Po aty.

[117] Po aty.

[118] Po aty f. 97

[119] Po aty.

[120] Po aty, f. 76-77.

[121] Po aty, f. 87. Për informacione të mëtejshme, shihni QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 87-89.

[122] Po aty, f. 85-87.

[123] Violeta Selimi, cituar në *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 86

Ne po takonim diplomatët më të mirë në moshën e re pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç. Ne po lobonim për vendin tonë në anglisht ... Pastaj, menduam se ishte ajo që ndodh normalisht. Por kjo nuk është ajo që ndodh normalisht. Si pesëmbëdhjetë vjeç nuk mund t'i informoni diplomatët se sa e mjerë është jeta në Kosovë dhe të zhvilloni aftësi të tilla komunikimi. Më pas, lobimi në marrëdhëniet me publikun, biseda, komunikimi erdhi natyrshëm për të gjithë ne. Këto ishin aftësi për të cilat nuk ishim përgatitur aspak në sistemin tonë arsimor. Ne nuk ishim mësuar të mendonim në mënyrë kritike, të vëmë në dyshim gjërat, të komunikonim hapur me njerëzit, ose të argumentonim çështjen tonë. Kjo nuk ishte diçka që mësova në shkollë. Kjo ishte diçka që unë mësova në shoqërinë civile. Post-pesimistët ishin pjesë e saj.[124]

Anëtarët kontribuan për paqen duke prezantuar historitë dhe përvojat e të rinjve kosovarë në atë kohë, duke bashkëpunuar me të rinj të etnive të ndryshme përtej kufijve të ish Jugosllavisë dhe duke kërkuar ndërhyrje ndërkombëtare për një zgjidhje paqësore të konfliktit. Jehona Gjurgjeala, një tjetër anëtare, gjithashtu kujtoi për QKSGJ rëndësinë e grupit për sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve:

Në këtë periudhë, ishte shumë e vështirë të jesh person i ri në Kosovë. Gjitha rrugët sportive, kulturore dhe arsimore të zhvillimit ishin të mbyllura për shqiptarët. Hapësirat tona të vetme publike ishin lokalet, të cilat funksiononin me magji degjenerative te rinia. Në këtë kontekst, Post-pesimistët ishin të vlefshëm [dhe] përfaqësonin një fazë kyçe në jetën e të gjithë neve që ishim të përfshirë drejtpërdrejt, dhe ne kemi vazhduar të jemi shumë të përkushtuar ndaj Kosovës dhe zhvillimit të shoqërisë kosovare, pavarësisht nga profesioni që kishim zgjedhur që atëherë.[125]

Disa vajza të përfshira në program u bën gazetare, mjeke, arkitekte dhe aktiviste.

Vajzat e tjera u fuqizuan përmes Klubit Rinor të Prishtinës, të operuar nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur. Klubi kishte pikturuar mesazhe të "paqes" dhe "dashurisë" në muret e tij dhe ishte ndër disa lokacione ku fëmijët serbë dhe shqiptarë bashkëvepronin. Kjo dhe mundësi të tjera arsimore për të rinjtë, arsimin, kulturën, gratë dhe shoqërinë civile u organizuan nga Luljeta Vuniqi.

"Lufta filloi jashtë Prishtinës. Gjithçka ishte shumë e tensionuar dhe serbët dhe shqiptarët u ndanë plotësisht. Por ne kishim një klub ku shqiptarët dhe serbët ishin nën një çati."

**Luljeta Vuniqi, aktiviste shqiptare, Prishtinë[126]**

Ndërkohë, në vitin 1997, Sazana Çapriqi themeloi *Sfingën* (Sfinksi), si një organizatë për të fuqizuar vajzat studiuese në arte dhe shkencë.[127] Organizata angazhoi të reja në përpilim e një reviste letrare feministe, e cila përfshinte përkthime të autorëve të shquar feministë nga gjithë bota, si dhe punë origjinale nga shkrimtare e artiste të reja shqiptare.

Kështu, gratë kanë kontribuar në arsimim gjatë viteve 1990, të cilat pa dyshim kanë rezultuar në sigurinë, përfshirë sigurinë ekonomike, për shumë fëmijë dhe të rinj.

[124] Po aty, f. 86

[125] Po aty, f. 86-87.

[126] Cituar në QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, e cila përmban detaje të mëtejshme në lidhje me qendrën (f. 84-85).

[127] Po aty, f. 78

## Kontributet e grave në shëndetësi

> "Most of those who provided medical help in the field and the most outrageous fighting zones were women. But their role remained really invisible. Still, [their work] did not reach the public domain as they should."
>
> **Albanian woman journalist, Prishtinë/Priština[128]**

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri përmes ofrimit të njohurive dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor gjatë viteve 1990. Ashtu si arsimi, shëndeti është i rëndësishëm për sigurinë dhe mirëqenien e njeriut. Mijëra gra shërbyen në sistemin shëndetësor paralel, duke kontribuar në sigurinë dhe mirëqenien e shqiptarëve që nuk kishin qasje në kujdesin shëndetësor gjatë viteve 1990. Shoqata Nënë Tereza u themelua në vitin 1990, fillimisht për të siguruar ndihmë humanitare për më të varfrit. Nga viti 1992, Shoqata administroi sistemin paralel të shëndetit. Gratë e ndryshme ishin të angazhuara duke dhënë ndihma, duke ofruar kujdes shëndetësor dhe duke promovuar rëndësinë e vaksinimeve.[129] Flora Brovina, Kimete Agaj, Fatime Boshnjaku dhe stafi tjetër i Shoqatës Nënë Tereza udhëtuan me mjekë dhe aktivistë të tjerë për të shpërndarë ndihma në zonat e prekura nga konfliktet, duke anashkaluar pikat e kontrollit ushtarak serb. Brovina më vonë themeloi Qendrën për Kujdesin e Nënës dhe Fëmijës, duke vizituar gratë në të gjithë Kosovën që nuk mund të kishin qasje në kujdesin shëndetësor.[130] Më vonë ajo u burgos për aktivitetin e saj.

Gratë me aftësi të ndryshme, të tilla si Feride Dervishi, Drita Vukshinaj dhe Myrvete Hasani, e tjera, ofruan fuqizimin, edukimin dhe kujdesin shëndetësor për gratë dhe fëmijët me aftësi të ndryshme, duke kontribuar pozitivisht në sigurinë e tyre fizike dhe emocionale.[131] Në atë kohë, Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë "Handikos" ishte OSHC-ja më e madhe që ofronte shërbime dhe mbështetje për personat me nevoja të veçanta në Kosovë. Organizata nisi punën në vitin 1983 nën udhëheqjen e Halit Ferizit, dhe gratë luajtën një rol aktiv brenda Handikos-it.[132]Gratë u angazhuan në informimin derë më derë për familjet, duke i inkurajuar ato të mbështesin anëtarët e familjes së tyre me aftësi të ndryshme në qasjen në kujdesin shëndetësor, arsimimin, shoqërimin dhe autonominë. Kur filloi lufta, përveç ndihmës për personat me nevoja të veçanta, anëtarët e Handikos gjithashtu mbështetën familjet e zhvendosura. Për shembull, përkundër sfidës së saj fizike, Sabrije Zeqaj gjeti një karrocë me rrota që të mund të shpërndante ndihma për pesëqind familje.[133] Dervishi lehtësoi komunikimin midis njerëzve me nevoja të veçanta dhe komunitetit më të gjerë përmes programeve në Qendrën Soros, si dhe u dha ndihmë familjeve të zhvendosura.[134]

Në zonat rurale përreth Prizrenit, Jëlldëze Gorani, si gjinekologe e vetme e zonës për shumë vite, ndihmoi qindra gra dhe i edukoi ato për shëndetin dhe të drejtat e tyre riprodhuese, shpesh së bashku me Motrat Qiriazi. Vjollca Çavolli dhe Mirlinda Bunjaku, dhe personeli tjetër i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) vizituan rajone të prekura nga lufta, duke siguruar barëra, furnizime dhe duke transportuar njerëz të plagosur ose shtatzëna në spital.[135] Në shkelje të Konventës së Gjenevës, forcat serbe shpesh ndaluan stafin e KNKK-së që të

---

[128] Intervista e RrGK me një gazetar që mbuloi pjesën më të madhe të konfliktit në Kosovë, 2020.

[129] Shih QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 47-49, 51-55.

[130] Po aty.

[131] Për detaje të mëtejshme, shih *Histori është edhe tregimi i saj.*

[132] Po aty faqe 313-314.

[133] Po aty f. 315

[134] Po aty f. 313

[135] Po aty f. 135

transportonin njerëz në spitalin e Prishtinës për kujdes shëndetësor.[136] Ata larguan individë të plagosur dhe i kthyen në fshatrat e tyre.[137] Në raste të tilla, KNKK informoi ekipin e tyre mjekësor, i cili do të vizitonte individët të nesërmen për të siguruar trajtim.

Në vitin 1993, aktivistja Sevdije Ahmeti dhe pediatrja Vjosa Dobruna krijuan një qendër që do të përqendrohej në mënyrë të qartë në nevojat shpesh unike të grave dhe fëmijëve. Ato themeluan Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF), e cila siguronte shërbime gjinekologjike dhe kujdes pediatrik.[138] Për më tepër, ndërsa konflikti u intensifikua dhe civilët u zhvendosën nga shtëpitë e tyre në Drenicë dhe rajone të tjera, qendra siguroi kujdes shëndetësor urgjent dhe strehim për gratë dhe fëmijët. Dobruna, Ahmeti, Samka Brovina, Fatlume Bujupi, Sanije Veseli dhe Selime Nuraj rrezikuan jetën e tyre çdo ditë, duke udhëtuar në rajone të prekura nga lufta dhe duke ndihmuar civilët që ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre deri sa ato u detyruan të evakuoheshin ose të fshiheshin më 24 mars 1999.[139] Në fund të viteve 1990, bodrumi i QMGF u bë një qendër organizuese ku aktivistet për të drejtat e grave takoheshin për të planifikuar demonstrata, siç diskutohet më vonë.[140]

Në përgjithësi, siç ilustron kjo nën-pjesë, gratë kontribuan në sigurinë njerëzore përmes ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor gjatë viteve 1990.

## Kontributet e grave për paqen përtej kufijve

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqen dhe sigurinë përmes bashkëpunimit ndërkufitar me gratë e grupeve të ndryshme etnike gjatë viteve 1990. Pikëpamjet e grave dhe burrave serbë ndaj shqiptarëve të Kosovës nuk mund të homogjenizohen. Ndërsa media e kontrolluar nga shteti serb dhe liderët politikë serbë gjatë viteve 1990 tentuan të portretizojnë negativisht shqiptarët e Kosovës, siç u përmend, kishte gra serbe që nuk ishin dakord me portretizimin dhe trajtimin e shqiptarëve të Kosovës. Në fakt, për sa i përket promovimit të paqes, siç vuri re një aktiviste shqiptare për të drejtat e grave, gratë "thyen barrierën, madje edhe në nivelin ndërkombëtar. Ato gjetën mënyra për të bashkëpunuar me Serbinë."[141] Për shembull, gratë shqiptare të Kosovës u bashkuan me gratë dhe burrat serbë në Beograd për të protestuar kundër Sllobodan Millosheviqit, duke bërë thirrje për dorëheqjen e tij nga pushteti, veçanërisht në mes të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë; ato gjithashtu bënë thirrje për një ndërhyrje ndërkombëtare për t'i mbështetur ato në përpjekjen e tyre për të dëbuar Milloshevqin nga pushteti, drejt paqes dhe sigurisë.[142]

Konkretisht, aktivistët e Grave në të Zeza në Beograd ishin gjithmonë kundër luftës dhe padrejtësisë.[143] Siç reflektoi më vonë Stasha Zajoviq, Bashkëthemeluese dhe Koordinatore e Grave në të Zeza në Beograd, në një fjalim në vitin 2006:

> Ne kemi jetuar në një shtet agresor ... Regjimi serb kreu një numër veprash agresive dhe kreu krime të panumërta, prej të cilave më i mizori ishte gjenocidi i Srebrenicës. Tani jetojmë në një shtet në të cilin as

---

[136] Po aty f. 135

[137] Po aty f. 135

[138] Gra të tjera kanë punuar atje përfshirë Melihate Juniku, Lumnije Luci, Teuta Hadri, Bojana Gojani, Sanije Hyseni-Veseli, Advije Gashi, Samka Brovina dhe Teuta Mulliqi.

[139] Po aty f. 137

[140] Shihni nën-pjesën në "Kontributet e grave në demonstrata paqësore"

[141] Intervista e RrGK me një grua aktiviste shqiptare, Prishtinë, 2020.

[142] Po aty.

[143] Nga Gratë në të Zeza në Beograd, faqja zyrtare në internet. Për dallim, një grua serbe në Kosovë tha se nuk e ndjente punën e Grave në të Zeza në lidhje me ndërtimin e paqes (intervista e RrGK, 2020).

elita në pushtet dhe as shumica e popullsisë nuk kanë hequr dorë nga trashëgimia e ish-regjimit kriminal. Ne [si Gratë në të Zeza] kemi qenë gjithmonë të pabindura: duke filluar nga viti 1991, në regjimin kriminal dhe pas vitit 2000, ndaj autoriteteve që nuk u shkëputën rrënjësisht… me politikën luftarake dhe krimet e luftës. Ne [aktivistet] kemi përfaqësuar gjithmonë një pakicë të vogël në Serbi: të shtyrë në margjina, të stigmatizuar, të etiketuar dhe të kriminalizuar, ne gjithmonë kemi qenë "një turp për Serbinë dhe popullin serb", ekskluzivisht për shkak të thirrjeve tona të pandërprera për përgjegjësi për luftën dhe krimet e luftës që janë kryer në emrin tonë.[144]

Gratë serbe anëtare të Grave në të Zeza hoqën dorë nga dhuna e kryer nga qeveria serbe, duke theksuar se ajo "nuk ishte në emrin e tyre". Ato bënë thirrje për t'i dhënë fund dhunës dhe për të vendosur paqe.




"Për Paqen në Kosovë", shkruhet në banderolë, gjatë një demonstrate të Grave në të Zeza në Beograd. © Gratë në të Zeza (arkivë)




Gratë në të Zeza protestojnë në Beograd gjatë viteve 1990. © Gratë në të Zeza (arkivë)

[144] Stasha Zajoviq, fjalim, Konferenca e Koalicionit të Grave për Paqe, Strugë, 2006.

Gjatë viteve 1990, gratë shqiptare dhe serbe u bashkuan si pjesë e takimeve ndërkombëtare të Grave në të Zeza të mbajtura në Serbi, të cilat mblodhën gra nga e gjithë bota për të sjellë vëmendjen ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut fillimisht në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe më vonë në Kosovë. Aktivistet e të drejtave të njeriut nga Kosova si Igballe Rogova, Shukrije Gashi, Marte Prenkpalaj, Nazlije Balaj dhe Rachel Wareham morën pjesë në disa takime ku gratë shqiptare dhe serbe qëndronin krah për krah, duke bërë thirrje për paqe dhe siguri në rajon. Ato qëndruan së bashku në rrugët e Beogradit, duke protestuar në heshtje me shenja dhe me trupat e tyre si vende të rezistencës.[145] Kalimtarët shpesh i kërcënuan ato dhe madje i pështynë, por ato qëndruan të qeta, të vendosura dhe të përkushtuara në protestat e tyre javore, ndëretnike dhe paqësore kundër dhunës gjatë viteve 1990. Edhe kur shqiptarët u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre gjatë luftës, gratë shqiptare dhe serbe mbanin marrëdhënie të afërta, duke iu përmbajtur punës së tyre të përbashkët përtej kufijve drejt paqes.

Ndërkohë, gjatë viteve 1990 dhe më pas, gratë serbe në Serbi mbështetën dokumentimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut që ndodhën në Kosovë. Për shembull, Qendra për të Drejtën Humanitare (QDH) e themeluar në vitin 1992 nga aktivistja e njohur për të drejtat e njeriut Natasha Kandiq, si një organizatë joqeveritare për të drejtat e njeriut, ka dokumentuar krime lufte dhe shkelje të të drejtave të njeriut që nga ajo kohë. Gjatë viteve, QDH ka mbledhur më shumë se tre milion dosje në lidhje me konfliktet e armatosura në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë.[146] Në Kosovë, QDH u themelua në vitin 1997 si një zyrë degë e QDH dhe vazhdoi të punojë pas luftës, që nga viti 2011, si një organizatë e pavarur, për të dokumentuar fakte që do ta ndihmojnë Kosovën në trajtimin e së kaluarës.[147]

Një tjetër aktiviste e njohur për të drejtat e njeriut, Sonja Biserko, ka shërbyer si themeluese dhe drejtore e Komitetit Serb të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Ajo ka kryer një punë të gjerë ndërkufitare në dokumentimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut në luftërat e Kroacisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës. Për punën e saj, ajo u emërua si pjesë e iniciativës "1000 Gra të Paqes" për Çmimin Nobel në vitin 2005.[148]

Kështu, gratë kontribuan për paqen përmes bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërkufitar, duke ndërtuar marrëdhënie paqësore midis disa shqiptarëve dhe serbëve.

## Kontributet e grave në dokumentimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri përmes dokumentimit të abuzimeve të të drejtave të njeriut gjatë viteve 1990. Për të mbledhur mbështetjen ndërkombëtare për një ndërhyrje paqësore, dokumentimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut ishte një strategji kryesore për shqiptarët e Kosovës. Në këtë drejtim, disa gra, përfshirë vajzat, të përfshira në OSHC-ë duke mbledhur prova të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe duke ua shpërndarë këtë KB, organizatave ndërkombëtare të të drejtave të nje-

> "Ne si gra bëmë një peticion kur një fëmijë u vra nga serbët në fillim të okupimit, i quajtur Afrim Prebreza. Në përgjigje të kësaj vrasjeje dhe krimeve që po ndodhnin, unë paraqita peticionin në KB në Gjenevë në vitin 1992, në Komisionin për të Drejtat e Fëmijëve, në emër të Kosovës. Ky Komision sapo ishte krijuar."
>
> **Edita Tahiri**

[145] Siç vërehet më përgjithësisht në konceptin e Harcourt të trupit si rezistencë (*Trupat në Rezistencë. Gjinia dhe politika seksuale në epokën e neoliberalizmit*, 2017).

[146] Shiko: http://www.hlc-rdc.org/?page_id=14390&lang=de.

[147] Shihni më shumë në: https://www.hlc-kosovo.org/en/about-us.

[148] Shihni më shumë në: http://rwlsee.org/members/sonja-biserko/.

riut, qeverive të huaja dhe mediave. Një nga OSHC-të e para të themeluara në Kosovë ekzistoi pothuajse vetëm për këtë qëllim: Këshilli i lartpërmendur për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ). Sipas QKSGJ, "një grup avokatësh dhe intelektualësh të tjerë themeluan KMDLNJ më 14 dhjetor 1989 për të avancuar të drejtat e njeriut sipas standardeve ndërkombëtare dhe për të informuar komunitetin ndërkombëtar për abuzimet e të drejtave të njeriut në Kosovë". Më shumë se 2,000 vullnetarë morën pjesë në rrjet, duke përfshirë shumë gra.[149] Sipas QKSGJ, gratë që punonin për KMDLNJ "guxuan veçanërisht në situata të rrezikshme për të dokumentuar abuzimet e të drejtave të njeriut". Për shembull, mbrojtësja e re e të drejtave të njeriut Zahrije Podrimçaku kujtoi për QKSGJ punën e saj në vitin 1998:

> Kur ndodhi masakra e Poklekut, unë e mbulova ngjarjen nga rreth peseqind metra larg. Unë pashë se si u vranë dhe u dogjën më vonë. Pasi forcat serbe u tërhoqën, unë doja të shihja nga dora e parë se çfarë ndodhi. Kishte rreth njëzet burra atje me mua (përfshirë gazetarë) të cilët unë kërkova të vijnë së bashku. Ata nuk pranuan. Njëri prej tyre më tha: "Ata kanë vdekur tani. Pse doni të shkoni dhe të vriteni edhe ju?" Vendosa që të shkoja sido që të ishte. U bashkua me mua një aktivist nga Drenasi, i cili më vonë më tha se mendoi me vete në atë moment, "Nëse kjo e re po do të shkojë, atëherë unë do t'i bashkohem".[150]

Podrimçaku transportoi dokumentacion të detajuar të shkeljeve të të drejtave të njeriut në rajonin e Drenicës, ndonjëherë duke ecur disa kilometra natën për të dërguar provat.

Sipas QKSGJ, "dokumentimi i masakrave ishte një punë jashtëzakonisht e rrezikshme që përfshinte ngacmime të vazhdueshme të policisë". QKSGJ dokumentoi përvojën e aktivistes së re të asaj kohe për të drejtat e njeriut Nazlije Balaj, e cila kujtoi:

> … duke mbërritur në punë për të gjetur policinë serbe të mbledhur rreth zyrës së KMDLNJ. Ndërsa ndërtesa ishte nën rrethim dhe policia nuk i lejonte punonjësit të hynin, Balaj i tha policisë: "Ju mund ta mbani ndërtesën të rrethuar, por unë do të përfundoj punën time." Policia ishte e dhunshme në përpjekjet e saj për ta ndaluar atë, por ajo arriti të hynte në ndërtesë. Ajo menjëherë shkroi një raport të shkurtër rreth rrethimit dhe e dërgoi atë përmes postës elektronike në zyra të ndryshme diplomatike në Prishtinë dhe në Beograd.[151]

"Gratë e reja që flisnin anglisht, si unë, kontribuan për të përkthyer për media të ndryshme ndërkombëtare."

**Gazetare shqiptare, Prishtinë**

Podrimçaku, Balaj dhe të reja të tjera që punuan për KMDLNJ iu ekspozuan rreziqeve të mëdha për të transportuar dokumentacionin e krimeve dhe shkeljeve të të drejtave, drejt inkurajimit të një ndërhyrje paqësore.[152] "Në fushën e të drejtave të njeriut, ne [gratë] kemi pasur barrën kryesore, si ambasadore, duke ngritur çështjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut

[149] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 38-39. Për të përmendur disa: Lirije Osmani, Elfete Spahiu, Elmije Plakaj, Florina Duli, Flaka Surroi, Dr. Flora Brovina, Dr. Flora Doko, Nazlije Balaj, Nekibe Kelmendi, Sanije Bodjaku, Sevdije Ahmeti, Shqipe Ahmeti, Shukrije Gashi, Dr. Vjosa Dobruna, Xheraldina Vula, dhe Zahrije Podrimçaku.

[150] Po aty f. 141

[151] Po aty.

[152] Po aty f. 92-93.

në Kosovë," kujtoi Nazlije Balaj.[153] Disa nga këto gra, si e reja Podrimçaku, u përballën me pasoja të mëdha për punën e tyre, duke u burgosur e torturuar.[154]

Shumë vajza punuan si përkthyese për mediat e huaja, duke kontribuar gjithashtu në dokumentimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut, dhe shpesh duke e vënë veten në rrezik.[155] "Gratë nuk rrinin ulur dhe vetëm të shikonin", tha një gazetare që raportoi për masakrën e Prekazit.[156] "Ne po bënim punën tonë. Ne po raportonim. Ne po ndiqnim situatën e plotë, duke mbledhur informacione nga terreni dhe qytetet dhe duke i shpërndarë ato në agjencitë tona ndërkombëtare, "tha gazetarja Afërdita Saraçini-Kelmendi për QKSGJ.[157] Xheraldina Buçinca-Vula gjithashtu kujtoi për QKSGJ punën e bërë në RTV21 nga tetori 1998 deri në fillim të vitit 1999:

> Situata në Kosovë ishte e tmerrshme. Pas orës tre ose katër pasdite, asnjë shpirt nuk ishte në rrugë. Vinte erë lufte, por ne duhet të bënim atë që duhej të bënim. Në RTV21 shpesh kemi punuar deri në mesnatë dhe më pas kemi shkuar në shtëpi me veturë. Ishte e frikshme; në rrugë shihje vetëm serbë me armë. Ne kishim radio transmetime përmes internetit, një mjet i madh për përhapjen e informacionit rreth asaj që po ndodhte këtu.[158]

Në vitin 1998, RTV21 ishte radio transmetimi i parë shqiptar i Kosovës i disponueshëm në internet,[159] dhe kështu luajti një rol kyç në shpërndarjen e informacionit ndërkombëtarisht.

Kështu, vajzat aktiviste, gazetare dhe përkthyese për mediat e huaja u përpoqën të dokumentojnë abuzimet e të drejtave të njeriut dhe të tërheqin vëmendjen ndërkombëtare për dhunën që po ndodhte në Kosovë, duke përfshirë gjendjen e vështirë të civilëve, drejt inkurajimit të mbështetjes ndërkombëtare në zgjidhjen paqësore të situatës.

> [Vajzat] ishin të angazhuara në agjenci lajmesh, media të shkruara, [duke punuar si] gazetare në terren. Në atë kohë, vajzat 15 deri në 16 vjeç në qytete angazhoheshin sepse kishte një vullnet të fortë mes njerëzve për të bërë diçka. Ata u frymëzuan nga veprimet e aktivisteve dhe shoqërisë civile [të tilla si] Motrat Qiriazi, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Sanije Grajçevci. Ata ndoqën gratë që punuan në Ilegale [që vuajtën] vite burgim [për aktivizmin e tyre].[160] … Përmes veprimeve të tilla, burrat gjithashtu kanë parë që gratë mund të kryejnë [këto] veprime. …. Gratë vepruan kolektivisht për të mirën kolektive.
>
> **Shukrije Gashi, activist, Executive Director, Partners Kosova – Centre for Conflict Management**

---

[153] Intervistë e RrGK me Nazlije Balaj, Prishtinë, 2020

[154] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 141-142.

[155] Për shembull, kjo përfshinte Ilirijana Loxha, Nexhmije Fetahu, Vlora Nushi, Lirije Osmani, Nazlije Balaj, Shukrije Gashi, Zahrije Podrimçaku, Elfete Spahiu, Shqipe Ahmeti dhe Elmije Plakaj, ndër të tjera (QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*

[156] Intervista e RrGK me një grua gazetare shqiptare, Prishtinë, 2020

[157] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 139

[158] Po aty.

[159] Po aty f. 125

[160] Në artikullin e saj, "Ilegalja: Gratë ne Lëvizjen e Rezistencës së fshehtë Shqiptare në Kosovë", antropologia Elife Krasniqi shkruan se "Ilegalja" ishte "lëvizje e fshehtë e shqiptarëve të Kosovës që përbëhej nga grupe të vogla ilegale të cilat zakonisht vepronin në formën e qelizave të vogla, duke u përfshirë në akte nga ato të shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe librave të paligjshëm deri në organizimin e protestave dhe kryerjen e akteve të ndryshme të përmbysjes kundër autoriteteve." Edhe pse këto grupe filluan të vepronin disa dekada më parë dhe kishin qëllime të ndryshme me kalimin e kohës, gjatë viteve 1980-ta, këto grupe synuan të promovojnë autonominë e Kosovës brenda Jugosllavisë" (QKSGJ, Histori është edhe tregimi i saj). Gratë dhe vajzat luajtën rol kyç brenda Ilegales, e cila përfshinte organizimin e demonstratave paqësore dhe, në përgjithësi, kërkimin e të drejtave të barabarta, lirinë nga diskriminimi dhe sigurinë.

## Kontributet e grave në demonstrata paqësore

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri përmes angazhimit të tyre në demonstrata paqësore gjatë viteve 1990. Gratë luajtën rol vendimtar në organizimin e protestave paqësore. Sipas Clark, ishin të rinjtë dhe gratë që drejtuan përpjekjet paqësore të rezistencës "aktive", të cilat shkuan përtej rezistencës "pasive" të udhëhequr nga LDK.[161] Ndërsa Presidenti i Kosovës i zgjedhur paralelisht që vinte nga LDK-ja, Ibrahim Rugova, i këshilloi me forcë njerëzit të mos ndërmerrnin ndonjë veprim të drejtpërdrejtë publik, nga frika se mund t'i vinte ata në rrezik të hakmarrjes nga forcat serbe, frustrimi midis shqiptarëve u rrit me kalimin e kohës, veçanërisht pasi dhuna u përshkallëzua dhe civilët u përndoqën nga shtëpitë e tyre.[162] Kështu, të rinjtë dhe gratë filluan të shpërfillin udhëzimet e Rugovës për rezistencë pasive, duke organizuar rezistencë aktive paqësore përmes një vargu demonstratash.[163]

Në vitin 1996, gratë refuzuan të qëndronin pasive ndaj padrejtësive që ishin duke ndodh, veçanërisht pasi një snajper civil serb goditi dhe vrau një djalë të ri.[164] Ato vendosën të thyejnë rezistencën pasive të kërkuar nga Rugova dhe dolën në rrugë. Gratë në politikë dhe aktivistet, Edi Shukriu, Naxhije Buçinca, Sevdije Ahmeti, Vjosa Dobruna dhe Flora Brovina udhëhoqën një protestë të mijëra grave që vendosën lule dhe qirinj aty ku u vra i riu.[165] Më vonë, në prill 1996, një numër më i vogël i grave kërkuan mbështetje ndërkombëtare për rezistencën e tyre paqësore përmes një letre dërguar KB, Këshillit të Evropës dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).[166]

Studentët, përfshirë vajzat, gjithashtu u angazhuan në rezistencë aktive paqësore përmes demonstratave. Pas protestës studentore të vitit 1981, sipas Clark, autoritetet serbe e konsideruan Universitetin e Prishtinës "fole të nacionalizmit shqiptar", që bëri që regjimi të zvogëlojë stafin dhe studentët e Universitetit.[167] Pastaj, në fillim të vitit akademik 1991-1992, policia serbe bllokoi hyrjen e studentëve në Universitet.[168] Si pjesë e sistemit paralel të arsimit, shqiptarët e Kosovës organizuan ligjërata universitare të fshehta, në 250 lokale private, duke filluar nga 17 shkurt 1992.[169] Vite më vonë, në vitin 1996, studentët organizuan një protestë për të kërkuar që autoritetet serbe të rihapin Universitetin për afatin e vjeshtës.[170] Studentja, artistja dhe aktivistja e atëhershme e re Ilirijana Loxha kujton:

> Ne i konsideronim protestat si të domosdoshme. Protestat ishin mënyra sesi ne, të rinjtë, po përballeshim me të keqen. Ishte një luftë që vinte nga bota e brendshme e të rinjve, e shprehur përmes zemërimit dhe vendosmërisë, për të mos lejuar askënd të shkatërronte shpirtin tonë. Alternativa e vetme ishte paqja. Vizioni i paqes ishte më i qartë se kurrë më parë. Ne e donim Kosovën pa të shtëna armësh, pa gaz lotsjellës. Vizioni ynë i përbashkët ishte një Kosovë e paqes, një Kosovë pa mure. ... Padyshim që roli i grave ishte i padiskutueshëm dhe shumë domethënës në të gjitha ngjarjet që ndodhën në atë kohë. Gratë ishin një burim frymëzimi për të ecur përpara. Ato ishin iniciatore të shumë protestave, duke treguar se ne jemi

[161] Clark, *Rezistenca Civile në Kosovë*, faqe 40-41.

[162] Po aty.

[163] Po aty.

[164] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 103

[165] Shih QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 104-105.

[166] Po aty.

[167] Clark, f. 101.

[168] Po aty.

[169] Po aty.

[170] Po aty, f. 125

të fortë dhe të pathyeshëm.

> Zakonisht ishte detyrimi ynë, si gra, të përgatisim lecka kundër gazit lotsjellës para protestës. Mbaj mend që përgatisja qindra lecka kundër gazit lotsjellës me gazë dhe qepë. Ne i merrnim me vete në mënyrë që t'i shpërndanim te protestuesit në mënyrë që sytë e tyre të mos lëndohen. Ato ishin shumë të dobishme sepse policia gjithmonë hidhte gaz lotsjellës. Më kujtohet gjatë protestës së vitit 1996, policia serbe hodhi aq shumë gaz lotsjellës, dhe ishte duke rrahur kaq shumë studentë. Isha me taka të larta, dhe na duhej të vraponim shpejt. Ne u fshehëm në një shtëpi që pastaj u rrethua nga policia serbe. Nuk mund të dilnim. Ne pritëm të fshehur për një ose dy orë, dhe pastaj filluam të vraponim dhe të vraponim....[171]

Krahas asaj që vajzat protestuan si studente, disa gra gjithashtu ishin të gatshme dhe të disponueshme për të ndihmuar studentët mes dhunës së policisë.[172]

Për më tepër, Ilirijana Loxha gjithashtu shpjegoi se "Të nxitur nga kjo gatishmëri për të shembur muret, ne [një grup i ri artistësh] themeluam Shoqatën e Arteve Ghetto, për ta kthyer artin e rezistencës në rezistencë të artit". Ata organizuan disa shfaqje, ekspozita dhe filma, të cilët gjithashtu u përdorën për të rritur ndërgjegjësimin ndërkombëtar për situatën në Kosovë, drejt një zgjidhjeje paqësore të konfliktit.

Në vitin 1998, gratë organizuan një varg protestash paqësore në Prishtinë në përpjekje për të tërhequr vëmendjen ndërkombëtare për situatën në Kosovë. Gratë nga politika dhe shoqëria civile organizuan këto demonstrata masive.[173] Gratë aktiviste besuan se mënyra më e mirë për të mobilizuar njerëzit në mënyrë të sigurt ishte informimi i tyre për demonstratat e ardhshme përmes mediave. Gazetarja Valentina Saraçini, e cila ka punuar për të *Deutsche Welle* në atë kohë, kujtoi QKSGJ se ajo i informoi dëgjuesit pak para se të planifikohej të fillonte një demonstratë:

> "Gratë kishin role kyçe kur bëhej fjalë për rezistencën dhe për të shtyrë përpara proceset. Gratë ishin në vijën e frontit në protesta, për të ngritur zërin e tyre kundër shtypjes. Për shembull, gratë ngritën një lëvizje për të ecur nga Prishtina në Drenicë, për t'i furnizuar me bukë. ... Ato treguan guximin e tyre dhe ngjarja u mbulua nga media."
>
> **Yllka Soba, Prishtinë**

> Sevdija [Ahmeti] më thirri dhe më tha, "A mund t'i njoftoni njerëzit në *Deutsche Welle*?" Unë i thashë: "Sigurisht". Unë raportova, dhe pastaj vrapova në shtëpinë time për të marrë regjistruesin tim sepse doja të isha në fillim të protestës. Në ndërtesën time të banesës ishin dyzet e dy familje dhe ndërsa po vija poshtë, pashë të gjithë fqinjët e mi që dilnin për të protestuar. Pashë shumë gra që dolën për t'u bashkuar me protestën. Në atë moment pashë fuqinë e medias.[174]

Në 1 mars, afërsisht 2,000 gra demonstruan jashtë Zyrës së Shërbimit Informativ të Shteteve të Bashkuara (USIS), pararendëse e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara (SHBA.). Ditën tjetër, mbi 100,000 njerëz erdhën për

[171] Komunikimi i RrGK me Ilirijana Loxha, 2021.

[172] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 106.

[173] Organizatoret përfshinin Sevdije Ahmeti, Vjosa Dobruna, Igballe Rogova, Safete Rogova, Edita Tahiri, Melihate Tërmkolli, Flora Brovina dhe Edi Shukriu (QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 114-115).

[174] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 110

të treguar mbështetje, me më shumë demonstrata që pasuan javën tjetër.[175] Sipas Clark, "Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 mars, gratë u kthyen tek USIS duke mbajtur në ajër mbi kokë letra të bardha për të simbolizuar mungesën e të drejtave në Kosovë".[176]

Demonstrata më e njohur u zhvillua në 16 mars: marshimi i grave "Bukë për Drenicën". Gratë organizatore dërguan një mesazh zyrtar për disa media dhe USIS, duke shpjeguar arsyet e marshimit të tyre, siç citohet nga QKSGJ:

> Ne gratë e Kosovës do të ecim drejt Drenicës për t'u solidarzuar me gratë dhe për tu dhëne bukë fëmijëve të cilët ishin mbyllur nga forcat serbe të policisë dhe ushtrisë. Në Drenicë u vranë fëmijë dhe gra, gra shtatzëna, të moshuar dhe njerëz të paralizuar. Nënat morën fëmijë për t'i shpëtuar, por fëmijët e tyre vdiqën në të ftohtin e acartë. Terrori vazhdon, spastrimi etnik vazhdon. Asnjë derë shprese nuk është hapur. Ne jemi të vetëdijshme se nuk është e mjaftueshme që komuniteti ndërkombëtare vetëm të flasë, pa ndonjë hap konkret për veprim. Ne vendosëm që me bukë në duar do të jemi përkrah popullit të Drenicës. Bota duhet ta kuptojë se duke marrë parasysh shumë viktima, vite lufte psikologjike dhe mekanizma të dhunshëm mbi ne, të gjithë jemi në rrezik. I gjithë komuniteti shqiptar në Kosovë është në rrezik.[177]

Rreth 12,000 gra që mbanin bukë filluan një marshim të paracaktuar prej 50 kilometrash nga Prishtina për në zonën e rrethuar të Drenicës.[178] Buka që mbanin gratë simbolizonte nevojat themelore të njerëzve që ishin të paplotësuara. Megjithëse policia serbe i ktheu ato përsëri në Prishtinë, demonstrata shumë vizuale arriti të fitojë vëmendjen e mediave ndërkombëtare.[179] Më vonë, më 25 mars 1998, gratë organizuan një demonstratë tjetër duke bërë thirrje për një "shkurorëzim paqësor" nga Serbia.[180]

Demonstratat synuan të tërheqnin vëmendjen ndërkombëtare për pasiguritë me të cilat përballen shqiptarët në Kosovë, duke bërë thirrje për një ndërhyrje ndërkombëtare dhe zgjidhje paqësore të konfliktit që përshkallëzohej. Në të vërtetë, aktivistet vunë re se këto demonstrata patën sukses në tërheqjen e vëmendjes ndërkombëtare ndaj kërcënimeve të sigurisë me të cilat përballen shqiptarët. Njëkohësisht, duke treguar veten e tyre publikisht, gratë aktiviste që drejtuan demonstratat besuan se ato luftuan stereotipet e lartpërmendura që shfaqeshin në mediat serbe dhe ndërkombëtare për gratë shqiptare; siç u tha nga QKSGJ, ato ilustruan se "ato ishin po aq moderne sa gratë e Evropës".[181] Potencialisht, kjo mund të kontribuojë në uljen e "tjetërsimit" dhe kështu të mbështesë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin drejt paqes.

Disa aktiviste jo-shqiptare që jetonin në Kosovë u solidarizuan gjatë rrethimit të Drenicës, sipas Hanimshahe Ilazi, e cila shkroi në ditarin e saj: "Gratë ngritën zërin e tyre kundër masakrave në Drenicë. Nga kjo ditë kur u ndezën mijëra qirinj, gratë dhe vajzat shqiptare, turke dhe egjiptiane nga Prishtina vazhdimisht i dhanë solidaritet Drenicës".[182] Ndërkohë, ky hulumtim nuk zbuloi shembuj të grave serbe në Kosovë që iu bashkuan demonstratave. Një grua serbe shpjegoi:

---

[175] Clark, *Rezistenca Civile në Kosovë*, f. 174.

[176] Po aty, f. 175.

[177] Shih QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 114.

[178] Po aty;

[179] Për shembull, shihni arkivin e Associated Press, "Kosovë: Gratë Protestuese Shqiptare të Kthyera nga Policia Serbe", 16 mars 1998.

[180] Po aty;

[181] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 118.

[182] Po aty f. 110.

Ju nuk mund të prisni që vajzat (15-29) të kontribuojnë gjatë konfliktit dhe në periudhën e parë pas konfliktit. Së pari, ai interval moshe ndahet në dy grupe: 1) ato që ishin shumë të vogla dhe kishin nevojë për mbrojtje nga prindërit e tyre; dhe 2) ato që ishin martuar tashmë dhe kishin fëmijët e tyre për t'u shqetësuar. Disa ishin në fakultet. Ndoshta ato patën një mundësi për t'u angazhuar në ndonjë formë, mbase në disa aktivitete universitare. Vajzat ishin të përfshira në shpërndarjen e ndihmave humanitare, por jo në protesta publike.[183]

Një përgjigje e përsëritur ishte se gratë serbe nuk ishin të përfshira në protesta publike për paqe gjatë asaj kohe, sepse kushtet e përgjithshme kontekstuale nuk i lejonin ato të angazhoheshin. Fakti i lartpërmendur që burrat dominonin politikën, së bashku me rolet tradicionale gjinore të grave, gjithashtu penguan angazhimin e tyre. Gratë kishin nevojë për të mbajtur familjet dhe fëmijët e tyre të sigurt, duke mos u përfshirë në veprimtari politike dhe potencialisht të pasigurta, thanë ato. Përjashtime që nuk janë identifikuar përmes këtij hulumtimi mund të kenë ekzistuar.

Në përgjithësi, siç ilustron kjo nën-pjesë, gratë shqiptare të Kosovës, përfshirë edhe vajzat, morën pjesë në disa demonstrata paqësore që synonin të tërhiqnin vëmendjen ndërkombëtare për gjendjen e vështirë të shqiptarëve në Kosovë, drejt një ndërhyrje ndërkombëtare dhe një zgjidhjeje paqësore të konfliktit që përshkallëzohej. Në disa raste, ato patën sukses në grumbullimin e mbështetjes së një mbulimi ndërkombëtar.

## Kontributet e grave në diplomaci

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri përmes diplomacisë gjatë viteve 1990. Në vitin 1995, 10 gra nga Kosova morën pjesë në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë në Pekin, Kinë. Edi Shukriu, Edita Tahiri, Shefkije Mullaademi dhe Saranda Vidishiqi përfaqësuan qeverinë paralele të Kosovës, ndërsa Afërdita Saraçini-Kelmendi, Alisa Maliqi, Naxhije Buçinca, Sevdije Ahmeti, Vjosa Dobruna dhe Xheraldina Buçinca-Vula morën pjesë në Forumin jo-qeveritar paralel të Grave në Huariou. Përmes grupeve të punës, aktivistet nga Kosova kontribuan në Platformën e Pekinit për Veprim, strategjinë globale që rezultoi nga kjo konferencë.[184]

Delegacioni i Kosovës gjithashtu përgatiti dhe prezantoi një raport që theksonte shkeljet e të drejtave të njeriut që ndodhin në Kosovë në atë kohë. Ato e shfrytëzuan konferencën për lobim diplomatik për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Kosovë. Pjesëmarrja në konferencë mbështeti gratë aktiviste dhe politikane në ndërtimin e marrëdhënieve me gratë e tjera dhe mësimin nga përvojat e tjera. Disa njohuri të marra, të tilla si lidhur me zgjidhjen e konflikteve, do të përdoren më vonë nga gratë aktiviste në promovimin e paqes në Kosovë.[185]

> "Kjo konferencë kishte një rëndësi të madhe pasi aty filloi gjithçka që lidhej me gratë, paqen dhe sigurinë. Gratë donin që një rezolutë brenda KB të jepte të drejta për organizatat e të drejtave të grave në vendet pas konfliktit për të qenë aktorë në ndërtimin e paqes. Nuk mund të bashkohesha me gra të tjera nga Kosova pasi regjimi serb më kishte marrë pasaportën. "
>
> **Igballe Rogova**

[183] Intervista e RrGK-së me një grua serbe, Mitrovicë e Veriut, 2020

[184] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 95 Shiko gjithashtu, Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, 1995

[185] Për më shumë mbi pjesëmarrjen e tyre në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë në Pekin, Kinë, shih QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 95

“Ndërsa të gjitha delegacionet sollën raporte për gjendjen e grave, ne sollëm një raport për situatën e okupimit të Kosovës. Të drejtat e grave u përfshinë në vetëm një kapitull të atij raporti, dhe dy gra nga ekipi ishin të ngarkuara për shpërndarjen e raportit për sa më shumë pjesëmarrës të Konferencës që të ishte e mundur, pasi 50,000 gra nga e gjithë bota po merrnin pjesë”.

**Edita Tahiri**

Ndërsa konflikti u përshkallëzua dhe tërhoqi vëmendjen ndërkombëtare, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) ndërmjetësoi bisedimet e paqes midis Republikës Federale të Jugosllavisë dhe udhëheqësve shqiptarë të Kosovës në Kështjellën e Rambujesë në Francë në fillim të vitit 1999. Atje, NATO propozoi “Marrëveshjen e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë”. Në këto të ashtuquajtura “negociata të Rambujesë”, ekipi i Kosovës përfshiu një grua, Edita Tahirin, si anëtare e udhëheqjes politike të LDK-së dhe Ministrin e Jashtëm të emëruar për qeverinë paralele të shqiptarëve të Kosovës.[186] Ndërsa ajo kujtoi, “Ekipi negociues përbëhej nga 15 anëtarë. Kishte 14 burra. Unë isha gruaja e vetme që merrja pjesë në negociatat e paqes.”[187] Pozicioni i saj si anëtare e udhëheqjes politike të LDK-së i siguroi asaj një vend në tryezë.



Burimi: KosovaPress

Marrëveshja e Rambujesë përfundimisht çoi në ndërhyrjen e SHBA dhe NATO në Kosovë në vitin 1999.[188] Marrëveshja, e nënshkruar nga delegatët shqiptarë të Rambujesë, ra dakord që NATO të dërgojë një forcë ndërkombëtare të mbrojtjes, Forcën e Kosovës (KFOR), për një periudhë tri-vjeçare të ”vetëqeverisjes”. Zyrtarët serbë hodhën poshtë marrëveshjen e Rambujesë, veçanërisht propozimin për trupat e KB dhe KFOR-in për të hyrë në Kosovë dhe mundësinë për të vendosur një zgjidhje përfundimtare në lidhje me statusin e Kosovës tri vjet pas

[186] Wille, T., “Përfaqësimi dhe agjencia në diplomaci: Si arriti Kosova të pajtohet me marrëveshjet e Rambujesë”, *Gazeta e Marrëdhënieve dhe Zhvillimit Ndërkombëtar* 22.4 (2019): 808-831; Carson, K. etj. “Programi i Menaxhimit të Konflikteve Udhëtimi në terren i Studentëve në Kosovë”, 2010.

[187] Intervista e RrGK me Edita Tahiri, ish Kryenegociatore e Dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Prishtinë, 2020.

[188] Clark, f. 180-184.

nënshkrimit të marrëveshjes.[189] Sipas Tahirit, “konferenca e Rambujesë tregoi rezultate, duke i dhënë fund luftës në mënyrë indirekte, sepse Serbia nuk nënshkroi marrëveshjen e paqes. Kështu, [SH.B.A. dhe NATO] vendosën që NATO … të fillojë të bombardojë Serbinë, në mënyrë që të përdorë forcën për të sjellë paqen.”[190]

Ndërsa vetë ndërhyrja ushtarake përfshinte dhunë, shqiptarët e Kosovës, të cilët ishin përpjekur për më shumë se një dekadë për një zgjidhje paqësore të konfliktit, kanë thënë se bombardimet përfaqësonin një veprim të domosdoshëm drejt vendosjes së paqes; kjo do të ishte në përputhje me nocionin neoliberal të sigurisë.[191] Duhet cekur se mes bombardimeve, forcat serbe përshkallëzuan masakrat e civilëve, përdorën dhunë seksuale ndaj grave dhe rritën dëbimin e gjerë të detyruar të shqiptarëve nga Kosova.[192] Njerëzit në Serbi gjithashtu përjetuan dhunën e bombardimeve të NATO-s.[193] Kështu, bombardimet gjithashtu kontribuan në disa pasiguri, duke përfshirë ato për gratë e të gjitha etnive.

Ndërkohë, disa gra të tjera politikane, gazetare dhe aktiviste, vepruan jozyrtarisht si diplomate, duke u takuar me diplomatë dhe media të huaja për të tërhequr vëmendjen ndërkombëtare tek abuzimet e të drejtave në Kosovë dhe për të kërkuar një ndërhyrje paqësore. Veçanërisht, Afërdita Saraçini-Kelmendi dhe Vjosa Dobruna udhëtuan në Uashington D.C. në prill 1999 për të bërë thirrje për një ndërhyrje të menjëhershme. Ato u shfaqën në Shërbimin Publik të Transmetimit Publik të SHBA (PBS) Ora e Lajmeve, Edicioni i Hershëm i CNN dhe shfaqjen e Larry King Live, duke treguar historitë e tyre personale të ditëve të kaluara duke u fshehur nga policia dhe dëbimi. Më 13 prill, Dobruna dhe Saraçini-Kelmendi u takuan me Zonjën e Parë të atëhershme Hillary Clinton dhe Sekretaren e Shtetit Madeline Albright. Të njëjtën ditë ato dëshmuan në Komitetin e Senatit të SHBA në Nënkomitetin e Gjyqësorit për Imigracionin. Gjatë kësaj seance, Dobruna deklaroi:

> “Në SHBA. fola me gjuhën që vjen nga zemra dhe u tregova shumë njerëzve si senatorëve, kongresmenëve dhe zonjës së parë. Ne ishim të parët në stacione të ndryshme televizive dhe ishim femra. Ne nuk po përdornim gjuhë politike. Ne përdorëm gjuhën e grave. ”
>
> **Afërdita Saraçini-Kelmendi[194]**

> Unë dua të them një pikë të rëndësishme këtu për njerëzit që janë larguar nga Kosova. Këta njerëz, përfshirë edhe unë, nuk janë refugjatë. Ne jemi të dëbuar. Ne jemi detyruar të braktisim shtëpitë tona. Ne nuk e kemi zgjedhur këtë. Ne nuk vrapuam, edhe pse kushtet ishin shumë të këqija. Qëndruam derisa na dëbuan. Kështu që unë ju kërkoj të na referoheni si të dëbuar, jo si refugjatë ju lutem... Të dëbuarit trajtohen si të burgosur, jetojnë në ambient të hapur, nuk kanë qasje në ujë të pastër dhe agjencive ndërkombëtare të ndihmës dhe gazetarëve u mohohet hyrja në kamp. […] Unë e di që ky komitet merret kryesisht me refugjatët, imigracionin, jo me çështjet ushtarake. Por imigrimi në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara nuk është përgjigjja për të dëbuarit nga Kosova. Për ne, ka vetëm një përgjigje - të shkojmë në shtëpi në siguri, të rindërtojmë jetën tonë dhe të rindërtojmë shtëpitë tona.[195]

---

[189] Po aty, f. 181-183.

[190] Intervista e RrGK me Edita Tahirin, 2020.

[191] Bisedat e autorit me shqiptarët e Kosovës, përfshirë aktivistet e të drejtave të grave.

[192] Për shembull, shih Human Rights Watch, *Kosovë: Përdhunimi si një armë e "Pastrimit Etnik"*, SHBA: HRW, 1998; Fitamant, S., "Raporti i Vlerësimit të Dhunës Seksuale në Kosovë", New York: UNFPA, 2000; dhe disa intervista.

[193] France24, *20 vjet më vonë, viktimat serbe të bombardimeve të NATO-s ndihen të harruara*.

[194] Cituar nga QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 150

[195] Zyra e Shtypit e Qeverisë Amerikane, "Dëgjim mbi Imigracionin e Komitetit për Gjyqësor, Senati i Shteteve të Bashkuara", S. Hrg. 106-443, 2000

Përpjekjet e tyre kontribuan në tërheqjen e vëmendjes ndërkombëtare ndaj situatës në Kosovë, drejt vendosjes së paqes dhe sigurisë.

Kështu, vajzat gjithashtu shërbyen si diplomate gjatë viteve 1990, duke u angazhuar në mënyrë aktive në forma të ndryshme të diplomacisë ndërkombëtare. "Gratë ishin shumë aktive në ngritjen e vetëdijes për padrejtësinë dhe shtypjen gjatë viteve '80 dhe '90," vërejti një përfaqësues i shoqërisë civile.[196] Përsëri, këto përpjekje synuan të inkurajojnë një ndërhyrje ndërkombëtare dhe zgjidhje paqësore të konfliktit.

## Organizimi i grave për sigurinë e personave të zhvendosur

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri përmes ndihmës humanitare dhe mbështetjes për personat e zhvendosur dhe refugjatët në vitet 1998 dhe 1999. Duke filluar nga viti 1998, gratë aktiviste gjetën strehë për gratë dhe fëmijët e zhvendosur nga shtëpitë e tyre në rajonin e Drenicës. Ndërkohë, të anketuarit serbë theksuan rolin e grave në shpërndarjen e ndihmës humanitare dhe sigurimin e shërbimit mjekësor përmes Kryqit të Kuq dhe OSHC-së së Rrethit të Motrave Serbe, si kur refugjatët mbërritën në Kosovë nga Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina, duke filluar në 1991,[197] por gjithashtu më vonë kur gratë serbe ofruan ndihmë humanitare gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999. "Gratë u përfshinë përmes punës humanitare, kryesisht shpërndarjes së ndihmave humanitare ... Kishte solidaritet brenda kësaj pune," kujton një aktiviste serbe për të drejtat e grave.[198]

> "Në atë kohë, shumë civilë u prekën nga operacionet ushtarake. Kështu që, për shembull, gratë dhe fëmijët nga Bajgora erdhën në Mitrovicë për shkak të konfliktit, ata u mirëpritën me ushqim, ujë dhe ndihma të tjera të nevojshme. Pra, megjithëse palët serbe dhe shqiptare po luftonin, ne nuk i bënim dallimet etnike kur bëhet fjalë për ndihmën humanitare. Kur shihni dikë me një fëmijë në një situatë të tillë, etnia e tij është e parëndësishme, dhe gjithçka që dëshironi të bëni është të ndihmoni. ... Unë nuk kisha ndonjë informacion në lidhje me OShC-të shqiptare, por nga këndvështrimi i sotëm, unë e kuptoj që OShC-të e drejtuara nga gratë shqiptare ishin shumë më të përparuara sesa ato serbe. Ndryshe nga komunitetet jo-shqiptare, shqiptarët kishin një sektor të shoqërisë civile të zhvilluar. "
>
> **Aktiviste serbe, Mitrovica Veriore**

Kur mijëra shqiptarë u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre, përfshirë edhe me armë, gratë u mobilizuan edhe pse ishin vetë refugjate. Në "Zonën Neutrale" të Bllacës në kufirin midis Kosovës dhe Maqedonisë, Igballe Rogova ishte shumë e vendosur të bëj diçka në ruajtjen e paqes dhe parandalimin e dhunës nga trupat paraushtarake maqedonase kundër të dëbuarve civilë. Vetë e dëbuar në atë kohë, ajo kujtoi se si çdo mëngjes fillonte me lajmet tragjike të foshnjave të sapolindura ose të moshuarve që vdisnin gjatë natës:

> Duhej të bënim diçka, nuk mund të qëndronim ulur atje dhe të mos bënim asgjë ndërsa njerëzit vdisnin në ato kushte. Na u desh të bënim një protestë. Ne krijuam një komitet organizues për të planifikuar protestën. Ne ramë dakord që të nesërmen në orën 11 të paradites të fillonim të palosnim valixhet tona dhe

[196] Intervista e RrGK me një aktiviste shqiptare dhe përfaqësuese të OSHC.

[197] Intervista e RrGK me një aktiviste serbe, Mitrovicë e Veriut, 2020.

[198] Intervista e RrGK, Prishtinë, 2020.

të bënim një rresht drejt kufirit me Maqedoninë. Pikërisht në mesditë ne do të fillonim të ecnim drejt kufirit ngadalë, por duke bërtitur me zë të lartë, "NDIHMË!" Të nesërmen, rreth orës 10 të paradites, erdhi një telefonatë nga një mik amerikan që jetonte në Maqedoni, "Igo, ti duhet ta ndalosh këtë protestë. Kjo do të çojë në një luftë më të madhe. Policia madje mund të qëllojë njerëzit!" Ai kishte të drejtë, ne duhet të ndryshonim planin tonë shpejt. Në vend që të ecnim drejt kufirit, ne vendosëm që thjesht të qëndronim në një rresht dhe të bërtisnim: "Ndihmë!" Ne e kishim të vështirë t'i bindnim njerëzit të ndryshonin planin tonë. Në orën 11 të paradites ata u ngritën dhe përgatitën valixhet. Unë po dridhesha, nga frika se njerëzit do të fillonin të ecnin. Por në ora 12, të gjithë qëndruan në rresht në një vend dhe për një orë e gjysmë të gjithë bërtitëm, "NDIHME!" Policia ishte e zemëruar por nuk ndërhyri sepse ne nuk ecëm drejt kufirit. Pas thirrjeve njerëzit ngadalë shpalosen sendet e tyre dhe vazhduan të bisedonin me njëri-tjetrin. Pastaj erdhi një telefonatë. "Ia dole! Funksionoi! Sonte ata do të lejojnë njerëzit të hyjnë në Maqedoni!"[199]

Në të vërtetë, të njëjtën natë të protestës, forcat maqedonase lejuan njerëzit të hynin. Megjithëse diplomacia ndërkombëtare kontribuoi që Maqedonia të hapte kufirin e saj, aktorëve do t'u kishte munguar informacioni rreth situatës në Bllacë nëse aktivistët nuk do të kishin mobilizuar njerëzit për të ngritur zërin dhe për t'i bërë të njohura rrethanat për mediat ndërkombëtare.

Mes kaosit, gratë aktiviste u përpoqën të lehtësonin fillimet e një procesi shërimi.[200] QMGF, e themeluar nga Vjosa Dobruna në Maqedoni, siguroi shërbime themelore shëndetësore për gratë që qëndrojnë si refugjate me familjet pritëse në Maqedoni.[201] Meqenëse shumë familje ishin ndarë gjatë luftës nga trupat serbe në Kosovë, forcat e sigurisë në Maqedoni, ose mes udhëtimeve të tyre, kuptohet që njerëzit ishin shumë të shqetësuar për anëtarët e tyre të humbur të familjes, kështu që aktivistët u organizuan për të bashkuar familjet. Në një program të koordinuar nga Nora Shehu, QMGF bashkoi familjet duke organizuar takime për gratë në rajonet e Tetovës dhe Gostivarit të Maqedonisë. Flora Macula bashkëpunoi me Adi, një organizatë maqedonase, për të sjellë televizione dhe gazeta në mënyrë që njerëzit të mund të shihnin se kush po mungonte dhe të gjenin anëtarët e familjes.[202] Florina Duli ndihmoi në programin e ribashkimit të Save the Children, i cili vuri në dispozicion telefonat mobil në kampe në mënyrë që njerëzit të mund të gjenin anëtarët e familjes.[203]

Në Maqedoni, Motrat Qiriazi ngritën një tendë të madhe si hapësirë të sigurt për gratë dhe vajzat, për trajtimin psikologjik, mbështetur politikisht dhe financiarisht nga Fondacioni Kvinna till Kvinna. Ato avokuan për t'u përmbushur nevojat më urgjente të grave, të tilla si kujdesi shëndetësor, siguria nga dhuna dhe trafikimi në kampe, dhe furnizime për ciklin menstrual. Aktivistet rezistuan kundër agjencive të KB dhe mediave të huaja kur u kërkuan grave të qajnë, duke kërkuar të portretizojnë gratë në rolin e homogjenizuar të viktimave. Përkundrazi, aktivistët kërkuan që gratë të kishin zgjedhje dhe duhet të përfshiheshin në vendimmarrje në kampe, pasi ato e dinin më së miri se cilët hapa duheshin ndërmarrë për të ruajtur sigurinë e tyre. Aktivistet e të drejtave të grave bashkëpunuan me artistë për të organizuar koncerte dhe ngjarje të tjera që do të forconin moralin në kampet e refugjatëve. Siç kujtoi Safete Rogova, një aktore dhe aktiviste, "Ne, gratë aktiviste organizuam shfaqje në kampe. Ne po përpiqeshim të mos e ndienim veten si refugjatë, në mënyrë që t'u ngrisnim moralin e bashkëqytetarëve tanë. Fokusi ynë ka qenë në ndihmën për të tjerët, veçanërisht për gratë dhe fëmijët."[204]

---

[199] Igballe Rogova, Histori Personale, dokumenti i siguruar për RrGK.

[200] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 132.

[201] Po aty, f. 154

[202] Po aty, f. 151

[203] Po aty.

[204] Intervista e RrGK, Prishtinë, 2020.



© Motrat Qiriazi
Në kampin e Çegranes, Motrat Qiriazi bashkëpunuan me aktorë të komedisë dhe njerëz të tjerë për të vënë në skenë shfaqje teatrale dhe muzikë.

Për më tepër, përveç ndihmës humanitare dhe një sigurie më të mirë, gratë aktiviste si Rreze Duli, Violeta Hoxha, Fitore Hajrullahu dhe Eliza Hajrullahu organizuan edukim dhe rehabilitim. Duli i shpjegoi QKSGJ:

> Ne filluam një shkollë jashtë kampit me një ndërrim vetëm për kosovarët. Drejtori i shkollës në fshat ishte shumë i mirë dhe UNICEF-i ndihmoi në negociata. Në fillim, kishim gjashtëqind fëmijë që shkuan në kopshtin e fëmijëve në fshat. Kishim një kopsht fëmijësh dhe një klasë punëtorie me shumë aktivitete. Kam organizuar trajnime të ndryshme me mësuesit se si të merremi me fëmijët e traumatizuar. Ne patëm trajnim për ndërgjegjësimin ndaj minave për fëmijët, sepse kishte shumë mina në Kosovë, veçanërisht në fshatra. Teatrot erdhën te ne. Fëmijët ishin aq të zënë, saqë ndonjëherë harronin se ishin refugjatë.[205]

Vajzat tjera aktiviste u përfshinë duke ndihmuar njerëzit të fillojnë të merren me çështje psikologjike. Për shembull, Emine Sherifi e cila filloi një program me Mjekët Francezë pa Kufij në kampin Stankovec në Maqedoni dhe Melihate Juniku përmes QMGF në Tetovë organizoi terapi grupore me fëmijët.[206]

Kështu, edhe si refugjatë dhe persona të zhvendosur me forcë, gratë, përfshirë vajzat, u organizuan për paqen dhe siguri të mëtejshme të grave dhe vajzave, të tillë si kujdesi shëndetësor fizik dhe psikologjik, arsimi, furnizimi për nevoja themelore, infrastruktura si ndriçimi, patrullat e rritura të sigurisë, dhe kurse të vetëmbrojtjes kundër dhunës me bazë gjinore.

[205] QKSGJ, *Historì është edhe tregimi i saj*, f. 153

[206] Po aty f. 155

## Rolet dhe kontributet e grave pas luftës

Në vitin 1999, RKSKB 1244 i dha fund luftës, duke deklaruar se Republika Federale e Jugosllavisë duhet t'i japë fund dhunës dhe shtypjes në Kosovë.[207] OKB vendosi një administratë civile për të administruar politikisht Kosovën derisa të vendoset statusi i saj sipas ligjit ndërkombëtar, të quajtur Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). RKSKB 1244 mandatoi UNMIK-un me autoritet ekzekutiv dhe legjislativ në Kosovë. RKSKB 1244 i dha Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së përgjegjësi të rezervuara dhe autoritet ekzekutiv, duke përfshirë edhe atë mbi sektorin e sigurisë.[208] NATO vendosi një prani ndërkombëtare të sigurisë, KFOR-in, për të krijuar një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit në Kosovë dhe për të lehtësuar kthimin e sigurt të personave të zhvendosur dhe refugjatëve në shtëpitë e tyre. Me kalimin e kohës, UNMIK-u u zvogëlua shumë, pasi kompetencat iu kaluan Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, dhe veçanërisht pas Deklaratës së Pavarësisë së shkurtit 2008 nga qeveria e Republikës së Kosovës.[209] Ndërsa roli i UNMIK-ut është zvogëluar, mandati i tij sipas ligjit ndërkombëtar vazhdon në mungesë të një rezolute të KB-së që konfirmon statusin politik të Kosovës pas RKSKB 1244.

Në përgjigje të pyetjes kryesore të hulumtimit, kjo pjesë diskuton rolet dhe kontributet e ndryshme të grave për paqen dhe sigurinë në Kosovë gjatë periudhës së pasluftës. Pjesa është e ndarë në nën-pjesë që dolën nga hulumtimi bazuar në dimensionet e ndryshme në të cilat gratë kontribuan. Aty përfshihen rolet e grave dhe kontributet e tyre për paqe dhe siguri përmes ndërtimit të paqes ndëretnike, rrjetëzimit, sigurimit të sigurisë njerëzore, sektorit të sigurisë, politikës dhe negociatave dhe dialogut. Nën-pjesa e fundit gjithashtu i përgjigjet pyetjes kryesore të hulumtimit duke paraqitur nevojat dhe pritjet e grave nga Dialogu Kosovë-Serbi.

### Kontributet e grave në ndërtimin e paqes ndëretnike

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqen dhe sigurinë përmes iniciativave ndëretnike për ndërtimin e paqes.

Sipas Databazës së Librit të Kujtimit të Kosovës, periudha prej 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2000 përfshiu 13,535 humbje ose zhdukje të njerëzve, përfshirë 10,812 shqiptarë, 2,197 serbë dhe 526 persona të etnive të tjera.[210] Pas luftës, tensionet ndëretnike midis shqiptarëve dhe serbëve ishin rritur, veçanërisht pasi personat e zhvendosur dhe refugjatët u kthyen për të gjetur pasuritë e tyre të humbura dhe anëtarët e familjes të zhdukur ose të vdekur. Një aktiviste serbe kujton:

> Pas luftës në vitin 1999, serbët nuk mund të blinin ushqime; shqiptarët nuk donin t'ua shisnin atyre. ... Edhe sot, kur hyj në një dyqan ku punon një vajzë, mund të ndiej armiqësi ndaj meje sepse flas serbisht.[211]

Ndërsa armiqësia kishte tendencë të ekzistonte midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve, grupet e tjera etnike gjithashtu u përballën me diskriminim për shkak të aleancave të perceptuara me serbët ose shqiptarët. Sipas

---

[207] RKSKB 1244.

[208] Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), *Analiza e kontekstit të reformës së sektorit të sigurisë në Kosovë 1999-2009*, 2011

[209] RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula: Një përmbledhje tregimesh rreth zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë*, 2011

[210] Fondi për të Drejtën Humanitare, 31,600 dokumente pa dyshim konfirmojnë vdekjen ose zhdukjen e 15,535 individëve gjatë luftës në Kosovë, 2015 Për informacion të hollësishëm, shih Libri i Kujtimit të Kosovës.

[211] Intervistë e RrGK-së me një grua serbe, Prishtinë, 2020

Human Rights Watch, megjithëse shqiptarët që hakmerreshin kishin kryesisht në shënjestër serbët, romët gjithashtu u përballën me rreziqe dhe kërcënime, pasi disa shqiptarë besonin se ata bashkëpunuan në krimet e orkestruara nga serbët.[212] Në të vërtetë, sipas një raporti nga Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve, midis strukturave paralele të para luftës, "ata duhej të zgjidhnin të jetonin me njërën ose me tjetrën shoqëri", gjë që gjithashtu kontribuoi në hakmarrjen e mëvonshme nga të dyja palët.[213]

Për të mbrojtur më mirë serbët dhe romët, KFOR-i krijoi "enklavat", fillimisht me pika kontrolli dhe kontrolle të sigurisë.[214] Ndërsa enklavat mundësuan organizimin më të lehtë të mbrojtjes, aktivistet e të drejtave të grave kanë argumentuar se kjo i ndau më tej grupet etnike.[215] Për më tepër, kjo kontribuoi në izolimin dhe pasigurinë e grave serbe në drejtim të sigurisë njerëzore. Gratë serbe, veçanërisht ato në enklavat jugore, nuk kishin liri të lëvizjes dhe qasje në shërbimet publike, veçanërisht pasi transporti publik ndër-urban nuk ishte i disponueshëm.

Në Mitrovicë, gjatë luftës, shumë shqiptarë u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre në pjesën veriore të qytetit, ndërsa serbët e Kosovës duke ikur nga shtëpitë e tyre në pjesët jugore të Kosovës hynë në veri. Ndërkohë, serbët nga pjesa jugore e qytetit lanë shtëpitë e tyre dhe morën vendbanimet në veri, nga frika për sigurinë e tyre. Qyteti u nda etnikisht. Familjet shqiptare që ende jetonin në veri të Kosovës, afër kufirit serb, nuk donin të linin shtëpitë ose qytetin e tyre nga frika e dhunës. Ndërkohë, serbët që jetonin në veri nuk donin të largoheshin nga shtëpitë e tyre nga frika e hakmarrjes. Kështu, që nga qershori i vitit 1999, lumi Ibër ka shërbyer si një vijë fizike e demarkacionit, duke ndarë Kosovën veriore dhe jugore, si dhe qytetin ndëretnik të Mitrovicës, ku njerëzit me etni të ndryshme më parë kishin jetuar së bashku me dekada.[216] Ura mbi lumin në qendër të Mitrovicës u bë një simbol i qytetit të ndarë dhe i mundësisë për të ndërtuar ura drejt paqes ndërkulturore, midis grupeve shoqërore si dhe paqes lokale brenda komunitetit.[217]

Që nga fillimi, aktivistet për të drejtat e grave organizuan një demonstratë në vitin 1999 për të protestuar ndaj ndarjes së Mitrovicës mbi baza etnike, duke bërë thirrje për paqe. Siç kujtoi aktivistja e re në atë kohë Ilirijana Loxha:

> Pas luftës, populli i Kosovës marshuan drejt Mitrovicës. Ne nuk donim që qyteti të ndahej. Shumë, shumë gra morën pjesë sepse kishim energji dhe vullnet për të mos lejuar që një pjesë e shpirtit tonë të shqyhej dhe të ndahej. Isha së bashku me shumë miq. Duke marrë parasysh që Mitrovica është 40 kilometra larg Prishtinës, ne ecëm nga mëngjesi deri në mbrëmje. Edhe pas kësaj ecjeje shumë të vështirë dhe të gjatë, në fund, në hyrje të qytetit, na ndaluan dhe u kthyem prapa. Ishte pikëlluese. Ne po jetonim në një kohë të vështirë pas luftës, edhe pse, me energji e vullnet, mbajtëm shpresën dhe dëshirën për të rindërtuar Kosovën.[218]

Demonstrata nuk pati sukses dhe qyteti u nda, me një pikë kontrolli të KFOR-it të vendosur në urë.

Menjëherë pas kësaj, gratë lokale ishin ndër të parat që filluan dialogun ndëretnik në Mitrovicë dhe zona të tjera të veriut të Kosovës. Vajzat nga OSHC Community Building Mitrovica (CBM) bashkuan të rinj dhe gra nga të dyja anët e lumit për të dialoguar dhe bashkëpunuar në iniciativa të përbashkëta. Valdete Idrizi, një aktiviste e re që

[212] Human Rights Watch, *Abuzimet kundër serbëve dhe romëve në Kosovën e re*, 1999

[213] Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, "Minoriteti i braktisur: Historia e të Drejtave të Romëve në Kosovë", 2011, f. 14

[214] Dahlman, CT, dhe Williams, T., "Ethnic Enclavisation and State Formation in Kosovo" (Enklavizimi Etnik dhe Formimi i Shtetit në Kosovë), *Geopolitics*, 15(2), 2010, f. 406

[215] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 228; dhe bisedat e autorëve me aktivistë për të drejtat e grave.

[216] Jaume Castan Pinos, "*Mitrovica: A city (re)shaped by division" (Mitrovica: Një qytet i (ri)formuar nga ndarja)*, 2016, f. 12

[217] Për t'iu referuar konteksteve të paqes të Andersonit diskutuar më parë.

[218] Komunikimi i RrGK me Ilirijana Loxha, janar 2021.

bashkë-themeloi CBM në fillim të vitit 2001, kujton:

> Përfshirja në diskutimet ndëretnike çoi në një kuptim më të mirë të nevojave të njëra-tjetrës. Në fillim, doja vetëm të flisja, të tregoja historinë time, vuajtjet tona dhe të mos dëgjoja. Por pastaj filluam të dëgjonim atë që të tjerët kishin për të thënë dhe të kuptoja që as për ta nuk ishte e lehtë. Kështu filluam të ndërtojmë ura.[219]

Në fillim, ato kishin dy zyra të ndara në Mitrovicën e Veriut dhe Jugut, respektivisht. Idrizi ishte e vendosur për bashkëpunim të ngushtë dhe aktivistet përfundimisht vendosën të krijojnë një vend të përbashkët pune.[220] CBM ka vazhduar të ndërtojë ura drejt bashkëpunimit midis grupeve shoqërore, veçanërisht serbëve dhe shqiptarëve, ndër vite. Disa përpjekje të tjera për të ndërtuar marrëdhënie ndëretnike gjithashtu filluan në Kosovë gjatë kësaj kohe.

Sidoqoftë, në mars 2004, marrëdhëniet ndëretnike u përkeqësuan pas asaj që u bë e njohur si "ngjarjet e marsit 2004". Siç përshkruhet nga Human Rights Watch:

> Më 17 mars 2004, në Kosovë shpërthyen trazira të dhunshme nga turmat e shqiptarëve etnik, një ditë pasi agjencitë e lajmeve të shqiptarëve etnik në Kosovë raportuan me raporte të bujshme dhe përfundimisht të pasakta se tre fëmijë të vegjël ishin mbytur pasi ishin ndjekur në lumë nga serbët. Me shpejtësinë e dritës, dhuna e turmës u përhap në të gjithë Kosovën, ku autoritetet e Kosovës numëruan tridhjetë e tri trazira të mëdha që përfshinë rreth 51,000 pjesëmarrës gjatë dy ditëve të ardhshme. Turma të mëdha të shqiptarëve etnik shënjestruan serbët dhe komunitetet e tjera joshqiptare, duke djegur të paktën 550 shtëpi dhe njëzet e shtatë kisha ortodokse serbe dhe manastire, dhe duke lënë rreth 4,100 serbë, romë, ashkalinj… dhe pakica të tjera joshqiptare të zhvendosura. Nëntëmbëdhjetë njerëz - tetë serbë të Kosovës dhe njëmbëdhjetë shqiptarë të Kosovës - u vranë, dhe mbi një mijë mbetën të plagosur - përfshirë më shumë se 120 ushtarë të KFOR-it dhe zyrtarë të policisë së UNMIK-ut dhe pesëdhjetë e tetë zyrtarë të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).[221]

Pas "ngjarjeve të marsit 2004", tensionet etnike u ngritën dhe disa nga marrëdhëniet e brishta të vendosura midis shqiptarëve dhe serbëve, duke përfshirë të grave aktiviste, u prishën. Presioni kundër bashkëpunimit përtej kufijve etnikë të socializuar u rrit.

Mes kësaj situate të vështirë, CBM dhe aktiviste të tjera të të drejtave të grave u përpoqen të ndërtojnë paqen midis grave dhe fëmijëve të etnive serbe, shqiptare dhe të tjera në Mitrovicë. Aktivistja Vetone Veliu e ofroi shtëpinë së saj në Mitrovicën e Veriut, nga e cila ishte arratisur pas luftës nga frika e dhunës, për të shërbyer si qendër e komunitetit, "Qendra e Grave". Ajo kujtoi:

> Ne e hapëm atë për të nxjerrë fëmijët nga shtëpitë e tyre, por asnjë [prind] nuk donte t'ju jepte fëmijën e tyre në atë situatë. Kjo është arsyeja pse ne vendosëm të mbledhim gra dhe fëmijë në një vend. Në të vërtetë, ishte një situatë shumë e tensionuar. Para hapjes së qendrës, kishte shumë kërcënime, por ditën e parë 103 gra shqiptare dhe serbe u mblodhën atje [në shtëpinë time]. Nga ajo ditë nuk kishte më konflikte

[219] Intervistë e RrGK-së me Valdete Idrizi, Prishtinë, 2020.

[220] Historia Gojore Kosovë, Intervistë e Valdete Idrizi, 2017, f. 25-26.

[221] Human Rights Watch, *Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo, March 2004*,, 2004

[mes nesh]. E tëra çfarë donim ishte të bënim paqe mes grave dhe fëmijëve.[222]

Takimet vazhduan dy deri në tri herë në javë dhe ata kaluan pushimet së bashku. Takimet çuan në një kuptim më të mirë të nevojave të njëra-tjetrës. Edhe kur Qendra mori kërcënime se do t'i hidheshin bomba, gratë vazhduan, duke refuzuar të ndërpresin aktivitetet e tyre. Për më tepër, ato vëzhgonin Qendrën gjatë natës për të siguruar sigurinë e saj.[223] Më vonë, në 2012, duke nxjerrë mësim nga kjo përvojë, Vetone Veliu themeloi Shoqatën multietnike të Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (MWAHR).[224] Që atëherë, MWAHR ka bashkuar të rinjtë dhe gratë anëtare të asamblesë komunale të etnive të ndryshme nga komunat veriore dhe Mitrovica e Jugut për të diskutuar çështjet e shqetësimit në komunitetet e tyre dhe për të bashkëpunuar në adresimin e çështjeve lokale. MWAHR më vonë e zgjeroi këtë bashkëpunim, duke zhvilluar marrëdhënie me Shoqatën e Grave Orë Rëre (*Peščanik* në serbisht), një organizatë për paqe e grave në Serbinë e Jugut. Që nga viti 2017, ato kanë sjellë së bashku gratë me etni të ndryshme nga Kosova dhe Serbia për të diskutuar çështje, përfshirë procesin e Dialogut Kosovë-Serbi dhe procesin e Anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE).[225] Këto diskutime gjithashtu kontribuuan në reduktimin e paragjykimeve, promovimin e mirëkuptimit dhe krijimin e marrëdhënieve pozitive ndëretnike midis grave serbe dhe shqiptare.[226] Këto diskutime gjithashtu kontribuan në minimin e paragjykimeve, promovimin e mirëkuptimit dhe krijimin e marrëdhënieve pozitive ndëretnike midis grave serbe dhe shqiptare.[227]



© RrGK
Në solidaritet, aktivistet Sevdije Ahmeti dhe Igballe Rogova vizitojnë bashkë aktivisten Nevenka Rikallo dhe burrin e saj në shtëpinë e tyre, pasi pësuan dëme si rezultat i ngjarjeve të Marsit 2004. Si Drejtore Ekzekutive e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Ahmeti dhe Qendra ngritën fonde nga Fondi Aktiv Urgjent për të mbështetur aktivistet dhe organizatat serbe të të drejtave të grave të ndikuara nga ngjarjet.

Ndërkohë, në vitin 2000, aktivistja për të drejtat e grave Igballe Rogova u informua nga Kvinna till Kvinna se gratë aktiviste serbe në jug të Kosovës dëshironin të punonin dhe të mësonin nga përvojat e grave aktiviste shqiptare. Megjithëse lëvizja midis komuniteteve shqiptare dhe serbe nuk ishte e lehtë në atë kohë, dhe ajo ishte përballur me përndjekje gjatë luftës nga forcat serbe dhe fqinjët e saj serbë, Rogova vendosi të vizitojë gratë serbe në enklava, për të kuptuar më mirë situatën dhe nevojat e tyre. Ajo kujtoi:

Sigurisht, unë bëra sikur isha staf [i një organizate] ndërkombëtare dhe shkova atje me një makinë të Kvinna till Kvinna. Kështu e takova Nenën [Nevenka Rikallo] dhe e ftova të bëhej pjesë e Rrjetit [RrGK].[228]

Ajo reflektoi mbi rëndësinë e përfshirjes së burrave, si burri i Nevenka Rikallo, Bora, dhe punën me të gjithë komunitetin për të (ri)ndërtuar marrëdhënie pozi-

[222] Intervistë e RrGK-së me Vetone Veliu, Mitrovicë e Jugut, 2020.

[223] Po aty.

[224] Intervistë e RrGK-së me gra aktiviste, 2020.

[225] Për më shumë informata, shihni nën-pjesën mbi "Kontributet e grave në negociata dhe dialog, dhe nevojat"

[226] Shkëmbim informatash përmes postës elektronike me Vetone Veliu, 2021.

[227] Korrespondenca me email me Vetone Veliu, 2021.

[228] Igballe Rogova, fjalim gjatë takimit me studentë nga Universiteti i Vjenës dhe Qendra Evropiane Ndëruniversitare për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizimin, Prishtinë, 2020.

tive midis shqiptarëve dhe serbëve. Në të vërtetë, me mbështetjen e burrit të saj, Nevenka Rikallo filloi organizatën e saj, Dora për Dorën (*Ruka Ruci*), për të fuqizuar gratë serbe në Fushë Kosovë dhe u bë anëtare e RrGK. Që atëherë ajo ka bashkëpunuar me OSHCG-të e drejtuara nga shqiptarët, veçanërisht me Dera e Hapur e udhëhequr nga Belgjyzare Muharremi, për të bashkuar gratë shqiptare dhe serbe, drejt paqes.

Gradualisht gratë e tjera serbe filluan të bashkëpunojnë me gratë shqiptare gjithashtu. Një aktiviste serbe për të drejtat e grave në Novobërdë kujton:

> Ne ishim të angazhuara në aktivitete së bashku me një grua serbe e cila ishte e martuar me një burrë shqiptar, i cili na ftoi të punojmë me të. Pastaj, ne filluam të shkonim në fshatra dhe të bisedonim me gratë serbe për të adresuar nevojat e tyre, veçanërisht në lidhje me shëndetin, pasi shtëpitë e shëndetit u mbyllën pas luftës dhe ekzistonte rreziku i infektimit. ... Me kalimin e kohës, ne e zgjeruam bashkëpunimin tonë multietnik më tej. Në vitin 2008, ne identifikuam nevojën për të informuar njerëzit në lidhje me decentralizimin dhe për të bashkëpunuar me ta për probleme të tilla si infrastruktura, emigrimi, etj. Në vitet 2007-2013, kryetari i komunës së Novobërdës ishte shqiptar dhe ai bëri shumë për serbët, madje edhe më shumë sesa për shqiptarët. Në këtë kohë, filloi bashkëpunimi me shqiptarët.[229]

Disa OSHCG të tjera kanë mbështetur bashkëpunimin ndëretnik brenda komuniteteve lokale në të gjithë Kosovën. Midis shumë shembujve, OShC-ja Gruaja Hyjnore fuqizoi gratë nga disa grupe etnike në Gjilan.[230] Në vitin 2019, OSHC-ja Të Drejtat e Grave [Žensko Pravo], me mbështetjen e UNMIK-ut, trajnoi një grup multietnik të grave në avokim; ato krijuan plane veprimi për barazinë gjinore për katër komuna veriore në Kosovë me prioritete të përbashkëta për gra dhe burra serbë, shqiptarë, romë, goranë dhe egjiptianë.[231] Ky grup gjithashtu kontribuoi në forcimin e rolit të grave në proceset e paqes dhe pajtimit përmes trajnimeve, diskutimeve dhe takimeve multietnike.[232]

Joformalisht, gra të reja individuale gjithashtu u përpoqën të nxisin dialogun dhe paqen. "Ne nuk kishim mundësinë të merrnim pjesë në vendimmarrje, por nuk do të thotë se nuk bëmë asgjë", tha një vajzë shqiptare në Prishtinë. "Ne po merrnim pjesë në [përpjekjet tona për ndërtimin e paqes] në shkollë. Ne patëm mundësinë të takonim gra nga Serbia". Gjatë grupeve të fokusit, gra të reja shtesë përmendën shembuj të përfshirjes së tyre personale në krijimin e paqes shoqërore.

Vajzat kanë vazhduar të merren me krijimin e paqes, si dhe janë përpjekur të bëjnë të dëgjohet zëri i tyre në proceset e paqes, kur nuk kishin vend në tryezë. Në vitin 2013, gjatë Forumit Rajonal të Feministeve të Reja të organizuar nga RrGK, afërsisht 40 të reja nga Kosova dhe vendet fqinje u bashkuan në Kosovë për të diskutuar feminizmin, përfshirjen e grave në vendimmarrje dhe për të zhvilluar një strategji të përbashkët avokimi, përmes së cilës ato u përpoqën të ngritin çështje që kanë të bëjnë me gratë e reja në Kosovë dhe në rajon.[233] Në strategjinë e tyre të avokimit, ato identifikuan zyrtarë përkatës për t'u takuar në mënyrë që t'iu përcjellin prioritetet e tyre. Kjo përfshinte takimin me Presidenten Jahjaga për të ndarë shqetësimet e tyre me të.[234]

Shkolla Verore Feministe vazhdoi vitin e ardhshëm, e organizuar nga RrGK, Qendra Alternative e Vajzave nga Krushevci dhe Shoqata Dea Dia nga Kovaçica, Serbi, si një iniciativë feministe për ndërtimin e paqes për gratë e

---

229 Intervistë e RrGK-së me një grua serbe, Novobërdë, 2020.

230 RrGK, faqja në internet, "OJQ Gruaja Hyjnore".

231 UNMIK, "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm", 2019.

232 Për më shumë informata, shihni faqen në Facebook: "Gratë për Barazi dhe Paqe në Veri të Kosovës "

233 Shihni deklaratën e *Forumit Rajonal të Feministeve të Reja*, 2013

234 RrGK, "RrGK organizon Forumin Rajonal të Feministeve të Reja 2013", 2013.

reja, mbështetur nga Kvinna till Kvinna.[235] "Kjo ishte hera e parë që pata mundësinë të ulesha dhe të bëja një bisedë të gjatë me një vajzë shqiptare," tha një grua e re pjesëmarrëse nga Serbia.[236] Gratë e reja reflektuan për rëndësinë e bisedave të tilla personale në ndërtimin e paqes midis grave të reja në Kosovë dhe Serbi. Më vonë, në vitin 2015, si pjesë e Akademisë së Paqes së Grave të Reja, gratë e reja bashkëpunuan për të bërë një deklaratë të përbashkët dhe strategji avokimi, edhe një herë, duke i dërguar rekomandimet e tyre te liderët politikë. Përsëri, si pjesë e strategjive të tyre të avokimit, gra të reja shtesë nga Kosova dhe Serbia u takuan me Presidenten e atëhershme Jahjaga, midis udhëheqësve të tjerë politikë dhe zyrtarëve qeveritarë, duke ngritur çështje me rëndësi prioritare për vajzat, drejt paqes dhe sigurisë së tyre. Presidentja Jahjaga ofroi mbështetjen e saj dhe theksoi rëndësinë e grave në forcimin e paqes dhe ndryshimin e shoqërive.[237]





© RrGK
Pas takimit feminist, vajzat ngritën çështje të rëndësishme për to nga takimi me zyrtarë Kosovarë duke organizuar demonstratë në rrugë dhe duke u deklaruar për media. Çështjet kryesore të identifikuara nga vajzat rreth sigurisë së tyre përfshinë përfshirjen në edukim, psikologët në shkolla dhe diskriminimin në punë.

[235] RrGK, "Shkolla Verore Feministe Bashkon Vajzat nga Kosova dhe Serbia", 2014.

[236] Po aty;

[237] Zyra e Presidentit, "Presidentja Jahjaga u takua me vajza nga Kosova dhe Serbia"

Tradita e vajzave që mblidhen përtej kufijve për të ndërtuar paqen u vazhdua nga Artpolis, anëtare e RrGK-së dhe Qendra Alternative e Vajzave nga Serbia, duke sjellë së bashku gra të reja nga Kosova dhe Serbia në Shkollën Pranverore të Feministeve të Reja. Siç vërejti Zana Hoxha-Krasniqi, themeluese dhe Drejtore e Artpolis:

> Ne krijuam një hapësirë për gratë me etni të ndryshme për të dialoguar në lidhje me feminizmin, paqen dhe sigurinë. Sot, shumica e atyre grave të reja janë pjesë e lëvizjes! Njohuritë që ato fituan atje kontribuojnë jo vetëm për veten e tyre por edhe për t'iu bërë me dije të tjerëve se gratë e reja mund të kontribuojnë në proceset e paqes.[238]

Si rezultat, vajzat ia dolën të thyejnë stereotipet dhe paragjykimet për njerëzit e etnive të tjera, të nxisin aftësitë e rrjetëzimit, të fillojnë miqësi ndëretnike dhe të krijojnë një hapësirë për gratë e tjera që të zhvillohen.[239] Duke përdorur artin si mjet ndaj ndryshimeve shoqërore, Artpolis gjithashtu ka organizuar disa shfaqje, punëtori, dhe aktivitete të tjera, shpesh duke angazhuar të rinjtë, në adresimin e stereotipave, largimin e paragjykimeve, thyerjen e barrierave dhe ndërtimin e paqes.[240]

Në vitin 2014, Kvinna till Kvinna organizoi Akademinë e Paqes së Vajzave, një iniciativë ndër-rajonale që bashkoi aktiviste nga pesë vende të prekura nga konflikti: Armenia, Azerbajxhani, Kosova, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Gjatë kësaj ngjarje, 140 të reja patën mundësinë të avancojnë aftësitë e tyre udhëheqëse.[241] Pastaj, në vitin 2015, si pjesë e Akademisë, gratë e reja nga Kosova së bashku me gratë e tjera nga Ballkani, Kaukazi i Jugut dhe Suedia krijuan një Konventë të Paqes të Grave të Reja, me synimin për të "ndërtuar angazhimin dhe kuptimin e sfidave dhe pengesave me të cilat përballen gratë e reja në vendet e prekura nga konflikti si dhe në shoqëritë e tjera".[242] Në Kosovë, gra të reja të ndryshme gjithashtu krijuan një Konventë Kombëtare, të mbështetur nga Kvinna till Kvinna, për të tërhequr vëmendjen e vendimmarrësve dhe OShC-ve për çështjet që ato i konsideruan me prioritet: ndihma personave që kishin pësuar dhunë seksuale gjatë luftës, fuqizimi ekonomik i grave dhe pjesëmarrja e grave të reja në proceset e vendimmarrjes.[243]

Që nga viti 2015, disa vajza kanë marrë pjesë në Akademinë e Dialogut vjetor të OSBE-së për Vajzat, që mbledh të reja nga Beogradi dhe Prishtina për të rritur pjesëmarrjen e grave në dialog, zgjidhjen e konflikteve dhe proceset e vendimmarrjes.[244] Një përfaqësues i OSBE-së shpjegoi:

> Në vitin 2015, ne krijuam Akademinë e Dialogut sepse ishte e nevojshme të përfshiheshin vajza 20-27 vjeç në Dialog. Ato nuk kishin kujtime të mira nga e kaluara, por e kuptuan se kanë shumë gjëra të përbashkëta.[245]

Vajzat thanë se pjesëmarrja e tyre kontribuoi në njohuri dhe bashkëpunim midis grave, si dhe në krijimin e një rrjeti të grave të reja në Kosovë dhe Serbi. Akademia fuqizoi gratë e reja për të dalë vullnetare, të marrin pjesë në OSHC-të që punojnë në ndërtimin e paqes dhe për të rritur ndërgjegjësimin për barazinë gjinore me kolegët

[238] Intervistë e RrGK, Prishtinë, 2020.

[239] Intervistë e RrGK-së me një grua aktiviste shqiptare, Prishtinë, 2020.

[240] Për më shumë informata në lidhje me aktivitetet e tyre, shih Artpolis.

[241] Kvinna till Kvinna, "#FEMDEFENDERS Young women who tears down barriers", 2015.

[242] Kvinna till Kvinna, "Konventa e Paqes e Vajzave", 2015.

[243] Dokumenti i siguruar për RrGK nga Kvinna till Kvinna: Kvinna till Kvinna, *Karta Kombëtare e Kosovës për Akademinë e Paqes së Vajzave.*

[244] OSBE, "Akademia e katërt e Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja Përfundon në Austri", 2018.

[245] Intervistë e RrGK-së me një vajzë përfaqësuese e OSBE-së, Prishtinë, 2020

e tyre meshkuj, drejt paqes ndërpersonale. Të diplomuarat e Akademisë së Dialogut filluan "WOmentorship", që synon të lidhë vajzat serbe dhe shqiptare në mënyrë që ato të ndajnë njohuritë dhe përvojat.[246]

Gjithashtu në nivelin rajonal, të rinjtë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në OSHC-të që promovojnë paqen, pajtimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut, siç është Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (NRDN). NRDN ka organizata anëtare të rrjetit në Serbi, Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Që nga viti 2003, vlerat e saj kanë përfshirë të vërtetën, drejtësinë, llogaridhënien, barazinë, lirinë, demokracinë dhe paqen përmes dialogut dhe arsimit. Për këtë qëllim, të rinjtë kanë organizuar disa aktivitete, të tilla si programe shkëmbimi, festivale, samite dhe raste gjyqësore.[247] Në Kosovë, NRDN përqendrohet në monitorimin, dokumentimin dhe raportimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut; ballafaqimin me të kaluarën, drejt kujtesës kolektive dhe paqes në Kosovë dhe rajon, ashtu si përmes Muzeut të saj Virtual të Refugjatëve;[248] dhe fuqizimin e angazhimit të të rinjve në jetën politike dhe shoqërore.[249] NRDN ka punuar në "dialogun njerëz me njerëz" midis të rinjve, përfshirë vajza nga bashkësi të ndryshme. NRDN Kosova ka vërejtur rëndësinë e përfshirjes së zërave të grave për të ndërtuar paqe të qëndrueshme, dhe kështu ata kërkojnë të sigurojnë një perspektivë gjinore në punën e tyre.[250] Në përgjithësi, NRDN ka kërkuar që të angazhojë të rinjtë, përfshirë vajzat, në ndërtimin e paqes.

Në vitin 2006, aktivistet për të drejtat e grave të moshave të ndryshme nga Kosova dhe Serbia u takuan për të formuar Koalicionin e Grave për Paqen, iniciuar nga Rrjeti i Grave në të Zeza Serbi dhe RrGK me mbështetje nga Kvinna till Kvinna dhe Fondi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM, më vonë UN Women). Shkëmbimi i dhimbjes dhe përvojave të tyre të luftës krijoi një themel të rëndësishëm për ndërtimin e bashkëpunimit dhe paqes. Ato shkruan një deklaratë historike, mjaft të rrezikshme për gratë serbe, e cila thotë: "Statusi i ardhshëm i Kosovës duhet të jetë pavarësia". Një aktiviste reflektoi: "Ne e njohëm gjendjen e njëra-tjetrës. Kështu ndërtohet paqja". Gjatë takimit të tyre, aktivistet serbe bënë një nga faljet e para publike për krimet e kryera nga qeveria serbe. Kjo pati një efekt të rëndësishëm te shqiptarët në Kosovë të cilët ndoqën faljen publike në televizion; kjo kontribuoi në trajtimin e së kaluarës, drejt ndërtimit të paqes.[251] Koalicioni i Grave për Paqe gjithashtu u angazhua në avokim në lidhje me negociatat Kosovë-Serbi, të diskutuar më vonë.

Në vitin 2006, gratë nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor themeluan Lobin Rajonal të Grave në Evropën Juglindore (LRGEJL) për Paqe, Siguri dhe Drejtësi, mbështetur nga UNIFEM. U bashkuan gratë politikane dhe gratë e shoqërisë civile nga vendet në të gjithë ish-Jugosllavinë, për të bashkëpunuar drejt paqes dhe sigurisë në rajon.[252] Pastaj shefja e Zyrës së UNIFEM në Kosovë, Flora Macula, kujtoi:

> Në takimin e parë ftuam gratë nga politika me fokus në ato nga Serbia dhe Kosova. Sidoqoftë, gra nga pjesë të tjera të Ballkanit gjithashtu u bashkuan me ne. Ishte vetëm një grua nga shoqëria civile, Igballe Rogova, të cilën e ftova për shkak të udhëheqjes së saj dhe punës së saj të madhe për paqe dhe siguri. Nekibe Kelmendi ishte gjithashtu, dhe nuk ishte e lehtë për të pasi burri i saj dhe dy djemtë [civilë] ishin vrarë [nga policia serbe] të ulej në të njëjtën tryezë me gratë që punonin për barazinë gjinore në Qeverinë e Serbisë.

---

[246] Intervistë e RrGK-së me një vajzë serbe, 2020.

[247] Për informata më të hollësishme rreth NRDN në Kosovë, vizitoni Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

[248] Dokumenton historitë e njerëzve që u desh të largoheshin nga shtëpitë e tyre gjatë luftës në Kosovë. Shiko: Muzeu Virtual i Refugjatëve.

[249] Po aty.

[250] Intervistë e RrGK-së me përfaqësuesin e NRDN në Kosovë, 2020.

[251] Koalicioni i Grave për Paqe, *Përmes solidaritetit të grave drejt një paqeje të drejtë: Një raport i bazuar në konferencën e dytë vjetore të koalicionit të grave për paqen*, Strugë, 2007.

[252] Lexo më shumë: Njoftimi i themelimit të LRGEJL nënshkruar nga anëtarët: Marieta Zaqe, Memnuna Zvezdiq, Gordana Sobol, Morana Pallikoviq, Nekibe Kelmendi, Edita Tahiri, Teuta Sahatqija, Igballe Rogova, Irina Pockova, Nada Drobnjak, Sonja Biserko, Natasha Kandiq, Sllavica Stojanoviq.

Menjëherë pas gjashtë muajsh, në një takim në Zagreb, u vendos që të krijohej Lobi për Paqe dhe Siguri për Gratë nga Evropa Juglindore.[253]

Lobi angazhoi gra të fuqishme që mbanin pozicione drejtuese në partitë ose qeveritë e tyre politike. Nga Kosova, Nekibe Kelmendi, Edita Tahiri dhe Teuta Sahatqija, si dhe aktiviste të forta për të drejtat e grave, si Igballe Rogova, Luljeta Vuniqi, Sonja Biserko dhe Stasha Zajoviq. Përveç kontributit në ndërtimin e paqes midis grave në rajon, LRGEJL gjithashtu do të kontribuonte në negociatat Kosovë-Serbi, të diskutuara më vonë.

Nëpërmjet bashkëpunimit rajonal, LRGEJL gjithashtu ka kontribuar në "fuqizimin e udhëheqjes së grave dhe pjesëmarrjen e barabartë në politikë, vendimmarrje, paqe, procese të sigurisë dhe drejtësisë". Për shembull, Akademia e re Rajonale për Gratë në Lidership dhe Ndërmjetësim synon gratë e reja, drejt forcimit të zërit dhe kapaciteteve të tyre; gjithashtu siguron hapësira që ato të përfshihen.[254] Në vitin 2019, PSSP i UNMIK-ut Zahir Tanin njohu ndikimin e fortë të rrjeteve të grave si LRGEJL në proceset e paqes.[255] Së shpejti, Rrjeti Mesdhetar i Grave Ndërmjetësuese (RrMGN), i cili synon "përmbushjen e nevojës për të rritur numrin e grave të përfshira në përpjekjet për bërjen e paqes dhe për të lehtësuar emërimin e grave të nivelit të lartë ndërmjetësuese në nivelin lokal dhe ndërkombëtar", lansoi në nëntor 2020 degën e vet në Kosovë. Deri më tani, ky rrjet ndëretnik ka afërsisht 40 ndërmjetëse nga 27 vende të ndryshme. Nga Kosova, gratë ndërmjetësuese ishin Edita Tahiri, Jeta Krasniqi dhe Linda Gusia.[256] RrMGN synon ta bëjë botën më të sigurt.[257] Gjatë ngjarjes së lansimit, Vjosa Osmani, Presidente në detyrë e Kosovës, shtoi:

> Ne duhet të kuptojmë që pjesëmarrja e grave në procesin e dialogut nuk është vetëm një vendim i domosdoshëm por edhe i zgjuar dhe mbi të gjitha dëshmi e angazhimit për të respektuar objektivat e RKSKB 1325 ... Agjenda e GPS do të jetë e qëndrueshme vetëm kur gratë të jenë të pranishme përmes akademisë, mediave, shoqërisë civile ose platformave të tilla si Dega e Kosovës.[258]

Një përpjekje tjetër rajonale njohu nevojën për drejtësi, drejt paqes, pas luftërave në ish-Jugosllavi, ku as gjykimet ndërkombëtare dhe as ato vendase nuk adresuan në mënyrë adekuate forma të ndryshme të dhunës ndaj grave. Si përgjigje, OSHCG vendosi të organizojë një Gjykatë të Grave. Lëvizja e Nënave të enklavave të Srebrenicës dhe Zhepës nga Bosnja dhe Hercegovina, RrGK nga Kosova, Gratë në të Zeza nga Serbia dhe OSHCG të tjera nga Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Sllovenia krijuan Gjykatën e Grave.[259] Gjykata nuk përfshiu as kryes të veprave, as gjyqtarë. Ajo ofroi një qasje me tepër feministe, sesa ligjore, të drejtësisë. Gjykata u përpoq të krijonte një hapësirë të sigurt që do të fuqizonte gratë nga e gjithë ish Jugosllavia për të treguar historitë e tyre të vuajtjeve, guximit dhe rezistencës.[260] Si shembull, në maj 2015, afërsisht 500 gra nga rajoni, përfshirë gratë nga Kosova, u takuan në Sarajevë për të ndarë histori personale të viteve 1990. Gjatë këtyre katër ditëve, gratë rrëfyen dëshmi

---

[253] Intervistë e RrGK-së me Flora Macula, 2020

[254] Lobi i Grave të Rajonit të Evropës Juglindore, "Akademia Rajonale për Gratë në Lidership dhe Ndërmjetësim".

[255] UNMIK, PSSP Tanin thekson rëndësinë e proceseve paqësore të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe përfshirëse në një seminar të nivelit të lartë në Romë, 2019

[256] Për informacion të detajuar në lidhje me këtë rrjet, shihni: Rrjeti Mesdhetar i Grave Ndërmjetësuese.

[257] Fjala e njërit prej ndërmjetësuesve të RrGMN në konferencën në internet, "Reclaiming Time: Women, Peace, Security and Justice Agenda in Kosovo and Beyond", 2020.

[258] Fjalimi i ushtrueses së detyrës së Presidentit, Vjosa Osmani në konferencën në internet, "Reclaiming Time: Women, Peace, Security and Justice Agenda in Kosovo and Beyond", 2020.

[259] RrGK, "Gjykata e Grave për Ish Jugosllavinë: Kërko për Drejtësi, të Vërtetë dhe Kujtim Aktiv", 2015

[260] Clark, JN, "Transitional Justice as Recognition: An Analysis of the Women's Court in Sarajevo", *International Journal of Transitional Justice*, 10 (1), 2015, f. 2

të trishtueshme rreth përdhunimit, torturave dhe humbjes së të dashurve të tyre.[261] Përkundër përvojave të tyre, sipas Kvinna till Kvinna, gratë treguan një "vendosmëri për paqe dhe drejtësi, jo për hakmarrje. Për rikuperim, siguri, për të ardhmen e mirë të tyre dhe fëmijëve të tyre dhe për solidaritet me të gjitha gratë, përtej të gjithë kufijve të mundshëm".[262] Gjykata e Grave kështu kontribuoi në paqen dhe sigurinë përmes njohjes së të kaluarës, drejt ndërtimit të një të ardhme paqësore.

Pas debateve në Forumin e Parë Rajonal për Drejtësinë Tranzicionale, në vitin 2008, OShC-të nga Ballkani gjithashtu filluan një iniciativë për krijimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë ndërmjet 1 janarit 1991 dhe 31 dhjetorit 2001 (KOMRA).[263] Përmes kësaj iniciative, KOMRA u konstituua si organ jashtëgjyqësor me detyra që përfshijnë:

> Hetimi i të gjitha akuzave për krime lufte dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut në lidhje me luftën; krijimin e listës së emrave të të gjitha viktimave të luftës dhe viktimave të krimeve që kanë të bëjnë me luftën; dhe mbledhjen e informacionit rreth kampeve dhe qendrave të tjera të paraburgimit të detyruar.[264]

KOMRA ka zhvilluar procese konsultative në nivel rajonal, kombëtar dhe lokal me studentë, pakica, veteranë dhe gra.[265] Në vitin 2010, Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim, anëtare e koalicionit KOMRA, organizoi një konsultim me gratë shqiptare, serbe dhe rome viktima të luftës në Komunën e Rahovecit, nga fshatrat e prekura rëndë Hoça e Madhe dhe Krusha e Madhe. Dëshmitë e grave ishin të ndryshme, dhe ndërsa disa bënë thirrje për paqe të tjerët kërkuan hakmarrje, duke deklaruar se "nuk ka vend për falje".[266] Përkundër pikëpamjeve të përziera të shprehura nga gratë, konsultimi pa dyshim kontribuoi në krijimin e një themeli për trajtimin e së kaluarës duke siguruar hapësirë për gratë për të ndarë dhe diskutuar përvojat e tyre, drejt ndërtimit të paqes përfundimisht. Në të vërtetë, pas ngjarjes, 27 nga gratë pjesëmarrëse nënshkruan një deklaratë duke shprehur gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në diskutime të ngjashme në të ardhmen, si dhe për të kërkuar të vërtetën dhe drejtësinë.[267]

KOMRA gjithashtu ka mbajtur disa aktivitete që synojnë të rinjtë, siç janë debatet publike mbi rolin e të rinjve në pajtim dhe "një milion nënshkrime për KOMRA" në 2011. Kjo u organizua nga NRDN në bashkëpunim me disa OSHC të tjera të të rinjve në rajon, përfshirë Integra nga Kosova. Së bashku, ata përfundimisht mblodhën 542,660 nënshkrime për themelimin e komisionit KOMRA. Në vitin 2012, "KOMRA për të ardhmen e të Rinjve" gjithashtu synoi të rinjtë, duke përfshirë diskutime në panel dhe mbledhjen e nënshkrimeve në disa qytete.[268] Në vitin 2017, KOMRA mblodhi në Beograd 20 vajza nga Ballkani Perëndimor për të diskutuar mënyrat për të arritur paqen pozitive në vendet e tyre dhe rëndësinë e rrjeteve rajonale.[269] Disa vajza janë angazhuar në KOMRA edhe pse asnjë informacion tjetër specifik nuk ishte në dispozicion në internet.

Ndërkohë, Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (ZRBR) u krijua në vitin 2016 me nënshkrimin e gjashtë

---

[261] Kvinna till Kvinna, Dëshmi të paharrueshme në gjykatë për gratë e mbijetuara, 2015

[262] Po aty.

[263] Shikoni Rrjetin e Pajtimit të KOMRA-së faqe në internet.

[264] Rrjeti i pajtimit KOMRA faqe në internet.

[265] Për më shumë informata në lidhje me procesin konsultativ, shih Arkivat e KOMRA-së.

[266] Për informacion mbi dëshmitë e tyre, shihni transkriptimi i "Konsultimit me Gratë Viktima të Luftës nga Rahoveci, Hoça e Madhe dhe Krusha e Madhe për Iniciativën për KOMRA".

[267] Për më shumë informata, shih Konsultimet me viktimat femra të luftës për themelimin e KOMRA-së, 2010

[268] Për më shumë informata, shihni: https://www.recom.link/en/recom-for-the-future-of-the-youth-2/.

[269] Rrjeti i Pajtimit të KOMRA, "Rëndësia e rrjetit rajonal për pajtimin", 2017.

Kryeministrave të Ballkanit Perëndimor nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Misioni i saj kryesor është promovimi i pajtimit midis të rinjve në Ballkanin Perëndimor përmes shkëmbimeve të të rinjve dhe mbështetjes së projekteve rinore në rajon. Përmes projekteve të tyre të ndryshme të mbështetur nga agjencitë e KB, BE dhe qeveritë e Ballkanit Perëndimor, ZRBR përpiqet të krijojë lidhje midis të rinjve të vendeve të ndryshme, përfshirë ato më të prekshmet, në lidhje me ndërtimin e paqes, që kanë të bëjnë me të kaluarën, mësimin ndërkulturor dhe dialogun, vullnetarizmi dhe pajtimin përmes ndërmarrjes sociale.[270] Dokumenti i tyre strategjik për 2019-2021 përmend shkurtimisht një angazhim për barazinë gjinore, por detaje të mëtejshme mbi angazhimin e vajzave dhe kontributet e tyre për paqen dhe sigurinë përmes ZRBR nuk ishin në dispozicion në internet.

Që nga viti 2020, drejt paqes dhe sigurisë ndërkufitare, OSHCG-të në Kosovë mbetën pjesë e disa koalicioneve rajonale dhe ndërkombëtare që punojnë për të adresuar dhunën në bazë gjinore, institucionalizimin e buxhetit të përgjegjshëm gjinor, adresimin e diskriminimit në bazë gjinore në punë, avokimin për përmirësimin e burimeve për OSHCG dhe integrimin e një perspektive gjinore në procesin e anëtarësimit në BE. Këto koalicione bashkojnë gra të ndryshme, përtej kufijve, duke krijuar marrëdhënie me interes të përbashkët drejt ruajtjes së dimensioneve të ndryshme të sigurisë së grave në rajon dhe avancimit të paqes.

Si përfundim, grupet e fokusit, intervistat dhe hulumtimet arkivore të gjitha sugjerojnë se gratë, përfshirë vajzat, kanë kontribuar drejtpërdrejt në ndërtimin e paqes midis grupeve të ndryshme etnike në Kosovë, veçanërisht shqiptarëve dhe serbëve; midis grave në Kosovë dhe Serbi; dhe midis grave (dhe burrave) në Evropën Juglindore. Koalicioni i Paqes së Grave, KOMRA, takimet e reja feministe dhe Gjykata e Grave, midis përpjekjeve të tjera, ilustrojnë rëndësinë e ballafaqimit me të kaluarën për të ndërtuar një themel për ndërtimin e paqes ndëretnike. Siç ilustrojnë shembujt në këtë nën-pjesë, të dy OSHCG-të dhe aktorët ndërkombëtarë kanë luajtur një rol në mbështetjen e përpjekjeve për ndërtimin e paqes. Gratë lokale që drejtuan OSHC-të si CBM, Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut, RrGK, dhe Dora për Dorën ishin ndër të parat që "ndërtuan ura" në Mitrovicë dhe zona të tjera. Ndërsa një vajzë dha një konkluzion gjatë një fokus grupi në Mitrovicën e Veriut: "Po të mos ishin aktivitetet multietnike të OSHC-ve, ne [të rinjtë nga komunitetet serbe dhe shqiptare] nuk do të kishim ndonjë ndërveprim."

Sipas nën-pyetjes së hulumtimit, shembujt në këtë nën-pjesë ilustrojnë gjithashtu se OSHCG-të kanë luajtur disa role në përfshirjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në proceset e paqes dhe të sigurisë, të tilla si përmes Forumit Rajonal të Feministeve të Reja, Shkollës Verore Feministe, Akademisë së Grave për Paqe dhe LRGEJL. Këto dhe përpjekjet e Konventës së Paqes për Gratë e Reja, Akademia e Dialogut e OSBE, NRDN dhe ZRBR të gjitha mund të shërbejnë si shembuj të mënyrave për të promovuar angazhimin e vajzave në proceset e paqes, duke rritur interesin e tyre, duke i fuqizuar ato për t'u angazhuar, duke avancuar aftësitë e tyre, duke zgjeruar rrjetet e tyre dhe duke u siguruar atyre një vend në tryezë për të dialoguar drejtpërdrejt me vendimmarrësit për prioritetet dhe nevojat e tyre.[271]

## Kontributet e grave drejt paqes dhe sigurisë përmes rrjetëzimit

Menjëherë pas luftës, gratë u përballën me sfida në sigurimin e një vendi në tryezën e vendimmarrjes pas luftës së Kosovës,[272] siç diskutohet në kapitullin tjetër. Të përjashtuara nga vendimmarrja, siç ishin gratë në situata pas luftës

[270] Për më shumë informata në lidhje me këtë nismë, vizitoni Zyra Rajonale e Bashkëpunimit të Rinjve.

[271] Sipas nën-pyetjes së fundit të hulumtimit.

[272] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 184

në vendet e tjera të botës,[273] gratë u përgjigjën duke krijuar rrjete si një mënyrë alternative për t'u angazhuar dhe mbrojtur prioritetet e grave. Përveç shembujve të dhënë në nën-pjesën paraprake, kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave në paqe dhe siguri përmes rrjetëzimit, si një strategji efektive.

Menjëherë në tetor 2000, ndërsa lufta dhe përvojat e përjetuara ishin akoma të freskëta në kujtesën e njerëzve, një koalicion joformal i aktivisteve të të drejtave të grave dhe Departamenti i Demokratizimit brenda OSBE-së, i udhëhequr nga aktivistja dhe ish-parlamentarja e Mbretërisë së Bashkuar Lesley Abdela, organizoi një konferencë në Prishtinë me titull "Gratë në Politikë: Agjenda për Komunitetet e Kosovës" në lidhje me gratë në vendimmarrje, përfshirë rolin e tyre në proceset e paqes dhe drejtësisë.[274] Gratë nga i gjithë rajoni u bashkuan në takim, pavarësisht nga vështirësitë e udhëtimit ndërkufitar, përfshirë gratë nga Serbia. Gratë me etni dhe kombësi të ndryshme shprehën shqetësime të përbashkëta. Çështjet kryesore përfshinin personat e zhdukur dhe krimet e kryera nga qeveria e Serbisë në Kosovë. Gratë pjesëmarrëse avokuan adresimin e këtyre çështjeve në forumet rajonale dhe ndërkombëtare.

Disa nga organizatat pjesëmarrëse, përfshirë ato aktive para luftës në Rrjetin Joformal të Grave Rurale, vendosën të krijojnë një rrjet joformal. Fillimisht, rrjeti ishte një përpjekje lokale, e mbështetur tërësisht "nga poshtë lart" me donacione vullnetare të bëra nga anëtarët e tij, të tilla si për ujë dhe përkthim në takime.[275] Duke pasur parasysh bollëkun e ndihmës së huaj që hynte në Kosovë pas luftës, disa aktorë të rinj ndërkombëtarë dhe OSH-CG-të ishin të hapur për të shpërndarë ndihmë dhe për të adresuar nevojat brenda komuniteteve të tyre.[276] Kështu, në fillim rrjeti u përqendrua në koordinimin drejt shpërndarjes më të mirë të ndihmave humanitare në mënyrë që të plotësonte nevojat e sigurisë së grave dhe vajzave. Ato donin të siguronin që gratë dhe vajzat e ndryshme të kishin qasje në kujdesin shëndetësor, arsimimin, ndihmën humanitare, psikologjike dhe mbështetje. Për më tepër, ato donin të siguronin që zëri i grave të dëgjohej në proceset vendimmarrëse në lidhje me rindërtimin e Kosovës pas luftës, veçanërisht nga UNMIK-u si administrator politik i Kosovës.

Deri në vitin 2003, aktivistet kuptuan se kishin nevojë për një rrjet më zyrtar për të mbledhur ndikim të mjaftueshëm politik në mënyrë që ato të merreshin seriozisht, përfshirë nga administrata e UNMIK-ut.[277] "Kjo është koha kur ne morëm një zyrë, karta biznesi dhe unë bleva kostumin tim të parë," kujton Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGK.[278] Rrjeti mori mbështetje nga Kvinna till Kvinna dhe STAR Network of World Learning (Rrjeti i Mësimit Botëror) për t'u regjistruar zyrtarisht si Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) më 12 nëntor 2003. Anëtarësia e RrGK-së, që arrinte 158 anëtare në vitin 2020, përfshin OSHCG të ndryshme që përfaqësojnë interesat e grave dhe vajzave të të gjitha etnive, vendndodhjeve gjeografike, aftësive dhe moshave. Parimi themelor i rrjetit është që pavarësisht ndryshimeve të tyre, OSHCG-të janë më të forta së bashku dhe mund të kenë një ndikim më të madh mbi proceset e vendimmarrjes, përfshirë ato që lidhen me paqen dhe sigurinë. Misioni i rrjetit është të:

> Mbështesë, mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimimit, orientimi seksual dhe aftësia e tyre. RrGK përmbush misionin e vet përmes shkëmbimit të përvojës dhe informacionit, partneritetit dhe rrjetëzimit, hulumtimit, avokimit dhe shërbimit.[279]

---

[273] Kvinna till Kvinna, *E drejtë jo dhuratë*, 2020, f. 30-31.

[274] OSBE, *Konferencë për gratë në politikë në Kosovë, 2000.*

[275] Intervistë e RrGK-së me Igballe Rogova, 2020.

[276] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*.

[277] Po aty.

[278] Po aty.

[279] Uebfaqja e RrGK, "Rreth Nesh"

Drejt realizimit të këtij misioni, anëtaret e RrGK bashkë-krijojnë dhe miratojnë strategji katër vjeçare, bazuar në analizën gjinore, drejt adresimit të çështjeve kryesore (të sigurisë njerëzore) me të cilat përballen gratë dhe vajzat në Kosovë.[280] Pastaj, anëtarët e RrGK bashkëpunojnë për të zbatuar strategjitë. Që nga viti 2012, Fondi i Grave të RrGK-së në Kosovë ka siguruar fonde për anëtarët e RrGK-së për të mbështetur përpjekjet e tyre të përbashkëta në zbatimin e strategjive të RrGK-së. Puna e Fondit dhe RrGK përfshin mbështetje të përshtatur për anëtarët e tij.

Stafi i RrGK raporton në Asamblenë e organizatave anëtare, si organ më i lartë vendimmarrës, në takimet gjashtëmujore dhe vjetore mbi progresin e bërë drejt zbatimit të strategjisë. Që nga fillimi i tij, RrGK vazhdimisht ka mbajtur takime mujore, dymujore ose tremujore, bazuar në nivelin e nevojës. Takimet e rregullta të rrjetëzimit janë përpjekur të ndërtojnë marrëdhënie midis anëtarëve të saj të ndryshëm përmes dialogut dhe diskutimit. Për më tepër, siç theksoi Igballe Rogova, "Gjithmonë kemi përfshirë burra në takimet e rrjetit. Ju nuk mund ta fuqizoni jetën e grave nëse nuk përfshini burra".[281] Kështu, Bordi i Drejtorëve të RrGK-së, i zgjedhur nga anëtarët e RrGK-së për të përfaqësuar interesat e tyre ka përfshirë tre burra avokues të barazisë gjinore gjatë viteve: Behar Selimi, Besim M. Kajtazi dhe Besnik Leka.

"Unë e shoh rrjetëzimin si një mënyrë shumë efikase për të kontribuar në paqe dhe siguri, për t'u marrë me të kaluarën, për të dëgjuar dhe njohur dhimbjen e njëra-tjetrës, për të vuajtur dhe për ta kapërcyer vuajtjen, dhe për të parë të ardhmen në një mënyrë tjetër."

**Aktiviste shqiptare, Prishtinë**

Disa të anketuar në intervista vërejtën se RrGK, si një rrjet multietnik, kontribuon për paqe dhe siguri duke bashkuar gra të ndryshme në bashkëpunimin drejt qëllimeve të përbashkëta nën strategjitë e bashkuara. Strategjitë e RrGK-së vazhdimisht kanë përfshirë objektiva drejt ndërtimit të paqes. Kështu, RrGK gjithashtu ka siguruar mbështetje përmes Fondit të Grave të Kosovës për gratë shqiptare dhe serbe që punojnë së bashku në nivelin lokal. Për shembull, anëtarët e RrGK-së, Dera e Hapur dhe Dorë për Dorë [*Ruka Ruci*] kanë ndërmarrë disa iniciativa të përbashkëta për të bashkuar gratë serbe dhe shqiptare brenda komuniteteve të tyre, duke ngritur së bashku çështje me rëndësi për to.

Siç kanë ilustruar pjesët e mëparshme, RrGK ka kontribuar për paqen dhe sigurinë në Kosovë dhe rajon në disa mënyra, duke përfshirë bashkimin e grave shqiptare dhe serbe në Kosovë si pjesë të rrjetit; mbështetjen e përpjekjeve të tyre të përbashkëta ndër-etnike përmes Fondit të Grave të Kosovës; bashkë-themelimin e Koalicionit të Grave për Paqe, LRGEJL dhe Gjykatës së Grave; ngritje të zërit të grave në proceset e paqes, përfshirë në negociatat dhe dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; mbrojtjen e zbatimit të RKSKB 1325; dhe disa përpjekje të tjera në lidhje me sigurinë njerëzore të grave, siç përshkruhet më vonë. Meqenëse stafi dhe anëtarët e RrGK-së përfshijnë edhe vajza, ato kanë qenë të angazhuara në të gjitha këto përpjekje.

"Pas luftës, ne filluam të punojmë me gratë për t'i bërë ato të njohin dhe të kërkojnë të drejtat e tyre. Për më tepër, gratë aktiviste ishin ato që punuan pas luftës për të përfshirë nevojat e grave në legjislacionin e Kosovës."

**Shpresa Agushi, aktiviste për të drejtat e grave rome, ashkali, egjiptiane, Prishtinë**

[280] Strategjitë e RrGK me kalimin e kohës janë në dispozicion në internet.

[281] Intervistë e RrGK-së me Igballe Rogova, Prishtinë, 2020

RrGK gjithashtu ka shërbyer si hapësirë për krijimin e rrjeteve dhe ndarjen e përvojave. Ndërsa disa gra aktiviste shqiptare kishin filluar OSHC gjatë viteve 1990, vetëm një OSHCG jo-shqiptare e drejtuar nga gratë duket se ka ekzistuar atëherë: Rrethi i Motrave Serbe. Të gjitha OShC-të e tjera serbe, boshnjake, turke, gorane, rome, ashkali dhe egjiptiane filluan aktivitetin pas luftës. Menjëherë pas luftës, gratë aktiviste shqiptare morën mësim nga përvoja e tyre e organizimit gjatë viteve 1990 për të mbështetur aktiviste të tjera të të drejtave të grave në krijimin e organizatave. Bazuar në përvojën e krijimit të RrGK, Igballe Rogova, duke punuar me Flora Macula dhe Luljeta Vuniqi, fillimisht mbështeti krijimin e një Rrjeti Serb të Grave, megjithëse ky rrjet hasi sfida pas "Ngjarjeve të marsit 2004", ku OSHCG-të serbe nuk ranë dakord të vazhdojnë me rrjetin. Të tri aktivistet gjithashtu mbështetën krijimin e Rrjetit të Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës. Pas fillimit si grup jo-formal në vitin 2000, zyrtarisht u regjistrua në vitin 2007. Më 2019, Shpresa Agushi, Drejtorja Ekzekutive, pranoi çmimin e BE-së "Heroinat e Panjohura", për punën e saj në integrimin e komunitetit Rom në Ballkanin Perëndimor.[282]

Siç sugjeron kjo nën-pjesë dhe shembujt në nën-pjesë të tjera, rrjetëzimi mund të jetë dhe ka qenë një strategji e rëndësishme përmes së cilës gratë, përfshirë vajzat, kanë kontribuar në avancimin e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon.

## Kontributet e grave për sigurinë njerëzore

Në lidhje me sigurinë njerëzore, gratë vuajnë pasoja të konsiderueshme sociale, ekonomike, fizike dhe psikologjike nga lufta. Në shumë raste, gratë jo vetëm që kanë qenë dëshmitare të dhunës ndaj familjeve dhe të njohurve të tyre, por gjithashtu kanë qenë të ekspozuara ndaj rrezikut më të madh të sëmundjeve, përfshirë sëmundjet seksualisht të transmetueshme si rezultat i abuzimit seksual.[283] Mosndëshkimi për krime të rënda dhe mizori, përfshirë dhunën seksuale dhe në bazë gjinore, të cilat mund të kenë ndodhur para, gjatë dhe/ose pas luftës, mund të rrezikojë përpjekjet për ndërtimin e paqes.[284] Në përgjithësi, siç dëshmojnë përkufizime dhe deklarata të ndryshme të grave në Kapitullin I, ato do të ndiejnë paqe dhe siguri vetëm pasi të adresohen disa aspekte të sigurisë së tyre njerëzore, duke përfshirë sigurinë e tyre ekonomike, sigurinë nga dhuna në bazë gjinore dhe forma të tjera të sigurisë personale dhe shoqërore, veçanërisht për grupet potencialisht të margjinalizuara. Prandaj, kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri që lidhen posaçërisht me përparimin e secilës prej këtyre formave të sigurisë njerëzore.

## Kontributet drejt sigurisë ekonomike

Për sa i përket sigurisë njerëzore, disa OSHCG kanë udhëhequr një mori përpjekjesh drejt avancimit të sigurisë ekonomike të grave. Menjëherë pas luftës, kjo përfshinte mbledhjen e fondeve dhe shpërndarjen e ndihmave për gratë që kishin humbur jetesën e tyre gjatë luftës, duke siguruar fara, traktorë, lopë, bletë dhe pajisje për përpunimin e ushqimit.[285] Shpesh këto ndërhyrje thelbësore ndërthuren me grupe të mbështetjes psikosociale, siç është qasja efektive e Medica Kosova; kjo OSHCG përdori një qasje psikosomatike dhe ndërtoi aleanca mes grave, të cilat shërbyen dyfish si rrjet i sigurisë sociale kur gratë përballen me sfida psikologjike dhe ekonomike. Gratë në kolektivet e tyre ndërhynin për të ndihmuar njëra-tjetrën kur ishte e nevojshme.

[282] Për më shumë informata, shihni: Çmimi i BE për Integrimin e Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, 2019

[283] Aragon J. and Miller, M., *Global Women's Issues: Women in the World Today, extended version (Çështjet Globale të Grave: Gratë në Botë Sot, version i zgjeruar)*, Byroja e Programeve Ndërkombëtarë të Informacionit, Departamenti i Shtetit i SHBA, 2017, f. 83-84.

[284] KB, "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi ndërtimin e paqes menjëherë pas konfliktit", 2009, f. 4

[285] Për detaje të mëtejshme rreth përpjekjeve të tilla, shih gjithashtu, QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*.

Një shembull tjetër, një nga masakrat më të tmerrshme të lidhura me luftën ndodhi në Krushë të Vogël, ku policia, paramilitarët dhe civilët serbë vranë 114 burra në fshat, kryesisht civilë.[286] Gratë dhe fëmijët u detyruan nën kërcënimin e armëve të hynin në lumë ose të ecnin për në Shqipëri. Kur u kthyen pas luftës, ato gjetën një vendbanim fantazmë. Ato bënë shtëpi të improvizuara për veten e tyre në hirin e fshatit të tyre të vjetër dhe mësuan të kryejnë punët bujqësore të ndërmarra zakonisht nga burrat.[287] Ndërsa fillimi i një jete të re ishte i vështirë, gratë vazhduan me mbështetjen nga aktivistet e Motrat Qiriazi. Fillimisht kjo përfshinte, bisedime, të dëgjuarit dhe shëruarit, por më pas mbështetja ekonomike u bë e rëndësishme. "Ne shpërndamë lopë për secilën familje për t'i fuqizuar ato ekonomikisht", kujton një aktiviste.[288] "Ato e trajtuan një lopë si një anëtare të familjes. Kjo i ndihmoi ato jo vetëm ekonomikisht, por gjithashtu kontribuoi në mirëqenien e tyre". Motrat Qiriazi filluan mësimin në auto shkollë në mënyrë që gratë të mësonin të drejtonin traktorët e tyre dhe t'i çonin produktet e tyre në treg, detyra të ndërmarra më parë nga burrat. Gratë që kishin humbur burrat e tyre përfundimisht u bënë të pavarura ekonomikisht. Gratë u fuqizuan gjithnjë e më shumë si udhëheqëse brenda komunitetit të tyre dhe përfundimisht filluan Shoqatën e Grave Fermere Krusha e Vogël, një nga shoqatat e para të grave fermere në Kosovë.



© RrGK
OSHCG-të kanë mbështetur sigurinë financiare të grave, si përmes granteve pë të zhvilluar mikrobiznese si mbajtja e bletëve. Këtu, kjo është bërë e mundur me përkrahjen e UN Women, përmes RrGK Fondit të Grave të Kosovës.

[286] OSBE, *Kosovo/Kosova As Seen, As Told*, 1999; *Washington Post*, "Kosovo's Killing Fields", 1999; *New York Times*, "Kriza në Ballkan: Refugjatët; Refugjatë të panumërt japin detaje për vrasjet masive", 1999; RrGK, "RrGK në përkrahje të grave të Krushës, kërkon drejtësi për krimet e luftës ", 2020.

[287] Mertus, J., *Improving the Status of Women in the Wake of War: Overcoming Structural Obstacles (Përmirësimi i statusit të grave pas luftës: kapërcimi i pengesave strukturore)*, 2003, f. 542-543.

[288] Intervistë e RrGK-së me aktivisten shqiptare Prizren, 2020.

Ekzistojnë disa shembuj të tjerë të OSHCG-ve rurale që kontribuan në sigurinë ekonomike të grave. Shoqata e Grave Bletare "Okarina e Runikut" në Skenderaj kontribuoi në fuqizimin e grave ekonomikisht duke u ofruar trajnime për bletari dhe tregtimin e mjaltit në panaire.[289] Shoqata e Grave "Lulishtja" ka ndihmuar gratë fermere dhe prodhuese bujqësore në pesë fshatra që të fillojnë biznese të reja dhe të shesin produktet e tyre, si dhe të avokojnë për marrjen e subvencioneve bujqësore shtetërore,[290] duke marrë parasysh nën përfaqësimin e grave në këtë sektor dhe midis përfituesve të subvencioneve.[291] Qendra e Grave për Zhvillim Rural në Gjakovë, ka punuar për të përmirësuar kushtet për gratë dhe familjet e tyre.[292] Në Mitrovicë, EMINA - Grupi i Grave Boshnjake ka ndihmuar gratë e veja dhe nënat të shesin produktet e tyre të punuara me dorë;[293] dhe Shoqata e Grave SABOR ndihmon personat e zhvendosur serbë, refugjatët, nënat vetushqyese dhe gratë e tjera në nevojë duke i fuqizuar ato ekonomikisht dhe shoqërisht lidhur me ndërmarrjen dhe udhëheqjen.[294] Shoqata e Grave GORA ndihmon gratë gorane dhe boshnjake në zonat rurale.[295]




© RrGK
Një aktiviste e re mban në duar pankartën, "Dua Pun'sim", ndërkohë që aktivistët tjerë brohorisnin këtë sllogan dhe të tjerë gjatë demonstratës për nder të Ditës Ndërkombëtare të Grave në Prishtinë.

Në vitet e fundit, OSHCG dhe aktivistet individuale për të drejtat e grave, veçanërisht vajzat, kanë avokuar për të drejtat e punës së grave, veçanërisht për një vend pune pa diskriminim të bazuar në gjini. Hulumtimi i tyre ka dokumentuar abuzime të gjera të të drejtave dhe pasiguri me të cilat përballen gratë në punë.[296] OSHCG-të në Kosovë kanë bashkëpunuar si pjesë e një koalicioni rajonal të aktivisteve të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat e grave në punë, të drejtën për një vend të sigurt pune dhe si të raportojnë shkeljet e të drejtave. Për më tepër, ato kanë bashkëpunuar me OSHC-të e tjera për të siguruar ndihmë juridike për gratë, të drejtat e të cilave janë shkelur, si dhe për të mbrojtur një kornizë ligjore të përmirësuar në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Aktivistet e reja kanë qenë në ballë të demonstratave tashmë vjetore në Ditën Ndërkombëtare të Grave, 8 Mars, si *"Marshojmë! S'festojmë!"* ["Mos festo, Marsho!"] duke kërkuar vëmendje për një mori çështjesh të sigurisë, përfshirë sigurinë ekonomike. Këto marshime janë planifikuar dhe organizuar nga gra të reja dhe tërheqin vëmendjen e konsiderueshme të mediave dhe publikut drejt adresimit të çështjeve të sigurisë me të cilat përballen gratë në Kosovë.

[289] RrGK, faqja në internet, Shoqata e Grave Bletare "Okarina e Runikut".

[290] RrGK, faqja në internet, "Lulishtja" avokon për fuqizimin ekonomik të fermereve në fshatrat e Malësisë së Gollakut, 2020

[291] Shiko RrGK, *Analiza gjinore e Kosovës*, 2018

[292] RrGK, faqja në internet, Qendra e Grave për Zhvillimin Rural.

[293] RrGK, faqja në internet, EMINA - Grupi i Grave Boshnjake.

[294] Për më shumë informata në lidhje me këtë organizatë, shih Shoqata e Grave SABOR.

[295] RrGK, faqja në internet, Shoqata e Grave GORA.

[296] RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë*, 2019 Gratë studiuese të reja që punojnë në Riinvest dhe D4D kanë botuar gjithashtu për këto çështje.




© RrGK
Qindra gra dhe burra të ndryshëm, shënojnë Ditën Ndërkombëtare të Grave, 8 Marsin (2020), duke marshuar përmes Prishtinës/Priština me moton, "Marshojmë S'festojmë", duke mbajtur pankarta me mesazhe kundër dhunës dhe për të drejtat e grave punëtore, përveq tjerash.

Si pjesë e mjedisit të mundësisë për sigurinë ekonomike të grave, ABGJ dhe disa OSHCG kanë mbështetur përpjekjet për të rritur pronësinë e grave. Pasi ABGJ dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës vendosën Udhëzimin Administrativ për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Përbashkëta në Regjistrim të të dy Bashkëshortëve për të mbështetur më shumë gra që të bëhen pronare të përbashkëta të pasurive,[297] OSHCG-të mbështetën promovimin e kësaj mase të rëndësishme afirmative. Një numër i OSHCG-ve kanë punuar për të informuar gratë për të drejtën e tyre të trashëgimisë dhe pronësisë së pronës, si dhe për të mbështetur gratë drejtpërdrejt në kërkimin e kësaj të drejte, drejt një sigurie të zgjeruar ekonomike të grave.

## Kontributet në adresimin e dhunës në familje dhe ngacmimit seksual

Në kontekste të pas-luftës, veçanërisht në mes të mungesës së shërbimeve shtetërore, OSHCG-të mund të jenë aktorë të rëndësishëm në mbështetjen e viktimave të dhunës.[298] Dhuna në bazë gjinore, veçanërisht dhuna në familje dhe ngacmimi seksual, mbetet ndër kërcënimet më serioze për sigurinë e grave në Kosovë, siç vërejtën gratë në Kapitullin I.[299] Në jetën e tyre, rreth 62% e njerëzve në Kosovë (56% e burrave dhe 68% e grave) kanë përjetuar dhunë në familje, ndërsa 20% e burrave dhe 41% e grave thanë se kishin përjetuar një




© RrGK
Gjatë ngjarjeve si Një Miliardë në Këmbë, OSHCG-të si Artpolis dhe RrGK kanë angazhuar burra në përpjekjet e tyre për t'i dhënë fund dhunës kundër grave. Në demonstratën e vitit 2014, djem mbajnë një pankartë që thotë, "Thuaj Jo Dhunës"

[297] Udhëzimi Administrativ - Nr. 08/2015 Për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme të Përbashkët në Sjellje të të dy Bashkëshortëve, 2015 Neni 2 i detyroi institucionet publike të zbatojnë masa të veçanta për të rritur numrin e grave të regjistruara si pronare të përbashkëta. Bashkëshortët që regjistronin bashkërisht pasurinë e tyre përjashtoheshin nga pagesa administrative. Në vitin 2017, RrGK me organizatat e saj anëtare dhe ABGJ avokoi zgjatjen e periudhës fillimisht një vjeçare të aplikimit, e cila u miratua nga Qeveria.

[298] Bastic, M. dhe Whitman, T., *A Women's Guide to Security Sector Reform (Udhëzues i grave për reformën në sektorin e sigurisë)*, 2015, f. 8

[299] Shqetësimi për dhunën në familje ishte një temë e përsëritur në mesin e të anketuarve.

formë të dhunës në familje vetëm në vitin 2014.[300] Për më tepër, disa raste të vrasjes së grave janë raportuar në vitet e fundit.[301] Përtej minimit të sigurisë njerëzore të grave, të intervistuarit kanë shprehur se dhuna në bazë gjinore gjithashtu pengon pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, përfshirë proceset e paqes dhe sigurisë. “Kosova është e sigurt ... por nuk mendoj se është e sigurt për gratë”, tha një pjesëmarrëse në hulumtim. “Gratë nuk janë të sigurta sepse i nënshtrohen dhunës së ndryshme. Prandaj, ato nuk janë përfshirë aq sa do duhej”.[302] Siç deklaroi Igballe Rogova në një konferencë të organizuar nga KFOR në prag të 20 vjetorit të Rezolutës 1325: “Siguria fillon në shtëpi; Prandaj, ne duhet të sigurojmë siguri për gratë në shtëpi”.[303]




© RrGK
Aktivistet e të drejtave të grave, posaçërisht përmes RrGK, kanë organizuar dhjetëra demonstrata për të bërë thirrje për drejtësi dhe siguri për gratë, sidomos nga dhuna në familje.

Drejt rritjes së sigurisë së grave në shtëpi, aktivistet për të drejtat e grave dhe gratë në disa institucione, veçanërisht ABGJ, kanë kontribuar në adresimin e dhunës në familje në Kosovë. ABGJ dhe RrGK kanë bashkëpunuar për të hulumtuar dhe informuar miratimin e disa ligjeve dhe politikave për të adresuar dhunën në bazë gjinore në Kosovë,[304]ABGJ kontraktoi RrGK-në për të bërë hulumtimin dhe shkruar raportin *Siguria fillon në shtëpi* në vitin 2008, mbështetur nga UNDP, të cilin ABGJ e përdori për të hartuar Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Në vitin 2013, ABGJ inicioi krijimin e Procedurave Standarde të Veprimit për të udhëzuar institucionet përgjegjëse në adresimin e dhunës në familje.[305] Për më tepër, ABGJ ka hartuar Komentarin e Ligjit per Mbrojtje nga Dhuna në Familje në vitin 2015. Gjithashtu në 2015 dhe 2020, bashkëpunimi i ABGJ dhe RrGK rezultoi në dy raporte të tjera monitorimi mbi dhunën në familje, që informuan dhe kontribuan në hartimin e dy strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit për parandalimin e dhunës në familje, procese të cilat i ka udhëhequr ABGJ duke angazhuar duk-

[300] RrGK, *Mjaft më me arsyetime*, 2015

[301] Shihni RrGK faqe në internet për thëniet dhe shembujt.

[302] Intervistë e RrGK-së me një grua, Prishtinë, 2020.

[303] RrGK, “Siguria fillon në shtëpi: Jo paqe pa drejtësi”, 2020

[304] Për shembull, shihni botimet e RrGK mbi dhunën me bazë gjinore.

[305] ABGJ, Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të), 2013.

shëm një gamë të larmishme aktorësh.[306] ABGJ gjithashtu propozoi krijimin e Koordinatorit Nacional për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, i cili shërbeu si një mekanizëm monitorimi dhe koordinimi.

Nga viti 2019, rekomandimet e RrGK dhe QKSGJ gjithashtu u përfshinë në ndryshimet e Kodit Penal për të përfshirë ngacmimin seksual dhe dhunën në familje si vepra penale, sipas Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (e njohur si "Konventa e Stambollit").[307] Për më tepër, në vitin 2020, pas avokimit të RrGK dhe QKSGJ, ndër të tjera, Konventa e Stambollit u përfshi qartë në Kushtetutën e Kosovës. RrGK, QKSGJ dhe strehimoret e grave, midis OSHCG-ve të tjera, kontribuan në hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje 2016-2020, i cili përfshinte 70% të rekomandimeve të RrGK-së për këtë Strategji. RrGK dhe avokimi i strehimoreve kanë kontribuar në miratimin e një linje buxhetore të shtetit për financimin e kostove kryesore të strehimoreve në vitin 2019 dhe 2020.[308] Ndërsa ky hulumtim u përqendrua në punën e OSHCG-ve, këto kontribute rezultuan nga avokimi i përbashkët me UN Women dhe anëtarët e Grupit të Sigurisë dhe Gjinisë.[309]

OSHCG-të kanë punuar pa u lodhur për të rritur sigurinë fizike, psikologjike dhe ekonomike të grave dhe fëmijëve që kanë pësuar dhunë. Për gati dy dekada, strehimoret dhe qendrat ditore të drejtuara nga OSHCG-të kanë ofruar shërbime esenciale për gratë dhe fëmijët që vuajnë nga dhuna, duke përfshirë hapësira të sigurta, kujdes shëndetësor, këshillim psikologjik, arsim, trajnim profesional, shërbime sociale, ndihmë juridike dhe për nevoja të tjera themelore.

Gjithashtu për dy dekada, një listë e gjerë e OSHCG-ve ka punuar në komunitete të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me dhunën në familje drejt parandalimit të saj dhe rritjes së sigurisë së grave, përfshirë punën përmes burrave.[310] OSHCG-të kanë organizuar një mori fushatash ndërgjegjësimi dhe demonstrimesh në nivelet komunale dhe qendrore drejt tërheqjes së vëmendjes së publikut për këtë çështje dhe mbajtjes së institucioneve përgjegjëse për sigurimin e drejtësisë, përfshirë në lidhje me raste specifike. Përmes banderolave, deklaratave publike dhe paraqitjeve në




Përmes posterave dhe kampanjave online, OSHCG-të dhe vajzat artiste janë përpjekur të ngrisin vetëdijen rreth dhunës në baza gjinore dhe si të raportohet ajo.

306 Shih më shumë në: Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014; dhe Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020.

307 Shih, RrGK, "Kodi Penal i Kosovës Penalizon Dhunën në Familje, Ngacmimet Seksuale", 2019. Këshilli i Evropës, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011.

308 RrGK letër deputetëve të parlamentit, dhjetor 2018; Ligji Nr. 06 / L –133 Për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, f. 46; RrGK, letër Koordinatorit Kombëtar kundër Dhunës në Familje, dhjetor 2019, [vetëm shqip]; Ligji Nr. 07L-001 Për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2020, f. 51

309 Grupi i Sigurisë dhe Gjinisë është një grup me shumë aktorë i themeluar në 2007. Përbëhet nga OShC si Kvinna till Kvinna, QKSGJ, Shoqata e Grave në Policinë e Kosovës; Institucionet e Kosovës si ABGJ, Grupi i Grave, Policia e Kosovës, Forcat e Sigurisë së Kosovës, Avokatët e Viktimave, Koordinatori Kombëtar kundër Dhunës në Familje; dhe organizata dhe aktorë ndërkombëtarë si UN Women, UNDP, UNICEF, UN-HABITAT, OHCHR, UNFPA, OBSH, UNOPS, UNHCR, UNMIK, Zyra e BE, EULEX, OSBE dhe KFOR.

310 Për shembull, shihni faqen e internetit të RrGK, "Anëtarët "Me ekspertizë mbi dhunën e bazuar në gjini.

media, ato kanë theksuar se gratë nuk mund të jenë të sigurta nëse nuk janë të sigurta brenda shtëpive të tyre. RrGK dhe strehimoret, ndër të tjera, vazhdimisht kanë avokuar në institucionet përkatëse për përgjigje më të mirë dhe qasje në drejtësi për gratë që kanë vuajtur dhunë në bazë gjinore, si dhe kanë siguruar ndihmë juridike dhe monitoruar rastet e dhunës në familje.

Aktivistet për të drejtat e grave dhe OSHCG-të ishin të parët që tërhoqën vëmendjen e publikut ndaj ngacmimeve seksuale në rrugë dhe kërkuan veprime qeveritare, përfshirë përmes hulumtimeve mbi këtë temë.[311] Aktivistet e reja prodhuan dhe promovuan një film të shkurtër duke dokumentuar një ditë në jetën e një vajze në Prishtinë, gjatë së cilës ajo u ngacmua afërsisht 50 herë.[312] Duke marrë mijëra shikime, filmi e nxori çështjen nga hija dhe e vuri në ballë të diskutimit publik, duke kontribuar në reagimet e publikut kundër ngacmimit në rrugë. Disa zyrtarë, policë dhe burra që kishin mohuar që ngacmimi seksual ekzistonte ose ishte një problem nuk mund të mohonin më lehtë pasiguritë me të cilat përballen gratë e reja në Kosovë çdo ditë.



Një film tërheqës nga vajzat aktiviste solli ngacmimin seksual jashtë hijeve dhe në a publike.

Gjithashtu, në reagim të ngacmimeve seksuale, vajzat programere nga Girls Coding Kosova bashkuan forcat me Open Data Kosova dhe RrGK për të krijuar një aplikacion mobil përmes të cilit gratë mund të raportonin ngacmimet seksuale: "Ec Shlirë".[313] Dialogët midis vajzave dhe policisë synonin të rrisnin hetimet policore të rasteve të ngacmimeve seksuale. Për më tepër, aplikacioni u përpoq të informonte planifikimin e qytetit dhe policimin duke identifikuar zona të pasigurta ku komunat mund të instalonin drita rrugësh, kamera dhe të ndërmerrnin përpjekje për të rritur policimin, drejt rritjes së sigurisë, veçanërisht për vajzat.

## Kontributet për sigurinë përmes njohjes së të mbijetuarve të dhunës seksuale

Ndërsa dhuna seksuale u njoh më herët si krim lufte,[314] në vitin 2008, Këshilli i Sigurimit i KB miratoi rezolutën 1820, e cila e njohu dhunën seksuale ndaj grave si një taktikë lufte.[315] Në Kosovë, ekzistojnë prova thelbësore që gratë ishin përdorur si një armë lufte; policë, ushtarë dhe paramilitarë përdhunuan gratë në shtëpitë e tyre, qendrat e paraburgimit dhe gjatë ikjes së tyre ose emigrimit të detyruar nga Kosova.[316] Duke pasur parasysh natyrën shumë private, të ndjeshme dhe shpesh tabu shoqërore të këtij krimi, numri i saktë i grave dhe burrave që pësuan dhunë seksuale mbetet i panjohur. Vlerësimet sugjerojnë se 10 mijë deri në 30 mijë persona kanë përjetuar dhunë të tillë, kryesisht gratë shqiptare nën moshën 25 vjeç.[317] Gratë e etnive të tjera gjithashtu pësuan dhunë seksuale, veçanërisht menjëherë pas luftës.[318]

[311] RrGK, *Ngacmimi seksual në Kosovë*, 2016

[312] Shikoni RRGK "Take Back the Night" video.

[313] Shih Open Data Kosova, "Ec Shlirë"

[314] KB, Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare miratuar në Romë në 1998 dhe hyri në fuqi në 2002; Neni 7 njeh dhunën seksuale si luftë kundër njerëzimit dhe neni 8 si një krim lufte.

[315] Rezoluta 1820.

[316] Shih Human Rights Watch, *Kosovë: Përdhunimi si një armë e "Pastrimit Etnik",* SHBA: HRW, 1998

[317] Fitamant, S., "Raporti i Vlerësimit të Dhunës Seksuale në Kosovë", Nju Jork: UNFPA, 2000; Corrin, "Situata pas konfliktit në Kosovë", 2001.

[318] Amnesty International, *Plagët që na djegin shpirtrat*, 2017, f. 18

Duke dokumentuar krimet e dhunës seksuale, OSHCG-të janë përpjekur të sjellin drejtësi për këto krime. Ato kanë argumentuar vazhdimisht se pa drejtësi, nuk mund të ketë paqe. Që menjëherë pas luftës, OSHCG-të kanë ndihmuar gratë në dokumentimin e provave dhe përgatitjen e dëshmive për Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY). Ato gjithashtu koordinuan me OSHCG-të diku tjetër për të gjetur strehë të sigurta për gratë dëshmitare kur jeta e tyre u kërcënua, duke pasur parasysh mungesën e mbrojtjes së duhur të dëshmitarëve. Dokumentimi i krimeve të tilla rrezikoi shumë aktiviste, gjithashtu, disa prej të cilëve u kërcënuan për punën e tyre.[319]

Pak gra që pësuan dhunë seksuale ndiheshin paqësore ose të sigurta. Ato ende përballeshin me stigmatizim nga familjet dhe komunitetet e tyre, trauma që kontribuan në sëmundjet psikologjike dhe fizike dhe vështirësitë ekonomike. Kështu, OSHCG-të gjithashtu ofruan shërbime për gratë që kishin pësuar dhunë seksuale, duke përfshirë këshillimin psikologjik, kujdesin mjekësor dhe mbështetjen ekonomike. Ndërsa disa të mbijetuar jetonin në situata të tmerrshme ekonomike, duke mos pasur siguri financiare, OSHCG-të ngritën fonde për të mbështetur gratë në zhvillimin e jetesës së tyre.

Më tej, OSHCG-të tërhoqën vëmendjen e publikut për nevojën e reagimit të qeverisë dhe njohjen e dhunës seksuale të kryer gjatë luftës. OSHCG-të e nxorën çështjen nga hija dhe e sollën në qendër të vëmendjes për herë të parë gjatë një demonstrate të organizuar më 8 mars 2012, Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Nën melodinë e "Ne do t'ia dalim", ato kënduan tekste të rishikuara në lidhje me drejtësinë për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës. "Ne bëjmë thirrje për drejtësi për gratë", kënduan ato së bashku. Demonstrata bëri që disa zyrtarë qeveritarë të përloteshin, dhe menjëherë, të nesërmen, çështja u diskutua në Kuvendin e Kosovës. Aida Dërguti, ish deputete e Parlamentit dhe ish nënkryetare e partisë politike Vetëvendosjes kujton:




© RrGK Gratë aktiviste duke kërkuar drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës në Kosovë, më 8 mars 2012, në Ditën Ndërkombëtare të Grave

> Gjithçka filloi brenda Vetëvendosjes, si një diskutim mes meje, si nënkryetare e partisë, dhe Nazlie Balaj. Pasi kjo ide u miratua nga kryesia e partisë dhe ne ishim në prag të 8 marsit 2012, u takuam me Igballe Rogovën dhe së bashku filluam të bëjmë planin për hapat e ardhshëm. Ne organizuam diskutime publike për të informuar publikun mbi këtë temë. Shanset për të mbështetur një iniciativë të ardhur nga një parti e vogël dhe shumë polarizuese e opozitës ishin mjaft të ulëta. Prandaj, Igo Rogova së bashku me RrGK morën rolin e ndërmjetësit midis grave deputete. Tryezat me dyer të mbyllura midis grave në politikë dhe shoqërisë civile, të organizuara nga RrGK, kishin për qëllim sigurimin e votave për këtë ligj përmes grave deputete nga partitë e tjera në parlament.[320]

Pas viteve të avokimit të palodhur nga OSHCG-të dhe gratë në politikë, përfshirë presionin e liderëve të partive politike që fillimisht rezistuan, në vitin 2014, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet që e njohën dhunën

[319] Bisedat e RrGK me aktivistet e të drejtave të grave.

[320] Intervistë e RrGK-së me Aida Dërguti, Prishtinë, 2020.

seksuale të mbijetuarve të luftës dhe u siguruan atyre përfitime si ato të veteranëve të tjerë.[321]

Të mbijetuarit duhet të prisnin deri në janar 2018, 18 vjet pas luftës, për të aplikuar më në fund për statusin e të mbijetuarit të dhunës seksuale në kohë lufte dhe për të marrë kompensim në formën e një pagese mujore, si dhe disa forma të tjera të kufizuara të mbështetjes.[322] Përtej forcimit të sigurisë së tyre ekonomike, të mbijetuarit thanë se njohja zyrtare e tyre dhe gjendja e tyre e vështirë kontribuan në mirëqenien e tyre më të gjerë psikologjike. Për më tepër, të intervistuarit ranë dakord që njohja e statusit të të mbijetuarve dhe fakti që ata marrin mbështetje monetare mujore kontribuan në fuqizimin e tyre. "Të mbijetuarit kanë ndarë me ne se ata kurrë nuk kanë pasur pagë. Ky pension u jep atyre jo vetëm pavarësi ekonomike por edhe vetëbesim, duke i bërë ata më mendjehapur. Sidoqoftë, ka ende shumë punë për të bërë", komentoi një përfaqësuese e Qendrës Kosovare të Rehabilitimit për Viktimat e Torturës (QKRMT).[323] OSHCG-të si QKRMT, Medica Kosova, Medica Gjakova dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas kanë mbështetur gratë në aplikimin për përfitime shtetërore, kanë monitoruar shpërndarjen e përfitimeve dhe kanë ndihmuar gratë ekonomikisht, të mbështetura nga UN Women. Siç shpjegoi përfaqësuesi i QKRMT-së:

> Në mënyrë indirekte, çdo fuqizim i grave dhe vajzave kontribuon në paqe dhe siguri. Unë them, pa modesti, se ne arritëm të nxirrnim një grua nga hija e harresës për të luftuar për të drejtat e tyre për të pasur një jetë "normale".[324]

Në vitin 2014, LRGEJL, e udhëhequr nga Edita Tahiri, nisi një peticion, duke kërkuar drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftërave në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci.[325] Më shumë se 110,000 burra dhe gra, nënshkruan këtë peticion, i cili iu drejtua Sekretarit të Përgjithshëm të KB António Guterres. Në vitin 2019, Edita Tahiri paraqiti peticionin te Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të KB mbi temën e viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit, Pramila Patten.[326]

Deri në këtë shkrim, askush nuk është dënuar për dhunë seksuale të kryer gjatë luftës në Kosovë. Prandaj, OSHCG-të vazhduan avokimin e tyre drejt drejtësisë për gratë dhe burrat që pësuan dhunë seksuale, si dhe për të mbijetuarit e masakrave dhe familjet e njerëzve të zhdukur. Siç ka theksuar Igballe Rogova, "Nuk ka paqe pa drejtësi".[327] Kështu, OSHCG-të, si dhe gratë politikane, janë përpjekur të kontribuojnë për paqe dhe siguri duke insistuar në njohjen e krimeve të kryera në Kosovë, drejtësinë dhe dëmshpërblimet për gratë që kanë vuajtur dhunën seksuale.

## Kontributet për sigurinë për grupet e margjinalizuara

OSHCG-të dhe aktivistet individuale për të drejtat e grave gjithashtu kanë kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të grave potencialisht të margjinalizuara dhe/ose të cenuara. Në periudhën e pasluftës Handikos vazhdoi të ndihmojë njerëzit me aftësi të ndryshme. Edhe pse Ligji Kundër Diskriminimit i Kosovës u miratua në 2004, normat shoqërore

[321] Ligji i Kosovës për të Drejtat e Luftëtarëve dhe Viktimave të tjera Civile të Luftës i ndryshuar, Neni 6.

[322] Amnesty International, *Plagët që na djegin shpirtrat "Kompensim për të mbijetuarit e përdhunimit në luftën e Kosovës, por ende nuk ka drejtësi*, f. 8.

[323] Intervistë e RrGK-së me një grua përfaqësuese e QKRMT, Prishtinë, 2020.

[324] Po aty.

[325] Intervistë e RrGK-së me Edita Tahiri, Prishtinë, 2020.

[326] LRGEJL, faqja në internet, "Edita Tahiri Dorëzoi në KB letrën e LRGEJL që kërkon drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftërave në Kosovë", 2019.

[327] Igballe Rogova, fjalim, konferenca e KFOR-it në prag të përvjetorit të 20-të të Rezolutës 1325, Prishtinë, 2020.

ende kontribuan në diskriminimin ndaj njerëzve me aftësi të ndryshme.[328] Handikos vazhdimisht avokoi që ky Ligj të zbatohet dhe që njerëzit me aftësi të ndryshme të kenë qasje të barabartë në punësim, arsim dhe vende publike.[329] Zyrat e degëve të Handikos i bënë presion qeverisë për të përfshirë njerëz me nevoja të ndryshme në vendimmarrje. Për shembull, Handikos dhe OSHCG-të tjera lokale lobuan në qeverinë komunale të Prizrenit për të krijuar një komitet për njerëzit me nevoja të veçanta. Në këtë komitet, të themeluar në qershor 2005, Drita Vukshinaj, Menaxhere e Handikos Prizren shërbeu si nënkryetare.[330] Disa gra të tjera ishin të angazhuara drejtpërdrejt në punën e Handikos.

Handikos gjithashtu vazhdoi të identifikojë dhe regjistrojë njerëzit me nevoja të veçanta. Myrvete Hasani, Menaxhere e Handikos Mitrovicë, i përshkroi QKSGJ-së sfidat me të cilat përballen në gjetjen e njerëzve me aftësi të ndryshme, në mënyrë që ata t'iu sigurojnë sigurinë e tyre njerëzore:

> Kur u thamë dy prindërve se e dinim që kishin një fëmijë me nevoja të veçanta, ata nuk pranuan ta pranonin atë. Ne i bindëm ata të na tregonin fëmijën e tyre. Kur ata hapën derën, ne pamë që vajza po qante sepse mendoi se ajo ishte personi i vetëm në botë me nevoja të veçanta. Ajo ishte njëzet vjeç dhe filloi të qante sepse më pa me paterica dhe sa krenare isha, se nuk kisha turp të dilja jashtë. Ajo filloi të më përqafonte dhe të më pyeste, "A del jashtë? Dhe familja jote e di që ti del?" Ajo ishte plotësisht e befasuar.[331]

Disa OSHC, përfshirë OSHCG-të, punuan kështu për të mbështetur njerëzit me aftësi të ndryshme në qasjen në të drejtat e tyre. OSHCG-të që kërkojnë të çojnë më tej sigurinë njerëzore të grave me aftësi të ndryshme përfshinin Shoqatën e të Verbërve dhe Personave të Verbër dhe me Shikim të Kufizuar, Komitetin e Grave të Verbra të Kosovës, Shoqatën e Grave të Shurdhra, Shoqatën e Grave për Gratë me Aftësi të Kufizuara, Down Syndrome Kosova, Hendifer, Svet Andjela (Bota e Engjëjve) dhe Shoqatën për Autizëm, si dhe degë të organizatave më të mëdha si Handikos të vendosura në nivelin komunal.[332]

OSHCG-të kanë ndërmarrë disa veprime për të mbështetur gratë me aftësi të ndryshme. Për shembull, në Prizren, Organizata për Personat me Distrofi Muskulare ka avokuar për trotuare të përmirësuara dhe qasje në hapësirat publike për njerëzit me karroca invalidore. Në Prishtinë, Shoqata e Grave të Verbra ka bërë thirrje për disponueshmëri më të mirë të shkrimit braj (*braille*) në shkolla dhe qasje të barabartë në pensionet shtetërore për të gjithë personat e verbër. Disa OSHCG-ë kanë mësuar gratë me aftësi të ndryshme aftësi profesionale, strategji të aplikimit për punë dhe informacione të tjera për t'i mbështetur ato në sigurimin e punësimit, si dhe për të jetuar në mënyrë autonome.



© RrGK
Aktivistet e të drejtave të grave kanë mbështetur Paradën e përvitshme të LGBTQIA+ që kur ka filluar të mbahet në Prishtinë.

[328] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, Kosovë, f. 315

[329] Po aty.

[330] Po aty.

[331] Po aty.

[332] USAID, *Vlerësimi i gjinisë, LGBTI dhe personave me aftësi të kufizuara*, 2018; RrGK faqe në internet.

Në komunitetet serbe dhe rurale, OSHCG-të kanë avokuar për transport publik për të mundësuar qasjen e vajzave në arsim dhe punësim. Ato kanë punuar për të shmangur martesën e hershme dhe për të fuqizuar gratë e reja rurale, rome, ashkali dhe egjiptiane për të vazhduar arsimimin e tyre. Aktivistet individuale për të drejtat e grave dhe OSHCG-të kanë mbështetur veprimet publike në mbështetje të të drejtave të personave LGBTQIA+, si dhe janë bashkuar me organizatat LGBTQIA+ në kërkimin e të drejtave të barabarta, duke përfshirë edhe kontributin në formulimin e frazave që do të lejonin të drejtën e martesave të të njëjtit seks në Kushtetuta e Kosovës. Përmes këtyre përpjekjeve të ndryshme, aktivistët dhe OSHCG-të janë përpjekur të kontribuojnë në rritjen e sigurisë për gratë që shpesh përballen me forma të shumta të diskriminimit.

Në përmbledhje, OSHCG-të dhe aktivistet e të drejtave të grave, përfshirë vajzat, kanë kontribuar për paqen dhe sigurinë njerëzore, përfshirë edhe zbatimin e RKSKB 1325 në drejtim të Ndihmës dhe Rimëkëmbjes: ato kanë siguruar mbështetje sociale, ekonomike, fizike dhe psikologjike për gratë. Duke ditur që "siguria fillon në shtëpi" dhe "nuk mund të ketë paqe pa drejtësi", OSHCG-të dhe aktivistet e të drejtave të grave në bashkëpunim me ABGJ, UN Women, Grupin e Sigurisë Gjinore dhe aktorë të tjerë kanë kontribuar në përmirësimin e kornizës ligjore për adresimin e dhunës në bazë gjinore. OSHCG-të kanë kontribuar në sigurinë njerëzore duke rritur sigurinë ekonomike të grave, duke mbështetur personat që vuajtën dhunë në bazë gjinore, dhe duke promovuar, si dhe mbrojtur të drejtat e njerëzve me aftësi të ndryshme dhe personave LGBTQIA+.

## Kontributet e grave për sigurinë përmes sektorit të sigurisë

RKSKB 1325 parashikon rritjen e pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë dhe sigurimin e një qasjeje më të ndjeshme gjinore në këtë sektor. Punësimi i grave në sektorin e sigurisë mund të rezultojë i paçmuar për t'iu përgjigjur nevojave specifike të sigurisë së grave dhe vajzave, duke siguruar një trajtim të ndershëm dhe duke u mundësuar viktimave të krimit që të komunikojnë më mirë me policinë.[333] Megjithatë, edhe pse gratë shpesh kanë aftësi të mira de-eskalimit dhe komunikimit, ato kanë tendencë të nënpërfaqësohen në forcat e sigurisë në shoqëritë pas luftës, për shkak të pengesave të rekrutimit dhe kulturës së brendshme të institucioneve të sigurisë; kjo kontribuon në mungesën e besimit të publikut në këto institucione dhe minon legjitimitetin e tyre.[334]

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqen dhe sigurinë përmes sektorit të sigurisë në Kosovë, përfshirë përpjekjet për të rritur angazhimin e grave në sektorin e sigurisë. Ajo përshkruan gjithashtu përpjekjet e OSHCG-ve dhe aktivistëve për të drejtat e grave për të integruar një qasje të përgjegjshme gjinore në punën e institucioneve të reja të sigurisë dhe aktorëve ndërkombëtarë të sigurisë në Kosovë.

Pas luftës, NATO kishte përgjegjësinë të siguronte sigurinë në Kosovë me 45,000 trupa në Forcën e Kosovës (KFOR).[335] Sipas aktivisteve për të drejtat e grave, atyre iu desh të "shtynin" që misionet ndërkombëtare të sigurisë të integronin gjininë në punën e tyre dhe për t'i "edukuar" ata në zbatimin e RKSKB 1325.[336] Për shembull, KFOR-i publikoi tabela afishimi të një burri muskulor, pa këmishë me mesazhin, "KFOR-i është i fortë". Igballe Rogova kujton:

> Ne reaguam! Ne shkruam në media, duke i kritikuar ata, dhe menjëherë pasi u ftuam të takoheshim me Shefin e KFOR-it. Ai tha, "Nuk e kuptoj pse u desh të shkosh në media. Mund të kishe ardhur tek unë. Unë

[333] Bastick, M., "Integrimi i gjinisë në reformën e sektorit të sigurisë pas konfliktit", 2008, f. 14 Pjesëmarrësit e hulumtimit në Kosovë e konfirmuan këtë.

[334] Po aty. Shih gjithashtu Bastic, M. dhe Whitman, T., Një udhëzues i grave për reformën në sektorin e sigurisë, 2015

[335] RKSKB 1244; RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, f. 12

[336] Intervistat e RrGK me gra aktiviste, 2020.

u përgjigja: "Sepse nuk do të na ftonit dhe unë e di këtë nga përvoja ime". Ai ishte me të vërtetë i sinqertë dhe tha, "Mirë, më thuaj çfarë të bëj". Unë thashë: "Numër një: kini një këshilltar gjinor në misionin tuaj".... Jo shumë kohë pas atij takimi, një këshilltar gjinor u caktua në mision. Pastaj, unë thashë, "Numër dy: këshillohuni me ne para se të botoni". Pas kësaj, KFOR-i pothuajse gjithmonë na këshillonte.[337]

Pas kësaj, RrGK, ndër të tjera, mbajti raporte të vazhdueshme me KFOR-in, drejt integrimit të një perspektive gjinore në punën e tyre. Kjo përfshiu trajnimin e trupave që vinin, siç parashikohet nga RKSKB 1325, mbi lëvizjen e grave në Kosovë, pabarazitë kryesore gjinore, dhunën seksuale dhe lidhjet e mundshme midis prostitucionit dhe trafikimit seksual.

Në vitin 1999, filloi procesi i çarmatosjes dhe transformimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK).[338] Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, disa institucione të sigurisë ndryshuan strukturën e tyre; TMK u shpërbë dhe u bë Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) më 14 qershor 2009.[339] Ministria e Forcës së Sigurisë u riorganizua në Ministri të Mbrojtjes.[340] Ndërkohë, gratë që ishin pjesë e stafit civil të Ministrisë që nga viti 2008 bashkëpunuan me OSHCG-të dhe aktivistet për të drejtat e grave në drejtim të krijimit të mekanizmave të brendshëm dhe programeve mësimore në përputhje me RKSKB 1325.[341] Gratë në Ministrinë e Mbrojtjes, të tilla si Halime Morina, Shefe e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Gjinore, e cila solli përvojën e mëparshme nga shoqëria civile në këtë pozitë, kanë kontribuar në përmirësimet në zbatimin e Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe RKSKB 1325 brenda këtij institucioni. Normat sociale vazhdojnë të minojnë përfshirjen e grave në FSK, veçanërisht perceptimin e përhapur të socializuar se ushtria është vetëm për burrat.[342] Sidoqoftë, Morina vuri re se "nocioni se ushtria është vetëm për burrat ka filluar të zbehet".[343] Një shenjë e ndryshimit të kohës, në vitin 2020, Sekretare e Përgjithshme e emëruar nga Ministria ishte një grua, Rozafa Ukimeraj.[344]

Ndërkohë, më 6 shtator 1999, UNMIK filloi krijimin e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) me 200 kadetë fillestarë, të zgjedhur nga 19,500 aplikantë. OSBE-ja, e asistuar nga Programi Ndërkombëtar i Ndihmës për Trajnimin Hetimor Penal (ICITAP) i mbështetur nga SHBA, i trajnoi kadetët.[345] Në fillim, kurrikulat e trajnimit policor përfshinin një qasje të ndjeshme gjinore ndaj policimit dhe reagimit ndaj dhunës në familje. Që nga fillimi, OSBE u përpoq të përfshinte gratë në polici.[346] Në vitin 1999, procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së UNMIK-ut synonte të siguronte që 15% e zyrtarëve do të ishin gra.[347] Në gjeneratën e parë, ata e tejkaluan këtë synim; 23% e 173 zyrtarëve që u diplomuan ishin gra (39), dhe 17 persona vinin nga grupe etnike të pakicave (10%).[348] Ata përdorën fushata për informim dhe punë në nivelin bazë për të tërhequr gratë dhe grupet etnike të pakicave për të marrë pjesë.[349] Transferimi i autoritetit nga UNMIK-u në Policinë e Kosovës (PK) filloi në vitin 2001. Me krijimin e Ministrisë

---

337 Intervistë e RrGK-së me Igballe Rogova, Prishtinë, 2020.

338 Skeppström, E., dhe Weibull, A., *Forca e Sigurisë në Bërje: Ndërtimi i Kapaciteteve në Kosovë,* 2011, f. 15

339 Po aty, f. 22

340 Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes.

341 Intervistë e RrGK-së me Halime Morina, Shefe e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore, Ministria e Mbrojtjes dhe FSK, Prishtinë, 2020

342 Ministria e Mbrojtjes, *Politika për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës*, 2019, f. 13. Për informacion të mëtejshëm në lidhje me këtë dhe sfidat e tjera ndaj pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë, shih kapitullin tjetër.

343 Intervistë e RrGK-së me Halime Morina, Prishtinë, 2020

344 Ministria e Mbrojtjes, faqe në internet.

345 Greene, M., Friedman, J., dhe Bennet, R., *Ndërtimi i Shërbimit Policor në një Vakum të Sigurisë: Përpjekjet Ndërkombëtare në Kosovë, 1999-2011*, 2012

346 Intervistë e RrGK-së me një grua përfaqësuese të OSBE, Prishtinë, 2020.

347 Greene, M., Friedman, J. dhe Bennet R.

348 Po aty.

349 QKSS, *Analiza e Kontekstit të Reformës së Sektorit të Sigurisë në Kosovë 1999-2009,* 2011, f. 19

së Punëve të Brendshme në vitin 2006, filluan përgatitjet për transferimin e komandës, duke përfshirë nivelin më të lartë.[350]

Gjatë këtyre proceseve, PK kërkoi ndihmë nga OSHCG-të dhe aktivistet e të drejtave të grave, si dhe UNIFEM, në identifikimin e mënyrave për të sfiduar normat gjinore dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së grave në institucionet e sigurisë. Këto gra ishin të gatshme të kontribuojnë, duke ofruar trajnime për të informuar stafin e ri të PK-së, kryesisht burra, për RKSKB 1325. Gjatë trajnimit, Behar Selimi, ish-Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, ishte ndër pjesëmarrësit më aktivë, duke u bërë një avokat i hapur për barazinë gjinore.[351] Hysni Shala gjithashtu kujtoi se kur ai mori zyrën për të Drejtat e Njeriut në vitin 2004, ai kërkoi këshillat e tyre se si të përfshihet më mirë gjinia në PK:

> Unë kisha nevojë të dija më shumë rreth rezolutës 1325 sepse kishte sfida... dhe kërkova ndihmë nga organizatat ndërkombëtare dhe lokale. Që nga ajo kohë, unë kam pasur takime javore me Igballe Rogovën dhe RrGK të cilat ishin një mbështetje e madhe për mua dhe Zyrën, dhe Flora Macula nga UNIFEM që na mbështeti edhe financiarisht. Atëherë, në 2005-2006, ishte ideja e Igos dhe Florës për të themeluar Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës.[352]

Flora Macula në mënyrë të ngjashme kujtoi:

> Kam punuar me policinë dhe ndihmova për të integruar rezolutën 1325 në Polici. Si rezultat, u formua Bordi i Barazisë Gjinore, u krijua Zyra për Barazi Gjinore, dhe ne krijuam një rrjet të policisë, UNIFEM, RrGK dhe organizatave të tjera. Në atë kohë, ne synonim të rrisnim numrin e grave në polici sepse gratë do të ndiheshin më të sigurta në Kosovë. Në fund, ndihmova në themelimin e Shoqatës së Grave Police në Kosovë. Brenda një viti e gjysmë, ato ishin tashmë të pavarura. Sot, ato janë shumë aktive dhe janë një shembull i shkëlqyeshëm.[353]

Para se të bëhej Presidente e Kosovës në vitin 2011, Atifete Jahjaga bashkë-themeloi Shoqatën e Grave Police. Ajo, vetë, ishte një shembull i rrallë i një gruaje që ngrihet nëpër radhët për t'u bërë Zëvendës Drejtore e Përgjithshme e PK-së në vitin 2009, mbështetur nga kolegët kryesorë meshkuj, siç është Behar Selimi. Duke përdorur përvojën e saj dhe pozicionin e udhëheqjes, ajo ishte ndër gratë e para police që fuqizoi gratë e tjera brenda PK. Ajo kujtoi:

> Shoqata e Grave brenda policisë filloi me qëllimin kryesor për të fuqizuar gratë në Policinë e Kosovës… pasi ne ishim të vetëdijshme për problemet me të cilat përballeshin. Gjithçka filloi në 2001-2002 dhe në 2006-2007, u krijua Shoqata e Grave në Polici.[354]

Sidoqoftë, ky nuk ishte një proces i lehtë. Ato hasën në vështirësi, thotë Jahjaga, pasi disa policë nuk e përkrahën idenë e një shoqate të grave brenda PK. "Ata e dinin që kjo Shoqatë do të garantonte fuqizimin dhe qëndrueshmërinë e grave në vendimmarrje brenda Policisë së Kosovës", vazhdoi Jahjaga.[355] "Atëherë dikush mund

---

[350] Greene, M., Friedman, J. dhe Bennet R.

[351] Intervistat e RrGK, 2020. Ai më vonë shërbeu si anëtar i bordit të RrGK-së.

[352] Intervistë e RrGK-së me Hysni Shala, ish-shef i Zyrës, 2020.

[353] Intervistë e RrGK, 2020

[354] Intervistë e RrGK, 2020

[355] Po aty.

të kishte numëruar me gishta numrin e grave në pozitat udhëheqëse dhe vendimmarrëse në Policinë e Kosovës", tha ajo.

Në të vërtetë, kur institucionet e Kosovës kishin marrë udhëheqjen e PK-së në vitin 2006, pjesëmarrja e grave tashmë kishte filluar të bjerë (shih Grafikun 1).[356]

**Grafiku 1.** Përqindja e grave dhe burrave në Policinë e Kosovës




Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitin 2011 vërejti se "numri në rënie i policeve të PK-së gjatë viteve tregon se mundësitë e ofruara për gratë police në PK nuk ishin të kënaqshme".[357] Faktorët e identifikuar që ndikojnë në dorëheqjen e grave nga PK përfshinin: të ardhura të pamjaftueshme/paga të ulëta, ndryshimi i statusit martesor, mundësi të dobëta për avancim dhe mjedisi i punës.[358]

Sipas Shalës, pasi një numër i grave dha dorëheqjen nga PK, Zyra për të Drejtat e Njeriut "filloi të mbledhë të dhëna dhe t'i kontaktojë ato për arsyen e dorëheqjes".[359] Zyra mësoi se shumë gra gjithashtu nuk kishin informacion në lidhje me të drejtat e tyre dhe legjislacionin përkatës që do t'i mbështeste ato. "Për shembull, njëra prej tyre tha se ajo u transferua në Mitrovicë nga Prishtina pasi ishte martuar, dhe ajo u përball me vështirësi për të udhëtuar çdo ditë [në Prishtinë], dhe kjo ishte arsyeja pse ajo dha dorëheqjen", tha ai. "Ajo nuk ishte informuar se mund të kishte bërë një kërkesë të thjeshtë për t'u transferuar në Mitrovicë dhe do t'i jepej kjo e drejtë."

Megjithëse PK nuk kishte politika të qarta për rekrutimin dhe promovimin e grave,[360] përfshirë gratë pakicë, përfaqësuesit e PK-së ndërmorën përpjekje të tjera për të inkurajuar angazhimin e grave. Zyra për të Drejtat e Njeriut u përpoq t'i informonte më mirë gratë për të drejtat e tyre. Në vitin 2010, Zyra krijoi një manual, si një udhëzues gjithëpërfshirës me të gjitha ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative, në mënyrë që t'u sigurojë grave police informacion në lidhje me të drejtat dhe mundësitë e tyre brenda PK. "Tani, të gjitha këto informata janë në

[356]Të dhëna për vitin 1999 nga Greene, M., Friedman, J. dhe Bennet R., f. 5; për 2006 nga të Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, 2011, f. 14; për vitin 2010 nga Jones, J., *Gratë në Policinë e Kosovës*, f. 5; për 2017 nga *Raport mbi Inspektimin e Burimeve Njerëzore brenda Policisë së Kosovës*, 2017, f. 13, (vetëm shqip); për vitin 2019 nga PK, *Raporti Vjetor 2019 i Policisë së Kosovës*; dhe për vitin 2020 nga korrespondenca me PK, 2020.

[357] Ministria e Punëve të Brendshme, *Raporti mbi pozitën e grave në Policinë e Kosovës*, 2011

[358] Po aty.

[359] Intervistë e RrGK, 2020

[360] Shikoni Shtojcën 5 për një shpjegim të politikave relevante dhe kapitullin tjetër lidhur me sfidat.

këtë dokument", tregon Shala.[361] Që nga viti 2020, institucioni ishte duke punuar për të zhvilluar një strategji të re të titulluar "Agjenda Gjinore", duke u përqendruar në punësimin, mbajtjen, promovimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të grave.[362]

Puna e grave aktiviste dhe zyrtareve të policisë brenda PK-së, si dhe disa burrave në pozicione vendimmarrëse, si Selimi dhe Shala, kontribuan në ndryshimet e perceptimeve me kalimin e kohës. Një zyrtare policie vëzhgoi që në kohën kur u bashkua me PK, ajo nuk mendonte se gratë përballeshin me shumë stereotipe gjinore. "Sipas mendimit tim, ato ishin thyer tashmë në kohën kur unë u bashkova me PK", tha ajo.[363] Gratë e tjera police ranë dakord që megjithëse u ndeshën me diskriminim nga kolegët e tyre dhe njerëzit në përgjithësi në fillim, kjo ndryshoi ndërsa dëshmuan kapacitetet e tyre dhe u ngritën në pozita më të larta.[364] Në ditët e sotme, gratë e intervistuara nga RrGK nuk identifikuan ndonjë sfidë. Sidoqoftë, ato thanë se PK ka nevojë për më shumë gra, të cilat mund të kontribuojnë drejtpërdrejt në besimin e njerëzve në institucion dhe në rritjen e raportimit të rasteve.

Rosenberg dhe Mertus arritën në përfundim se gratë në PK kanë sfiduar "perceptimet patriarkale të grave ndërsa transformojnë imazhin dhe sjelljen e policisë nga një forcë autokratike abuzuese e të drejtave të njeriut në një komunitet demokratik në shërbim që ka në qendër komunitetin".[365] Gratë në PK, si dhe OSHCG-të dhe aktivistet për të drejtat e grave që mbështesin PK, kështu kanë kontribuar për paqen dhe sigurinë përmes punës së tyre.

## Kontributet e grave drejt paqes dhe sigurisë përmes politikës

Kjo nën-pjesë diskuton rolet dhe kontributet e grave për paqe dhe siguri përmes angazhimit të tyre në politikë në Kosovë. Ajo shqyrton tri dimensione të kontributeve të grave: rritjen dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në politikë, drejt mundësimit të grave për të dëgjuar zërin e tyre dhe të grave të tjera; vendosjen e legjislacionit dhe mekanizmave drejt barazisë gjinore, dhe kështu, paqes dhe sigurisë; dhe kontributet e grave politikane për paqen dhe sigurinë përmes punës së tyre. Ajo nuk përfshin kontributet e grave në mënyrë specifike në negociata dhe dialog, të cilat diskutohen, posaçërisht, në nën-pjesën tjetër. As nuk diskuton sfidat me të cilat përballen gratë në qasjen në proceset e vendimmarrjes, të cilat do të vijnë në kapitullin tjetër.

### Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në politikë

Rezoluta 1325 bën thirrje për pjesëmarrje të barabartë të grave në proceset e vendimmarrjes në konflikt dhe pas konfliktit, për të siguruar që të adresohen nevojat dhe prioritetet e grave. Phillips e konsideron barazinë gjinore në politikë një "kusht minimal për transformimin e agjendës politike", duke argumentuar se kuota gjinore

> "Kur erdhi UNMIK-u, mendova se [RKSKB 1325] do të zbatohej, por nuk ishte ashtu. Ata dërguan burra që ishin konservatorë dhe nuk besonin te gratë. Unë kisha pritur që ata të na dëgjonin Kur kuptuam që UNMIK-u po na largonte, ne u organizuam dhe avokuam që gjithçka të ndryshonte. "
>
> **Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive, RrGK[365]**

[361] Intervistë e RrGK, 2020

[362] Jones, J., *Gratë në Policinë e Kosovës*, 2020, f. 20

[363] Intervistë e RrGK-së me një grua shqiptare në PK, Prishtinë.

[364] Intervistat e RrGK-së.

[365] Rosenberger, L. i Mertus, J. "When Adding Women Matters: Making Lieutenant Ahmeti" *("Ka rëndësi kur gratë janë të pranishme: Rrugetimi i Togere Ahmetit")*, Gjinia dhe Kombi në Evropën Juglindore, Karl Kaser, Elisabeth Katschnig-Fasch, 2005.

[366] Intervistë e RrGK, 2020

“sfidon rregullimet shoqërore që sistematikisht i kanë vendosur gratë në pozitë vartëse”.[367] Kuotat mund të ndihmojnë grupet që përndryshe janë të margjinalizuara, si gratë, të krijojnë një “masë kritike” që u mundëson grave të përfaqësojnë interesat e tyre në proceset e vendimmarrjes.[368] Pa përfaqësim të barabartë, gratë kanë më shumë të ngjarë të mbizotërohen nga burrat në udhëheqje dhe kështu u mungon ndikimi në proceset e vendimmarrjes. Sipas Dahlerup, kur gratë përbëjnë 15% të pozitave të larta politike, ato mund të ndryshojnë agjendën politike, por ato duhet të mbajnë të paktën 40% të pozicioneve për të prezantuar “politika miqësore me gratë”.[369] Kështu, rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë mund të kontribuojë që gratë të jenë në gjendje të prezantojnë nevojat e tyre në mjediset pas luftës. Ndërkohë, madhësia e saktë e masës kritike të nevojshme për gratë për të ndikuar në politikë mund të ndryshojë në varësi të vendit. Dahlerup sugjeroi një pikë prej të paktën 30%. Për më tepër, ajo vuri në dukje se një përfaqësim minimal i grave në politikë, një “masë kritike”, nuk do të thotë domosdoshmërisht se gratë do të përfaqësohen në mënyrë thelbësore; kjo, thotë ajo, “varet nga shumë faktorë si identiteti gjinor, përkatësia politike dhe roli legjislativ i grave”.[370] Kështu, gratë në politikë gjithashtu duhet të fuqizohen dhe të kenë hapësirë për të përfaqësuar çështjet me të cilat përballen gra të ndryshme.

Menjëherë pas luftës, administrata e UNMIK-ut përgjegjëse për qeverisjen e Kosovës nuk përfshiu asnjë grua në Këshillin e Përbashkët të Përkohshëm Administrativ të krijuar për të këshilluar qeverisjen e Kosovës derisa të mund të organizoheshin zgjedhjet. Gratë ndiheshin të larguara nga këto procese vendimmarrëse.[371] Prandaj, pasi Këshilli i Sigurimit i KB miratoi RKSKB 1325 më 31 tetor 2000, aktivistët e të drejtave të grave menjëherë filluan të përdorin rezolutën për të mbrojtur të drejtën e tyre për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe ndërtimit të paqes në Kosovë pas luftës. Igballe Rogova kujtoi: “Nga dita e parë kemi filluar përdorimin e rezolutës. Ne po i shkruanim letra UNMIK-ut, OKB-së në Nju Jork madje duke thënë, ‘Ju duhet ta zbatoni rezolutën’.”[372] Avokimi i tyre arriti në veshët e Sekretarit të Përgjithshëm të KB Kofi Annan, dhe përfundimisht disa gra u përfshinë në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes.[373]

Më 7-9 qershor 2000, “Unioni i Grave Kosovare” organizoi një konferencë të titulluar, “Gratë për Gratë Shqiptare”,[374] bashkon gratë në politikë dhe shoqëri civile për të mbrojtur kuotën. Igballe Rogova kujton:

> Ne e dinim nga përvojat e kaluara të KB-së se ata kishin prirjen të sillnin udhëheqësit e konfliktit si udhëheqësit kryesorë politikë pas konfliktit. Ata vazhduan të bëjnë të njëjtën gjë në Kosovë, kështu që ne, së bashku me gratë në politikë, shtynim për kuotën. Ne ishim mbështetur dhe kritikuar, por… nëse nuk do të kishim një kuotë, gratë nuk do të vinin kurrë as afër parlamentit.[375]

Edita Tahiri në mënyrë të ngjashme kujtoi:

> Në këtë konferencë, ne, gratë në politikë dhe gratë nga shoqëria civile ranë dakord për nevojën e një

[367] Phillips, A., *Politika e pranisë: Përfaqësimi politik i gjinisë, etnisë dhe racës*, Oxford: Oxford University Press, 1995, cituar në Brown, J., “Qasja Kritike e Shënjuesit të Masës: Kuotat e Femrave dhe Drejtësia Sociale”, *Studime Politike*, 62 (4), 2013, f. 865.

[368] Dahlerup, D., Hilal, Z., Kalandadze, N. dhe Kandawasvika-Nhundu, R., *Atlasi i Kuotave Gjinore Zgjedhore*, 2013

[369] Dahlerup, D., *Historia e Teorisë së Masës Kritike. Politika dhe Gjinia,* 2006, f. 494. Për shembull, ajo përmend shembullin e Zelandës së Re, ku “shumë politika miqësore ndaj grave u miratuan pothuajse 20 vjet pasi gratë zënë 15% të vendeve në legjislaturën kombëtare” (f. 496).

[370] Po aty, f. 509

[371] RrGK, 1325 Fakte dhe Fabula, 2011.

[372] Po aty, f. 22

[373] Për një përshkrim të plotë të ngjarjeve, shihni RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, f. 20-21.

[374] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj* f. 192

[375] Intervistë e RrGK, Prishtinë, 2020

kuote. Bashkëpunimi ynë e bindi kreun e atëhershëm të UNMIK-ut, [PSSP] Kushner, por edhe udhëheqësit [politik] [Ibrahim] Rugova dhe [Hashim] Thaçi, të aprovojnë kuotën prej 30% për zgjedhjet e para lokale në vitin 2000.[376]

Aktivistet e të drejtave të grave vunë re se ka pasur përpjekje për t'u dhënë meritë aktorëve ndërkombëtarë për vendosjen e kuotës, por kjo ishte kryesisht rezultat i iniciativës dhe presionit që vinte nga aktivistët e të drejtave të grave në shoqërinë civile dhe politikë.[377] Përpjekjet e tyre patën sukses dhe zgjedhjet e para komunale përfshinë një kuotë prej 30% për pjesëmarrjen e grave në listat e partive politike. Sidoqoftë, mënyra në të cilën funksionoi ky sistem zgjedhor me listë të hapur, në të cilën votuesit zgjodhën kandidatë individualë pa siguri që një kuotë e grave do të hynte në asamble, kontribuoi që gratë të mbanin vetëm 8% të vendeve në kuvendet komunale.[378]

Kjo çështje u adresua me zgjedhjet e para të përgjithshme në vitin 2001, të cilat themeluan Kuvendin e Kosovës; aty përfshihej si një kuotë ashtu edhe një sistem zgjedhor me listë të mbyllur.[379] Në një sistem zgjedhor me listë të mbyllur, njerëzit votojnë për një parti politike në vend të kandidatëve individualë, dhe partitë politike zgjedhin kandidatët e jo populli.[380] Sidoqoftë, OShC-të menduan se një sistem me lista të mbyllura minonte shkallën në të cilën votuesit mund të bënin individët deputet përgjegjës për punën e tyre.[381] Prandaj, para zgjedhjeve të dyta të përgjithshme në vitin 2004, ato avokuan në OSBE për këtë ndër ndryshimet e tjera të sistemit zgjedhor. OSBE ishte përgjegjëse nën UNMIK-un për demokratizimin dhe organizimin e zgjedhjeve; ajo kishte propozuar të përdorej një sistem zgjedhor me listë të mbyllur në zgjedhjet e ardhshme.[382]

Ndërkohë, në vitin 2002, gratë nga politika dhe shoqëria civile themeluan Lobin e Grave të Kosovës (LGK), për të mbështetur pjesëmarrjen cilësore të grave në politikë, duke kërkuar gjithashtu një sistem të listave të hapura.[383] Mes ndarjeve të zjarrta midis partive kryesore politike, natyra unike, joformale dhe e pasigurt e këtij grupi i lejoi anëtarët e tij të merrnin pjesë në një numër përpjekjesh lobimi që ato mund të mos kishin qenë në gjendje t'i adresonin brenda organizatave, institucioneve ose partive të tyre.[384] Kjo ishte veçanërisht e vërtetë kur bëhej fjalë për avokim për kuotën gjinore, një propozim që disa liderë të partive politike e kundërshtuan. Më vonë, LGK gjithashtu do të avokonte për përfshirjen e grave në negociata në lidhje me statusin politik të Kosovës.[385]

Duke marrë parasysh se një nga arsyet e OSBE-së për të propozuar sistemin e listave të mbyllura ishte nevoja për një kuotë gjinore, zërat e anëtarëve të LDK-së, si gra udhëheqëse, ishin thelbësore në argumentimin e një sistemi zgjedhor ndryshe, më përfaqësues. "Pasi arritëm të kemi kuotën, ne, gratë në politikë dhe shoqërinë civile, dëshironim gjithashtu cilësi", tha Edita Tahiri.[386] Kështu, gratë dhe burrat që përfaqësojnë 300 OSHC në të gjithë Kosovën formuan Koalicionin për Reformën e Ligjit Zgjedhor, "Reforma 2004", për të avokuar për një sistem zgjedhor me listë të hapur. Në vitin 2003, Koalicioni Reforma 2004 i paraqiti Grupit Punues Zgjedhor të OSBE-së,

---

376 Intervistë e RrGK, Prishtinë, 2020.

377 Intervistat e RrGK, 2020

378 QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj,* f. 192

379 KIPRED, *Reformimi i Sistemit Zgjedhor të Kosovës*, 2005

380 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Zgjedhjet në Kosovë 2000 - 2014,* 2017, f. 12

381 Farnsworth, N., " Kosovë: Presioni rritet për reformën", Instituti për Raportimin e Luftës dhe Paqes, 2005.

382 KIPRED, *Reformimi i Sistemit Zgjedhor të Kosovës*, 2005, f. 8

383 Intervistë e RrGK-së me Edita Tahirin, 2020.

384 QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj,* f. 195

385 *Po aty;*

386 Intervistë e RrGK-së me Edita Tahirin, 2020.

propozimin e tyre për një sistem me listë të hapur.[387] Ndërsa avokimi i Koalicionit u intensifikua në mars dhe prill 2004, aktivistët në RrGK dhe LGK udhëhoqën përpjekjet e Reformës 2004 dhe u përshkruan si "forcë lëvizëse" prapa fushatës.[388] Kjo përfshinte shkrimin e letrave dhe takimin me vendimmarrësit vendorë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të KB Annan, PSSP Holker dhe kreun e Misionit të OSBE në Kosovë, Paschal Fieschi, si dhe një fushatë mediatike. Për më tepër, aktivistët organizuan demonstrata paqësore në pesë rajone ku populli kërkonte një listë zgjedhore me listë të hapur.




© RrGK Gratë duke mbajtur pankarta si "Kuota gjinore nuk është arsyetim" gjate një demonstrate jashtë zyreve kryesore të UNMIK-ut dhe OSBE-së, duke kërkuar listë të hapur zgjedhore

Si përgjigje, OSBE-ja deklaroi se atyre u mungonte koha për të riorganizuar sistemin zgjedhor. Ata gjithashtu argumentuan që njerëzit mund të hutohen se si të plotësojnë fletëvotimet me listë të hapur. Megjithëse gratë aktiviste kishin lobuar për një sistem zgjedhor me listë të hapur që nga viti 2002, sistemi nuk do të ndryshonte në një listë të hapur duke përfshirë një kuotë prej 30% deri në zgjedhjet e përgjithshme në 2007.[389] Sidoqoftë, gratë aktiviste kontribuan në sjelljen e çështjes së reformës së ligjit zgjedhor në krye të diskutimeve politike në Kosovë herët, si dhe ndihmuan votuesit të kuptonin se një sistem me listë të hapur do t'u mundësonte atyre përfaqësuesit e zgjedhur më të përgjegjshëm.[390] Kjo pa dyshim krijoi një mjedis të mundshëm për miratimin përfundimtar të sistemit zgjedhor me listë të hapur.

Në muajt përpara zgjedhjeve të vitit 2004, RrGK udhëhoqi dy fushata për të sjellë zërat e grave në diskutime. E para, në bashkëpunim me Departamentin e Demokratizimit të OSBE-së, ishte "Gratë Propozojnë", e cila mblodhi dhe promovoi idetë e grave për platformat elektorale të partive politike për zgjedhjet e vitit 2004. Duke organizuar takime në të gjithë Kosovën, RrGK mblodhi së bashku gra të etnive të ndryshme nga politika dhe shoqëria civile për të diskutuar mbi prioritetet e grave.[391] Së dyti, RrGK udhëhoqi një fushatë të titulluar "Partitë Politike Punojnë për Gratë" në bashkëpunim me OSBE-në. Ajo prezantoi gratë kandidate nga të gjitha partitë politike te burrat dhe gratë votues para zgjedhjeve të vjeshtës 2004. Përmes fushatës, partitë e turqve, romëve dhe të pakicave të tjera gjithashtu promovuan platformat e tyre për votuesit në gjuhën e tyre, ndërsa RrGK i përktheu.[392] Të

[387] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 199

[388] Po aty.

[389] Shikoni tabelën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, *Zgjedhjet në Kosovë 2000 - 2014*, 2017, f. 16

[390] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 200

[391] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*.

[392] Po aty f. 201

dy fushatat morën mbulim mediatik, veçanërisht nga RTV21, kështu që debatet midis votuesve dhe grave kandidate arritën një audiencë të gjerë. Violeta Selimi, Koordinatore e Fushatës, më vonë kujtoi për QKSGJ: "Ne dëshironim të promovonim gratë kandidate dhe t'u tregojmë grave në Kosovë që jo vetëm burrat punojnë në kuvend."[393]

Një përpjekje e tretë për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë ishte "Gratë munden", emëruar sipas motos së Lëvizjes së Grave të Partisë Norvegjeze të Punës në vitet 1980. Qendra e Trajnimit dhe Hulumtimit Gjinor, Rrethi i Motrave Serbe dhe Koalicioni i Grave Kosovare udhëhoqën këtë përpjekje, e cila synonte t'u siguronte grave aftësitë dhe mbështetjen e nevojshme që ato të merrnin pjesë në politikë dhe të përfaqësonin prioritetet e grave.[394] Gjatë seminareve, gra të ndryshme mësuan rreth koncepteve gjinore, politikës, legjislacionit lokal dhe ndërkombëtar, të folurit në publik, debatit, moderimit dhe bashkëveprimit me mediat.[395]

Pas zgjedhjeve të dyta, në vitin 2005 gratë deputete themeluan Grupin e Grave Deputete, një grup joformal në Kuvendin e Kosovës.[396] Ai bashkonte gratë nga parti të ndryshme politike dhe me etni të ndryshme në avokimin për çështje për të cilat ato ranë dakord se ishin në interesin e grave. Për shembull, në vitin 2011, anëtaret e grupit protestuan dhe bllokuan me sukses një seancë votimi në Kuvend sepse perspektivat e tyre si gra nuk u përfshinë në diskutime. Ato u përpoqën të ndikonin në proceset duke marrë pjesë si vëzhgues në komitetet ku asnjë grua nuk ishte e angazhuar zyrtarisht.[397] Kështu, përmes lobimit të tyre, Grupi i Grave Deputete ka ndihmuar në përmirësimin e përfaqësimit të grave në vendimmarrje. Nën të njëjtën dinamikë, disa grupe të kuvendit të grave dhe grupe joformale të grave gjithashtu janë krijuar në komuna.[398]

OSHCG, veçanërisht RrGK dhe anëtaret e saj, kanë vazhduar punën e tyre për të fuqizuar më shumë gra për të hyrë në politikë, si dhe për të forcuar pozicionin e grave tashmë në politikë. Në vitin 2014, RrGK themeloi Lobin e Kosovës për Barazi Gjinore, i cili bashkoi OSHCG-të dhe gratë në politikë në disa komuna në avokimin për çështje me interes të përbashkët. Një qëllim dhe atribut kyç i Lobit është qëllimi i tij për të ndërtuar unitetin dhe solidaritetin midis grave të ndryshme, ndërmjet partive politike, etnive, moshave dhe dallimeve të tjera. Lobi bashkon gra të ndryshme drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta. Të paktën dy herë në vit anëtarët e Lobit nga e gjithë Kosova takohen për të diskutuar strategjitë e tyre të avokimit, për të shkëmbyer përvoja dhe për të përpiluar strategji të reja, duke mësuar nga njëri-tjetri. RrGK pastaj mbështet anëtarët e Lobit në arritjen e qëllimeve të tyre të avokimit në nivelin komunal. Së bashku, grupet e Lobit kanë arritur qindra ndryshime drejt barazisë gjinore në nivelin komunal.[399] Për më tepër, përmes mentorimit dhe mbështetjes së individualizuar, Lobi ka fuqizuar shumë gra, përfshirë edhe vajzat, të bëhen aktive në politikë në nivel lokal; disa më vonë kandiduan për pozita si deputete.

Në vitin 2018, anëtaret e Lobit ranë dakord se ato dëshironin të zgjeronin përpjekjet e tyre dhe të bashkëpunonin më shumë me gratë deputete drejt qëllimeve të përbashkëta. Kështu, u krijua Koalicioni për Barazi, duke bashkuar OSHCG-të dhe gratë politikane në të gjitha nivelet në strategjitë për angazhimin e mëtejshëm të grave në politikë si dhe për të arritur qëllimet e përbashkëta, përtej vijave partiake dhe etnike.[400] Kështu, RrGK ka kërkuar që t'i fuqizojë gratë të hyjnë në politikë përmes Lobit, Koalicionit, takimeve të tyre, rrjetëzimit, fuqizimit dhe mentorimit të individualizuar dhe të përshtatur të grave politikane në kapërcimin e sfidave të ndryshme me të

---

393 Po aty.

394 Po aty f. 202

395 Për më shumë, shih QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 202

396 RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, 2011, f. 62-63.

397 UNDP, *Forcimi i pjesëmarrjes politike të grave. Një analizë e ndikimit të rrjeteve parlamentare të grave në Evropë dhe Azinë Qendrore*, 2016, f. 13

398 OSBE, *Një studim krahasues i strukturave për gratë deputete në rajonin e OSBE-së*, 2013, f. 35-36.

399 Për disa shembuj, shih Tabelën 3 në nën-pjesën që vijon.

400 RrGK, "Gratë bashkohen: Krijohet koalicioni për barazi", 2018.

cilat përballen liderët e partive politike dhe media, ndër të tjera.[401] Fuqizimi i RrGK-së i pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarrjes gjithashtu ndodhi përmes granteve të dhëna grupeve të ndryshme për të drejtat e grave përmes Fondit të Grave të Kosovës. Pothuajse të gjitha grantet e Fondit të Grave të Kosovës kanë përfshirë një komponent për avancimin e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje, përmes së cilës OSHCG-të kanë angazhuar 4,510 gra dhe vajza të ndryshme në proceset politike që nga viti 2012, disa për herë të parë.

Gjithashtu që nga viti 2012, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) ka organizuar "Javën e Gruas" vjetore, të mbështetur nga USAID. Iniciativa filloi si një përgjigje ndaj angazhimit të ulët të grave në proceset politike. Ngjarja e madhe mbledh një gamë të gjerë të grave, vajzave dhe burrave të shquar nga politika, shoqëria civile dhe akademia, në mesin e specialistëve të tjerë, nga Kosova dhe jashtë vendit për të diskutuar tema të ndryshme çdo vit.[402] Gratë politikane të shquara flasin, duke fuqizuar gratë e tjera, veçanërisht vajzat, të angazhohen, siç ilustrohet në Kutinë 3. Si vazhdim i Javës së Gruas, NDI organizon një Akademi gjashtëmujore të Lidershipit të Grave gjatë së cilës gratë ndjekin aktivitetet e ndërtimit të aftësive dhe rrjeteve. Sipas NDI, kjo mbështet pjesëmarrësit të "krijojnë koalicione të qëndrueshme për të çuar përpara çështjet me interes të përbashkët për ta dhe komunitetet e tyre".[403] Në vitin 2018, për herë të parë morën pjesë gratë nga të gjitha grupet etnike që jetojnë në Kosovë.[404]

**Kutia 1. Pjesë nga Fjalimi i Vjosa Osmanit në Javën e Gruas 2020 të NDI**

"Gjatë karrierës suaj politike do të përballeni me aq shumë fyerje që nuk e keni imagjinuar se do të merrni, në mënyrë që të bëheni më pak të fuqizuar, në mënyrë që të ndaloni zërin tuaj për të cilin keni punuar si gra dhe të reja gjatë gjithë jetës tuaj. Por, mbani në mend një gjë, nëse hiqni dorë, ju nuk po hiqni dorë vetëm për veten tuaj, por edhe për të gjitha gratë e reja që vijnë pas jush dhe për të gjitha vajzat e vogla që ju shikojnë sot dhe çdo ditë me shpresën se ju do ta fitoni këtë luftë në lidhje me keqinformimin dhe sulmet që bëhen pikërisht për ta bërë zërin e grave më të dobët në politikë dhe vendimmarrje "[405]

OSBE gjithashtu ka pasur aktivitete për të vazhduar më tej pjesëmarrjen e grave në politikë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, siç janë përmes mbështetjes për grupet joformale të grave dhe grupet e zgjedhjeve në nivelin komunal.[406]

Që nga viti 2016, QKSGJ gjithashtu ka udhëhequr një iniciativë që kërkon të inkurajojë angazhimin e vajzave në politikë. Sipas QKSGJ, aksioni "Gratë e reja të përfshira në parti politike dhe procese politike", i mbështetur

[401] Për shembull, shihni raportet vjetore të RrGK-së, dhe RrGK, "Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore: Një nismë për bashkimin e grave në Dragash", 2020.

[402] Për më shumë informata rreth Javës së Grave, shihni: http://www.weekofwomen.org/.

[403] NDI ,*Barazia gjinore në vendimmarrjen në nivelin lokal*, 2018, f. 43

[404] Po aty.

[405] Vjosa Osmani, fjalim, Konferenca Java e Grave 2020 organizuar nga NDI.

[406] OSBE, "Aktivitetet dhe prioritetet programore të misionit për barazinë gjinore", 2018. Shih gjithashtu Uebfaqja e OSBE-së. Shih gjithashtu, OSBE, "Misioni i OSBE-së në Kosovë promovon fuqizimin e grave në vendimmarrjen politike", 2012.

nga BE, ka "promovuar zbatimin e plotë të Ligjit për Barazinë Gjinore dhe Anti-Diskriminimin e Grave përmes përmirësimit të pjesëmarrjes së tyre në politikë dhe pozita vendimmarrëse në institucionet publike ".[407]

Në vitin 2017, UNMIK organizoi mbledhjen e parë të Asamblesë Rinore të KB-së në Kosovë, ku rekomandimet e 140 të rinjve kontribuan në krijimin e Udhërrëfyesit të Kosovës për rininë, paqen dhe sigurinë.[408] Në vitin 2020, konkluzionet kryesore u prezantuan në Këshillin e Sigurimit të KB përmes takimit virtual, në të cilin dy vajza nga Kosova ndanë pikëpamjet dhe përvojat e tyre mbi ndërtimin e paqes dhe qëndrueshmërinë.

Që nga viti 2019, RrGK ka partneritet me Ruka Ruci (*Dora për Dorë*) dhe organizatën e personave me distrofi muskulore të Kosovës në Aksionin "Forcimi i pjesëmarrjes së grave në politikë", i mbështetur nga BE, drejt fuqizimit të grave, veçanërisht grave të pakicave etnike dhe grave me aftësi të ndryshme, për të marrë pjesë në politikë. Anëtarët e RrGK-së orkestruan një fushatë të gjerë informimi pak para zgjedhjeve të vitit 2019 me anketim në rrugë dhe derë më derë, si dhe një fushatë mediatike, për të bindur votuesit të votojnë për gratë. RrGK dhe BE gjithashtu kanë bashkëpunuar për të mbështetur angazhimin e grave në politikë në mënyra të tjera. Duke filluar nga viti 2019, Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë mbështeti një program të grave në udhëheqje që siguroi trajnim dhe këshillim për gra të ndryshme.[409]




Gjatë kampanjës elektorale të vitit 2019, aktivistet e RrGK u shpërndanë nëpër rrugët përreth Kosovës, duke i inkurajuar votuesit, "Nuk ka rëndësi cilën parti politike zgjedhni, votoni më shumë gra në parlament".

Forumi për Lidership dhe Diplomaci mbajti gjithashtu një Akademi të Lidershipit në vitin 2020, mbështetur nga GIZ Kosova, përmes së cilës 40 gra, përfshirë vajzat, u fuqizuan të përfshihen në proceset e vendimmarrjes; kjo përfshinte ndërtimin e aftësive në bashkëpunimin multietnik dhe jo-dhunën.[410]

Të gjitha këto përpjekje filluan të tregojnë rezultate pas zgjedhjeve të vitit 2019. Që nga viti 2015, Ligji i ri për Barazi Gjinore (LBGJ) përcaktonte se barazia gjinore përfshinte pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e qeverisjes, e përcaktuar si 50% pjesëmarrje e secilës gjini. Sidoqoftë, dy ligjet zgjedhore të Kosovës përfshijnë një kuotë për 30% pjesëmarrje të secilës gjini në listat zgjedhore të partive politike. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2019 (legjislatura e shtatë), partitë politike ndoqën ligjet zgjedhore dhe jo LBGJ. Kjo ndodhi

[407] QKSGJ, "Gratë e reja të përfshira në parti politike dhe procese politike"

[408] UNMIK, Udhërrëfyesi i Kosovës për rininë, paqen dhe sigurinë, 2017.

[409] Komunikimi i RrGK me BE, 2020

[410] Ekipi i KB për Kosovën, "Tejkalimi i pengesave për fuqizimin e grave në sferën publike", 2020.

edhe në mes të inkurajimit të fortë nga ABGJ dhe Institucioni i Avokatit të Popullit për të zbatuar LBGJ duke përfshirë 50% pjesëmarrje të secilës gjini në listat e partive.[411] Ndërsa partitë politike nuk e përfillën LBGJ, 39 (33%) nga 120 deputetët e zgjedhur ishin gra.

Siç u diskutua, nënpërfaqësimi i grave në Kuvend mund të minojë shkallën në të cilën përparësitë e ndryshme të grave konsiderohen në ligjet, politikat dhe programet qeveritare.[412] Ndërsa një burrë pjesëmarrës në hulumtim komentoi:

> Ku ka më shumë gra është ndryshe, por ato janë shumë pak në sasi. Për shembull, aktualisht ka 39 në Kuvend, por kur ato shpërndahen në komisione, ato zakonisht janë më pak të dukshme pasi janë më të pakta në numër. Për shembull, partitë zakonisht caktojnë burra të fortë si kryetarë të komisioneve. Por është çështje tjetër nëse ata do të përfaqësoheshin në mënyrë të barabartë në komision...[413]

Në këtë kuptim, përmirësime të mëdha ndodhën në legjislaturën e shtatë, ndërsa gratë drejtonin tetë nga 17 komisione.[414] Për më tepër, Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes drejtohej nga një grua, Fatmire Kollçaku nga Vetëvendosje.[415] Në vitin 2017, asnjë komision nuk drejtohej nga një grua, megjithëse gratë drejtuan tri komisione në vitin 2010 dhe një në vitin 2013. Kjo tregon një përmirësim të lehtë me kalimin e kohës në udhëheqjen e grave brenda komisioneve parlamentare.

Ndërsa kuota mund të ndihmojë më shumë gra të marrin një vend në tryezë, ajo nuk garanton përfaqësim cilësor të çështjeve që prekin gra të ndryshme ose që gratë do të bëjnë përpjekje për të avancuar barazinë gjinore, siç vuri re Dahlerup.[416] Në këtë kontekst, Ushtruesja e Detyrës së Presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, tha në vitin 2020:

> Ne si gra duhet ta kuptojmë se të gjithë ne që kemi këto vende në vendimmarrje nuk mjafton. Nuk ka të bëjë vetëm me praninë. Ka të bëjë me sigurimin që zëri ynë të dëgjohet, kështu që nuk jemi thjesht një numër diku. Është shumë e rëndësishme që ne ta përdorim atë mundësi për të zgjidhur problemet me të cilat merren qytetarët tanë. Dhe unë mendoj se gratë në Kosovë, në Parlament dhe gjetkë dhe në zyrën e Presidentit po tregojnë saktësisht se, ne sjellim cilësi, zgjidhim probleme, kontribuojmë në zgjidhjen e çështjeve që merren me jetën e përditshme të qytetarëve në një cilësi shumë më të lartë që shumë burra të tjerë në politikë. Kjo duhet të njihet dhe duhet ta themi me zë të lartë, sepse vetëm kështu ndërtojmë rrugën për gratë e tjera që do të vijnë në pozita drejtuese në të ardhmen dhe do të bëjnë një punë të jashtëzakonshme.[417]

Dëshmitë sugjerojnë që gratë së pari duhet të "shihen" në arenat politike në mënyrë që ato të "dëshmojnë" veten si lidere. Sapo të kenë vendin e tyre në politikë, gratë duhet të demonstrojnë lidershipin e tyre, duke u mundësuar atyre që të rizgjidhen.

---

[411] ABGJ, faqja në internet, "Ligji për Barazinë Gjinore do të respektohet në drejtim të përfaqësimit të barabartë prej 50% gjatë zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit 2019"; dhe Klan Kosova, "Avokati i Popullit bën thirrje për barazi gjinore në zgjedhjet e 6 tetorit" [Shqip], 2019.

[412] Shikoni hyrjen e këtij nën-pjese.

[413] Intervistë e RrGK-së me një aktivist, Prishtinë, 2020.

[414] Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Komisionet parlamentare", qasur në vitin 2020.

[415] Po aty, "Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes", qasur në vitin 2020.

[416] Shikoni hyrjen për këtë nën-pjesën.

[417] Vjosa Osmani, Fjalim, NDI, "Konferenca Java e Grave 2020".

| Tabela 1. Gratë politikane që fillimisht zgjedhen me kuota dhe më vonë nga votat popullore | | | |
|---|---|---|---|
| **Politikania** | **Partia** | **Kuota** | **Vota Popullore** |
| Donika Kadaj-Bujupi | AAK | 2007 | 2010 |
| Jellena Bontiq | LS | 2010 | 2014 |
| Duda Balje | VAKAT | 2010 | 2014 |
| Albulena Haxhiu | VV | 2010 | 2014 |
| Time Kadrijaj | AAK | 2010 | 2014 |
| Sala Berisha Shala | PDK | 2010 | 2014 |
| Jasmina Zhivkoviq | LS | 2010 | 2014 |
| Teuta Haxhiu | AAK | 2010 | 2017 |
| Ganimete Musliu | PDK | 2010 | 2017 |
| Doruntinë Maloku Kastrati | LDK | 2014 | 2019 |
| Besa Baftija | VV | 2014 | 2017 |
| Saranda Bogujevci | VV | 2017 | 2019 |
| Fitore Pacolli Dalipi | VV | 2017 | 2019 |

Kështu, sipas NDI, kuota ka kontribuar në një përfaqësim minimal të grave në Kuvendin e Kosovës, por gjithashtu krijoi një hapësirë në të cilën gratë mund të bëhen "modele publike" dhe të zhvendosin opinionin publik mbi rolin e grave në politikë.[418] Aktivistet e të drejtave të grave në mënyrë të ngjashme deklaruan se kuota ka sjellë fytyrat e grave në vëmendjen e publikut dhe u ka dhënë grave një shans për të treguar aftësinë e tyre për të udhëhequr, gjë që ndoshta nuk do të kishte ndodhur pa kuotën.[419] Me të vërtetë, 13 gratë që fillimisht morën vende falë kuotës u zgjodhën më vonë me votën e popullit (shih Tabelën 1). Zgjedhja e tyre mund të mos ketë qenë e mundur pa kuotën. Kuota i mundësoi ato që të fitojnë rëndësi publike, në mënyrë që ato të zgjidhen me votën e popullit. Në zgjedhjet e përgjithshme më të fundit të vitit 2019, 26 nga 39 gratë deputete u zgjodhën pa kuotë, më shumë se kurrë më parë, duke ilustruar mbështetjen në rritje të publikut për gratë individuale politikane (shih Grafikun 2).[420]

**Grafiku 2.** Numri i grave me ulëse sipas votës popullore dhe kuotës




[418] NDI, Kosova: Tejkalimi i barrierave për pjesëmarrjen politike të grave, 2015, f. 8

[419] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 198-199.

[420] Nga të dhënat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në: Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës: rezultatet përfundimtare, 2019. Shih gjithashtu, ABGJ, *Programi për Barazi Gjinore 2020-2024*, f. 47

Së bashku, përmes përpjekjeve të sipërpërmendura për të përfshirë një kuotë gjinore me një sistem zgjedhor me listë të hapur, angazhimin e votuesve, zërin e përparësive të grave në lidhje me platformat e partive politike dhe fuqizimin e grave për të hyrë në politikë, veçanërisht gratë e reja, OSHCG-të dhe aktivistët e të drejtave të grave në shoqërinë civile dhe politika dhanë kontribute në pozicionimin e grave në mënyrë që ato të mund të bënin të dëgjoheshin zërat e grave në proceset e vendimmarrjes pas luftës, duke përfshirë edhe paqen dhe sigurinë.

## Themelimi i legjislacionit dhe mekanizmave të barazisë gjinore

OSHCG-të dhe aktivistët për të drejtat e grave në politikë dhe shoqëria civile gjithashtu kanë avokuar për krijimin e disa ligjeve, politikave dhe mekanizmave të barazisë gjinore në Kosovë. Termi "mekanizma të barazisë gjinore" i referohet legjislacionit, institucioneve, posteve zyrtare, zyrave, komisioneve dhe organeve të tjera qeveritare të krijuara për të nxitur të drejtat e barabarta dhe për të institucionalizuar barazinë gjinore në Kosovë.[421] Një përpjekje veçanërisht gjithëpërfshirëse dhe e rëndësishme ishte krijimi i Planit të parë Kombëtar të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore në vitin 2003, i zhvilluar nga një grup i ndryshëm i grave të të gjitha moshave nga politika, shoqëria civile, qeveria, media dhe bizneset, mbështetur nga UNIFEM.[422] Pas dy vjetësh punë vullnetare të përkushtuar, Kuvendi i Kosovës miratoi Planin e parë në vitin 2004.[423] Procesi gjithëpërfshirës dhe miratimi i këtij Plani çuan në arritje të tjera të shumta, shumë prej tyre në lidhje me objektivat e zbatimit brenda Planit.

Si rezultat, Grupi Ndërministror për Arritjen e Barazisë Gjinore dhe komitetet gjinore u formuan dhe përdorën Planin për të informuar punën e tyre. Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së, shumë qeveri komunale dhe Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Shanse të Barabarta dhe Çështje Gjinore të gjithë e përdorën Planin si bazë për krijimin e strategjive të tyre.[424] Për më tepër, një rekomandim brenda Planit çoi në krijimin e LBGJ të parë dhe disa mekanizmave institucionalë me mandatin për të avancuar barazinë gjinore në Kosovë.[425] Mekanizmat e barazisë gjinore përfshinin zyrtarët komunalë të barazisë gjinore; komitetet komunale për barazi gjinore; Zyra për Barazi Gjinore brenda Zyrës së Kryeministrit (më vonë ABGJ); Nën-Komisionin për Barazi Gjinore në Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizën Kushtetuese në Kuvendin e Kosovës; Grupin Ndërministror për Arritjen e Barazisë Gjinore; Zyrtarët për çështje gjinore ose pikat qendrore në ministri; dhe Njësinë Gjinore në Institucionin e Avokatit të Popullit.[426] Igballe Rogova kujton:

> Ne luftuam shumë për të krijuar ABGJ, e cila së pari u quajt Zyra për Barazi Gjinore, dhe për ta vendosur atë ku i takon, në nivelin më të lartë qeveritar. Në fillim, kishte qëllime për ta vendosur atë në Ministrinë e Administratës Publike. Sidoqoftë, për shkak të avokimit të vazhdueshëm të grave në shoqërinë civile dhe grave në politikë, ne patëm sukses në vendosjen e ABGJ në nivelin më të lartë të vendimmarrjes, brenda Zyrës së Kryeministrit, në mënyrë që ajo të ndikonte në punën e ministrive të tjera gjithashtu. Kishte edhe burra të përfshirë në këto përpjekje, si Besim Kajtazi dhe Behar Selimi, ndër të tjerët.[427]

Kështu, gra dhe burra të ndryshëm kërkuan krijimin e ABGJ-së në Zyrën e Kryeministrit, në nivelin më të

---

[421] Intervistat e RrGK me aktivistë dhe përfaqësues të OSHCG-ve, 2020.

[422] Intervistë e RrGK-së me Flora Macula, 2020.

[423] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 194

[424] Po aty, f. 196

[425] Po aty.

[426] Po aty.

[427] Intervistë e RrGK, 2020

lartë të vendimmarrjes, si një çështje thelbësore mekanizmi institucional për barazinë gjinore në Kosovë.[428]

Ligji për Barazinë Gjinore (LBGJ) u miratua në 2004, duke përfshirë mandatin e ABGJ-së, kurse ABGJ u krijua në vitin 2005. Që nga ajo kohë, ABGJ ka bashkëpunuar me aktiviste për të drejtat e grave dhe OSHCG-të, ndër aktorë të tjerë, drejt arritjes së barazisë gjinore dhe avancimit të sigurisë njerëzore në mënyra të ndryshme. Përveç veprimeve të lartpërmendura që ABGJ ka ndërmarrë për të adresuar dhunën me bazë gjinore, në vitin 2014 ABGJ udhëhoqi hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 për grate, paqen dhe sigurinë në Kosovë.[429] ABGJ gjithashtu publikoi një raport mbi pjesëmarrjen, rolet dhe pozitën e grave në institucionet e Kosovës, mbështetur nga UN Women dhe UNDP.[430] Në të, ata identifikuan pengesat kryesore dhe dhanë rekomandime për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje.

Më vonë, ABGJ udhëhoqi procesin e ndryshimit të LBGJ për ta përmirësuar atë, në bashkëpunim të ngushtë me OSHCG dhe aktorë të tjerë; kjo përfshinte ridefinimin e barazisë gjinorenga 40% në LBGJ-në e parë në përfaqësim prej 50% për secilën gjini në LBGJ-në e vitit 2015, midis rishikimeve të tjera të rëndësishme. ABGJ gjithashtu udhëhoqi proceset konsultative drejt krijimit të dy programeve përkatëse dhe planeve të veprimit për barazinë gjinore sipas kërkesave të LBGJ.[431]

Gratë në shoqërinë civile dhe gratë politikane gjithashtu ofruan ekspertizë për të informuar disa ligje, programe dhe politika të rëndësishme drejt rritjes së sigurisë dhe mirëqenies së grave.[432] Siç përmblodhi Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive e ABGJ, "Si rezultat i gjithë këtij organizimi, hapat e parë janë ndërmarrë drejt hartimit të ligjeve; krijimit të mekanizmave drejt barazisë gjinore; deri në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila, për herë të parë, përfshin CEDAW", Konventën e KB për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave.[433] Aktivistet për të drejtat e grave dhe OSHCG-ë ishin jetësore për informimin e të gjitha këtyre proceseve, ligjeve dhe mekanizmave, të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kanë shërbyer për të vendosur bazën ligjore dhe institucionale për avancimin e paqes dhe sigurisë në Kosovë. Për më tepër, ato mbështetën disa ligje dhe politika të tjera që lidhen me paqen dhe sigurinë që nuk janë përfshirë këtu.

## Shembuj të grave politikane që avancojnë paqen dhe sigurinë

Lista e grave në politikë që kanë kontribuar për paqen dhe sigurinë pas luftës është e gjatë dhe do të kërkonte një hulumtim shtesë të përqendruar vetëm në këtë. Sidoqoftë, kjo nën-pjesë paraqet disa shembuj të kontributeve të dukshme të grave politikane për paqen dhe sigurinë në Kosovë. Tabela 2 ofron një listë jo-shteruese të disa kontributeve të grave politikane në nivelin e Kosovës (sipas rendit alfabetik sipas emrit). Tabela 3 përfshin shembuj të kontributeve të grave në nivelin komunal.

[428] Intervistë e RrGK, 2020, dhe RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, f. 149-150.

[429] Qeveria e Kosovës, ABGJ, Plani i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës1325 'Gratë, Paqja dhe Siguria' në Kosovë 2013-2015", 2014.

[430] ABGJ, Raport hulumtimi, *Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore dhe lokale dhe partitë politike në Kosovë,* 2014.

[431] Qeveria e Republikës së Kosovës, " Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013"; " Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024", 2020.

[432] Për një listë të pjesshme të ligjeve në të cilat OSHCG-të kanë kontribuar, shih RrGK raporte vjetore, strategji, dhe RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave? Trendët e financimit*, 2020, f. 26

[433] Intervistë e RrGK, 2020

| Tabela 2. Shembuj të kontributeve të grave në politikë për paqen dhe sigurinë |
|---|
| ABGJ-ja dhe anëtarët e stafit të nëpunësve të saj civilë kontribuan në një politikë dhe programe të panumërta drejt paqes dhe sigurisë, veçanërisht për gratë.[434] |
| Në vitet 2012-2013, 40 gra deputete të grupeve të ndryshme etnike dhe partive politike avokuan me sukses për Ministrinë e Punëve të Jashtme për të zbatuar LBGJ dhe RKSKB 1325, duke pasur parasysh nën-përfaqësimin e grave në misionet diplomatike; që nga viti 2020, gratë përbejnë 40% të diplomatëve dhe ambasadorëve të karrierës së Kosovës, të cilat janë të pozicionuara për t'u angazhuar në proceset e paqes dhe sigurisë në lidhje me punët e jashtme.[435] |
| Ish-deputetja Aida Dërguti fillimisht bëri presion dhe ndërtoi koalicione për mbështetjen e grave të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës dhe për përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës. |
| Presidentja Atifete Jahjaga mbrojti kauzën e sigurimit të njohjes dhe mbështetjes për gratë dhe burrat që pësuan dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë. Me dekret presidencial dhe në bashkëpunim të ngushtë me grupet e të drejtave të grave, Jahjaga themeloi Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, i cili kontribuoi në miratimin përfundimtar të ligjit që njeh dhe cakton përfitimet e shtetit për të mbijetuarit. Në bashkëpunim të ngushtë me OSHCG-të me përvojë, ajo gjithashtu udhëhoqi krijimin e Komisionit Kombëtar për Verifikimin dhe Njohjen e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës, i përbërë nga ekspertë të zgjedhur me kujdes të cilët përdorin një qasje dhe proces të ndjeshëm në shqyrtimin e aplikimeve për përfitime të shtetit për të mbijetuarit. |
| Si Kryenegociatore, Edita Tahiri nënshkroi marrëveshjen e parë teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ajo është ndër të paktat gra në botë që kanë nënshkruar një marrëveshje paqeje dhe e para në Ballkan. Si anëtare dhe udhëheqëse e LRGE-JL, ajo kontribuoi për paqen dhe sigurinë në rajon. |
| Ministrja e Ekonomisë Hykmete Bajrami siguroi alokimin e burimeve shtetërore për ABGJ për të mbështetur gratë në mes të pandemisë COVID-19, të tilla si përmes financimit të qendrave kryesore të kujdesit ditor. |
| Deputetja Mimoza Kusari-Lila kontribuoi në fuqizimin ekonomik të grave, ndër të tjera. Ajo bëri presion për një kuotë prej 40% të pjesëmarrjes së grave në Bordin e Drejtorëve të shoqërive aksionare[436] dhe mbështeti ndryshimet e ardhshme në Ligjin e Punës në lidhje me dispozitat e pushimit të lindjes të nenës dhe babait. |
| Deputetja Saranda Bogujevci gjithashtu avokoi për të mbijetuarit e dhunës seksuale, kthimin e personave të zhdukur dhe drejtësi për viktimat e luftës. Ajo bëri një propozim për të konsideruar 14 prillin si Ditë Përkujtimi për të mbijetuarit e përdhunimit të luftës. |
| Deputetja Teuta Saraçini mobilizoi Grupin e Grave dhe grumbulloi fonde ndërkombëtare për të blerë pajisje për t'i bërë kontrollet e kancerit të gjirit më të disponueshme, duke kontribuar në shëndetin e grave (sigurinë njerëzore). |
| Si deputete, Vjosa Osmani mbështeti njohjen e viktimave të dhunës seksuale, vëmendjen ndaj vrasjes së grave dhe adresimin e dhunës në bazë gjinore.[437] Si Kryetare e Kuvendit, ajo vazhdoi ngritjen e çështjes së drejtësisë për viktimat e luftës në Kosovë.[438] Ajo vazhdoi atë që nisi deputetja Aida Dërguti, për të përfshirë Konventën e Stambollit në Kushtetutë. Në mes të pandemisë COVID-19 dhe krizës politike të Kosovës 2020, ajo bëri që partitë të bashkohen për të përmbushur nevojat e njerëzve dhe për të miratuar Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike, drejt sigurisë njerëzore.[439] Si Ushtruese e Detyrës së Presidentit, ajo ka qenë e zëshme në lidhje me njohjen e krimeve të kryera në Kosovë gjatë luftës,[440] duke theksuar në takimet në Kosovë dhe jashtë saj se Ballkani Perëndimor "do të shkojë përpara kur të ketë drejtësi, sepse drejtësia është një parakusht për paqen dhe pajtimin".[441] |
| Si Ambasadorje e Kosovës në SHBA, Vlora Çitaku ka ngritur në takimet e Këshillit të Sigurimit të KB dhe më gjerë, çështjen e krimeve të luftës të kryera nga Serbia, përfshirë dhunën seksuale, thirrjen për të vërtetën dhe drejtësinë. Si Ministre e Integrimit Evropian, ajo mbështeti të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe ishte e zëshme në lidhje me padrejtësitë me të cilat përballeshin. |

[434] Ligji për Shoqëritë Tregtare, 2018, f. 35

[435] Vjosa Osmani fjalim, 2017

[436] Vjosa Osmani, "Osmani: S'mund të ketë paqe të qëndrueshme pa drejtësi për viktimat", Telegrafi, 2020

[437] Kallxo.com, "Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike është miratuar pas gjashtë përpjekjeve të dështuara" (Në shqip), 2020.

[438] Zyra e Presidentit të Kosovës, "Fjalimi i u.d. Presidentes Vjosa Osmani në Kuvendin e Shqipërisë", 2020.

[439] Deklaratë gjatë takimit me David Sassoli, President i Parlamentit Evropian, Bruksel, 12 janar 2021, e mbuluar nga media e Kosovës.

[440] Ligji për Shoqëritë Tregtare, 2018, f. 35

[441] Vjosa Osmani fjalim, 2017

| Tabela 3. Shembuj të kontributeve të grave në politikë për paqen dhe sigurinë në nivelin komunal |
|---|
| Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore në Dragash avokoi me sukses për të ri-vitalizuar qendrat e kujdesit ditor, drejt mundësimit të grave për të punuar; për buxhetim më pjesëmarrës dhe me përgjegjësi gjinore; dhe për investime komunale në sigurinë ekonomike të grave rurale, në bashkëpunim me bizneset lokale.[442] |
| Në Malishevë, ato avokuan që komuna të financojë shërbime shëndetësore për gratë dhe të ndryshojë politikat e subvencionit për bujqësinë dhe bursat për studentët.[443] |
| Në Drenas, ato avokuan për adresimin e dhunës në bazë gjinore që ndodhi gjatë pandemisë COVID-19, përfshirjen e grave në biznese dhe politikë, ndërgjegjësimin për shëndetin riprodhues dhe barazinë gjinore.[444] |
| Në Gjakovë, ato avokuan për kujdesin shëndetësor gjatë pandemisë dhe ndërgjegjësimin për ngacmimet seksuale.[445] |
| Në Mitrovicë, ato avokuan për strehim për gratë, fëmijët dhe njerëzit me aftësi të ndryshme; dhe, me sukses, që Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik të alokojë 80% të subvencioneve për gratë.[446] |
| Në Prishtinë, ato avokuan për përfshirjen e grave në pozicionet vendimmarrëse, përfaqësimin e njerëzve me aftësi të ndryshme, zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, dhe ngritjen e vetëdijes për trafikimin.[447] |
| Në Shtime, ato avokuan një strategji lokale mbi dhunën në familje,[448] dhe lehtësimin e taksave për gratë që hapin biznese të reja.[449] |
| Në Istog, ato avokuan për punësimin e grave, vetëpunësimin,[450] përfshirë gratë rurale,[451] dhe të drejtat e trashëgimisë.[452] |
| Në Viti ato avokuan për fuqizimin ekonomik të grave dhe përfshirjen e grave në këshillat lokale.[453] Në vitin 2019, komuna miratoi Strategjinë kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit 2019-2023. Ato gjithashtu avokuan për harmonizimin e rregulloreve komunale me Ligjin për Barazinë Gjinore, duke përfshirë vendosjen e masave pohuese, përjashtimin nga taksat komunale për gratë ndërmarrëse, fermeret, nënat e vetme dhe fëmijët e tyre nën moshën 18 vjeç, përjashtimin nga taksat e kujdesit shëndetësor për dhunën në familje dhe viktimat e trafikimit, dhe masa pohuese për bursat për studentët. Tani, Kryetare e Këshillit të Vitisë është një grua.[454] |
| Në Mamushë, ato mbështetën gratë në krijimin e bizneseve dhe ngritën vetëdijen për dhunën në familje.[455] |
| Në Kllokot, ato avokuan për trashëgiminë e grave dhe të drejtat pronësore dhe ngritën vetëdijen për çështjet shëndetësore gjatë pandemisë.[456] |
| Në Suharekë, ato ngritën vetëdijen për rëndësinë e ndërtimit të qendrave ditore të fëmijëve,[457] dhe avokuan që të përfshihen rampat e qasjes në hapësirat publike për nënat me fëmijë dhe njerëzit në karroca invalidore në planifikimin e tyre të buxhetit komunal.[458] |

[442] Kallxo.com, "Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike është miratuar pas gjashtë përpjekjeve të dështuara" (Në shqip), 2020.

[443] Zyra e Presidentit të Kosovës, "Fjalimi i u.d. Presidentes Vjosa Osmani në Kuvendin e Shqipërisë", 2020.

[444] Deklaratë gjatë takimit me David Sassoli, President i Parlamentit Evropian, Bruksel, 12 janar 2021, e mbuluar nga media e Kosovës.

[445] Ligji për Shoqëritë Tregtare, 2018, f. 35

[446] Vjosa Osmani fjalim, 2017

[447] Vjosa Osmani, "Osmani: S'mund të ketë paqe të qëndrueshme pa drejtësi për viktimat", Telegrafi, 2020

[448] Kallxo.com, "Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike është miratuar pas gjashtë përpjekjeve të dështuara" (Në shqip), 2020.

[449] Zyra e Presidentit të Kosovës, "Fjalimi i u.d. Presidentes Vjosa Osmani në Kuvendin e Shqipërisë", 2020.

[450] Deklaratë gjatë takimit me David Sassoli, President i Parlamentit Evropian, Bruksel, 12 janar 2021, e mbuluar nga media e Kosovës.

[451] RrGK, Raporti vjetor, 2019, f. 109.

[452] RrGK, Raporti vjetor, 2017, f. 137

[453] RrGK, Raporti Vjetor, 2020 (i ardhshëm), f. 129

[454] RrGK, Raporti vjetor, 2019, f. 110

[455] RrGK, Raporti Vjetor, 2020 (i ardhshëm), f. 131

[456] Po aty.

[457] Po aty.

[458] RrGK, Raporti vjetor, 2018, f. 105

| |
|---|
| Në Prizren, ato avokuan për të rritur përfaqësimin e grave në pozitat vendimmarrëse, duke bërë thirrje për të paktën 30% përfaqësim të grave në drejtoritë komunale.[459] |
| Në Deçan, ato ngritën vetëdijen për të drejtat e punës së grave.[460] |
| Në Pejë, ato avokuan për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.[461] Ato gjithashtu rritën ndërgjegjësimin e grave në lidhje me pronën dhe të drejtat e trashëgimisë.[462] |
| Në Skenderaj, ato avokuan për krijimin e banesave sociale për personat që mbijetojnë nga dhuna në familje, duke rritur shkallën e punësimit të grave dhe duke ndihmuar gratë në bujqësi.[463] Në vitin 2017, komuna akomodoi tri gra që kishin vuajtur dhunë në familje në banesa sociale.[464] |
| Në Ferizaj, ato avokuan për shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor për nënat beqare.[465] Në vitin 2018, komuna gjithashtu avokoi për ndryshimin e rregulloreve komunale në lidhje me hendekun gjinor.[466] |
| Në Novobërdë, ato avokuan për punësimin e grave.[467] |
| Në Obiliq, kishte aktivitete ndërgjegjësimi mbi të drejtat e njeriut dhe zhvillimin ekonomik të grave.[468] |
| Në Kamenicë, ato ndihmuan financiarisht gratë me kancer.[469] |
| Në Gjilan, ato avokuan që Departamenti i Arsimit të integrojë tema të lidhura me gjininë në programet mësimore dhe ngritën vetëdijen për trashëgiminë dhe të drejtat e pronës.[470] |
| Në Podujevë, ato avokuan për shpërndarjen e 100 € në përfitimet e lidhura me maternitetin.[471] |

Si përfundim, OSHCG-të dhe aktivistet nga politika dhe shoqëria civile, të mbështetura nga UNIFEM, OSBE dhe BE, ndër të tjera, kanë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë përmes kuotës, fuqizimit të grave, ndërtimit të kapaciteteve, rrjetëzimit, mbështetjes për solidariteti midis grave dhe avokimit për ligjet, politikat dhe mekanizmat e rëndësishëm drejt barazisë gjinore. Disa burra në pozicione kryesore kanë mbështetur përpjekjet e tyre. Puna e tyre ka kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje në Kosovë. Gratë në politikë, shpesh në bashkëpunim me OSHCG-të, e kanë përdorur politikën si një platformë për avancimin e paqes dhe sigurisë për gratë në Kosovë, veçanërisht në lidhje me mbështetjen e grave që pësuan dhunë seksuale gjatë luftës, adresimin e dhunës në bazë gjinore, përmirësimin e sigurisë ekonomike të grave, dhe avancimin e qasjes së grave në kujdesin shëndetësor, ndër fusha të tjera.

459 RrGK, Raporti vjetor, 2019, f. 108

460 Po aty, f. 109.

461 RrGK, Raporti vjetor, 2019, f. 109.

462 RrGK, Raporti vjetor, 2017, f. 141

463 RrGK, Raporti vjetor, 2019, f. 110

464 RrGK, Raporti vjetor, 2017, f. 143

465 RrGK, Raporti vjetor, 2019, f. 114

466 RrGK, Raporti vjetor, 2018, f. 105

467 Po aty, f. 104.

468 Po aty, f. 105

469 RrGK, Raporti vjetor, 2017, f. 137

470 Po aty, f. 136.

471 RrGK, Raporti vjetor, 2019, f. 112.




Më 8 mars 2006, aktivistët e të drejtave të grave varen një banderolë që rikujton të drejtën e tyre për të marrë pjesë në negociata, sipas RKSKB 1325, jashtë Kuvendit dhe ndërtesës së qeverisë në Prishtinë. Mbeti atje për disa muaj, një kujtesë e vazhdueshme e së drejtës së grave për të qenë pjesë e negociatave

## Kontributet e grave për negociata dhe dialog, dhe nevojat e tyre

Siç është elaboruar në Hyrje, RKSKB 1325 parashikon pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes, të tilla si negociatat dhe dialogu,[472] veçanërisht duke pasur parasysh dëshminë se përfshirja e grave mund të kontribuojë në qëndrueshmërinë e paqes. Prandaj, kjo nën-pjesë përqendrohet në rolet dhe kontributet e grave për paqen dhe sigurinë përmes angazhimit të tyre në negociata dhe Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë pas luftës.[473] Në fund, ajo përmbledh gjetjet në lidhje me çështjet kryesore që gratë do të dëshironin të shihnin të diskutuara gjatë Dialogut Kosovë-Serbi.

Në Kosovën e pasluftës, fillimisht asnjë grua nuk ishte e përfshirë në negociata. Sekretari i Përgjithshëm i KB vendosi Martti Ahtisaari si të Dërguarin e tij Special në nëntor 2005 për të udhëhequr diskutimet rreth statusit të ardhshëm të Kosovës, siç parashikohet në RKSKB 1244.[474] Pas 15 muajsh negociatash të sponsorizuara nga KB, palët nuk mund të arrinin një marrëveshje. Kështu, Grupi i Kontaktit (Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA) vendosën të ndërmarrin një periudhë tjetër negociatash drejt arritjes së një marrëveshjeje.[475] Në këto bisedime të para të paqes pasluftës, të dy ekipet negociuese përbëheshin nga burra. Serbia u përfaqësua nga Presidenti Boris Tadiq, Kryeministri Vojislav Koshtunica, Ministri i Jashtëm Vuk Jeremiq dhe Ministri për Kosovën

[472] RKSKB 1325, 31 tetor 2000.

[473] Këtu "Dialogu" i referohet posaçërisht Dialogut Kosovë-Serbi, ndërsa dialogu i referohet pjesëmarrjes në dialogje në përgjithësi.

[474] RKSKB, "Raporti i Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara, Trojkës së Federatës Ruse për Kosovën", 2007.

[475] Po aty.

Sllobodan Samarxhiq, ndërsa Kosova u përfaqësua nga "Ekipi i Unitetit" përfshirë Presidentin Fatmir Sejdiu, Kryeministrin Agim Çeku, Kryetarin e Kuvendit Kolë Berisha, Hashim Thaçin dhe Veton Surroin.[476]




© RrGK
Disa vajza morën pjesë në protestën e RrGK-së më 8 mars 2006, duke bërë thirrje që zërat e grave të dëgjohen në negociata mes Kosovës dhe Serbisë.




© RrGK
Aktivistet e të drejtave të grave angazhuan burra në avokimin për pjesëmarrje të grave në negociata.

Pas dështimit të të dy qeverive për të përfshirë gratë në ekipet e tyre negociuese, gratë nga Kosova dhe Serbia morën masa. "Gratë nuk qëndruan të heshtura", kujton një aktiviste. "Ato filluan të kërkojnë që të zbatohet rezoluta 1325, pasi ajo u siguronte grave të drejtën për një vend në tryezë në negociata".[477] Aktivistet menjëherë bënë thirrje për pjesëmarrjen e grave në negociata.[478] Anëtarët e RrGK u mobilizuan, së bashku me aktiviste të tjera, duke dalë në rrugë për të bërë thirrje për pjesëmarrjen e grave. Ato përdorën Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsin, për t'i bërë thirrje qeverisë që të përfshijë gratë në negociata. Motoja e tyre dalluese shfaqej çdo vit

[476] Po aty.

[477] Intervistë e RrGK-së me një grua aktiviste, Prishtinë, 2020.

[478] RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, f. 149-150.

në protesta në vitet që pasuan: "Ne nuk duam lule, ne duam pushtet".[479] Për më tepër, ato paraqitën një propozim konkret në lidhje me atë se cila grua duhet të marrë pjesë në ekipin negociator: Edita Tahiri kishte përvojë në politikë të jashtme dhe diplomaci, përfshirë pjesëmarrjen e saj të mëparshme në negociatat në Rambuje.[480]

"Në atë periudhë, ne nuk u thamë brezave të rinj 'Ndaluni atje! Nuk keni ndonjë gjë për të thënë? Koalicioni i Grave të Paqes u dha hapësirë të gjithë brezave që të përfshihen. "

**Grua shqiptare, aktiviste, Prishtinë**

Ndërkohë, aktivistët e të drejtave të grave u mobilizuan për t'i bërë të dëgjuara prioritetet e grave në negociatat në vazhdim. RrGK dhe Rrjeti Gratë në të Zeza Serbi, një organizatë feministe antimilitariste e paqes, themeloi Koalicionin të Grave për Paqe në vitin 2006.[481] Ato sollën së bashku gra të ndryshme nga Kosova dhe Serbia për të diskutuar çështje kyçe që i prekin ato, duke zhvilluar një dialog alternativ gjatë negociatave zyrtare midis shteteve të tyre. Së pari, aktivistet diskutuan përvojat e tyre të luftës dhe nevojat e tyre personale; për to, diskutimi për të kaluarën ishte thelbësor që të fillonin të flisnin për të ardhmen. Ato ndanë histori personale të luftës, duke respektuar përvojat e njëra-tjetrës. Vetëm atëherë ato mund të fillojnë të flasin për të ardhmen dhe atë që prisnin të shihnin nga negociatat. Ato hartuan një seri deklaratash të përbashkëta, dërguar liderëve politikë në të dy vendet, si dhe ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, duke kërkuar që negociatat të adresonin çështje që gratë i konsideronin përparësi.




© RrGK
Aktivistet e të drejtave të grave Igballe Rogova (RrGK), Xheraldina Vula-Buçinca (RTV21), Osnat Lubrani (UNIFEM) dhe Staša Zajović (Gratë në të Zeza) diskutojnë rreth paqes dhe sigurisë në kontekst të negociatave mes Kosovës dhe Serbisë në takimin a Koalicionit të Grave për Paqe në Strugë, Maqedoni, 2006.

[479] Kosovo 2.0, "Tri dekada protestë; *Një histori e aktivizmit të udhëhequr nga gratë më 8 mars* ", 2018.

[480] RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, f. 52

[481] RrGK, "Rrjeti i Grave në të Zeza Serbi, RrGK formojnë koalicionin e grave për paqe ", 2013.




© RrGK
Aktivistet e të drejtave rë grave nga Kosova dhe Serbia bëjnë thirrje për drejtësi dhe barazi, përfshirë zëvendësimin e financimit për ushtri me financim në mbështetje të nevojave të sigurisë njerëzore, si ushqim dhe medikamente, gjatë një demonstrate të organizuar nga Gratë e Koalicionit të Paqes në Strugë, Maqedoni më 2007.

Koalicioni i Paqes së Grave u takua përsëri në vitin 2007, duke përgatitur një seri tjetër deklaratash të përbashkëta për të informuar negociatat.[482] Deklarata e parë e Koalicionit adresoi dështimin e vendimmarrësve nga Kosova dhe Serbia që nuk përfshin gratë në procesin e negociatave. Deklarata e dytë kërkonte të informonte negociatorët, si dhe njerëzit në Kosovë dhe Serbi, në lidhje me qëndrimin e Koalicionit mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, e cila ishte, në atë kohë, çështja që diskutohej nga negociatorët në Vjenë.[483] Me mbështetje nga UNIFEM, përfaqësueset shprehën pikëpamjet e Koalicionit gjatë një takimi me Martti Ahtisaari, të Dërguarin Special për Procesin e Statusit të Ardhshëm të Kosovës.[484] Sipas një aktivisteje për të drejtat e grave, Ahtisaari tha: "Nuk besoja aq shumë në barazinë gjinore; U udhëzova ta bëja këtë nga gratë e rajonit."[485] Gratë serbe dhe shqiptare gjithashtu organizuan demonstrata në rrugë që kërkonin paqe dhe fund të militarizmit. Simbolikisht, ato theksuan rëndësinë e vëmendjes më të madhe të shteteve për sigurinë njerëzore, duke zëvendësuar shpenzimet ushtarake me shpenzime që do të adresonin më mirë nevojat e sigurisë njerëzore të grave dhe burrave. LRGEJL gjithashtu dërgoi deklarata të përbashkëta për të informuar negociatat zyrtare midis Kosovës dhe Serbisë, duke

[482] RrGK, *Përmes solidaritetit të grave për një paqe të drejtë : Një raport i bazuar në konferencën e dytë vjetore të koalicionit të paqes për gratë*, Strugë, 2007.

[483] Po aty.

[484] Po aty.

[485] Intervistë e RrGK-së me një grua aktiviste shqiptare, Prishtinë, 2020.

ngritur çështje me rëndësi për gratë. Për shembull, një deklaratë e përbashkët nga gratë politikane dhe OSHCG-të në rajon bëri thirrje për "një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme për Kosovën" në vitin 2006.[486] Deklaratat morën një mbulim të gjerë mediatik. Nuk kishte asnjë përgjigje ndaj kërkesave të bëra në LRGEJL ose letrat e Koalicionit të Grave për Paqe në vitet 2006 ose 2007.

Në vitin 2011, Atifete Jahjaga u bë Presidente e Kosovës. Megjithëse Jahjaga mbajti një nga postet më të larta drejtuese në vend, ajo tha se nuk ishte konsultuar në lidhje me negociatat me Serbinë. "Gjatë asaj kohe unë u këshillova në sasinë minimale të mundshme", kujton ajo. "Mesazhi i dhënë nga ata [udhëheqësit politikë përgjegjës për negociatat] ka qenë, 'Ne jemi këtu. Ne e dimë më mirë'."[487]

Gjithashtu, në vitin 2011, Edita Tahiri u bë Udhëheqëse e Dialogut Teknik me Serbinë, shpesh i referuar si "Dialogu i Brukselit", një post i cili zgjati deri në vitin 2017.[488] Padyshim, pozicioni i saj para-ekzistues në politikë, shoqëruar me përvojën e viteve në politikë dhe diplomaci, kontribuan në aftësinë e saj për të siguruar një vend në tryezë. Mbrojtja e OSHCG-ve që ajo të ketë këtë pozicion gjithashtu mund të ketë qenë një faktor kontribues.[489]

Ekipi këshillues i Edita Tahirit përfshinte 50% (3) gra dhe 50% (3) burra. Gratë gjithashtu shërbyen në "pjesën politike të Dialogut si koordinatore", tha Edita Tahiri. "Sa i përket përbërjes së grupit të ekspertëve, gjithçka që më interesoi ishte të kisha ekspertë të një fushe të caktuar, dhe këta ekspertë u propozuan nga ministra të ministrive të veçanta. Por ata sollën kryesisht burra, pasi kishte mungesë të grave në pozitat e vendimmarrjes në institucionet publike".[490] Kështu, nën-përfaqësimi i përgjithshëm i grave në politikë kontribuoi në nën-përfaqësimin e tyre si eksperte në Dialog.

"Ne kemi mungesë të grave në pozitat udhëheqëse brenda institucioneve publike. Kjo është arsyeja pse gratë mbeten jashtë tryezës së vendimmarrjes."

**Grua politikane, Prishtinë, 2020**

Aktivistet e të drejtave të grave shprehën shqetësimin se procesit të përgjithshëm të Dialogut Teknik i mungonte transparenca; kështu, njerëzit kishin informacion të kufizuar në lidhje me procesin dhe rezultatet e tij.[491] Zyra e BE-së që ndërmjetësoi Dialogun ishte raportuar e paarritshme dhe e padëshirueshme për gazetarët; as përfaqësuesit e ekipeve negociuese nga asnjë vend nuk dhanë shumë informacion.[492] Deklaratat e mediave publike të bëra nga secila qeveri shpesh ishin kundërshtuese.[493] Siç tha një grua përfaqësuese e një OSHCG-je në Mitrovicën e Veriut:

> Popullata e përgjithshme nuk është e informuar se për çfarë flasin atje. Njerëzit e dinë që bisedimet ekzistojnë, por ata marrin vetëm informacion të pjesshëm nga politikanët dhe media. Ekzistojnë edhe interpretime të ndryshme. Beogradi thotë një gjë, Prishtina, një tjetër. Nga ana tjetër, Brukseli, diçka krejt tjetër. Një konfuzion i tillë krijon çështje në marrëdhëniet ndëretnike midis njerëzve.[494]

[486] LRGEJL, "Lobi i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore mbështet me gjithë zemër një Zgjidhje të Drejtë dhe të Qëndrueshme për Kosovën", Zagreb, 19 korrik 2006.

[487] Intervistë e RrGK-së me Atifete Jahjaga, Prishtinë, 2020.

[488] RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, f. 52

[489] Po aty.

[490] Intervistë e RrGK, 2020

[491] Grupi i Avokimit të Politikave Kosovë-Serbi, "DIALOGU KOSOVË - SERBI, Prishtinë - Marrëveshjet e Dialogut Teknik të Beogradit: Perceptimet në terren Prishtinë, Mitrovica e Veriut, Beograd", shkurt 2020. Gjatë konferencës, një Redaktor i Përgjithshëm i një media në Kosovë tha se Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishte më jotransparenti që kur ai filloi të punonte si gazetar në vitet 1990.

[492] Po aty.

[493] Konferencë mbi Dialogun Përfundimtar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 18 dhjetor 2019, Prishtinë.

[494] Intervistë e RrGK-së me një aktiviste serbe për të drejtat e grave, Mitrovicë e Veriut, 2020.

Konfuzioni dhe transparenca e dobët përreth negociatave dhe dialogut minuan kështu potencialin e këtij procesi për të kontribuar në paqe dhe siguri, thanë aktivistet.

## Reflektimet e grave mbi negociatat dhe dialogun

"Për çfarë flasin ata në negociatat e Brukselit? Po pyes sepse ato që i dëgjojmë këtu janë të pakuptimta. Ata tregojnë të gjitha llojet e gjërave në lajme. Ata e bëjnë atë të duket sikur ne [serbët në Kosovë] jemi të lidhur me zinxhirë këtu. Ne jetojmë shumë më mirë sesa ata e tregojnë atë në lajme. Por, sa herë që shkojmë në Serbi, ata ndihen keq për ne atje sepse jemi nga Kosova."

**Vajzë serbe, fokus grupi Graçanicë**

"Gratë ishin pjesë e negociatave, por jo ashtu siç pritej. Ato nuk ishin shumë të angazhuara sepse nuk ishin të ftuara."

**Grua shqiptare, aktiviste, Prishtinë**

"Gratë me aftësi të kufizuara janë prekur më shumë gjatë luftës, madje edhe më parë. Kështu, ne gjithashtu kemi të drejtë të marrim pjesë në këto procese. Zëri ynë duhet të ngritet në këto procese. Personat me aftësi të kufizuara nuk janë ankuar asnjëherë, por kërkesat e tyre nuk janë marrë parasysh. Nëse do të isha pjesë e ekipit negociator, do të kërkoja që drejtësia të vihej në vend."

**Vajzë me aftësi të ndryshme, Prizren**

"Po, ne e kishim Edita Tahirin, por, për shembull, roli i saj atje ishte vërtet i diskutueshëm."

**Vajzë serbe, gazetare, Beograd**

"Ata duhet të na japin një shans për t'u përfshirë, veçanërisht për gratë dhe gratë me aftësi të kufizuara, sepse gjëja më e rëndësishme për ne është të realizojmë të drejtat për barazi... dhe pjesëmarrje në të gjitha fushat."

**Grua boshnjake me aftësi të ndryshme, përgjigje në anketë, Prizren**

Pavarësisht disa progreseve, aktivistet e të drejtave të grave në Kosovë menduan se gratë mbetën të nën-përfaqësuara në Dialog, për sa i përket pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, konsultimit publik dhe prioriteteve të çështjeve të diskutuara (shih gjithashtu Reflektimet e grave mbi negociatat dhe dialogun). Një përfaqësuese e OSHCG tha:

> Ne kishim Edita Tahirin, por… nuk mjafton vetëm të kesh një grua [të angazhuar], por të jesh në gjendje të sjellësh çështje të grave. Ne kurrë nuk kemi parë një rast kur organizatat e grave janë thirrur të konsultohen për ato tema që duhen përfshirë [siç janë] dhuna seksuale, dëmshpërblimet, [ose] sesi marrëveshja do të ndikonte te gratë dhe burrat.[495]

Lidhur me këtë, disa pjesëmarrëse në hulumtim menduan se Edita Tahiri nuk ngriti çështje me rëndësi për gratë në Kosovë gjatë Dialogut.

Sidoqoftë, Agjenda e përgatitur për Dialogun e parë, i cili filloi zyrtarisht në 8 mars 2011,[496] përfshiu çështjen e gjetjes së personave të zhdukur dhe riparimin e dëmeve të luftës të shkaktuara nga Serbia, midis kërkesave të tjera teknike.[497] Çështja e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës u përfshi në dëmshpërblime, siç u detajua më vonë në vitin 2014 në platformën e Dialogut të Brukselit.[498] Agjenda u prezantua në BE dhe në tryezën e negociatave me Serbinë. Që një pikë të bëhej pjesë e Agjendës, ajo duhej të pranohej nga të dy palët në negociatë dhe Serbia nuk pranoi të diskutonte pika të caktuara, përfshirë dëmshpërblimet. Çështja e personave të zhdukur ishte pjesë e Dialogut, por u diskutua vetëm një herë.[499]

> "Megjithëse kishim Edita Tahirin, OShC-të nuk kishin asnjë grua [që i përfaqësonte ato] për Dialogun. Ata propozuan burra në Rambuje. Kjo tendencë vazhdon edhe sot; edhe ekspertët ndërkombëtarë janë fajtorë për këtë. Gjysma e popullsisë nuk ka qenë e përfshirë në Dialog. Kishte vetëm burra. Nuk kishte gatishmëri politike. Ato [gratë] shihen vetëm si nëna, por ato bënë po aq sa burrat."
>
> **Vajzë shqiptare, fokus grupi, Prishtinë, 2020**

Kështu, disa pjesëmarrës në hulumtim vunë re se fakti që disa çështje të ngritura nga gratë nuk ishin adresuar në Dialog kishte të bënte me natyrën e vetë Dialogut: "Për shembull, nga ana jonë, ne kishim Edita Tahirin, por [Dialogu] u konsiderua në një nivel teknik. Në një nivel teknik, ishte pak e vështirë të përfshiheshin interesat e grave".[500] Disa të anketuara thanë se Edita Tahiri nuk mund të ngrinte çështje të rëndësishme për gratë sepse Dialogu përfshinte vetëm çështje "teknike". Ato e lavdëruan atë për ekspertizën e saj, të demonstruar në Dialog. Në mënyrë të ngjashme, ndërsa disa OSHCG-ë shprehën zhgënjimin që BE si ndërmjetës nuk siguroi pjesëmarrjen e grave dhe diskutimin e çështjeve të rëndësishme për gratë, për shkak të formatit të Dialogut, BE nuk mund të rishikonte Agjendën pa pëlqimin e të dy palëve.

Disa pjesëmarrëse në hulumtim ia atribuan nënpërfaqësimin e grave në negociata dhe Dialog jo vetëm liderëve politikë të Kosovës, të cilët nuk caktuan gra për të marrë pjesë, por gjithashtu aktorëve ndërkombëtarë që

---

[495] Intervistë e RrGK-së me një grua përfaqësuese e OSHCG, Prishtinë, 2020.

[496] Grupi i Hulumtimit të Politikave Ballkanike, *Dialogu i Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - Arritjet dhe Sfidat*, 2020, f. 12

[497] Zyra e Kryeministrit të Kosovës, "Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për një Dialog Teknik Ndër-Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", Agjenda e Dialogut. Prishtinë, 2011, f. 7

[498] Kabineti i Zëvendës Kryeministres Edita Tahiri, "Dialogu i Brukselit - Temat për Fazën Tjetër", Prishtinë, 29 mars 2014, f. 7 dhe 16.

[499] Intervistë e RrGK-së me Edita Tahirin, 2020.

[500] Intervistë e RrGK-së me një grua përfaqësuese e OSHCG, Prishtinë, 2020.

lehtësuan Dialogun, të cilët nuk siguruan ose nuk mund të siguronin që palët të zbatonin RKSKB 1325. Siç ilustron citimi, pjesëmarrësit në hulumtim besuan se dështime të tilla ishin pjesërisht për shkak të homogjenizimit të grave në rolet tradicionale gjinore, si nëna dhe viktima të dhunës, gjë që injoroi agjencinë (veprimtarinë) e grave dhe historinë e gjatë të aktivizmit. Ndërkohë, përfaqësuesit e BE-së kanë theksuar se pjesëmarrësit në Dialog, ashtu si Agjenda, propozohen nga qeveritë përkatëse dhe BE nuk mund të ndërhyjë.[501]

Pjesëmarrëset në hulumtim vunë re se një nga pasojat kryesore të mos përfshirjes së grave në Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishte mungesa e perspektivave të ndryshme në Dialog. Ato përmendën që përfshirja e grave në këtë proces do të kishte kontribuar në përfshirjen e çështjeve të rëndësishme për gratë, të tilla si dhuna seksuale e kryer gjatë luftës ose strehimoret e grave. Ato gjithashtu thanë se angazhimi i grave do të kontribuonte në paqe më të qëndrueshme, pasi ato janë më këmbëngulëse sesa burrat. Pjesëmarrësit e hulumtimit të grupeve të ndryshme etnike thanë se gratë do të nënshkruanin vetëm një marrëveshje që mund ta zbatonin atë dhe kështu do ta zbatonin. Një grua serbe aktiviste tha:

> Nëse gratë nënshkruajnë diçka, ato sigurohen që ajo të zbatohet. Të rrallë janë burrat që janë përgjegjës dhe shikojnë se çfarë po nënshkruajnë. Një grua nuk nënshkruan diçka që nuk mund ta zbatojë më. Rezultatet e Dialogut deri më tani nuk e kanë përmirësuar jetën e qytetarit. Gratë do të kishin një efekt po të kishin hapësirë.[502]

Në të vërtetë, një rishikim i të gjitha marrëveshjeve të bëra në lidhje me Kosovën që nga mbarimi i luftës, përfshirë negociatat në Rambuje, sugjeron se asnjë nga këto marrëveshje nuk përfshinte çështje që gratë i kishin ngritur ose konsideruar si prioritete.

Kështu, disa gra ndiheshin se kishin humbur të drejtat dhe se angazhimi në Dialog ishte i padobishëm. Një grua serbe që ishte pjesë e ekipit përgatitor për negociatat e Vjenës, komentoi:

> Unë isha pjesë e ekipit të përgatitjes së negociatave të ICO-së [Zyra Civile Ndërkombëtare]. Doja të përfshihesha sepse komuniteti serb bojkotoi negociatat. Sidoqoftë, kuptova se ishte e gjitha politikë globale dhe ata që negociojnë janë vetëm marioneta. Prandaj, gratë e reja nuk humbën shumë duke mos u përfshirë.[503]

Duke ndjerë se zërat e tyre ishin të padëgjuar gjatë negociatave dhe Dialogut, gratë vazhduan të ngrisnin çështje me rëndësi për to përmes letrave të avokimit, deklaratave për shtyp dhe demonstratave, duke kërkuar vëmendje për prioritetet e tyre.[504] Çështjet kryesore përfshinin njohjen dhe faljen publike për krimet e kryera; drejtësinë për të mbijetuarit e dhunës seksuale; dëmshpërblimet për pronën civile të shkatërruar; dhe gjetjen e personave të zhdukur. Fotografitë dhe nëntitujt vijues ilustrojnë disa nga përpjekjet e tyre.

[501] Deklaratat e bëra në takimet publike në të cilat RrGK mori pjesë dhe në letrat e marra nga zyrtarët e BE-së.

[502] Intervistë e RrGK-së me një aktiviste serbe, Stanishor, Gjilan, 2020.

[503] Intervistë e RrGK, Mitrovicë e Veriut, 2020

[504] Për shembull, shih: RrGK, "Letra e Lobit të Grave të Kosovës për Soren Jesen Petersen "Për të kërkuar përfaqësimin e grave në bisedimet për një zgjidhje paqësore, 2005; "Letër e Koalicionit të Grave për Paqe për Martti Ahtisaari "Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në procesin e negociatave, 2006; "Letër e Koalicionit të Grave për Paqe për Martti Ahtisaari" për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në procesin e negociatave, 2006; " Letër e LRGEJL drejtuar Martti Ahtisaari "Për statusin përfundimtar të Kosovës, 2006; "Letër e Koalicionit të Grave për Paqe për Martti Ahtisaari "Thirrje për pavarësi, mbrojtje të vendeve kulturore, garantim të barabartë të të drejtave të plota për grupet e pakicave dhe pjesëmarrje të barabartë të grave në procesin e negociatave, 2007.






Organizatat e të drejtave të grave si Thirrjet e Nënave, të mbështetura nga RrGK dhe organizatat anëtare, kanë sjellur në mënyrë të vazhdueshme çështjen e personave të zhdukur përmes organizimit të demonstrative të ndryshme, si ajo e vitit 2014. Ato i kanë kërkuar qeverisë që të adresojë çështjen e personave të zhdukur, sepse njerëzit duhet të ballafaqohen me të kaluarën para se t'a ndërtojnë një të ardhme të qëndrueshme.




© RrGK
Aktivistet për të drejtat e grave kanë vazhduar të sjellin çështje të rëndësishme të grave në hapësirën publike kur grave u është mohuar qasja në dialogn zyrtar. Përmes një demonstrate publike në 2014, ato insistojnë që një paqe e qëndrueshme nuk mund të krijohet para njohjen e së kaluarës dhe drejtësisë për krimet e kryera.



© RrGK
Gjatë një demonstrate massive në Nëntor 2012, gratë, të cilave i'u bashkuan disa burra, kërkuan "Drejtësi dhe Dinjitet para Negociatave". Kjo u shoqërua nga një letër me kërkesat e tyre për një falje zyrtare nga Serbia për krimet e kryera; kthim të penzioneve; drejtësi për personat të cilët i'u kanë ekspozuar dhunës gjatë luftës dhe kompenzim moral dhe ekonomik

Për më tepër, Shoqata e Grave e Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (MWAHR) dhe Shoqata e Grave Ora e Rërës (Peščanik) shkruan një raport të përbashkët duke përmbledhur shqetësimet e grave përreth Dialogut, duke u mbështetur në takime me gra të etnive të ndryshme nga Kosova dhe Serbia.[505] Gratë identifikuan çështje, të tilla si: bashkëpunimi i dobët i BE-së, zyrtarëve vendorë dhe lokalë me OSHCG-të; qasje e dobët në informacion në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE dhe Dialogun Kosovë-Serbi; gjuha e urrejtjes e përdorur nga politikanët nga të dy palët gjatë dhe pas negociatave, e cila preku perceptimet e publikut dhe marrëdhëniet ndëretnike; dhe nënpërfaqësimi i grave në procesin e Dialogut.

Si përfundim, fillimisht gratë nuk kishin një vend në tryezën e negociatave në bisedimet e paqes të ndërmjetësuara nga KB. Gratë aktiviste, OSHCG-të dhe rrjetet organizuan kështu negociata paralele dhe ngritën çështje publike të rëndësishme për gratë. Pas avokimit të OSHCG-ve dhe bazuar në pozicionimin dhe përvojën e saj politike, nga viti 2011, Edita Tahiri, mori pjesë direkt si Kryenegociatore e Dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ajo kishte një ekip më të ekuilibruar gjinor që parashtroi disa nga çështjet e rëndësishme për gratë në Agjendë. Sidoqoftë, Serbia nuk ishte dakord të diskutonte këto çështje, dhe dialogu u përqendrua në çështjet teknike. OSHCG-të dhe aktivistët e të drejtave të grave vazhduan kështu të ngrenë çështje të rëndësishme për gratë në sferat publike, duke kërkuar që Dialogu të merret me këto çështje.

## Prioritetet e grave për Dialogun Kosovë-Serbi

Duke qenë se shumica e grave ishin lënë jashtë negociatave dhe Dialogut, RrGK pyeti gra të ndryshme se cilat do të ishin prioritetet e tyre, nëse do të kishin një vend në tryezë. Duke marrë informata nga gjetjet nga anketa e RrGK-së në internet, intervistat telefonike të anëtareve të RrGK-së, intervistat ballë për ballë dhe grupet e fokusit të zhvilluara me gra të moshave, aftësive dhe etnive të ndryshme në të gjithë Kosovën, RrGK ka identifikuar disa nga prioritetet kryesore që gratë kanë për Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Gratë thanë se do të ngrinin çështjet kryesore vijuese:

- Sigurimi i pjesëmarrjes domethënëse të grave në vendimmarrje në lidhje me negociatat dhe Dialogun, si përmes pjesëmarrjes në ekipet zyrtare të negociatave ashtu edhe përmes konsultimeve publike. Angazhimi i grave të ndryshme, përfshirë gratë me aftësi të ndryshme dhe vajzat.
- Adresimi brenda Dialogut i nevojave të ngritura nga gra të ndryshme gjatë këtyre konsultimeve.
- Kërkesa që Serbia të njohë publikisht dhe të kërkojë falje për krimet dhe dhunën e kryer ndaj civilëve nga shteti.
- Sigurimi i kthimit të personave të zhdukur të të gjitha etnive.
- Ndjekja penale e të gjithë personave që kanë kryer krime lufte, përfshirë dhunën seksuale të kryer gjatë luftës, duke siguruar kështu drejtësi.
- Sigurimi i kompensimit dhe dëmshpërblimit për shkatërrimin e jetesës së civilëve,
- Për njerëzit në Kosovë, kthimi i pensioneve të tyre.
- Sqarimi se cilat ligje duhen respektuar, posaçërisht për serbët në Kosovë.
- Zgjidhja e çështjeve në lidhje me lirinë e lëvizjes, përfshirë ato që lidhen me llojin e ndryshëm të pasaportave të lëshuara për serbët në Kosovë.
- Sigurimi i mbrojtjes për të gjitha vendet e trashëgimisë kulturore, mediat dhe fetë, duke përfshirë xhamitë, manastiret, kishat dhe varrezat.

[505] Kvinna till Kvinna, "Negociatat midis Beogradit dhe Prishtinës nga perspektiva e grave", 2018

Për më tepër, disa gra shqiptare gjithashtu kërkuan që Dialogu të përpiqet të sigurojë që shqiptarët që jetojnë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc në Serbi të kenë të njëjtat të drejta si serbët që jetojnë në Kosovë. Të intervistuarat kishin tendencë të deklarojnë se adresimi i çështjeve të lartpërmendura ishte mënyra e vetme për të vendosur një paqe të qëndrueshme në Kosovë dhe në rajon, duke i përfshirë gratë.

## Konkluzion

Siç ilustrojnë gjetjet në këtë kapitull, gratë, përfshirë edhe vajzat, kanë dhënë disa kontribute për paqen dhe sigurinë në Kosovë. Gjatë konfliktit dhe luftës, gratë kontribuan për paqen dhe sigurinë në lidhje me politikën, arsimin, kujdesin shëndetësor, paqen përtej kufijve, dokumentimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut, demonstrata paqësore, diplomacinë dhe organizimin e sigurisë për personat e zhvendosur dhe refugjatët.

Pas luftës, rolet dhe kontributet e tyre paraprake u harruan kryesisht, pasi vendimmarrësit ndërkombëtarë dhe vendorë, i zhvendosën gratë në role tradicionale gjinore. Sidoqoftë, gratë rezistuan dhe vazhduan të kontribuojnë për paqen dhe sigurinë pas luftës përmes ndërtimit të paqes ndëretnike, rrjeteve, sigurimit të sigurisë njerëzore, sektorit të sigurisë dhe politikës. Ndërsa gratë që janë larguar kryesisht nga negociatat dhe Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ato kanë bërë të dëgjohen zërat e tyre përmes dialogëve alternative ndëretnike, demonstratave publike, letrave zyrtare dhe njoftimeve për shtyp. Gratë, përfshirë edhe vajzat, kanë identifikuar disa nga nevojat dhe pritjet e tyre kryesore nga Dialogu Kosovë-Serbi, të përmbledhura këtu dhe të pasqyruara në rekomandime.

# Kapitulli III. Sfidat për përfshirjen e grave në proceset e paqes

Përkundër miratimit të RKSKB 1325 dy dekada më parë, dhe rezolutave pasuese për GPS, gratë vazhdojnë të jenë në pjesën dërmuese të përjashtuara nga proceset e bërjes së paqes dhe të ndërtimit të paqes. Në nivel global, gratë kanë hasur në disa pengesa për të marrë pjesë në proceset e paqes, duke përfshirë patriarkalizmin, vullnetin e dobët politik, llogaridhënien e dobët ndërkombëtare, agjendat që nuk përfshijnë nevojat e grave, dhunën me bazë gjinore dhe proceset e ndërtimit të shtetit që nuk kanë një qasje të ndjeshme gjinore ose vëmendje ndaj çështjeve që lidhen me sigurinë.[506] Pabarazitë strukturore me të cilat përballen gratë në shoqëritë në konflikt dhe pas luftës mund të minojnë pjesëmarrjen e tyre në jetën publike dhe rrjedhimisht edhe në proceset e ndërtimit të paqes.[507] Për shembull, pasiguritë financiare mund t'i vendosin gratë në disavantazh sepse ato nuk kanë mjete për të udhëtuar për takime politike, duhet të punojnë në vend që të marrin pjesë. Mungesa e pjesëmarrjes së grave, nga ana tjetër, mund të kontribuojë në margjinalizimin dhe varfërinë e mëtejshme, sepse prioritetet dhe nevojat e tyre nuk përfaqësohen në proceset e politikëbërjes.[508]

Ky kapitull i përgjigjet pyetjes së nën-hulumtimit: cilat kanë qenë sfidat e përfshirjes së grave (të reja) në proceset e paqes dhe sigurisë, përfshirë proceset e negociatave dhe dialogut? Sfidat kryesore që dolën nga hulumtimi si tendenca të përsëritura shtjellohen në katër pjesët në vijim: konflikti dhe kërcënimet ndëretnike; aktorët ndërkombëtarë forcojnë fillimisht pabarazitë gjinore; vazhdimi i *Odës* dhe partive politike të demokratizuara dobët; dhe patriarkalizmi.

## Konflikti dhe kërcënimet ndëretnike

Kjo pjesë shtjellon sfidën që ka paraqitur konflikti ndëretnik për pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes dhe sigurisë, veçanërisht për gratë serbe. Ndërsa gratë shqiptare përgjithësisht kishin një histori të organizimit politik të pranuar nga shoqëria gjatë viteve të 1990-ta, gratë serbe prireshin që të mos kishin përvoja të tilla në angazhimin politik. Në vend të kësaj, shoqëria përgjithësisht prirej të zhgënjehej nga pjesëmarrja e tyre politike, treguan pjesëmarrëset në hulumtim. Sipas normave tradicionale shoqërore, "vendi" i grave ishte sfera private. Norma të tilla tradicionale gjinore ishin të ndërlidhura me konfliktin ndëretnik në atë që grave serbe u thuhej se nuk kishte "siguri" që ato të angazhoheshin publikisht dhe se ato duhej të qëndronin në shtëpi, për sigurinë e tyre dhe të fëmijëve të tyre.[509] Në këtë mënyrë, konflikti ndëretnik kryqëzohej me normat tradicionale gjinore për të minuar pjesëmarrjen e grave serbe në proceset e vendimmarrjes ose paqes gjatë viteve të 1990-ta.

Pas luftës, pasiguritë vazhduan dhe, në disa raste, u përkeqësuan. Siç kujtoi një aktiviste serbe për të drejtat e grave:

> Pas vitit '99-të, gratë mbetën të izoluara. Serbët në atë kohë jetonin në enklava. Nuk kishte qasje në shërbime dhe kishte një rritje të ndjeshme të aktiviteteve kriminale. Prandaj, gratë qëndruan të përqendruara në shtëpi me fëmijët, si dhe në arsim dhe shëndetësi, pasi në atë kohë nuk kishte shërbime të tilla [pub-

[506] Kvinna till Kvinna, *E drejtë, jo dhuratë*, 2020, f. 33-36.

[507] Ibid., f. 27.

[508] Ibid., f. 41.

[509] Intervistë e RrGK-së, 2020.

like]. Burrat ishin ata që ishin përgjegjës për politikën. Gratë gjithashtu nuk kishin kontakte me gratë nga komunitetet e tjera [etnike]. Pra, ato nuk mund të përfshiheshin në proceset e paqes. Edhe nëse një gruaje do t'i ofrohej të shkonte në Prishtinë, ajo do të pyeste: "Pse unë e para? Pse duhet të gjykohem unë për përfshirjen në proceset e paqes nëse politikanët nuk e kanë bërë hapin e parë?"[510]

Në të vërtetë, ekzistojnë disa shembuj të grave nga Serbia që janë "gjykuar" publikisht kur ato janë përpjekur të përfshiheshin në proceset e paqes. Për shembull, pasi mbështetën deklaratën e pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, aktivistet për të drejtat e njeriut si Nataša Kandić, ndër të tjera, u përballën me kërcënime, përfshirë edhe kërcënimet nga Partia Socialiste e Serbisë[511]. Policia kundër terroristëve e Ministrisë së Brendshme i ka etiketuar Gratë në të Zeza si "anti-serbe" [512]. Aktivistet e Grave në të Zeza në Serbi janë përballur me kërcënime të vazhdueshme[513], janë quajtur "bushtra" kanë gjetur "mace të ngordhura të varura në dorezat e dyerve të tyre" dhe kanë hasur në "burra të panjohur me shkopinj dhe bomba tymi" në dyert e zyrave të tyre, sipas një interviste për Telegraf-in[514]. Sipas njoftimit të "Amnesty International" të paraqitur në Komitetin e KB kundër Torturës në vitin 2015, thirrjet e medieve sociale nga grupet djathtiste bënin thirrje për linçime, protesta, fyerje dhe sulme ndaj Grave në të Zeza.[515]

Në vitin 2020, portalet e medieve serbe në internet *Prismotra* dhe *Istraga* publikuan informacione të papërshtatshme private në lidhje me gratë gazetare, duke deklaruar se ato "kanë bërë filma kundër Serbisë",[516] dhe "e kanë turpëruar Serbinë", duke aluduar në angazhimin e tyre në një film me titull "*Shqiptaret janë motrat tona*".[517] Gjithashtu në vitin 2020, gjatë një gjykimi kundër tij, kryeredaktori i *Informer*, Dragan J. Vu Vičević, "sulmoi" dhe "ofendoi" një aktiviste të Nismës Rinore për të Drejtat e Njeriut, Anita Mitić, duke deklaruar se ajo ishte një lavire "Šiptare"[518] dhe ishte paguar nga "vrasësit e serbëve".[519]

Në shtator 2020, një aktivist nga Sandglass, një organizatë e grave për paqen dhe të drejtat e grave në Serbinë jugore, që bashkëpunon me gratë shqiptare të Kosovës, gjithashtu përjetoi dhunë. Një koktej molotovi u hodh në oborrin e saj. Policia nuk mundi ta identifikonte specifikisht motivin dhe teorikisht mund të ishte një akt i rastësishëm dhune. Sidoqoftë, aktivistja e prekur beson se ka të ngjarë të motivohej nga fakti që autori i krimit e dinte se kush jetonte atje, ku punonte ajo dhe çka punonte ajo, punë kjo që përfshinte bashkëpunimin me shqiptarët e Kosovës.[520]

---

[510] Intervistë e RrGK me një grua serbe, Prishtinë, 2020.

[511] Amnesty International, "Thirrje për qetësi gjatë tubimeve të serbëve", 2008.

[512] Dragojlo, S., ' "Kërcënimet e inspiruara" nga Policët e Serbisë ndaj Grave të Paqes", BIRN, 2016. Artikulli citon aktivisten Violeta Djikanović e cila tregoi që organizata ishte përballur me kërcënime të tilla që prej themelimit në vitin 1993.

[513] Për informacione të mëtejshme në lidhje me sulmet ndaj Grave në të Zeza, shihni dosjet e tyre. Në vitin 2014, RrGK-ja dërgoi një letër duke i bërë thirrje Qeverisë së Serbisë që "menjëherë të dënojë publikisht ngacmimin, gjuhën e urrejtjes dhe dhunën që shënjestron aktivistet gra të paqes (RrGK, Letra e mbështetjes për aktivistet në Serbi, 2014).

[514] Telegraf, ["GRATË NË TË ZEZA: Ata na quajnë bushtra, ata kërcënojnë se do të na therin!"] "*ŽENE U CRNOM: Nazivaju nas kurvama, prete da će nas zaklati!*", 2014.

[515] Amnesty International, "Serbia: Parashtresa në Komitetin e KB kundër Torturës", 2015, f. 43-45.

[516] Građanske Inicijative, ["Tri Liritë nën lupë. Shqyrtimi i rasteve të shkeljes së lirive të asociimit, Kuvendi dhe shprehjes në Serbi 16-28 shkurt 2020"] *Tri Slobode Pod Lupom: Prikaz Slučajeva Kršenja Sloboda Udruživanja , Okupljanja i Izražavanja u Srbiji 16-28. Februar 2020. Godine* [në serbisht], cituar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, *Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor*, 2020, f. 83-84.

[517] Popović, D., et al., ["Shoqatat e qytetarëve: ngushtimi i hapësirës për veprim"] "*Udruženje Građana: Sužavanje Prostora za Delovanje*" [në serbisht], Građanske Inicijative, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, 2020, cituar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, *Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor*, 2020, f. 83-84 .

[518] "Šiptar" është një fyerje etnike në gjuhën serbe që u referohet shqiptarëve në mënyrë nënçmuese.

[519] Direktno, ["Vučićević më tha që unë isha një lavire *Šiptare*?!"] "*Vučićević mi govorio da sam šiptarska kurva?!*", 2 qershor 2020 [në serbisht], cituar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, *Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor*, 2020, f. 84

[520] Korrespondenca me email e RrGK-së me Snežana Jakovljević nga Sandglass, 2021.

Në përgjithësi, Komiteti i Helsinkit në Serbi ka vërejtur se tema "Kosova" krijon frikë që shkakton krijimin e "armiqve të brendshëm", që e legjitimon në aspektin social poshtërimin dhe dhunën[521]. Kërcënimet e publikuara, dhuna dhe turpërimi publik i aktivistëve që bashkëpunojnë me shqiptarët, siç janë incidentet e lartpërmendura, ndër të tjera, potencialisht kanë ngjallur frikë te aktivistët e mundshëm dhe i kanë dekurajuar gratë serbe që të mos rrezikojnë të bashkëpunojnë me gratë shqiptare drejt paqes. Disa gra serbe në Kosovë gjithashtu janë përballur me kërcënime për bashkëpunimin e tyre me shqiptarët.[522]

Duke pasur parasysh presionin shoqëror kundër bashkëpunimit me shqiptarët e Kosovës, veçanërisht menjëherë pas luftës, gratë serbe të Kosovës duhej të ishin të kujdesshme për mënyrën e angazhimit.[523] Në fillim, ato nuk mund të bashkëpunonin drejtpërdrejt me aktivistet shqiptare për të drejtat e grave. Prandaj, aktivistet serbe në Kosovë fillimisht prireshin të përqendroheshin në takimin e grave të izoluara në fshatra të ndryshme, në shpërndarjen e ndihmave dhe organizimin e tubimeve më të vogla që mund të kalonin pa u vërejtur. Gratë serbe të Kosovës filluan të kërkojnë mënyra për të përmbushur nevojat themelore të familjeve të tyre dhe për të mbështetur gratë dhe familjet e tjera në komunitetet e tyre me ushqim, strehim, shërbime të kujdesit shëndetësor dhe arsim. Në të vërtetë, ngjashëm me punën e grave shqiptare në vitet e 1990-ta, fakti që ato ishin gra që bënin "gjërat e grave", të tilla si shpërndarja e ndihmave humanitare, mbase e bëri punën e tyre jo kërcënuese për kritika të mundshme. Ato mbanin një profil të ulët dhe përmbaheshin nga përfshirja e drejtpërdrejt në politikë, e cila, siç deklaruan ato, ishte e kontrolluar nga burrat.[524]

Ndërsa disa gra serbe filluan krijimin e një bashkëpunimi me gratë shqiptare, siç u përshkrua më parë,[525] kjo ishte veçanërisht e vështirë për gratë aktiviste serbe që jetonin në veri, të cilat duket se janë përballur me një presion më të fuqishëm shoqëror kundër një bashkëpunimi të tillë. Për shkak të kërcënimeve nga vetë komunitetet e tyre, ato nuk mund të bashkëpunonin lehtë me shqiptarët. Për shembull, disa thanë se nuk mund të bëhen anëtare zyrtare të Rrjetit të Grave të Kosovës, për shkak të emrit të tij, që mund të keqinterpretohet si njohje prej tyre e shtetit të Kosovës dhe të çojë në kërcënime ose dhunë.[526] Kjo u rrit pas "ngjarjeve të marsit 2004".[527] Më pas, pak serbë ishin të gatshëm të bashkëpunonin me shqiptarët. Mrekullisht, disa gra të guximshme serbe krijuan aleanca, zakonisht kur kishin mbështetje nga familjet e tyre, siç u diskutua në seksionin paraprak për bashkëpunimin ndëretnik. Për të tjerat, rehabilitimi kërkoi kohë dhe vetëm pasi situata u bë më e qëndrueshme disa organizata serbe për të drejtat e grave filluan të bashkëpunonin me shqiptarët; disa nga veriu i Kosovës madje u bënë edhe anëtare të RrGK-së në vitin 2020.

Një sfidë tjetër në lidhje me konfliktin ndëretnik, sipas aktivisteve, ishte se menjëherë pas luftës disa punonjës të UNMIK-ut dhe OSBE-së u thanë grave që të mos bashkëpunonin me njëra-tjetrën, veçanërisht në Mitrovicën e Veriut dhe të Jugut/Mitrovicë.[528] Siç kujton Igballe Rogova:

> Personeli i CBM-së ishin të gjithë të rinj dhe ata bënin shumë gjëra në nivelin lokal. Pas luftës, UNMIK-u dhe OSBE-ja u thanë atyre: "Ju nuk mund ta bëni këtë!" UNMIK u tha "Ju nuk mund të punoni me Mitrovicën e Veriut". Por ata vazhduan atë sepse besuan në punën e tyre, pra ata po lidheshin me të rinjtë serbë atje.

---

[521] Helsinške SVESKE, ["Drejt ndërtimit të një Kosove të qëndrueshme"] "*Ka izgradnji održivog kosovskog društva*", [në serbisht] 2007, f. 27.

[522] Intervistat dhe vëzhgimet e RRGK-së bazuar në përvojat e drejtpërdrejta me gratë aktiviste serbe.

[523] Intervistat e RrGK-së me aktiviste për të drejtat e grave.

[524] Intervistat e RrGK-së me aktiviste serbe për të drejtat e grave.

[525] Shikoni pjesën për "Kontributet e grave në ndërtimin e paqes ndëretnike".

[526] Vëzhgimi i pjesëmarrësve nga RrGK dhe diskutime me gratë aktiviste serbe.

[527] Për informata të mëtejshme, shihni seksionin "Kontributet e grave në ndërtimin e paqes ndëretnike".

[528] Bisedat e RrGK-së me aktiviste.

> … organizatat nuk po e dëgjonin UNMIK-un dhe OSBE-në, që thoshin "Jo, kjo nuk është zona juaj". .... Për mua kjo është e guximshme.[529]

Ajo shpjegoi se organizatat dhe aktivistet për të drejtat e grave "nuk iu bindën" rekomandimeve të UNMIK-ut dhe të OSBE-së, edhe pse në disa raste si rezultat i mosbindjes së tyre, organizatave u mungonin burimet ose e vinin veten në rrezik duke udhëtuar pa automjete të mbrojtura menjëherë pas luftës.

Gjatë grupeve të fokusit, vajzat reflektuan mbi sfidat dhe mundësitë për t'u angazhuar në ndërtimin e paqes sot. Për shembull, gratë e reja serbe deklaruan: "Ne u kemi bërë gjëra të këqija atyre [shqiptarëve], por edhe ata na kanë bërë gjëra ne në 20 vitet e fundit"; "Unë e di se çfarë më thanë prindërit e mi për luftën"; dhe "Unë nuk ndihem i sigurt të shëtis me familjen time në qendër të Prishtinës dhe të flas lirisht serbisht." Vajzat shqiptare, veçanërisht ato nga rajonet multietnike, deklaruan: "Ata [serbët] na konsiderojnë si armik; ata nuk e pranojnë që ata ishin agresori"; "Nëse diçka i ndodh një serbi të gjithë alarmohen, por nëse e njëjta gjë i ndodh një shqiptari, askush nuk e konsideron atë si një çështje të rëndësishme." Megjithëse vajzat e ditëve të sotme nuk e kanë përjetuar personalisht luftën, perceptimet e tyre dhe rrjedhimisht aftësitë për të bërë paqe me gjasë janë dëmtuar nga vlerat dhe besimet ndaj të cilave ato janë ekspozuar në shtëpi, përmes medieve dhe në komunitetet e tyre.

Vajzat serbe gjithashtu vënë në pah se shkeljet e të drejtave të tyre gjuhësore pengonin pjesëmarrjen e tyre në proceset politike. "Kur shkojmë në ndonjë ministri në Prishtinë, të gjitha etiketat në dyer janë vetëm në shqip. Kështu që unë trokas në çdo derë deri sa përfundimisht të arrij te ajo e duhura", tha një grua e re. Kjo dhe deklarata të tjera treguan se vajzat serbe nuk ndiheshin të përfshira ose nuk kishin qasje në organet politike, gjë që i kanë dekurajuar të kërkonin të angazhoheshin në procese politike, përfshirë ato në lidhje me ndërtimin e paqes.

Megjithatë, gjatë grupeve të fokusit me vajza u shfaq një model i dukshëm i pranimit të diversitetit dhe jetës në një mjedis multikulturor. Qëndrime të tilla u shprehën përmes deklaratave si: "Ne kalojmë mirë kur jemi bashkë"; "ne luajmë së bashku në fshat"; "ne i kemi kapërcyer barrierat e të jesh serb apo shqiptar"; "për mua e vetmja barrierë është gjuha"; dhe "unë mendoj se ne (vajzat nga komuniteti serb dhe ai shqiptar) duhet të organizojmë një protestë së bashku". Këto deklarata, bazuar në përvojat dhe mendimet e tyre, sugjerojnë se ekzistojnë mundësi për bashkëpunim ndëretnik në ndërtimin e paqes, veçanërisht në mesin e vajzave.

Si përfundim, presioni shoqëror kundër bashkëpunimit me shqiptarët duket se i ka dekurajuar shumë gra serbe nga përfshirja në proceset e paqes si para ashtu edhe pas luftës. Gratë që bashkëpunuan nganjëherë janë përballur me mbulim negativ të medieve dhe medieve sociale, të cilat kontribuuan në kërcënime dhe dhunë. Kjo potencialisht i dekurajoi gratë e tjera serbe nga përfshirja në proceset e paqes ku përfshihet bashkëpunimi me shqiptarët. Ndërsa perceptimet dhe përvojat e grave të reja reflektojnë familjet dhe komunitetet e tyre, një trend i përsëritur në mesin e vajzave ishte interesi i tyre i përbashkët, veçanërisht në angazhimin më të madh në proceset e paqes.

## Aktorët ndërkombëtarë fillimisht forcojnë pabarazitë gjinore

Kjo pjesë shtjellon sfidat me të cilat ballafaqoheshin gratë gjatë angazhimit të tyre në proceset e paqes dhe sigurisë për shkak të qasjes fillestare të UNMIK-ut për qeverisjen e Kosovës, përmes së cilës UNMIK-u i përforcoi rolet tradicionale gjinore në vend se t'i sfidonte ato. Pas luftës, Rezoluta RKSKB i siguroi UNMIK-ut përgjegjësinë për administrimin e Kosovës derisa të vendosej statusi i saj politik. Si bartës i detyrës, roli dhe detyrimi i KB përfshinte sigurimin e zbatimit të RKSKB 1325.

Duke pasur parasysh që Kombet e Bashkuara operonin me UNMIK-un, aktivistet për të drejtat e grave dhe

[529] Intervistë e RrGK-së, 2020.

politikanët ishin optimistë se UNMIK-u do të përdorte fuqinë e tij për të rritur rolin e grave në proceset e vendimmarrjes, përfshirë në ato që lidhen me paqen dhe sigurinë, sipas RKSKB 1325.[530] "Ne e përshëndetëm me gëzim vendimin që e vendosi Kosovën nën një administratë të OKB-së", kujton Igballe Rogova. Veprore Shehu komentoi në mënyrë të ngjashme:

> Kur erdhën ndërkombëtarët, mendova se ata nuk do të kishin qëndrimet shoqërore dhe stereotipet që ne i kemi këtu për gratë. Kam pasur shumë shpresa dhe pritje. Ka pasur arritje, por shpresat dhe pritjet që i kisha nuk u përmbushën.[531]

Shpresat fillestare të aktivisteve u zhdukën shpejt. Në vend që të mbështeste angazhimin e grave në proceset e paqes, Igballe Rogova tha se PSSP i parë i OKB-së Bernard Kouchner "i shikonte gratë si objekte".[532] Sipas këndvështrimit të saj, aktorët ndërkombëtarë prireshin t'i homogjenizonin gratë vetëm si viktima, duke injoruar rolin e tyre si agjente të ndryshimit. Aktivistja për të drejtat e njeriut Sevdije Ahmeti në mënyrë të ngjashme kujtoi: "Komuniteti ndërkombëtar donte të thoshte dhe tha se nuk kishte asnjë lëvizje feministe këtu; këtu nuk kishte lëvizje për të drejtat e grave; gratë nuk ishin të artikuluara sipas tyre. Ne ishim gra memece, analfabete".[533] Siç tha Igballe Rogova për QKSGJ-në:

> Në vend që të përkushtonim të gjithë energjinë tonë për të ndihmuar gratë dhe familjet e tyre të rindërtonin jetën e shkatërruar nga lufta, ne përpiqeshim të luftonim për t'u dëgjuar dhe për t'i thënë UNMIK-ut se ne e dinim se çfarë ishte më e mira për ne, se gratë në Kosovë nuk ishin vetëm viktima që prisnin të ndihmoheshin - ato mund ta ndihmonin veten e tyre, siç kishin bërë në të kaluarën, dhe ato mund të ishin aktorët kryesorë dhe efektivë në ndërtimin e së ardhmes së tyre.[534]

Duke u mbështetur në shembullin e Kosovës, ndër vendet e tjera, Jill Benderly në mënyrë të ngjashme vuri re se në kohë krizash politike: "Gratë shihen si viktima që kanë nevojë për shpëtim dhe ndihmë humanitare, jo si udhëheqëse të shoqërisë civile, negociatore të paqes ose vendimmarrëse politike të cilat mund të sjellin forcë dhe përvojë në tryezën e paqes".[535]

Aktivistet e të drejtave të grave në Kosovë rikujtuan aktorët ndërkombëtarë që deklaronin shpesh dhe publikisht: "Kjo është një shoqëri patriarkale". Aktivistet mendojnë se deklaratat e tilla jo vetëm që e përforcuan patriarkalizmin, por gjithashtu u përdorën nga aktorët ndërkombëtarë, përfshirë përfaqësuesit e UNMIK-ut, për të arsyetuar zgjedhjet e tyre për të anashkaluar gratë në proceset e vendimmarrjes.[536] Aktivistet deklaruan se për shkak të pikëpamjeve të tilla, UNMIK-u nuk i kishte përfshirë gratë në pozicione ose procese vendimmarrëse menjëherë pas luftës.

Kur PSSP-ja i UNMIK-ut caktoi Këshillin e Përbashkët të Përkohshëm Administrativ për ta këshilluar atë, ai zgjodhi udhëheqës politikë të caktuar meshkuj të cilët ishin përfshirë në konflikt, në rezistencën paqësore dhe në negociata në Rambuje: Ibrahim Rugovën, Kryetar i LDK-së dhe President i Kosovës i zgjedhur paralelisht para

---

530 Intervistë e RrGK-së me Igballe Rogova, 2020; RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, f. 19-20.

531 RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*, f. 19-20.

532 Më shumë në *Fakte dhe Fabula* , f. 19-20.

533 *QKSGJ*, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 184

534 Ibid.

535 Benderly, Jill, "Vendi i grave është në tryezën e paqes", *SAIS Review* , Vëllimi 20, Numër 2, Verë-Vjeshtë 2000, f. 79-83. Shih gjithashtu Kapitullin I.

536 RrGK, *1325 Fakte dhe Fabula*. Ky libër përmban shembuj shtesë të grave që nuk ishin përfshirë në procese të ndryshme vendimmarrëse të pasluftës.

luftës; Hashim Thaçin, udhëheqës i UÇK-së; dhe Rexhep Qosjen, themelues dhe kryetar i Forumit të Intelektualëve Shqiptarë.[537] Rada Trajković u caktua në Këshill në emër të Këshillit Kombëtar Serb (SNC), por vetëm në një rol vëzhgues.[538]

> "Ishte një tendencë e UNMIK-ut në atë kohë, në emër të stabilitetit, të flisnin me udhëheqës të veçantë [meshkuj] vetëm sepse ata kishin ndikim për ta mbajtur Kosovën nën kontroll. Demokracia gjatë asaj kohe u flijua, dhe kjo vazhdon edhe sot."
>
> **Aktiviste grua shqiptare, Prishtinë**

Duke i zgjedhur dhe vendosur ata në pozicione të pushtetit, UNMIK-u legjitimoi më tej pozitat e këtyre burrave si udhëheqës politikë. Pjesëmarrja në këtë Këshill, si organi i parë qeverisës i Kosovës, gjithashtu u siguroi atyre rritje të dukshmërisë publike, thanë aktivistet. Pa të njëjtën hapësirë politike dhe dukshmërisë, gratë udhëheqëse politike duhej të luftonin, më shumë sesa burrat, për të demonstruar aftësitë e tyre si udhëheqëse politike para votuesve. Edhe pse UNMIK-u ka ndërmarrë disa hapa drejt avancimit të barazisë gjinore që nga periudha e menjëhershme e pasluftës,[539] trashëgimia e kësaj përzgjedhjeje të udhëheqësve politikë menjëherë pas luftës vazhdon të ketë pasoja për udhëheqjen e grave në Kosovë edhe sot siç thanëgratë aktiviste dhe politikane, pasi të njëjtit persona dhe parti që u vendosën në pozicionet e pushtetit në vitin 1999 mbetën në pushtet për gati dy dekada. Gratë e veçanërisht vajzat kanë luftuar për të siguruar një vend në tryezë.

Si përfundim, qasja e UNMIK-ut menjëherë pas luftës në emërimin dhe promovimin e burrave udhëheqës dhe jo e grave udhëheqëse ishte ndër sfidat kryesore për pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes, sipas pjesëmarrëseve në hulumtim. Megjithëse qasja e UNMIK-ut kishte ndryshuar me kalimin e kohës, emërimet fillestare e bënë një ndryshim; UNMIK-u fillimisht nuk u dha grave një vend në tryezë dhe kjo ka kontribuar në mungesën e fuqisë politike të tyre edhe sot, sugjerojnë intervistat.

## Vazhdimi i partive politike të odës dhe të demokratizuara dobët

Në këtë pjesë shtjellohen sfidat me të cilat ballafaqohen gratë gjatë pjesëmarrjes së tyre në proceset e paqes dhe sigurisë për shkak të *Odës* dhe demokratizimit të dobët të partive politike. Në kulturën tradicionale shqiptare, ekziston një dhomë brenda një shtëpie që quhet "*Oda e Burrave*" ose "Dhoma e Burrave". Kjo ishte një dhomë e rezervuar vetëm për burrat, përveç hyrjeve dhe daljeve të shpejta e sporadik të grave për të shërbyer çaj, kafe, raki dhe/ose ushqim. Në Odë, burrat diskututonin situatën politike, ekonominë dhe çështje të tjera. Aty janë marrë vendime që kanë ndikuar në jetën e familjeve dhe komuniteteve të tyre.[540]

> "E gjithë ajo që kemi parë në qeveri përbëhet nga biseda të stilit të odës. Diçka duhet të ndryshojë."
>
> **Aktiviste grua shqiptare, Prishtinë**

Pjesëmarrëseve të hulumtimit partitë politike iu ngjasojnë me vazhdimin e Odës. Në 20 vitet e fundit, pak gra, nëse ka ndonjë, janë ulur në mesin e udhëheqjes së partive kryesore politike të Kosovës. Udhëheqja e partisë merr vendimet kryesore në lidhje me qasjen e partisë ndaj çështjeve të ndryshme të politikave. Pastaj,

[537] QKSGJ, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 187. Ata i mbanin ato pozita para vitit 1999 (Clark, f. 222).

[538] *QKSGJ*, *Histori është edhe tregimi i saj*, f. 187

[539] Për disa shembuj, shih seksionet e tjera të këtij publikimi dhe publikimin *Fakte dhe fabula për Rezolutën 1325* të RrGK-së, botimi i dytë (i ardhshëm, 2021).

[540] Gëzim Krasniqi, "Socializmi, Utopia Kombëtare dhe Muzika Rok: Brenda Rok-Skenës Shqiptare të Jugosllavisë, 1970–1989", *Evropa Qendrore Lindore,* 2011.

këto vendime barten dhe futen në politikën e Kosovës, ku partitë politike kanë një peshë të konsiderueshme. Me përfaqësimin e pak pikëpamjeve të grave, partitë janë të prirura të përqendrohen në çështje që janë prioritete për burrat, por jo domosdoshmërish për gratë. Për më tepër, me përjashtimin në masë të madhe të grave nga vendimmarrja brenda partive politike, atyre iu është dëgjuar zëri shumë pak në lidhje me proceset e paqes.

Megjithëse disa gra politikane kanë punuar brenda partive të tyre për të bindur kolegët e tyre se gratë mund të jenë udhëheqëse të afta, gratë kanë mbetur të nënpërfaqësuara brenda udhëheqjes së partisë. Siç deklaroi politikania Aida Dërguti:

> Elitat politike të mbizotëruara nga meshkujt nuk e kanë as vullnetin dhe as interesin për ta rritur numrin e grave në vendimmarrje. Dëshmia më e mirë për këtë janë listat zgjedhore ku gratë përbëjnë vetëm 30% të listës, aq sa minimumi i përcaktuar me ligj.[541]

Megjithëse partitë politike mund të sigurojnë përfshirje të barabartë të grave dhe burrave, veçanërisht në përputhje me LBGJ-në, ata kanë zgjedhur të mos e bëjnë këtë.

Në përgjithësi, përkundër kuotës zgjedhore, kërkesave të LBGJ-së për pjesëmarrje të barabartë, disa përpjekjeve dhe njëfarëlloj përparimi,[542] pjesëmarrja e grave në politikë në Kosovë ka mbetur minimale në krahasim me pjesëmarrjen e burrave. Sipas Raportit të Komisionit Evropian të vitit 2020 për Kosovën, "gratë mbeten të nënpërfaqësuara në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes në partitë politike, administratën zgjedhore dhe kuvendin qendror dhe ato lokale".[543] Për më tepër, burrat kanë mbajtur pozitat më të larta udhëheqëse të qeverisjes si në nivelin komunal ashtu edhe në atë kombëtar.[544]

> "Ekzistojnë sfida; ne jemi shtatë gra në udhëheqjen e partisë. … Meqenëse minimumi është 30%, ne megjithatë duhet të synojmë më shumë. Ne duhet të bëjmë presion brenda partisë për t'i detyruar ata [burrat] t'iu besojnë më shumë grave".
>
> **Grua shqiptare, politikane, Prishtinë**

Pjesëmarrëset në hulumtim prireshin të pajtoheshin që nënpërfaqësimi i grave në politikë rrjedh nga demokratizimi i dobët i partive politike, mungesa e një perspektive gjinore brenda strukturave të partive politike dhe mosgatishmëria e udhëheqësve politikë për të përfshirë më shumë gra në vendimmarrje. Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën në vitin 2020, gratë kandidate në zgjedhjet e vitit 2019 "nuk morën mbështetje të barabartë financiare ose logjistike nga subjektet e tyre politike për fushatat e tyre dhe ato rrallë flisnin në tubime. Për më tepër, media u dha hapësirë me përparësi kandidatëve meshkuj".[545] Qasja e pabarabartë në financimin e partive dhe hapësira në medie minuan gjasat e grave për t'u zgjedhur.

> "Gratë [në politikë] janë zakonisht kukulla, pas të cilave zakonisht qëndrojnë burrat e partisë."
>
> **Vajzë serbe**

Nënpërfaqësimi i përgjithshëm i grave në poli-

[541] Intervista e RrGK-së me Aida Dërgutin, Prishtinë, 2020.

[542] Shih seksionin paraprak të kapitullit për "Kontributet e grave në paqe dhe siguri përmes politikës".

[543] Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2020, f. 9.

[544] Shih RrGK, *Analiza Gjinore e Kosovës*, 2018. Kosova ka pasur vetëm një grua kryetare të komunës, Mimoza Kusari-Lila, e cila shërbeu si kryetare e Komunës së Gjakovës nga viti 2013 deri në vitin 2017. Tetë gra kanë garuar për këtë post në zgjedhjet e fundit komunale, duke përbërë 4% të kandidatëve për kryetar komune (të dhëna nga Komisioni Zgjedhor, 2017). Vetëm tri komuna kanë zbatuar kërkesat e LBGJ-së për emërimin e barabartë të grave dhe burrave si drejtorë të drejtorive: Drenasi, Kamenica dhe Kllokoti (Ministria e Qeverisjes Lokale, *Raporti për të drejtat e njeriut në komunat, janar - qershor 2020*, 2020).

[545] Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën 2020*, f. 9.

“Fuqizimi i grave në politikë duhet të fillojë tek partitë politike. Në negociata ne shohim udhëheqës të partive politike që janë kryesisht burra. Duhet bërë më shumë për të fuqizuar gratë në partitë politike. Unë besoj fort në potencialin e grave të reja, dhe ato duhet të fuqizohen. Ato po japin kontribute të vlefshme brenda partive të tyre politike, por kjo nuk reflektohet në publik.

Media luan një rol të rëndësishëm: i bën gratë të dukshme, dhe unë gjithmonë u them medieve, ‘mësoni sytë tanë të shohin më shumë gra’, veçanërisht gjatë zgjedhjeve. Ato duhet të bllokojnë partitë politike dhe të kërkojnë që kur, për shembull, [diskutohet] për industrinë, [ato] të kërkojnë që një grua të jetë aty nga një parti e caktuar politike. Kemi mjaft gra të arsimuara edhe në këtë fushë. Dhe ato [partitë politike] nuk do të jenë në gjendje të ... thonë ‘Jo, ne kemi vetëm burra’. Ato do të ndryshonin.”

**Vlora Tuzi Nushi, Shefe e Zyrës së UN Women në Kosovë**

tikë dhe në vendimmarrje ka penguar pjesëmarrjen e tyre në proceset zyrtare të paqes dhe të vendimmarrjes. Fakti që gratë mbanin pak pozita brenda partive politike ose politikës kontribuoi në nënpërfaqësimin e grave në negociatat dhe dialogun midis Kosovës dhe Serbisë.

Në periudhën 2011-2017, prej 90 individëve të përfshirë në grupet e punës në Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, vetëm 14 ishin gra (16%) dhe 76 burra.[546] “Procesi i negociatave u drejtua nga burrat”, tha Drejtorja Ekzekutive e QKSGJ-së Luljeta Demolli.[547] “Ata nuk i lejojnë gratë të marrin pjesë në procese të tilla sepse ata [burrat] duan të jenë ata që shkruajnë historinë sepse kjo është mënyra e vetme që mund të portretizojnë veten ekskluzivisht si heronj, ndërtues të shtetit dhe paqebërës. Për shkak se burrat gjithmonë kanë pasur më shumë privilegje dhe burime nuk i lënë gratë të jenë pjesë e historisë. Në vend të kësaj, ata ftojnë miqtë e tyre burra, siç ndodhi gjatë procesit të negociatave me Serbinë”, tha ajo.[548] Disa pjesëmarrëse në hulumtim kishin perceptimin se ato pak gra që morën pjesë në negociata kishin presion nga burrat në pozita të larta në partitë e tyre politike, gjë që ndikoi në vendimet e tyre.

Në vitin 2019, delegacioni i Kosovës në BE në Bruksel, për të diskutuar normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, nuk kishte asnjë grua. Për më tepër, kjo ndodhi në një kohë kur dy nga zyrtaret më të larta të Kosovës që merreshin me BE-në ishin gra: Ministrja e Integrimit Evropian Dhurata Hoxha,[549] përgjegjëse për koordinimin e punëve të qeverisë me BE-në dhe Blerta Deliu-Kodra, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian.[550] Pas kësaj, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së e theksoi në raportin e tij të vitit 2019 për Kosovën nevojën për përfshirje më të madhe të grave në Dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, duke u kërkuar udhëheqësve politikë të marrin masa specifike për të siguruar një proces politik të përgjegjshëm gjinor.[551]

[546] Grupi Ballkanik i Hulumtimit të Politikave, *Dialogu i Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë: Arritjet dhe Sfidat,* f. 18, Prishtinë, 2020.

[547] Intervistë e RrGK-së, Prishtinë, 2020.

[548] Shkëmbim i informatave përmes postës elektronike me Luljeta Demolli, 2021

[549] Dhurata Hoxhaj dhe Albena Reshitaj ishin të vetmet gra ministre në kabinetin qeveritar me 21 anëtarë.

[550] Begisholli, B., “For Kosovo, Talking with Serbia is Men’s Work” (Për Kosovën, bisedimet me Serbinë janë punë e burrave), *Prishtina Insight*, 23 janar 2019.

[551] Këshilli i Sigurimit i KB *Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm*, qershor 2019.



© Bashkimi Evropian, 1995-2021 (Imazhi u modifikua në bardh e zi dhe është prerë nga RrGK)
Delegacioni Shtetëror i Kosovës në Bruksel takohet me Federica Mogherini, Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, më 8 janar 2019 për të diskutuar normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Ekipi përbëhej nga: Fatmir Limaj, Shpend Ahmeti, Blerim Shala, Avni Arifi, Behgjet Pacolli, Enver Hoxhaj, Mahir Yağcılar, Bernand Nikaj, Dardan Gashi, Visar Ymeri dhe Dukagjin Gorani.

Si përfundim, partitë politike në Kosovë mbeten të ngjashme me një "Odë" tradicionale, një dhomë për burra në të cilën gratë nuk kanë vend në tryezë. Mbështetja e dobët e partive politike për gratë brenda strukturave të tyre partiake, si kandidate elektorale, dhe kur emërohen zyrtarët qeveritarë ka kontribuar në nën-përfaqësimin e grave në politikë përgjithësisht. Mungesa e grave në pozicionet vendimmarrëse, pjesërisht për shkak të vendimeve të marra nga udhëheqësit politikë burra, ka kontribuar drejtpërdrejt në përfaqësimin e dobët të grave në proceset e paqes.

## Patriarkalizmi

Kjo pjesë diskuton sfidat me të cilat përballen gratë për të marrë pjesë në proceset e paqes dhe sigurisë për shkak të patriarkalizmit, një gjetje e përsëritur e hulumtimit. Lerner e ka përkufizuar patriarkalizmin si "manifestim dhe institucionalizim të dominimit mashkullor mbi gratë dhe fëmijët në familje dhe shtrirjen e dominimit mashkullor mbi gratë në shoqëri në përgjithësi. Kjo nënkupton që burrat mbajnë pushtetin në të gjitha institucionet e rëndësishme të shoqërisë dhe se gratë janë të privuara nga qasja në një pushtet të tillë."[552] Lidhur me strukturat patriarkale, Hunt dhe Posa kanë argumentuar se hezitimi për të përfshirë gratë në proceset e paqes buron nga çështje strukturore dhe psikologjike, pasi lufta konsiderohet si "punë e burrit", kështu që përfundimi i luftës duhet të jetë gjithashtu punë e tyre.[553] Kështu, supozohet se personat që përfshihen në luftë duhet t'i japin fund luftës, dhe se këta janë burrat.

Në Kosovë, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së ka identifikuar normat patriarkale dhe stereotipet si pengesa kryesore që pengojnë rolin e grave në politikë.[554] Siç ilustrohet nga pjesët e mëparshme në këtë kapitull, në fund

---

[552] Lerner, G., *The Creation of Patriarchy (Krijimi i Patriarkalizmit)*, Vol. 1, USA: Oxford University Press, 1986, p. 239.

[553] Hunt, Swanee and Posa, Cristina, "Women Waging Peace" (Gratë që bëjnë paqen), *Foreign Policy*, No. 124, 2001, f. 38-47.

[554] Grupi Punues i OJQ-së për Gratë, Paqe dhe Siguri, "Hartëzimi i Grave, Paqes dhe Sigurisë në Këshillin e Sigurimit të KB", 2019, f. 13.

“Gruaja supozohet të kujdeset për fëmijët dhe burrit  nuk i intereson nëse ata kanë kopsht fëmijësh apo jo sepse ‘vendi i gruas është në kuzhinë’ dhe të kujdeset për fëmijët.”

**Grua serbe, aktiviste, Novobërdë**

“Njerëzit nga Ballkani janë akoma shumë konservatorë; po ndryshon por jo sa duhet. Unë mendoj se si një shoqëri ballkanike [ne] po i shohim gratë si amvise. Roli i tyre është ende i diskutueshëm, ato nuk po marrin pozita të nivelit të lartë.”

**Vajzë serbe, gazetare, Leposaviq**

të fundit, pjesëmarrësit në hulumtim gjithashtu identifikuan patriarkalizmin si çështjen kryesore që mbështet nën-përfaqësimin e grave në vendimmarrje dhe në këtë mënyrë proceset e paqes. Rolet tradicionale, të socializuara gjinore kontribuojnë në homogjenizimin e grave si nëna dhe amvise, duke i zbritur ato në sferën private. Kjo sfidë shtohet për vajzat të cilat, sipas normave tradicionale të familjes, janë përgjegjëse për pjesën më të madhe të punëve të shtëpisë. Ndërkohë, mes normave të tilla shoqërore, me burrat që marrin vendime në sferën publike, pak burime shtetërore janë ndarë për shërbimet e kujdesit. Mungesa e kopshteve dhe qendrave të kujdesit për të moshuarit pengon më tej pjesëmarrjen e grave në politikë, përfshirë në proceset e paqes, sepse ato nuk kanë kohë për të marrë pjesë duke marrë parasysh rolet e tyre të papaguara si ofruese të kujdesit.[555] Për disa gra, familjet dhe komunitetet e tyre nuk e mbështesin angazhimin e tyre në jetën publike për shkak të normave të tilla gjinore.

Patriarkalizmi gjithashtu ndikon në mënyrat në të cilat portretizohen dhe shihen gratë që hyjnë në politikë. Disa pjesëmarrës në hulumtim, si gra edhe burra, reflektuan se në mënyrë që një grua të ketë sukses, ajo do të duhej të sillej “si një burrë”; përndryshe, ajo nuk do të ishte në gjendje të fitonte një vend në tryezë mes drejtuesve të partive politike.[556] Megjithatë, në të njëjtën kohë, gratë u përballën me kritika për “veprimin si burra”. Ndërsa Mimoza Kusari-Lila, ish-Zëvendës Kryeministre, ish-Ministre e Tregtisë dhe Industrisë dhe ish-Kryetare e Gjakovës reflektoi:

> Ata presin që gratë të jenë në një pozitë inferiore dhe kur një grua është e hapur, ka vetëbesim, ajo konsiderohet arrogante dhe e tepruar. Ndërsa, nëse një burrë ka të njëjtën qasje, atëherë ai konsiderohet i suksesshëm, ambicioz.[557]

“Qëllimi i grave të reja në Novobërdë ishte të martoheshin dhe të dalin jashtë Kosovës. Ato nuk kishin mbështetjen e familjeve të tyre për të kontribuar në shoqëri.”

**Grua serbe, aktiviste, Novobërdë**

Ky standard i dyfishtë, i mbështetur nga patriarkalizmi dhe normat shoqërore mbi rolet e perceptuara të grave dhe burrave në shoqëri, paraqiti sfida për gratë si në sigurimin e votave për t’u zgjedhur ashtu edhe në ndikimin e vendimeve politike sapo ato të hynin në politikë. Ndërsa ish-Presidentja Atifete Jahjaga kujtoi:

> Qasja dhe trajtimi ishin seksist që nga koha kur dhashë betimin deri sa e dorëzova mandatin. Askush nuk

[555] Intervistat e RrGK-së, 2020.

[556] Intervistat e RrGK-së me një burrë që punon në shoqërinë civile dhe një grua serbe aktiviste, 2020.

[557] Intervistë e RrGK-së me Mimoza Kusari-Lila, 2020.

> pyeti se çfarë vendimesh po merrja ose se si ai vendim do të ndikonte në jetët tona. Media u përqendrua në mënyrën se si po ecja, në flokët e mia, takat e mia, manikyrin tim ose mënyrën se si po i jepja deklaratat. Detyrat e mia ligjore dhe kushtetuese ishin punë e lehtë për mua, ndërsa 80% të kohës sime duhej të merresha me atë që të tjerët po thoshin [për mua].[558]

Normat gjinore të socializuara në lidhje me mënyrën se si gratë duhet të duken dhe të sillen në hapësirën publike i morën kohë dhe vëmendje rolit të saj si udhëheqëse politike. Stereotipet dhe seksizmi i tillë ishin tema të përsëritura midis grave politikane të intervistuara. Gjatë Javës së Grave të NDI-së në vitin 2020, Vjosa Osmani, në atë kohë u.d. Presidente, gjithashtu tha se ajo u përballë me diskriminim dhe seksizëm:

> Shumica e komenteve, veçanërisht në rrjetet sociale, kanë të bëjnë me mënyrën se si dukesh, me peshën tënde, fytyrën tënde, me faktin që je femër. Por as 10% e tyre ... nuk flasin për punën tuaj aktuale. Kështu, përqendrohuni në 10% që mund të jetë kritikë e mirëfilltë e punës sonë, sepse kjo 10% mund t'ju ndihmojë të përmirësoni punën tuaj dhe ta përqendroni atë në interesin e qytetarëve.[559]

Duke u bazuar në përvojat e veta, Mimoza Kusari-Lila tha se termat nënçmues përdoren ndaj grave në politikë, dhe gratë politikane gjykohen bazuar në gjininë e tyre, e jo në bazë të vlerave dhe kapaciteteve të tyre. Ajo reflektoi mbi sfidat që paraqesin seksizmi dhe patriarkalizmi për angazhimin e grave në politikë:

> Edhe sot stereotipet dhe paragjykimet janë shumë të zakonshme ndaj grave dhe vajzave në politikë. Kjo është shumë shqetësuese sepse jo të gjithë kanë durim dhe vullnet për të vazhduar të përfshihen pasi të kritikohen hapur dhe publikisht ... Kjo gjuhë mizogjiniste është shumë e zakonshme në Kosovë dhe në institucione në përgjithësi, duke e bërë atë një nga faktorët që pengon pjesëmarrjen e grave në politikë.[560]

Sfidat e shtuara me të cilat përballen gratë politikane *sepse ato janë gra*, si rezultat i drejtpërdrejtë i normave patriarkale, shpesh të dokumentuara mirë në media, potencialisht i dekurajojnë vajzat nga dëshira për të hyrë në politikë. Gratë që kanë arritur të bëhen udhëheqëse politike theksuan se u duhej të kapërcenin fyerjet, të punonin më shumë dhe të përpiqeshin të përqendroheshin në kritikat e punës së tyre, e jo në vëmendjen negative bazuar në gjininë e tyre.

Normat gjinore të socializuara paraqitën sfida shtesë për pjesëmarrjen e vajzave në vendimmarrje dhe në këtë mënyrë edhe në proceset e paqes. "Të moshuarit nuk e marrin seriozisht rininë", tha një grua e re serbe. Për shembull, "Ne i ftuam banorët dhe institucionet në protestë. Askush nuk u paraqit. Ata besuan se fëmijët organizuan protestën dhe [se ne] nuk do të arrijmë asgjë." Vajzat e të gjitha etnive mendonin se zërat e tyre shpesh hidheshin poshtë për shkak të moshës së tyre. Moshizmi i tillë, që përfshin pikëpamjet se vajzat janë "të reja" dhe kështu nuk kanë asgjë për të kontribuar minuan angazhimin e vajzave, thanë pjesëmarrëset e hulumtimit.

Edhe intervistat me disa aktiviste relativisht të moshuara të të drejtave të grave treguan qëndrime të tilla. Gjatë intervistave disa thanë se një person ka nevojë për pjekuri dhe njohuri që vijnë me moshën. Një e anketuar tha që gratë e moshës 15 deri 29 vjeç nuk duhet të merren me çështje serioze siç janë zgjidhja e konflikteve ose politika:

[558] Intervistë e RrGK-së, 2020.

[559] Vjosa Osmani, fjalim, Java e Grave e NDI, 2020.

[560] Intervistë e RrGK-së, Prishtinë, 2020.

Për shembull, një vajzë 15 vjeçare është fëmijë. Vajza ime është 15 vjeç, dhe ajo është një fëmijë për mua. Ajo është akoma e papjekur të lejohet nga unë të merret me aktivizëm politik. Mundohem ta përfshij atë në aktivitetet e OJQ-së me një ritëm të ngadaltë, por do të ishte e papërgjegjshme ta angazhoja në gjëra që nuk janë të përshtatshme për të. Nëse shtoni dhunën ndëretnike si një faktor, atëherë unë jam e shqetësuar edhe për sigurinë e saj. Gruaja nuk ka qenë kurrë luftëtare në komunitetin tonë. Ajo është humanitare dhe kujdeset për fëmijët.[561]

Personave krahasimisht të moshuar u mungonte kuptimi në lidhje me rolet që të rinjtë mund të luajnë në përpjekjet për ndërtimin e paqes, thanë vajzat. Norma të tilla shoqërore janë të rrënjosura thellë në shoqëri, duke filluar nga familja dhe të përforcuara në sistemin arsimor. Nga ana kulturore, familjet, institucionet dhe shoqëria e tyre hedhin poshtë mendimet e vajzave si të parëndësishme dhe jo kompetente, thanë vajzat pjesëmarrëse në hulumtime. Prandaj, rinia bëhet pa zë. Kështu, vajzat përballen me diskriminim të ndërthurur duke qenë vajza, gjë që minon pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes, përfshirë ato që lidhen me paqen. Vajza të ndryshme shprehën dëshirën e tyre për t'u përfshirë por thanë se nuk kishin mbështetje për ta bërë këtë.

Ndërkohë, një temë e përsëritur midis grave politikane të shquara ishte se ato e shihnin rolin e tyre si të rëndësishëm në "hapjen e rrugës" që gratë e tjera ta ndjekin si udhëheqëse.[562] Vjosa Osmani ka theksuar rëndësinë e grave që bëhen bashkë për të hequr pengesat e mbetura, "në mënyrë që nesër vajzat në Kosovë të mos përballen me ato me të cilat përballemi sot".[563] Solidariteti midis grave gjithashtu ka qenë një fushë kryesore përqendrimi e RrGK-së, që është përpjekur të bëjë gratë së bashku përtej kufijve të partive politike, moshës, etnive dhe kufijve të tjerë, drejt mbështetjes së njëra-tjetrës, siç u diskutua në kapitujt e mëparshëm.

Ndërkohë, patriarkalizmi gjithashtu ka penguar pjesëmarrjen e grave në sektorin e sigurisë, për sa i përket pjesëmarrjes së grave në krijimin dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Veçanërisht në fillim, gratë serbe mund të jenë përballur me sfida më të mëdha për t'u përfshirë në forcën e policisë. Sipas Rosenberg dhe Mertus, komunitetet e tyre kishin tendencë të ndjenin se duke marrë pjesë në Policinë e Kosovës, gratë dhe burrat serbë tradhtuan kombin e tyre; madje disa gra

"Stereotipet janë diçka që ata e mësojnë në sistem. Askush nuk na mëson kur hyjmë në vitin e parë të arsimit se duhet të kemi pjesëmarrje të barabartë në çdo sferë të shoqërisë, pasi nuk ka arsim të përgjegjshëm gjinor."

**Grua, përfaqësuese e OSBE-së**

"Problemi është se tani gratë e reja nuk konsiderohen vërtet se janë 'e tashmja'. Gratë e reja konsiderohen si 'e ardhmja' dhe kjo është qasja e gabuar, madje edhe ndaj çështjeve si Dialogu. ... Prandaj, kjo është arsyeja pse brezat e rinj sot thonë: 'Nuk më intereson. Askush nuk dëshiron të dijë se çfarë mendoj unë.' Sepse u thuhet se ato janë e ardhmja, dhe KJO ËSHTË E GABUAR! Në '98 -'99-tën ne nuk i thamë askujt, 'ti je e ardhmja'. Ne i thamë: 'Bashkohu me ne!'"

**Grua shqiptare, aktiviste, Prishtinë**

561 Intervistë e RrGK-së me një aktiviste serbe, Mitrovicë e Veriut, 2020.

562 Intervistat e RrGK-së me gra politikane, 2020.

563 Vjosa Osmani, fjalim, Java e Grave e NDI, 2020.

edhe u kërcënuan.[564]

Në Policinë e Kosovës, pjesëmarrja e grave ra nga 23% në vitin 1999[565] deri në 14% në vitin 2016,[566] duke u rritur në 15% në vitin 2020.[567] Përkundër disa përpjekjeve për të rritur pjesëmarrjen e grave në polici, siç është diskutuar më parë,[568] gratë police janë përballur me disa pengesa shoqërore, duke përfshirë edhe nga kolegët tjerë zyrtarë të policisë. Sipas një ish-policeje, për të fituar respektin e kolegëve të saj meshkuj, asaj iu desh të punonte tri herë më shumë sesa ata.[569] Intervistat me gratë në polici gjithashtu zbuluan se disa gra police është dashur të lënë punën e tyre kur u martuan, për shkak të normave shoqërore dhe legjislacionit jo mbështetës, siç është Rregullorja e mëparshme e UNMIK-ut për Punën.[570] Një aktiviste për të drejtat e grave reflektoi, "Gratë mund të ofrojnë siguri veçanërisht duke u përfshirë në polici, por për shkak se grave nuk u garantohen të drejta në këtë sektor ... ato nuk bashkohen".[571] Patriarkalizmi dhe rolet tradicionale gjinore të socializuara nënkuptojnë që gratë pritet të qëndrojnë në shtëpi dhe të shërbejnë si ofruese të kujdesit. Disa gra thanë se familjet e tyre ose bashkëshortët nuk i linin të punonin në institucionet e sigurisë.[572]

Në mënyrë të ngjashme, përfshirja e grave në Forcën e Sigurisë së Kosovës u pengua nga normat shoqërore që e konsiderojnë sigurinë si "punë të burrit", por edhe për shkak të mungesës së zbatimit të LBGJ. Deri në vitin 2018, gratë kishin 36 pozita në mesin e stafit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes (28%).[573] Nëntë gra shërbyen në pozitat e vendimmarrjes (7%), dhe ishin vetëm katër gra me uniformë në Ministrinë e Mbrojtjes (6% e të gjithë stafit).[574] "Ne ende nuk jemi të kënaqur me numrin e grave, i cili nuk është as afërsisht i barabartë me burrat në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në," tha Halime Morina, Shefe e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore.[575]

Në përgjithësi, përfshirja minimale e grave në vendimmarrje në lidhje me paqen dhe proceset e sigurisë ka kontribuar në mungesën e besimit në këto procese, gjë që minon më tej pjesëmarrjen e grave. Pa shpresë ose besim në proces, gratë mund të mos shohin një arsye për të marrë pjesë. Një grua e re serbe tha: "nuk ka besim se në të vërtetë mund të ndryshosh diçka nga poshtë-lart; njerëzit mendojnë se të gjitha vendimet vijnë nga nivelet më të larta". Një vajzë serbe nga Graçanica ra dakord: "Gratë nuk do ti gëzojnë kurrë të drejtat e tyre. Ishte gjithnjë ashtu dhe do të jetë gjithmonë. Nuk ekziston askund që burrat dhe gratë të kenë të njëjtat të drejta".[576] Mungesa e shpresës dhe përjashtimi nga të drejtat kësisoj gjithashtu i dekurajuan gratë nga përfshirja në proceset e vendimmarrjes ose paqes.

---

[564] Rosenberger, L. dhe Mertus, J., "When Adding Women Matters: Making Lieutenant Ahmeti" (Kur shtimi i grave ka rëndësi: Bërja e togeres Ahmeti), *Gender and Nation in South Eastern Europe*, Karl Kaser, Elisabeth Katschnig-Fasch (ed.), 2005, f. 183.

[565] Llogaritja e RrGK, duke bazuar në Greene, M., Friedman, J., and Bennet R., *Ndërtimi i Shërbimit Policor në një Vakum të Sigurisë: Përpjekjet Ndërkombëtare në Kosovë, 1999 - 2011,* p. 5.

[566] ABGJ, *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024* Plani i veprimit, f. 48.

[567] Intervistë e RrGK-së me një rreshtere në Policinë e Kosovës, Prishtinë, 2020.

[568] Shiko pjesën për "Kontributet e Grave për Sigurinë përmes Sektorit të Sigurisë".

[569] Fjalimi i një ish-policeje në konferencën, "Gratë në Polici", Prishtinë, 2020.

[570] Intervistat e RrGK-së me gra në polici, 2020. Deri në vitin 2010, pushimi i lehonisë rregullohej nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, e cila u jep të drejtën grave të punësuara me 12 javë pushim të lehonisë. Kjo e bëri të vështirë për gratë të punojnë duke pasur parasysh mungesën e mjediseve të kujdesit për fëmijët që marrin fëmijë nën një vjeç. Në vitin 2010, Ligji për Punën u miratua, duke u siguruar grave të punësuara pushim lehonie deri në 12 muaj (neni 49).

[571] Intervistë e RrGK-së me një përfaqësuese femër të OSHC.

[572] Bastick, M. "Integrating Gender in Post-Conflict Security Sector Reform" (Integrimi i gjinisë në reformën e sektorit të sigurisë pas konfliktit), 2007, f. 164.

[573] Politika për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, 2019, f. 13.

[574] Po aty.

[575] Intervistë e RrGK-së, Prishtinë, 2020.

[576] Fokus grupi i RrGK-së me vajza serbe në Graçanicë, 2020.

Si përfundim, patriarkalizmi ka kontribuar në minimin e pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarrjes dhe kështu ka penguar pjesëmarrjen e tyre në proceset e paqes. Normat gjinore të socializuara që sugjerojnë që gratë duhet të qëndrojnë në shtëpi, në sferën private dhe burrat duhet të marrin vendime, dobësojnë mbështetjen për angazhimin e grave në politikë, si nga udhëheqësit e partive politike ashtu edhe nga publiku. Këto role tradicionale gjinore përforcohen nga portretizimet mediatike të grave politikane. Portretizime të tilla mund të demoralizojnë më tej gratë, duke i dekurajuar ato të hyjnë në politikë nga frika se si media dhe shoqëria mund t'i trajtojnë ato. Vajzat përballen me sfida shtesë për t'u përfshirë në proceset e paqes për shkak të moshizmit, ashtu si gratë serbe për shkak të vazhdimit të konflikteve etnike.

## Përfundim

Përkundër disa përparimeve në zbatimin e RKSKB 1325, gratë kanë vazhduar të përballen me pengesa për pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në vendimmarrje, përfshirë në proceset e paqes. Veçanërisht në vitet e mëparshme, por disi akoma edhe sot, konfliktet e vazhdueshme midis serbëve dhe shqiptarëve kanë paraqitur një sfidë veçanërisht për gratë serbe për t'u angazhuar, pasi vendimmarrja është konsideruar "për burrat" dhe një rrezik i pasigurt, i panevojshëm për gratë. Presioni shoqëror, kërcënimet dhe sulmet me të cilat u përballen disa gra serbe kur bashkëpunuan me shqiptarët mund të kenë dekurajuar gratë e tjera serbe që të angazhohen. Në përgjithësi, për gratë e të gjitha etnive, normat tradicionale, patriarkale të mbështetura nga vendimmarrësit ndërkombëtarë, udhëheqësit e partive politike dhe shoqëria në përgjithësi homogjenizojnë gratë si viktima dhe/ose ofruese të kujdesit, duke injoruar agjencinë e grave. Këto norma shoqërore dhe rolet e socializuara gjinore të grave si ofruese të kujdesit i lënë grave pak kohë ose hapësirë për t'u përfshirë në procese politike. Për më tepër, patriarkalizmi i shpie familjet dhe komunitetet të kufizojnë angazhimin e grave në politikë përmes presionit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë shoqëror. Patriarkalizmi gjithashtu kontribuon në ndërthurjen, diskriminimin e dyfishtë për vajzat, të cilat janë lënë anash nga vendimmarrja për shkak të moshës dhe gjinisë së tyre. Këto pengesa kanë ushqyer mungesën e shpresës dhe besimit te gratë, gjë që i frenon ato më tej nga përpjekja për tu angazhuar. Sidoqoftë, vajzat e të gjitha etnive priren të shprehin interesin e tyre për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në proceset e ardhshme të paqes.

# Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme kanë dalë nga gjetjet e hulumtimit. Ato propozojnë mënyra për të siguruar paqen dhe sigurinë për gra të ndryshme, duke u bazuar në rekomandimet e vetë grave. Rekomandimet gjithashtu i përgjigjen nën-pyetjes përfundimtare të hulumtimit: si mund të përfshihen vajzat në dialog dhe negociata në të ardhmen? Megjithëse është ndoshta e pazakonshme të paraqiten gjetjet brenda pjesës së rekomandimeve, gjetjet në të vërtetë përbëjnë rekomandimet.

## Për Qeverinë e Kosovës

- Të sigurohet pjesëmarrja dhe përfaqësimi i barabartë i grave në proceset e paqes, në përputhje me CEDAW, RKSKB 1325 dhe Ligjin për Barazi Gjinore. Më konkretisht, rritja e përfaqësimit të grave në të gjitha pozitat vendimmarrëse të zgjedhura dhe të emëruara në nivelet kombëtare dhe komunale, duke zbatuar kështu përkufizimin për barazi gjinore të Ligjit për Barazi Gjinore si pjesëmarrje 50% të secilës gjini në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.
- Të krijohen mundësi që gratë, përfshirë edhe vajzat, të përfshihen në mënyrë domethënëse dhe të informojnë proceset e vendimmarrjes. Të ketë takime me vajza me etni të ndryshme për të kuptuar dhe adresuar më mirë nevojat e tyre.
- Të avancohet fokusi i qeverisë në sigurinë njerëzore, duke përfshirë investimin e më shumë burimeve shtetërore në arsim cilësor, kujdes shëndetësor, fuqizim ekonomik të grave dhe siguri për gratë në shtëpitë e tyre, në rrugë dhe në institucione.

## Për Dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë

- Të informohet më mirë publiku për procesin, për temat që do të diskutohen dhe për marrëveshjet e arritura.
- Të sigurohet pjesëmarrje domethënëse e grave në vendimmarrje në lidhje me negociatat dhe Dialogun, si përmes pjesëmarrjes së barabartë të grave në ekipet zyrtare të negociatave (një vend në tryezë) ashtu edhe përmes konsultimeve publike me gra të ndryshme dhe burra në lidhje me prioritetet e tyre për Dialogun.
- Të përfshihet të paktën një grua përfaqësuese e shoqërisë civile në të gjitha negociatat dhe dialogun e ardhshëm. Ajo duhet të zgjidhet përmes një procesi demokratik nga shoqëria civile, të jetë e përgjegjshme para grupeve të tjera të shoqërisë civile, dhe të sigurohet që ajo të konsultohet dhe të sjellë në proces pikëpamjet dhe prioritetet e grave të ndryshme në Kosovë.
- Të përfshihen në agjendën e Dialogut pikat kryesore drejt ballafaqimit me të kaluarën dhe drejtësinë tranzicionale, përfshirë ato që gratë i konsiderojnë si prioritete:
    - Kthimi i personave të zhdukur të të gjitha etnive ose të bëhet i qartë fati i tyre;
    - Sigurimi i drejtësisë për viktimat e dhunës seksuale të të gjitha etnive dhe pagesa e dëmshpërblimeve për dhunën e kryer;
    - Që qeveria e Serbisë të kërkojë falje publike për krimet e kryera nga shteti, drejt pranimit të këtyre krimeve dhe përparimit në ballafaqimin me të kaluarën;
    - Të sigurohet mbrojtja e të gjitha vendeve të trashëgimisë kulturore, mediave dhe feve, përfshirë xhamitë, manastiret, kishat dhe varrezat;
    - Të kompensohen pasuritë e humbura të civilëve dhe të kthehen pensionet e humbura; dhe
    - Të zgjidhen çështjet në lidhje me lirinë e lëvizjes, përfshirë pasaportat e ndryshme të lëshuara për serbët në Kosovë.

- Të merret parasysh zhvillimi i referendumit për çështje me rëndësi politike, në mënyrë që njerëzit të jenë pjesë e zgjedhjes të së ardhmes së tyre dhe të kenë pronësinë mbi procesin, drejt paqes së qëndrueshme.

## Për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë

- Të bëhet institucionalizimi i trajnimit shtesë, të detyrueshëm për të gjithë zyrtarët e policisë në trajtimin e duhur të të gjitha formave të dhunës në baza gjinore, përfshirë ngacmimet seksuale, me kujdes dhe ndjeshmëri. Të merret parasysh emërimi i grave police të trajnuara dhe të specializuara në secilin stacion si zyrtare të vetme përgjegjës për intervistimin e personave që kanë përjetuar dhunë të bazuar në gjini.
- Të rritet prania e policisë në zonat ku vajzat kthehen nga distanca të gjata nga shkolla, veçanërisht natën dhe në vendet ku nuk ka drita ose kamera.
- Të kryhet veprimtari aktive bazuar në praktikat më të mira më të hershme për të rekrutuar më shumë gra të ndryshme në forcë dhe duke përdorur masa afirmimi, sipas nevojës, për të promovuar më shumë gra zyrtare në nivele më të larta.
- Të zbatohet një politikë me tolerancë zero mbi diskriminimin brenda forcës me ndëshkime.
- Të jetësohen politikat e bilancit punë-jetë, siç është orari fleksibil i punës.

## Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Të ndërmerren përpjekje shtesë për të përmirësuar qasjen e grave në tregun e punës, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit.[577]
- Përmes Qendrave të Trajnimit Profesional, të zhvillohen aktivitete shtesë në shkolla dhe komunitete, duke synuar gratë e reja me mbështetje për orientimin në karrierë dhe trajnimin profesional.
- Të bëhet monitorimi dhe sigurimi i zbatimit të Ligjit për Familje gjatë ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës sociale, veçanërisht në lidhje me martesat e hershme në mesin e vajzave rome, ashkali dhe egjiptiane.

## Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

- Të integrohet arsimi mbi rolet gjinore, stereotipet dhe marrëdhëniet në kurrikulë shkollore, me qëllim të transformimit të normave tradicionale gjinore. Të sigurohet që mësuesit të jenë të trajnuar mirë në mënyrë që ata të mos i përforcojnë normat ekzistuese gjinore.
- Të krijohen më shumë qendra të kujdesit për fëmijë, kopshte dhe qendra ditore të financuara në mënyrë publike, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe drejt arritjes së Objektivave të Barcelonës të BE-së.[578]
- Të iniciohet bashkëpunimi midis universiteteve publike, OSHCG-ve, grave politikane, mediave dhe institucioneve për të mësuar, shkëmbyer përvojat dhe fuqizuar vajzat në lidhje me proceset e paqes. Të ofrohen më shumë mundësi për arsim joformal për të rritur interesin e të rinjve për të marrë pjesë në vendimmarrje.
- Të sigurohet dhe promovohet qasja në arsim cilësor për personat e të gjitha etnive dhe në të gjitha rajonet e Kosovës, veçanërisht për vajzat rome, ashkali dhe egjiptiane.[579]
- Të ofrohen mësime falas të gjuhës serbe dhe shqipe në të gjithë vendin si pjesë e sistemit arsimor dhe arsimit të

[577] Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016 - 2021, Prishtinë, janar 2016, f. 11.

[578] Shihni më shumë për Objektivat e Barcelonës.

[579] Sipas Ligjit, arsimi fillor dhe i mesëm në Kosovë është falas, i financuar nga buxheti i Kosovës. Gjithashtu, është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët e moshës 6 deri në 15 vjeç (Portali shtetëror i Republikës së Kosovës).

vazhdueshëm.

## Për komunat

- Të sigurohet që hapësirat publike, përfshirë trotuaret, të jenë të qasshme për persona me aftësi të ndryshme. Të përmirësohet asfaltimi i rrugëve, pastrimi, dhe kontrolli i qenve endacakë, të cilat minojnë sigurinë, veçanërisht për personat me aftësi të ndryshme.
- Të avancohet siguria në rrugë duke instaluar kamera dhe drita. Të bashkëpunohet me vajzat për të identifikuar vendet që paraqesin shqetësime të sigurisë dhe duhet të kenë prioritet për investime të tilla.
- Të sigurohet disponueshmëria e transportit publik në zonat rurale dhe me shumicë serbe, gjë që mund të rrisë sigurinë fizike për vajzat që udhëtojnë nga dhe në shkollë, si dhe të mundësojë pjesëmarrjen e grave serbe në proceset e vendimmarrjes.
- Të zbatohet buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, duke përdorur analizën gjinore për të informuar buxhetet bazuar në nevojat e grave të ndryshme.
- Të rritet përfaqësimi i grave në vendimmarrje në nivelin lokal, drejt sigurimit që zërat e grave të dëgjohen më mirë dhe nevojat e sigurisë të adresohen në mënyrë adekuate nga komuna. Për këtë qëllim, të zhvillohen më shumë konsultime me gra të ndryshme, përfshirë edhe vajzat, për të dëgjuar dhe adresuar nevojat e tyre.

## Për partitë politike

- Të përmirësohet demokratizimi i partive dhe të angazhohen më shumë gra në pozita vendimmarrëse, drejt reflektimit më të mirë të prioriteteve të grave në proceset e paqes dhe sigurisë.
- Të rekrutohen në mënyrë aktive dhe angazhohen më shumë vajza të ndryshme për të marrë pjesë në parti politike, përfshirë në pozitat e vendimmarrjes.
- Të ofrohen më shumë mundësi për gratë në parti që të përfaqësojnë partinë në media.
- Të sigurohet që listat zgjedhore të kenë një përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave, siç përcaktohet në Ligjin për Barazi Gjinore (50%).
- Të ndahen burime të barabarta për gratë dhe burrat kandidatë gjatë fushatave zgjedhore.
- Të përfshihet në platformat e partive politike vëmendja ndaj çështjeve kryesore me rëndësi për gratë, përfshirë qasjen në arsim cilësor dhe punësim, si dhe adresimin e dhunës në bazë gjinore.

## Për organet dhe organizatat ndërkombëtare, përfshirë KB dhe BE

- Të komunikohet rregullisht me OSHCG-të, përfshirë për proceset kyçe politike dhe të paqes, sipas Agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë.
- Të inkurajohet fuqimisht përmes dialogut politik dhe, kur është e mundur, të sigurohet pjesëmarrja domethënëse e grave në negociata dhe dialog, si përmes pjesëmarrjes në ekipet zyrtare të negociatave ashtu edhe përmes konsultimeve publike.
- Të inkurajohen fuqimisht palët negociuese për të përfshirë në rendin e ditës çështjet që gratë i konsiderojnë me prioritet.
- Të kërkohet që Serbia të pranojë publikisht krimet e kryera kundër civilëve nga shteti dhe të kërkojë falje për to drejt pajtimit dhe paqes së qëndrueshme.
- Të mbështeten përpjekjet për të siguruar kthimin e personave të zhdukur.

- Të inkurajohet fuqimisht ndjekja penale e personave që kanë kryer krime lufte, përfshirë dhunën seksuale, drejt drejtësisë.
- Të mbështetet në mënyrë politike kompensimi dhe dëmshpërblimet për dhunën seksuale, shkatërrimin e pronave dhe jetesës, dhe kthimi i pensioneve.
- Të vazhdohet të ndahen fonde për të mbështetur agjendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë, përfshirë fuqizimin e grave në politikë.
- Për BE-në, të bëhet urgjentisht liberalizimi i vizave për Kosovën, duke u mundësuar të rinjve të të gjitha etnive të udhëtojnë, të mësojnë, të komunikojnë dhe të ndërtojnë marrëdhënie me bashkëmoshatarët e tyre, drejt paqes dhe sigurisë.

## Për OSHC-të

- Të vazhdohet me organizimin e punëtorive, diskutimeve dhe mundësive të zhvillimit të kapaciteteve me vajza të ndryshme për politikën, paqen dhe sigurinë. Nëse ato njihen me të drejtat e tyre dhe fuqizohen që në moshë të hershme, ato mund të jenë më të interesuara të jenë pjesë e këtyre proceseve në të ardhmen.
- Të vazhdohen punëtoritë ndëretnike ndërmjet moshatarëve për vajza me etni të ndryshme për të diskutuar konceptet e paqes dhe sigurisë, drejt kuptimit më të mirë të nevojave të tjerave. Pastaj, të përkrahen ato në mobilizimin e përbashkët për të realizuar nevojat e tyre të identifikuara përmes takimeve me zyrtarë, duke rritur kapacitetet e tyre në avokim, fjalim publik dhe diplomaci.
- Të vazhdohet të bëhet presion mbi partitë politike dhe zyrtarët qeveritarë për të përfshirë më shumë gra në pozitat vendimmarrëse brenda partive, pozitave qeveritare dhe proceseve të paqes.
- Të vazhdohet avokimi për qeverinë për të caktuar një grua përfaqësuese të shoqërisë civile për të marrë pjesë në Dialog, në përputhje me RKSKB 1325. Të sigurohet që personi të jetë zgjedhur në mënyrë demokratike dhe më pas të komunikon dhe përfaqëson interesat e grave të ndryshme në Dialog.
- Të identifikohen gratë eksperte në fusha të ndryshme, duke avokuar që ato të bëhen pjesë e Dialogut, kur të vijë koha.
- Kur gratë nuk përfshihen në proceset zyrtare të paqes, të vazhdohet të organizohen dialogë paralel, përfshirë aktivizmin në rrugë, për t'i dëgjuar zërat e grave. Të angazhohen më shumë gra të ndryshme në këto aktivitete, duke siguruar dukshmëri të nevojave të të gjitha grave nga grupe të ndryshme etnike.
- Të vazhdohet të organizohen aktivitete me burra, veçanërisht të rinj, për të adresuar rolet gjinore dhe për të krijuar kuptime të reja të maskulinitetit.
- Të organizohen diskutime me gra të ndryshme, veçanërisht me vajza në zonat rurale, për t'i informuar ato më mirë në lidhje me të drejtat e pronës, në drejtim të sigurisë së tyre ekonomike.
- Të bëhet shpërndarja e mëtejshme e informacionit në lidhje me aktivitetet e OShC-ve, drejt fitimit të një audience më të gjerë dhe pjesëmarrëseve më aktive dhe të ndryshme në aktivitete.

## Për Media

- Të zhvendoset opinioni publik në lidhje me rolet dhe kontributet e grave në proceset e vendimmarrjes duke siguruar më shumë mbulim të punës së grave në politikë, përfshirë proceset e paqes dhe sigurisë. Të përfshihet vëmendje e veçantë për punën e vajzave.
- Të përmbahet nga mbulimi seksist, bombastik dhe tjetër që përforcon normat dhe stereotipet gjinore. Të shmanget mbulimi i grave i cili përqendrohet në pamjen e tyre, ndërsa tërheq vëmendjen nga puna e tyre dhe

vendimet e politikave.

- Të ftohen më shumë gra të ndryshme për të marrë pjesë në debate mbi tema që lidhen me paqen dhe sigurinë, përfshirë edhe vajzat.
- Të ftohet një numër i barabartë i grave dhe burrave të moshave të ndryshme për të folur gjatë diskutimeve të fushatës zgjedhore, përfshirë nga politika, shoqëria civile, si ekspertë dhe komentues.
- Si një shërbim publik, ndani fushata ndërgjegjësimi që synojnë parandalimin e dhunës dhe promovimin e të drejtave, përfshirë informacionin se ku njerëzit që kanë përjetuar dhunë mund të marrin mbështetje. Për fushatat, bashkëpunoni ngushtë me policinë dhe OSHCG-të.
- Të prodhohet përmbajtje që nxit paqen dhe sigurinë.
- Të trajnohen gazetarët për të përmirësuar raportimin e tyre mbi gratë, paqen dhe çështjet e sigurisë, përfshirë dhunën në bazë gjinore, duke siguruar një qasje të ndjeshme.

# Punimet e cituara


Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës në 2019", 2020, tek: https://ask.rks-gov.net/media/5537/vlersimi-i-popullsise-2019-angisht.pdf.

Amnesty International, "Thirrjet për qetësi ndërsa serbët mblidhen" [Amnesty International, "Calls for calm as Serbs rally"], 2008, tek: https://www.amnesty.org/en/latest/news/2008/02/calls-calm-serbs-rally-20080221/.

_____, "Serbia: Dorëzimi në Komitetin e KB kundër Torturës", 2015.

_____, *Plagë që na Djegin Shpirtrat "Kompensimi për të mbijetuarit e përdhunimit në kohë lufte në Kosovë, por ende pa drejtësi, 2017, tek:* https://www.amnesty.org/en/documents/eur70/7558/2017/en/.

Anderson, R., "Një Definicion i Paqes" ["A Definition of Peace"], *Paqja dhe Konflikti: Gazeta e Psikologjisë së Paqes*, 10(2), 2004, tek: https://doi.apa.org/doiLanding?doi=10.1207%2Fs15327949pac1002_2.

Aragon, J. and Miller, M., "Çështjet Globale të Grave: Gratë në Botë Sot, version i zgjeruar" ["Global Women's Issues: Women in the World Today, extended version"], Byroja e Programeve Ndërkombëtare të Informacionit, Departamenti i Shtetit të Sh.B.A., 2017, tek: https://open.umn.edu/opentextbooks/textbooks/465.

Arkivi i Shtypit Shoqërues, "Kosova: Gratë Protestuese Shqiptare të Kthyera nga Policia Serbe" ["Kosovo: Albanian Women Protestors Turned Back by Serbian Police"], 16 Mars 1998, tek: http://www.aparchive.com/metadata/youtube/97274b579371816d69458367cfe8f061.

Asambleja e Përgjithshme e OKB, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, pershtatur ne Dhjetor 1979, tek: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/cedaw.pdf

_____, Transformimi i Botës Sonë: Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, 2015 [Transforming Our World: The 2030 Agenda for Sustainable Development], 2015, tek: https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf?fbclid=IwAR2R93Vgn-9lISpD8SkQ1L9GFPD7YM7b_dZMM8vN1ILAoXgR10pADUFQqclY%22%20%22%20

Bastick, M. "Integrimi i gjinisë në reformën e sektorit të sigurisë pas konfliktit" [Integrating Gender in Post-Conflict Security Sector Reform], 2007, tek: http://peacewomen.org/sites/default/files/SSR_GenderInPostConflic_GCDCAF_2008_0.pdf.

Bastick, M. dhe Whitman, T., [*Një udhëzues i grave për reformën në sektorin e sigurisë*], 2015, tek: https://www.inclusivesecurity.org/wp-content/uploads/2015/09/WGTSSR-Web.pdf

Begisholli, B., "Për Kosovën, Biseda me Serbinë është punë e burrave" [For Kosovo, Talking with Serbia is Men's Work], Prishtina Insight, 23 Janar 2019, tek: https://balkaninsight.com/2019/01/23/for-kosovo-talking-with-serbia-is-men-s-work-01-21-2019/

Benderly, Jill, "Një Vend i Grave është në Tavolinën e Paqes"["A Women's Place Is at the Peace Table"], SAIS Review, Vëllimi 20, Numri 2, Verë-Vjeshtë 2000.

Brown, J., "Qasja kritike e shënjuesit të masës: Kuotat e grave dhe drejtësia sociale" ["The Critical Mass Marker Approach: Female Quotas and Social Justice"], *Studimet Politike*, 62(4), 2013

Carson, K., Udhëtimi në terren i Studentëve për Programin e Menaxhimit të Konflikteve ["Conflict Management Program Student Field Trip to Kosovo"], 2010, tek: https://www.scribd.com/document/60473543/2010-Kosovo-Report

Castan Pinos, J., "Mitrovica: Një qytet (ri) i formuar nga ndarja" në Politika e identitetit në shtetet pas konfliktit [Mitrovica: A city (re)shaped by division" in Politics of identity in Post-Conflict States] (f. 128-142), 2016.

Chinkin, C., dhe Charlesworth, H., "Ndërtimi i Grave në Paqe: korniza ligjore ndërkombëtare" ["Building Women into Peace: the international legal framework"], Tremujori i Botës së Tretë, Vëllimi 27, Numri 5, Korrik 2006, tek: http://www.ingentaconnect.com/content/routledg/ctwq.

Clark, H., *Rezistenca Civile në Kosovë*, 2000.

Clark, J. N., “Drejtësia Tranzicionale si Njohje: Një Analizë e Gjykatës së Grave në Sarajevë” [“Transitional Justice as Recognition: An Analysis of the Women’s Court in Sarajevo”], Revista Ndërkombëtare e Drejtësisë Tranzicionale, 10 (1), 2015.

Confortini, C. C., “Galtung, Dhuna dhe Gjinia: Rasti i një Aleance Studimesh Paqe / Feminizëm” [“Galtung, Violence, and Gender: The case of a Peace Studies/Feminism Alliance”], Paqe dhe Ndryshim, 31 (3), 2006, tek: https://onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1111/j.1468-0130.2006.00378.x.

Corrin, C., “Situata pas konfliktit në Kosovë”, 2001.

Dahlerup, D., “Historia e Teorisë së Masës Kritike” [“The Story of the Theory of Critical Mass”], *Politika & Gjinia*, 2006.

Dahlerup, D., Hilal, Z., Kalandadze, N. dhe Kandawasvika-Nhundu, R., Atlas i Kuotave Gjinore Zgjedhore [Atlas of Electoral Gender Quotas], 2013, tek: https://www.idea.int/sites/default/files/publications/atlas-of-electoral-gender-quotas.pdf.

Dahlman, C. T., dhe Williams, T., “Enklavizimi Etnik dhe Formimi i Shtetit në Kosovë” [“Ethnic
Enclavisation and State Formation in Kosovo”], *Geopolitics,* 15(2), 2010.

Deklarata e Rinisë së Amanit, “Për Rininë, Paqen dhe Sigurinë” [Amman Youth Declaration, “On Youth, Peace, and Security], 2015, tek: http://unoy.org/wp-content/uploads/Amman-Youth-Declaration.pdf.

Dragojlo, S., Polici Serb ‘Kërcënime të frymëzuara’ për gratë e paqes [“Serbian Policeman ‘Inspired
Threats’ to Peace Women”], BIRN, 2016, tek: https://balkaninsight.com/2016/07/20/threats-multiplied-after-police-spokespersons-post-women-in-black-testified-07-19-2016/.

Ekipi I UN Kosovo, Parlamenti i Kosovës Njëzëri Miraton Rezolutën e SDG [“Kosovo Parliament
Unanimously Adopts SDG Resolution”], 2018, tek: https://unkt.org/2018/01/25/kosovo-parliament-unanimously-adopts-sdg-resolution/.

_____, Tejkalimi i pengesave për fuqizimin e grave në sferën publike [“Overcoming Barriers to
Empowering Women in Public Sphere”], 2020, tek: https://unkt.org/2020/02/07/overcoming-barriers-empowering-women-public-sphere/.

El Jack, A., Raporti i Përgjithshëm mbi Gjininë dhe Konfliktet e Armatosura, 2003.

Eurostat, [“Rinia - Përmbledhje”], tek: https://ec.europa.eu/eurostat/web/youth.

Farnsworth, N., Kosovë: Rritet presioni për reformën [“Kosovo: Pressure Grows for Reform”], *Instituti për Raportimin e Luftës dhe Paqes*, 2005, tek: https://iwpr.net/global-voices/kosovo-pressure-grows-reform.

Fitamant, S., Raporti i Vlerësimit të Dhunës Seksuale në Kosovë [“Assessment Report on Sexual Violence in Kosovo”], UNFPA, 2000.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Zyra për Ndërtimin e Paqes (PBSO), Paqja që mungon [*The Missing Peace]*, 2018, tek: https://www.youth4peace.info/system/files/2018-10/youth-web-english.pdf .

Fondi për të Drejtën Humanitare, 31,600 dokumente pa dyshim konfirmojnë vdekjen ose zhdukjen e
15,535 individëve gjatë luftës në Kosovë [“31,600 documents undoubtedly confirm death or disappearance of 15,535 individuals during war in Kosovo”], 2015, tek: http://www.hlc-rdc.org/?p=28185&lang=de

_____, *Libri i Kujtesës së Kosovës, tek:* http://www.kosovomemorybook.org/?page_id=29&lang=de.

France24, 20 vjet më vonë, viktimat serbe të bombardimeve të NATO-s ndihen të harruara [“20 years on, Serbian victims of NATO bombings feel forgotten”], tek: https://www.france24.com/en/20190321-20-years-serbian-victims-nato-bombings-feel-forgotten.

Galtung, J., dhe Fischer, D., Paqja pozitive dhe negative [“Positive and Negative Peace”], *SpringerBriefs mbi pionierët në shkencë dhe praktikë*, Vol. 5, 2013, tek: https://link.springer.com/chapter/10.1007%2F978-3-642-32481-9_17.

Gizelis, T-I., “Fuqizimi Gjinor dhe Ndërtimi i Paqes i Kombeve të Bashkuara” [“Gender Empowerment and United Nations Peacebuilding”], *Gazeta e Hulumtim rreth Paqes,* 2009, tek: https://doi.org/10.1177%2F0022343309334576.

Greene, M., Friedman, J., dhe Bennet, R., *Ndërtimi i Shërbimit Policor në një Vakum të Sigurisë: Përpjekjet Ndërkombëtare në Kosovë [Building the Police Service in a Security Vacuum: International Efforts in Kosovo], 1999-2011*, 2012, tek: https://successfulsocieties.princeton.edu/sites/successfulsocieties/files/Kosovo%20Policing_RB_MG_FINAL%20ToU%20TD%2030Jun20.pdf.

Grupi Ballkanik i Kërkimit të Politikave, Dialogu i Brukselit midis Kosovës dhe Serbisë: Arritjet dhe Sfidat, Prishtinë / Priština, 2020.

Grupi Punues i OJQ-ve për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Hartimin e Grave, Paqen dhe Sigurinë në Këshillin e Sigurimit të KB [NGO Working Group on Women, Peace and Security, *Mapping Women, Peace and Security in the UN Security Council]*, 2019, tek: https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/NGOWG-Mapping-WPS-in-UNSC-2018.pdf

Guerrina, R. dhe Wright, R.K.M, "Gjinia e Fuqisë Normative në Evropë: Mësimet e Grave, Axhenda e Paqes dhe e Sigurisë" [Gendering Normative Power in Europe: Lessons of the Women, Peace and Security Agenda], Çështjet Ndërkombëtare, 92, 2016

Harcourt, W., *Trupat në Rezistencë. Gjinia dhe politika seksuale në epokën e neoliberalizmit*, 2017.

Helsinške SVESKE, "Drejt ndërtimit të një Kosove të qëndrueshme" [*"Ka izgradnji održivog kosovskog društva"]*, 2007, tek: https://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/sveske26.pdf.

Human Rights Watch, Abuzimet Kundër Serbëve dhe Romëve në Kosovën e Re [*Abuses Against Serbs and Roma in the New Kosovo*], 1999, në:https://www.hrw.org/reports/1999/kosov2/.

_____, Mosmbrojtja: Dhuna Kundër Pakicave në Kosovë [*Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo]*, 2004 tek: https://www.hrw.org/report/2004/07/25/failure-protect/anti-minority-violence-kosovo-march-2004#:~:text=On%20March%2017%2C%202004%2C%20violent,into%20the%20river%20by%20Serbs.

_____, Dhuna me bazë gjinore ndaj grave shqiptare të Kosovës, [*Gender-Based Violence Against Kosovar Albanian Women]*, 2000, tek: https://www.hrw.org/reports/2000/fry/Kosov003-02.htm#P184_35604.

_____, Shkeljet e së Drejtës Humanitare në Kosovë, Sh.B.A . [*Humanitarian Law Violations in Kosovo*, U.S.A.]: Human Rights Watch, 1998, tek: https://www.hrw.org/report/1998/10/01/humanitarian-law-violations-kosovo.

Hunt, Swanee dhe Posa, Cristina, Gratë që bëjnë paqen ["Women Waging Peace"], *Foreign Policy*, No. 124, 2001.

IKD, Barazia Gjinore (In) në Vendimmarrjen e Nivelit Lokal, 2018, tek: https://www.ndi.org/sites/default/files/Women_Representation_3_Gjuhet_Print.pdf

_____, Kapërcimi i barrierave për pjesëmarrjen politike të grave, [*Overcoming Barriers to Women's Political Participation]*, 2015, tek: https://www.ndi.org/sites/default/files/Gender-Assesment-report-eng.pdf.

Institucioni i Avokatit te Popuullit të Kosovës, Deklarata e Ombudspersonit në lidhje me procesin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës ["Ombudsperson's statement with regard to early elections process for the Assembly of Kosovo"], 2021, tek: https://www.oik-rks.org/en/2021/01/13/ombudspersons-statement-with-regard-to-early-elections-process-for-the-assembly-of-kosovo/ .

Instituti GAP, Procesi i ri i formulimit të Strategjisë së Sigurisë së Kosovës - Përfshirja dhe transparenca [The new Kosovo Security Strategy formulation process - Inclusiveness and transparency], 2013, tek: https://www.institutigap.org/documents/45119_The%20new%20Kosovo%20Security%20Strategy%20development%20process.pdf.

Istrefi, K., dhe Morina, V., Zbatimi gjyqësor i së drejtës ndërkombëtare në Kosovë ["Judicial Application of International Law in Kosovo"], in Rodin, S. & Perišin, T., *Zbatimi gjyqësor i së drejtës ndërkombëtare në Evropën Juglindore, Springer*, 2015.

Jones, J., *Gratë në Policinë e Kosovës, 2020, në*: https://www.justice.gov/criminal-icitap/file/1307176/download.

Kallxo.com, "Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike është miratuar pas gjashtë përpjekjeve të dështuara", 2020, tek: https://kallxo.com/lajm/pas-gjashte-tentimeve-votohet-ne-parim-projektligji-per-rimekembjen-ekonomike/.

Këshilli i Bashkimit Evropian, Qasja Gjithëpërfshirëse për Zbatimin e BE-së të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 dhe 1820 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë [Comprehensive Approach to the EU Implementation of the United Nations Security Council Resolutions 1325 and 1820 on Women, Peace and Security], 2008, tek: https://www.peacewomen.org/sites/default/files/eu_comprehensive_eu_approach_to_the_implementation_of_unscr_1325_and_1820_december2008.pdf.

Këshilli i Bashkimit Evropian, Treguesit e rishikuar për qasjen Gjithëpërfshirëse për zbatimin e BE të

Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të KB 1325 dhe 1820 për gratë, paqen dhe sigurinë [Revised indicators for the Comprehensive approach to the EU implementation of the UN Security Council Resolutions 1325 and 1820 on women, peace and security], 2016, tek: https://www.peacewomen.org/sites/default/files/ST_12525_2016_INIT_EN.pdf.

Këshilli i Evropës, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 2011, tek: https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/090000168008482e.

Këshilli i Sigurimit i OKB, Raporti i Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara, Trojka e Federatës Ruse për Kosovën [*Report of the European Union, United States, Russian Federation Troika on Kosovo*], 2007, në: https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20723.pdf.

_____, Rezoluta 1244, tek: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/Res1244ENG.pdf.

_____, Rezoluta 1325, 31 Tetor 2000, tek: https://www.undocs.org/en/S/RES/1325(2000).

_____, Rezoluta 1820, 19 Qershor 2008, tek: http://unscr.com/en/resolutions/doc/1820.

_____, Rezoluta 1888, 30 Shtator 2009, tek: http://unscr.com/en/resolutions/doc/1888.

_____, Rezoluta 1889, 5 Tetor 2009, tek: http://unscr.com/en/resolutions/doc/1889.

_____, Rezoluta 1960, 16 Djetor 2010, tek: http://unscr.com/en/resolutions/doc/1960.

_____, Rezoluta 2106, 24 Qershor 2013, tek: https://undocs.org/en/S/RES/2106(2013).

_____, Rezoluta 2122, 18 Tetor 2013, tek: http://unscr.com/en/resolutions/doc/2122.

_____, Rezoluta 2242, 13 Tetor 2015, tek: https://undocs.org/en/S/RES/2242(2015).

_____, Rezoluta 2250, 9 Dhjetor 2015, tek: https://www.undocs.org/en/S/RES/2250(2015).

_____, Rezoluta 2419, 6 Qershor 2018, tek: https://undocs.org/en/S/RES/2419(2018).

_____, Rezoluta 2467, 23 Prill 2019, tek: https://undocs.org/pdf?symbol=en/S/RES/2467(2019).

_____, Rezoluta 2493, 29 Tetor 2019, tek: https://www.undocs.org/en/S/RES/2493(2019).

_____, Rezoluta 2535, 14 Korrik 2020, tek: https://undocs.org/en/S/RES/2535(2020).

Këshilli për Marrëdhënieve të Huaja, Pjesëmarrja e Grave në Proceset e Paqes [Women's Participation in Peace Processes], tek: https://www.cfr.org/womens-participation-in-peace-processes/#:~:text=Between%201992%20and%20 2019%2C%20women,peace%20processes%20around%20the%20world.

KIPRED, *Reformimi i Sistemit Zgjedhor të Kosovës*, 2005, tek:

http://www.kipred.org/repository/docs/REFORMING_THE_ELECTORAL_SYSTEM_OF_KOSOVA_840210.pdf.

Klan Kosova, *"Avokati i Popullit bën thirrje për barazi gjinore në zgjedhjet e 6 tetorit"*, 2019, tek:

https://klankosova.tv/avokati-i-popullit-ben-thirrje-per-barazi-gjinore-ne-zgjedhjet-e-6-tetorit1/.

Koalicioni i Paqes së Grave, Përmes Solidaritetit të Grave në një Paqe të Drejtë: Një Raport i Mbështetur në Konferencën e Dytë Vjetore të Koalicionit të Paqes së Grave [*Through Women's Solidarity to a Just Peace: A Report Based on the Women's Peace Coalition Second Annual Conference*], 2007, tek: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130120172604733.pdf.

Kombet e Bashkuara, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi ndërtimin e paqes menjëherë pas konfliktit [*Report of the Secretary-General on peacebuilding in the immediate aftermath of conflict*], 2009, tek: https://www.un.org/ruleoflaw/blog/document/report-of-the-secretary-general-on-peacebuilding-in-the-immediate-aftermath-of-conflict/

_____, Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, [Rome Statute of the International Criminal Court], at: https://

legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/7_4_1998.pdf

Komisioni Evropian, Plani i Veprimit Gjinor i BE (GAP) III - Një Agjendë Ambicioze për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Veprimin e Jashtëm të BE [EU Gender Action Plan (GAP) III – An Ambitious Agenda for Gender Equality and Women's Empowerment in EU External Action], 2020, tek: https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join_2020_17_en_final.pdf

_____, *Kosova* Raporti 2020*, tek: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

_____, Një Bashkim i Barazisë: Strategjia e Barazisë Gjinore [*A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025]*, 5 March 2020, at: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN.

Komisioni i Bashkimit Afrikan, Karta Rinore Afrikane [African Union Commission, African Youth Charter], 2006, tek: https://www.un.org/en/africa/osaa/pdf/au/african_youth_charter_2006.pdf.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet në Kosovë 2000 - 2014, 2017, tek: https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Zgjedhjet-ne-Kosove-2000-2014_en.pdf

_____, Rezultatet Finale, 2019, tek: https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/3.Ndarja-e-ul%C3%ABseve-n%C3%AB-Kuvend-Subjektet-dhe-kandidat%C3%ABt-e-zgjedhur-1.pdf.

Kosovar Centre for Security Studies, Analiza e kontekstit e reformës së sektorit të sigurisë në Kosovë 1999-2009 [*Context Analysis of the Security Sector Reform in Kosovo 1999-2009]*, 2011, tek: http://www.qkss.org/repository/docs/Context_Analysis_of_the_Security_Sector_Reform_in_Kosovo_1999-2009_470823.pdf .

____, Brief Policy, "Konteksti i zhvillimit të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë - perspektiva e shoqërisë civile", 2013, tek: http://www.qkss.org/repository/docs/The_Development_Context_of_Strategic_Security_Sector_Review_877377.pdf .

____, Gjendja e lojës së politikave të integritetit në Policinë e Kosovës, [*State of Play of Integrity Policies in the Kosovo Police]*, 2020, tek: http://www.qkss.org/repository/docs/State_of_play_of_integrity_policies_in_the_Kosovo_Police_English_Version__13188.pdf.

Kosovo 2.0, "Three decades of protest; A history of women led activism on March 8", 2018, at: https://kosovotwopointzero.com/en/three-decades-protest/.

Krasniqi, Gëzim, Krasniqi, Gëzim, "Socializmi, Utopia Kombëtare dhe Muzika Rock: Brenda Skenës Shqiptare të Jugosllavisë, 1970–1989" ["Socialism, National Utopia, and Rock Music: Inside the Albanian Rock Scene of Yugoslavia, 1970–1989"], Evropa Qendrore Lindore, 2011.

Krause, J., Krause, W. dhe Bränfors, P., "Pjesëmarrja e grave në negociatat e paqes dhe qëndrueshmëria e paqes" [Women's Participation in Peace Negotiations and the Durability of Peace], Ndërveprimet Ndërkombëtare, 2018, tek: https://doi.org/10.1080/03050629.2018.1492386

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, tek: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702.

_____, Ligji i Familjes Nr. 2004/32, tek: https://childhub.org/en/system/tdf/library/attachments/366_428_EN_original.pdf?file=1&type=node&id=7103 .

_____, Ligji Nr. 04 / L-076 për Policinë, tek: https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/Ligji-per-Policine-anglisht.pdf.

_____, Ligji Nr. 06 / L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, tek: https://mod.rks-gov.net/repository/docs/LAW_ON_KOSOVO_SECURITY_FORCE__2019.pdf .

_____, Ligji Nr. 06 / L –133 Për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, tek: https://

mf.rks-gov.net/desk/inc/media/6DD9224D-9C40-448E-B71F-06284B8E810C.pdf .
_____, Ligji Nr. 07L-001 Për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2020, në: https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/EA0446D5-97E0-4540-A9CB-73521FD245A9.pdf.
_____, Ligji për Organizatat e Biznesit, 2018, tek: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426
_____, Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes, tek: https://mod.rks-gov.net/repository/docs/LAW_ON_MINISTRY_OF_DEFENSE__2019.pdf .
_____, Ligji për të Drejtat e Luftëtarëve dhe Viktimave të tjera Civile të Luftës, tek: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9436 .
_____, Ligji për Barazinë Gjinore Nr. 05 / L-020, tek: https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/LAW%20%20ON%20GENDER%20EQUALITY(1).pdf .
_____, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, tek: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544.
_____, Ligji për Zgjedhjet Lokale në Kosovë, tek: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2549.
Kvinna till Kvinna, #FEMDEFENDERS Gratë e reja që rrëzojnë barrierat [Young women who tears down barriers], 2015, tek: https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2018/10/7-Femdefenders-young-women-who-tear-down-barriers-ENG.pdf.
_____, Një e drejtë jo një dhuratë [*A Right Not A Gift]*, 2020, tek: https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2020/05/A-Right-Not-A-Gift.pdf
_____, Negociatat midis Beogradit dhe Prishtinës nga perspektiva e grave [*Negotiations between Belgrade and Prishtinë/Priština from women's perspective]*, 2018.
_____, "Dëshmi të paharrueshme në gjykatë për gratë e mbijetuara", ["Unforgettable testimonies at court for women survivors"], 2015, tek: http://vipa.kvinnatillkvinna.se/regioner/balkan/unforgettable-testimonies-at-court-for-women-survivors
_____, Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor [*Women's Rights in the Western Balkans]*, 2020, tek: https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2019/11/Womens-rights-in-Western-Balkans.pdf.
_____, Karta e Paqës së Grave të Rinj ["Young Women's Peace Charter"], 2015, tek: https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2018/10/6-Young-womens-peace-charter.pdf.
Lerner, G., Krijimi i Patriarkatit [*The Creation of Patriarchy]*, Vol. 1, USA: Oxford University Press, 1986.
Lobi Rajonal i Grave në Evropën Juglindore, Akademia Rajonale për Gratë në Lidership dhe Ndërmjetësim [Regional Academy for Women in Leadership and Mediation], tek: http://rwlsee.org/wp-content/uploads/2020/09/Regional-Academia-RAWLM-.pdf .
_____, Edita Tahiri Dorëzoi në KB letrën e RWLSEE që kërkon drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftërave në Kosovë ["Edita Tahiri Handed to UN the letter of RWLSEE Demanding International Justice for Women Raped during the Wars in Kosovo"], 2019, tek: http://rwlsee.org/2020/09/edita-tahiri-handed-to-un-the-letter-of-rwlsee-demanding-international-justice-for-women-raped-during-the-wars-in-kosovo-bosnia-and-herzegovina-and-croatia/.
_____, Lobi i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore mbështet me gjithë zemër një Zgjidhje të Drejtë dhe të Qëndrueshme për Kosovën ["Women's Lobby for Peace, Security and Justice in South East Europe wholeheartedly supports a Just and Sustainable Settlement for Kosovo"], 2006, tek: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130124004317350.pdf.
Malcolm, N., Kosova: Një histori e shkurtër [*Kosovo: A Short History]*, 1998.
Manjoo, R., Gratë, Paqja dhe Siguria - Negocimi për interesat më të mira të grave ["Women, Peace and Security – Negotiating in Women's Best Interests"], *Global Policy*, 2016.

Mertus, J., Përmirësimi i statusit të grave në zgjim të luftës: tejkalimi i pengesave strukturore [*Improving the Status of Women in the Wake of War: Overcoming Structural Obstacles]*, 2003.

_____, Ofensiva e Luftës ndaj Grave [*War's Offensive on Women]*, 2000.

Mesa, M., CEIPAZ, Fondacioni Kultura e Paqes, "Paqja dhe siguria" [Culture of Peace Foundation, "Peace and security"], tek: http://www.unescoetxea.org/ext/manual_EDS/pdf/16_paz_seguridad_ingles.pdf.

*New York Times*, Kriza në Ballkan: Refugjatët; Llogari të panumërta të refugjatëve japin detaje të vrasjeve masive ["Crisis in the Balkans: The Refugees; Countless Refugee Accounts Give Details of Mass Killings"], 1999, tek: https://www.nytimes.com/1999/04/06/world/crisis-balkans-refugees-countless-refugee-accounts-give-details-mass-killings.html?auth=login-google.

Norville, V., *Roli i Grave në Sigurinë Globale,* 2011, tek: https://www.usip.org/sites/default/files/SR264-The_role_of_Women_in_Global_Security.pdf

Oral History Kosovo, Intervistë me Valdete Idrizi ["Interview with Valdete Idrizi"], tek: https://oralhistorykosovo.org/wp-content/uploads/2018/02/valdete-idrizi_eng.docx.pdf.

OSBE, Një studim krahasues i strukturave për gratë deputete në rajonin e OSBE-së [*A comparative study of structures for women MPs in the OSCE region]*, 2013.

_____, Akademia e katërt e Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja Përfundon në Austri ["Fourth OSCE Dialogue Academy for Young Women Concludes in Austria"], 2018, tek: https://www.osce.org/mission-in-kosovo/400577.

_____, *Kosovo/Kosova As Seen, As Told*, 1999, tek: http://kosovo.sense-agency.com/assets/mass-murders/04-16-EN.pdf.

_____, Aktivitetet dhe prioritetet programore të misionit mbi barazinë gjinore ["Mission's activities and programmatic priorities on gender equality"], 2018, tek: https://www.osce.org/files/f/documents/3/e/367186.pdf.

_____, Misioni i OSBE-së në Kosovë promovon fuqizimin e grave në vendimmarrjen politike ["OSCE Mission in Kosovo promotes empowerment of women in political decision making"], 2012, tek: https://www.osce.org/kosovo/91677.

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, Minoriteti i braktisur: Historia e të Drejtave të Romëve në Kosovë ["Abandoned Minority: Roma Rights History in Kosovo"], 2011, tek: http://www.errc.org/uploads/upload_en/file/abandoned-minority-roma-rights-history-in-kosovo-dec-2011.pdf.

Qendra Kosovare e Studimeve Gjinore (QKSGJ), Histori është edhe Tregimi i Saj: Historia e Grave në Shoqërinë Civile në Kosovë 1980-2004, 2008.

Qeveria e Kosovës, Plani i veprimit në zbatim të rezolutës 1325, "Gratë, Paqja dhe Siguria" [*Action Plan in Implementation of Resolution 1325, "Women, Peace and Security"], Kosovë 2013-2015*, tek: https://www.peacewomen.org/sites/default/files/kosovo_nap_2014.pdf .

_____, Udhëzimi Administrativ - Nr. 08/2015 Për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Përbashkëta në Reagim të të dy Bashkëshortëve, tek: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15083.

_____, Agjencia për Barazi Gjinore "Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024", 2020, tek: https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024%20-%20ANGLISHT.pdf .

_____, Ministria e Mbrojtjes, rregullorja nr. 09/2019 për Planifikimin në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, 2019, tek: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=24041

_____, Ministria e Mbrojtjes, Projekt Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës, tek: https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40992.

_____, Ministria e Mbrojtjes, Politika për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e
Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, 2019, tek: https://mod.rks-gov.net/repository/docs/POLICY_ON_HUMAN_RIGHT_AND_GENDER_PARITY_IN_MoD_AND_KSF.pdf

_____, Ministria e Punëve të Brendshme, Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2019 për Procedurën e Nxitjes së Zyrtarëve të Policisë, tek:
https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/ADMINISTRATIVE-INSTRUCTION-No.-02-2019-FOR-THE-PROMOTION-PROCEDURE-FOR-POLICE-OFF-1.pdf.

_____, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Raporti Vjetor 2019 i Policisë së Kosovës, tek: https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-vjetor-2019-anglisht.pdf.

_____, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Rregullorja për Personelin dhe Administratën në Policinë e Kosovës, tek:https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/3.-Regulation-on-personnel-and-administration-in-Kosovo-Police.pdf.

_____, Ministria e Punëve të Brendshme, Raporti mbi pozicionin e grave në Policinë e Kosovës, 2011, tek: https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/country/kosovo/kosovo%20police%20research%20%20report.pdf?la=en&vs=5256.

_____, Ministria e Punëve të Brendshme, Rregullorja për Personelin dhe Administratën në Policinë e
Kosovës, Raporti mbi Inspektimin e Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës, 2017, tek: https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/10/Raport-i-Inspektimit-nr.-08-2018-Menaxhimi-i-Burimeve-Njerezore-ne-Policine-e-Kosoves.pdf.

_____, Ministria e Qeverisjes Lokale, Raporti mbi të Drejtat e Njeriut në Komuna, Janar - Qershor 2020, 2020, tek: https://mapl.rks-gov.net/en/mlga-annual-reports/.

_____, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, "Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për një Dialog Teknik Ndër-Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", Agjenda e Dialogut, 2011, tek: https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Platform_of_the_Government_of_Republic_of_Kosovo_on_an_interstate_dialogue_between_Republic_of_Kosovo_and_Republic_of_Serbia_010311.pdf.

_____, *Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016 – 2021*, 2016, tek:
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf.

_____, *Strategjia e Sigurisë së Kosovës,*2010, tek:
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_E_SIGURISE_E_REPUBLIKES_SE_KOSOVES.pdf.

Reardon, B.A. & Snauwaert, D.T., *Betty A. Reardon: Tekstet kryesore në gjini dhe paqe [Key Texts in
Gender and Peace]*, 2015, tek: https://link.springer.com/book/10.1007%2F978-3-319-11809-3

Rogel, C., "Kosova: Aty ku filloi gjithçka" ["Kosovo: Where It All Began"], Gazeta Ndërkombëtare e
Politikës, Kulturës dhe Shoqërisë, Vol. 17, Nr. 1, Shtator 2003.

Rosenberger, L. dhe Mertus, J., "Kur Shtojmë Çështje të Grave: Të Bënit Toger Ahmeti" ["When Adding Women Matters: Making Lieutenant Ahmeti"], Gjinia dhe Kombi në Evropën Juglindore, Karl Kaser, Elisabeth Katschnig-Fasch (red.), 2005

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGGK), 1325 Fakte dhe Fabula: Një koleksion tregimesh rreth zbatimit të
Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë, 2011, tek: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130120165559661.pdf.

_____, Raporti Vjetor, 2017, tek:
https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20180605125300561.pdf

_____, Raporti Vjetor, 2018, tek:
https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2019/11/KWN-Annual-Report-2018_A5_FINAL_2019-06-19.pdf.

_____, Raporti Vjetor, 2019, tek:
https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2019/12/Annual-Report-2019_2020-05-11_FINAL.pdf.

_____, Raporti Vjetor, 2020 (e ardhshme)

_____, “Shkolla Verore Feministe Bashkon Vajzat nga Kosova dhe Serbia” [“Feminist Summer School Unites Girls from Kosova and Serbia”], 2014, tek: https://womensnetwork.org/feminist-summer-school-2014-unites-girls-from-kosova-and-serbia/.

_____, Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë, 2019, tek: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2019/05/GBD-Labour-Kosovo_ISBN-978-9951-737-31-9_FINAL.pdf.

_____, Kodi Penal i Kosovës Penalizon Dhunën në Familje, Ngacmimet Seksuale, 2019, tek: https://womensnetwork.org/kosovo-criminal-code-criminalizes-domestic-violence-sexual-harassment/.

_____, *Analiza Gjinore e Kosovës,* 2018, tek: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf.

_____, “Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore: Një stimul për bashkimin e grave në Dragash”, 2020, tek: https://womensnetwork.org/kosovo-lobby-for-gender-equality-an-incentive-to-unite-women-in-dragash/.

_____, “RrGGK organizon Forumin Rajonal Feminist Rinor 2013”, 2013, tek: https://womensnetwork.org/kwn-organizes-regional-young-feminist-forum-2013/.

_____, “RrGGK qëndron me gratë e Krushe, duke kërkuar drejtësi për krimet e luftës”, 2020, tek: https://womensnetwork.org/kwn-stands-with-women-of-krushe-demanding-justice-for-war-crimes/.

_____, *Nuk ka më justifikime, 2015, tek:* https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20151124105025622.pdf

_____, “Siguria fillon në shtëpi: Jo paqe pa drejtësi ”, 2020, tek: https://womensnetwork.org/security-begins-at-home-no-peace-without-justice/

_____, *Ngacmimi seksual në Kosovë, 2016, tek:* https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20160223185243349.pdf

_____, *Përmes solidaritetit të grave në një paqe të drejtë: Një raport i bazuar në Konferencën e Dytë Vjetore të Koalicionit të Paqes së Grave, Strugë*, 2007, tek: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130120172604733.pdf.

_____, “Rrjeti i Grave në të Zeza në Serbi, RrGGK Formon Koalicionin e Paqes për Gratë”, 2013, tek: https://womensnetwork.org/women-in-black-network-serbia-kwn-form-womenrsquos-peace-coalition/.

_____, “Gratë bashkohen: Krijohet koalicioni për barazi”, 2018, tek: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/11/20180625090302265.pdf.

_____, “Gjykata e Grave për Ish Jugosllavinë: Kërkoni për Drejtësi, të Vërtetë dhe Kujtim Aktiv”, 2015, tek: https://womensnetwork.org/sq/gjykata-e-grave-per-ish-jugosllavine-kerkon-drejtesi-te-verteten-dhe-kujtese-aktive/.

Rrjeti i pajtimit KOMRA, Rëndësia e rrjetit rajonal për pajtimin [“Importance of regional networking for reconciliation”], 2017, tek: https://www.recom.link/en/importance-regional-networking-reconciliation/.

Sekretariati i Forumit të Ishujve te Paqësorit, Plani i veprimit rajonal i Paqësorit [*Pacific Regional Action Plan 2012-2015]*, 2015, https://www.peacewomen.org/assets/file/pacific_region_regional_action_plan_2012-2015.pdf.

Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm, Qasja Strategjike e BE-së për Gratë, Paqen dhe Sigurine [*EU Strategic Approach to Women, Peace and Security*], 2018, tek: https://www.consilium.europa.eu/media/37412/st15086-en18.pdf .

Shroff, S., Profesori i Paqes, Futbolli Decolonial, Feminist dhe Queer [“The Peace Professor, Decolonial, Feminist, and Queer Futurities”] në Groarke, M., dhe Welty, E., Paqja dhe Drejtësia Studime: Pedagogjia Kritike (Ed. 1), 2018.

Skeppström, E., dhe Weibull, A., “Forca e Sigurisë në Bërje: Ndërtimi i Kapaciteteve në Kosovë”, 2011.

Telegraf, “Gratë në të zeza: Ata na quajnë kurva, ata kërcënojnë të na therin!” [“ŽENE U CRNOM: Nazivaju nas kurvama, prete da će nas zaklati!”], 2014, tek: https://www.telegraf.rs/vesti/1052307-zene-u-crnom-nazivaju-nas-kurvama-prete-da-ce-nas-zaklati-foto-video.

Telegrafi, "Osmani: Asnjë paqe e qëndrueshme pa drejtësi për viktimat", 2020, tek:
https://telegrafi.com/osmani-smund-te-kete-paqe-te-qendrueshme-pa-drejtesi-per-viktimat/

Tickner, J. A., Paqja dhe siguria nga një perspektivë feministe ["Peace and Security from a Feminist Perspective"], Manuali i Grave, Paqes dhe Sigurisë në Oksford, 2018, tek: https://www.oxfordhandbooks.com/view/10.1093/oxfordhb/9780190638276.001.0001/oxfordhb-9780190638276-e-6.

_____, "Thjesht nuk e kupton: Angazhime të trazuara midis feministëve dhe teoricienëve te Marredhenieve Nderkombetare" [You Just Don't Understand: Troubled Engagements between Feminists and IR Theorists"], International Study Quarterly, Vol. 41, Nr. 4., 1997, tek: https://www.jstor.org/stable/2600855.

UN Women, Të Rejat në Paqe dhe Siguri: Në Kryqëzimin e Agjendave të YPS dhe WPS [*Young Women in Peace and Security: At the Intersection of the YPS and WPS Agendas]*, tek: https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2018/research-paper-young-women-in-peace-and-security-en.pdf?la=en&vs=2849.

_____, Parimet, Dimensionet dhe Prioritetet e Integrimit Gjinor për PVE ["Gender Mainstreaming Principles, Dimensions and Priorities For PVE"], 2019, tek: https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2019/gender-mainstreaming-principles-dimensions-and-priorities-for-pve-en.pdf?la=en&vs=1240.

UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor [*Human Development Report]*, 1994, tek:
http://hdr.undp.org/sites/default/files/reports/255/hdr_1994_en_complete_nostats.pdf

______, Analiza e Pulsit Publik: Korrelacioni ndërmjet tregut të punës në Kosovë dhe migrimit jashtë [*Public Pulse Analysis: Correlation between labour market in Kosovo and out migration]*, 2020, tek: https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-analysis--correlation-between-labour-market-in-koso.html.

______, Forcimi i pjesëmarrjes politike të grave. Një analizë e ndikimit të rrjeteve parlamentare të grave në Evropë dhe Azinë Qendrore [*Strengthening Women's Political Participation. An analysis of the impact of women's parliamentary networks in Europe and Central Asia]*, 2016.

UNMIK, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm [*Report of the Secretary-General]*, 2019, tek:
https://unmik.unmissions.org/file/158611/download?token=j2_KdX6Y.

USAID, Vlerësimi i gjinisë, LGBTI dhe personave me aftësi të kufizuara [*Gender, LGBTI, And Persons with Disabilities Assessment]*, 2018, tek: https://www.edu-links.org/sites/default/files/media/file/Gender-LGBTI-PWD%20assessment%20Kosovo%202018.pdf. Vargas, V., Disa mendime mbi epistemologjitë e reja në feminizmin e Amerikës Latine ["Some Thoughts on New Epistemologies in Latin America Feminism"], në Harcourt, W., Trupat në Rezistencë. Gjinia dhe politika seksuale në epokën e neoliberalizmit, 2017.

Washington Post, Fushat e Vrasjes së Kosovës ["Kosovo's Killing Fields"], 1999, tek:
https://www.washingtonpost.com/wp-srv/inatl/longterm/balkans/maps/kosovo050899.htm.

Weldeab Sebhatu, R., "(En) gjinia e të rinjve për paqe me drejtësi gjinore me Rezolutën 2250 të Këshillit të Sigurimit të KB" ["(En)gendering youth for gender-just peace with UN Security Council Resolution 2250"], *Paqja e Drejtë Gjinore dhe Drejtësia Kalimtare*, 3, 2017, tek: https://portal.research.lu.se/portal/files/38075949/3._2017.pdf.

Wille, T., Përfaqësimi dhe agjencia në diplomaci: Si arriti Kosova të pajtohet me marrëveshjet e Rambujesë ["Representation and agency in diplomacy: How Kosovo came to agree to the Rambouillet accords"], *Gazeta e Marrëdhënieve dhe Zhvillimit Ndërkombëtar*, 2019, tek: https://link.springer.com/article/10.1057/s41268-017-0120-2.

Zyra e Presidentit, "Presidentja Jahjaga u takua me vajza nga Kosova dhe Serbia", tek:
https://president-ksgov.net/?page=2,6,3846.

Zyra e Shtypit e Qeverisë Amerikane, "Seanca dëgjimore mbi imigracionin e komitetit për gjyqësor Senati i Shteteve të Bashkuara" ["Hearing on Immigration of the Committee on the Judiciary United States Senate"], S. Hrg. 106-443, 2000, tek: https://www.govinfo.gov/content/pkg/CHRG-106shrg63248/pdf/CHRG-106shrg63248.pdf.

# Shtojcat

## Shtojca 1. Detaje metodologjike

Kjo shtojcë ofron detaje të mëtejshme në lidhje me metodologjinë e hulumtimit përveç përshkrimit paraprak në Hyrje. Ekipi hulumtues filloi duke përkufizuar konceptet kryesore që lidhen me këtë hulumtim. “Konflikti” u përkufizua gjerësisht si situata në të cilat njerëzit ose grupet shoqërore kanë ose perceptojnë se kanë qëllime, vlera ose interesa të kundërta. “Paqja” u përkufizua në mënyrë të ngjashme gjerësisht për të përfshirë mungesën e të gjitha dimensioneve të dhunës, duke përfshirë format e drejtpërdrejta, strukturore dhe kulturore të dhunës. “Siguria” u përkufizua gjerësisht në terma të sigurisë njerëzore. “Rinia” u përkufizua duke përdorur përkufizimin e BE-së për personat e moshës 15 deri në 29 vjeç.[580]

Tabela e mëposhtme përmbledh numrin e pjesëmarrësve në hulumtim sipas moshës dhe përkatësisë etnike. Në total, 266 vajza morën pjesë.

Tabela 4. Pjesëmarrësit e hulumtimit sipas moshës dhe gjinisë

| Metoda | Shqiptarë | | Serb | | Rom, Ashkali, Egjiptianë | | Boshnjakë | | Goranë | | Tjerë | | Refuzoi të tregojë | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjinia | G | B | G | B | G | B | G | B | G | B | G | B | G | B | G | B |
| Intervistat | 39 | 4 | 5 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 48 | 5 |
| Anketa | 176 | 0 | 36 | 0 | 3 | 0 | 4 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 221 | 0 |
| Intervistat e shkurtra të anëtarëve të RrGK | 53 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 18 | 0 | 79 | 0 |
| Fokus grupet | 71 | 0 | 24 | 0 | 34 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 130 | 0 |
| Totali | 339 | 4 | 65 | 1 | 42 | 0 | 9 | 0 | 1 | 0 | 3 | 0 | 18 | 0 | 478 | 5 |

### Grafiku 3. Pjesëmarrëset në Pyetësor sipas Nivelit të Edukimit




[580] Siç duket, pasi kjo metodologji u finalizua, KB-ja miratoi RKSKB 2535 në korrik 2020, që thotë: “Duke theksuar se termi i të rinjve përcaktohet në kontekstin e kësaj rezolute si persona të moshës 18-29 vjeç, dhe duke theksuar më tej variacionet e përkufizimit të termit që mund të ekzistojnë në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë përkufizimin e të rinjve në Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme”.

Lidhur me të anketuarat, siç ilustron Grafiku 3, shumica kishin diplomë Bachelor (42%), ndërsa 27% kishin diplomë Master, dhe 1% Doktoratë. Ndërkohë, 17% kishin përfunduar arsimin e mesëm, 9% arsimin e lartë profesional, 3% arsimin profesional bazuar në arsimin e mesëm dhe 1% arsimin fillor.

Më shumë se një e treta e të anketuarave punonin me orar të plotë (41%), 6% punonin me gjysmë orari, 21% ishin studente, 21% ishin të papuna, 5% ishin të vetëpunësuara, 6% punonin për familjen e tyre por nuk paguhen. (Grafiku 4).

**Grafiku 4. Statusi i punësimit të pjesëmarrëseve në Pyetësor**




Në tërësi, të anketuarat shqiptare të Kosovës u shpërndanë gjeografikisht në qytetet vijuese: Prishtinë, Ferizaj, Pejë, Podujevë, Fushë Kosovë, Prizren, Vushtrri, Gjakove, Lipjan, Therandë, Mitrovice, Gjilan, Deçan, Skenderaj, Dragash, Istog, Obiliq, Viti, dhe Shtime. Të anketuarit serbë të Kosovës ishin të vendosur në: Mitrovicë, Viti, Ranillug, Leposaviq, Zveçan, Obiliq, Prishtinë, Graçanicë, Vushtrri, Çagllavicë, Zubin Potok, Fushë Kosovë dhe Prizren. Vajzat nga komuniteti rom, ashkalinjë dhe egjiptasë ishin nga komunat e Prishtinës, Gjakovës, Prizrenit, Mitrovicës dhe Fushë Kosovës. Goranet dhe turket ishin në Prizren, dhe boshnjaket ishin në Prishtinë dhe Prizren. Në lidhje me përpjekjet për të siguruar një perspektivë ndër-sektoriale, pjesëmarrësit e hulumtimit përfshinin gjithashtu persona nga grupet e mëposhtme:

- 1 person/organizatë LGBTIQIA
- 266 gra, nën moshën 30 vjeç (4 të intervistuar, 130 në fokus grupe, 226 të anketuar)
- 11 gra me aftësi të ndryshme
- 5 gra politikane
- 30 aktivistë të shoqërisë civile
- 2 gazetarë
- 3 gra në akademi
- 7 organizata ndërkombëtare
- 3 zyrtare/ë policie
- 1 grua përfaqësuese e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Për më tepër, RrGK nxori nga arkivat dhe dokumentacioni ekzistues i historisë gojore bazuar në intervista me shumë gra dhe burra të ndryshëm, siç citohet në botim.

## Shtojca 2. Udhëzuesi për intervistë

## Definicionet

Së pari, dëshirojmë t'iu pyesim se çfarë kuptimi kanë disa nga termat e përdorur në këtë hulumtim.

1. Çfarë kuptimi ka paqja për juve?
2. Çfarë kuptimi ka siguria për juve?

**Rolet dhe kontributet e grave në paqe dhe siguri**
Tani, do të fillojmë me pyetje rreth mendimit tuaj rreth rolit dhe kontributit të grave në paqe dhe siguri.

3. Sipas jush, sa është e rëndësishme përfshirja e grave, veçanërisht vajzave, në procesin e paqes dhe sigurisë, nëse diçka e tillë mendoni se ekziston?

4. Sipas mendimit tuaj, a mendoni se gratë kanë luajtur rol gjatë proceseve të paqes dhe negociatave gjatë konfliktit të fundit në Kosovë? Nëse po çfarë roli specifikisht kanë pasur ato?
   4.1 Çfarë roli kanë pasur vajzat e moshës 15-29 vjeç gjatë konfliktit? [Jep shembuj]
   4.2 Cili ka qenë kontributi i grave gjatë periudhës së konfliktit? [Jep shembuj]
   4.3 Cili ka qenë kontributi i vajzave gjatë periudhës së konfliktit?
   4.4 Çfarë mendoni, cilat kanë qenë arsyet që gratë ose vajzat kanë pasur ose nuk kanë pasur rol/kontribut gjatë periudhës së konfliktit? [Jep shembuj]

5. Cili ka qenë roli i grave në proceset e paqes dhe sigurisë pas konlikfitit, nga viti 1999 deri më sot? [Jep shembuj]
   5.1 Cili ka qenë roli i vajzave gjatë kësaj periudhe, nëse mendoni që ka? [Jep shembuj]
   5.2 Cili ka qenë kontributi i grave gjatë periudhës nga viti 1999 deri më sot, nëse ka? [Jep shembuj]
   5.3 Cili ka qenë kontributi i vajzave? [Jep shembuj]

6. Nëse flasim konkretisht për dialogun në mes Kosovës dhe Serbisë, si janë përfshirë gratë, me theks të veçantë vajzat në këtë proces nëse mendoni se ka pasur përfshirje të tyre? [Jep shembuj] Me theks të veçantë, rreth dialogut të fundit.

7. Sa mendoni se kanë ndikuar organizatat e grave në avokimin e përfshirjes së grave në proceset e paqes dhe sigurisë, siç janë negociatat dhe dialogu?
   7.1 Çfarë çështje me rëndësi kanë ngritur ato? (Shembuj)
   7.2 Sa mendoni se kërkesat e tyre janë marrë parasysh në procese të paqes dhe sigurisë?

8. Si kanë ndikuar aktivitetet dhe puna juaj në përfshirjen/rritjen e numrit të vajzave në proceset e paqes dhe sigurisë?

9. Cilat kanë qenë sfidat e përfshirjes së grave, veçanërisht vajzave, në proceset e paqes dhe sigurisë?

10. Çfarë efekte ka përfshirja/mospërfshirja e grave, veçanërisht vajzave, në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës

dhe Serbisë? [Jep shembuj]

**Paqja, Siguria dhe Nevojat sot**

11. A mendoni që kemi paqe dhe siguri në Kosovë?

12. Sipas mendimit tuaj, cilat janë nevojat e grave krahas paqes dhe sigurisë në Kosovë sot?
    12.1 Çfarë mënyra keni përdorur për t'u njohur më shumë me nevojat e grave, veçanërisht vajzave? (për shembull, puna juaj me gratë dhe vajzat, konsultat me ato etj)?

13. Cilat çështje/nevoja do duhej të përfshihen në dialogun Kosovë-Serbi?

**Rekomandimet**

14. Cilat janë idetë tuaja **për përfshirje të vajzave në proceset e paqes dhe të dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë?**
15. Më konkretisht, si mendoni se qeveria mund të përfshijë më mirë gratë në procese të paqes dhe sigurisë?
16. Çfarë roli mund të luajnë organizatat ndërkombëtare në angazhimin e grave, veçanërisht të vajzave në procese të paqes dhe sigurisë?
17. Po organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht organizatat për të drejtat e grave, çfarë roli mund të luajnë ato në përfshirjen e më shumë grave në procese të paqes?
18. Cili mund të jetë roli i medias?

**Pyetjet përmbyllëse**

19. A mendoni që ka diçka të rëndësishme që nuk iu kam pyetur?
20. A keni komente shtesë?

**Pyetje për të intervistuar specific**
**Për zyrtarët:**

1. Si jeni përpjekur të konsultoheni me gratë në lidhje me nevojat e tyre rreth sigurisë dhe paqes, për të informuar proceset e negociatave / dialogut?
    1.1. Po për gratë e e grupeve të ndryshme? (përkatësia etnike, mosha, zona gjeografike, statusi i punësimit, feja, aftësia, seksualiteti)
    1.2. Për çfarë arsye nuk jeni këshilluar shumë me gra / gra të ndryshme?
2. Si i keni përfaqësuar prioritetet e grave në proceset e paqes dhe sigurisë?

**Për gratë në vendimmarrje:**

1. Si grua në një pozicion vendimmarrës dhe e rrethuar nga burra, cilat sfida keni hasur në punën tuaj? Deri në çfarë mase këto sfida e kufizojnë angazhimin tuaj dhe / ose angazhimin e grave të tjera në proceset e paqes.
2. Çfarë sfidash keni hasur gjatë përfshirjes së grave në proceset e paqes, nëse ka?
3. Si grua në një pozicion vendimmarrës, a jeni ndjerë ndonjëherë e diskriminuar, qoftë në pozicionin tuaj ose gjatë procesit për ta fituar këtë pozicion?

## Shtojca 3. Pyetësori

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) është duke kryer një hulumtim në lidhje me rolin e vajzave dhe grave në procesin e Paqes dhe Sigurisë në Kosovë, mbështetur nga UN Women. Përmes këtij pyetësori, ne duam t'i njohim mendimet tuaja! Do t'iu marrë afërsisht 10 minuta për ta përfunduar. Kontributi juaj është shumë i rëndësishëm për informim më të mirë të dialogut Kosovë-Serbi rreth prioriteteve tuaja si dhe proceseve të tjera të paqes.

***Të gjitha informatat që do të ndani me ne do të mbesin konfidenciale.**

**1. Gjinia juaj?**

*Grua*
*Burrë*
*Preferoj të mos e them*
*Tjetër (Ju lutem, specifikoni)* _______________

**2. Në cilin vit keni lindur?**

________________

**3. Në cilin qytet jetoni?**

_______________

**4. Me cilin grup etnik identifikoheni? Nëse përgjigja është më tepër se një, ju lutem shënoni të gjitha opsionet e vlefshme.**

*Shqiptar*
*Serb*
*Rom*
*Ashkali*
*Egjiptian*
*Turk*
*Boshnjak*
*Goran*
*Kroat*
*Nuk dëshironi ta thoni*
*Tjetër (Ju lutem specifikoni)* _____________

**5. Cili është niveli më i lartë arsimor që keni përfunduar?**

- Arsim fillor apo arsim fillor i pambaruar
- Arsim i mesëm
- Arsim profesional në bazë të arsimit të mesëm
- Arsim profesional i lartë
- Diplomë bachelor
- Diplomë master

- Doktoraturë (PhD)

**6. Statusi juaj i punësimit?**

*E punësuar me orar të plotë*
*E punësuar me gjysmë orari*
*E vetëpunësuar*
*Duke punuar për familjen por pa u paguar*
*Studente*
*E papunë*

7. Aktualisht, në shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 është aspak paqësore dhe 5 është plotësisht paqësore, sa paqësore do ta konsideronit situatën në Kosovë?
8. Ju lutem, na tregoni më shumë: Pse mendoni se është paqësore/nuk është paqësore?
9. Bazuar në të njëjtën shkallë, prej 1 deri në 5, sa të sigurtë e konsideroni situatën në Kosovë sot?
10. Ju lutem na tregoni më shumë: pse mendoni se Kosova është e sigurtë/jo e sigurtë?
11. Çfarë do të mund të bënte qeveria për t'iu bërë të ndiheni më të sigurta?
 11. Cilat janë pritshmëritë tuaja për Dialogun Kosovë-Serbi? Cilat çështje do të dëshironit më së shumti të diskutoheshin atje?
12. Sipas mendimit tuaj, çfarë do të mund të bënin partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile për të fuqizuar përfshirjen tuaj dhe të grave tjera në procese të paqes dhe sigurisë, përfshirë dialogun?

## Shtojca 4. Udhëzuesi për Fokus Grupe

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) është duke realizuar një hulumtim rreth rolit të vajzave të reja në Paqe dhe Siguri në Kosovë, mbështetur nga zyra e UN Women. Përmes këtij diskutimi, ne dëshirojmë të kuptojmë më mirë rolet dhe kontributet e vajzavetë reja në Paqe dhe Siguri gjatë periudhës së konfliktit dhe pas konfliktit në Kosovë. Më konkretisht, ne duam të dëgjojmë më shumë nga ju për nevojat tuaja, se si zyrtarët do të mund t'i plotësojnë këto nevoja përmes dialogut Kosovë Serbi dhe se si mund të angazhohen vajzat në proceset e paqes dhe sigurisë. Këto pra janë temat që do të diskutojmë me juve sot.

1. Çfarë kuptimi kanë për juve fjalët paqe dhe siguri?
2. Sa mendoni se Kosova është paqësore dhe e sigurtë sot?[Pse? Jep shembuj]
3. Në çfarë mase mendoni se gratë, veçanërisht vajzat, kanë qenë të përfshira në proceset e paqes dhe të sigurisë në Kosovë? Çfarë shembuj mund të jepni?
4. Si keni kontribuuar ju personalisht në në proceset e paqes dhe të sigurisë? [Jep shembuj]
5. Çfarë mendoni se mund të sjellin (ose si mund të kontribuojnë) vajzat në ndërtimin e paqes dhe proceset e sigurisë?
6. Sipas jush, çfarë duhet të bëhet, dhe nga kush, për të përfshirë më shumë gra, veçanërisht vajza, në ndërtimin e paqes dhe të sigurisë? [Çfarë ide keni]
7. Nëse do të ishit pjesë e dialogut Kosovë-Serbi, çfarë çështje do të siguroheshit që të diskutoheshin aty? [Temat]

## Shtojca 5. Korniza përkatëse ligjore dhe e politikave për gratë, të rinjtë, paqen dhe sigurinë

Kjo shtojcë përmbledh shkurtimisht kornizën përkatëse ligjore dhe të politikave në nivel global dhe në Kosovë, e cila ka formësuar agjendën e GPS-së për 20 vitet e fundit. Ajo përfshin tri rezoluta në lidhje me agjendën e RPS-së. Diskuton gërshetimet përkatëse të agjendave të GPS dhe RPS. Siguron kontekstin përkatës për pjesën tjetër të raportit, në lidhje me zotimet ekzistuese dhe detyrimet e aktorëve të ndryshëm drejt implementimit të agjendave të GPS dhe RPS në Kosovë.

### Shtyllat e agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë

Dispozitat dhe parimet e agjendës së GPS zakonisht grupohen në katër "shtylla", siç përshkruhen nga UN Women:

1) **Pjesëmarrja** e grave në qeverisje të paqes dhe sigurisë,e cila mbulon shumë dimensione të përfshirjes së grave nëmjediset e konfliktit dhe pas konfliktit;
2) **Mbrojtje** të të drejtave të njeriut të grave në mjediset e konfliktit dhe pas konfliktit;
3) **Parandalimin** e dhunës, duke përfshirë si parandalimin e konfliktit të dhunshëm, ashtu edhe parandalimin e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin (CRSV); dhe
4) **Ndihmën dhe rimëkëmbjen,** që kërkon programim humanitar të ndjeshëm ndaj gjinisë pas katastrofave dhe emergjencave komplekse, si dhe përfshirjen e grave në rindërtimin pas konfliktit dhe aktivitetet e lidhura mendërtimin e paqes".[581]

[581] UN Women, Parimet, Dimensionet dhe Prioritetet e Integrimit Gjinor për PVE, 2019, f. 11

## Konventa e KB për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Konventa e KB për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) (1979) deklaron se diskriminimi ndaj grave shkelë të drejtat e barabarta dhe dinjitetin njerëzor.[582] Megjithëse CEDAW nuk ofron dispozita të drejtpërdrejta për GPS, ajo përfshin rekomandime të përgjithshme ligjërisht të detyrueshme për mos-diskriminimin dhe barazinë.[583] Ajo njeh situatat në të cilat gratë vuajnë nga diskriminimi dhe u bën thirrje shteteve të marrin masat e nevojshme për arritjen e barazisë gjinore. Në të thuhet posaçërisht se progresi në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare do t'i kontribuojë barazisë. Ajo pranon që "mirëqenia e botës dhe kauza e paqes kërkojnë pjesëmarrjen maksimale të grave në kushte të barabarta me burrat në të gjitha fushat".[584] Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmend në mënyrë të qartë CEDAW në nenin 22, duke e bërë atë të zbatueshëm në Kosovë dhe me "përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike".[585]

## RKSKB për gratë, paqen dhe sigurinë

RKSKB 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë (2000) mbetet ndër rezolutat kryesore dhe më të rëndësishme për GPS. RKSKB 1325 ka katër shtylla: parandalimin, mbrojtjen, pjesëmarrjen dhe ndihmën dhe rimëkëmbjen.[586] Ajo shpreh shqetësimin se shumica dërrmuese e personave të prekur nga konflikti i armatosur janë gra. Kështu, rezoluta thekson rëndësinë e njohjes së rolit të grave në parandalimin, zgjidhjen dhe konsolidimin e paqes. Gratë duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë plotësisht në të gjitha proceset e vendimmarrjes, nga niveli lokal në atë ndërkombëtar, thuhet në të. Ajo gjithashtu thekson nevojën për operacione paqësore dhe negociata për të adaptuar një perspektivë gjinore.[587] RKSKB 1325 përmend që të gjitha shtetet janë përgjegjëse për "t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për të ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës" veçanërisht ato të një natyre seksuale kundër grave dhe vajzave. Ajo thekson se krime të tilla duhet të përjashtohen nga amnistitë kur është e mundur.[588] RKSKB 1325 ka shërbyer si bazë për rezolutat e mëvonshme mbi GPS, të cilat kanë vazhduar të përsosin agjendën.

## RKSKB për dënimin e përdorimit të dhunës seksuale si mjet lufte

582 Asambleja e Përgjithshme e KB, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, miratuar dhjetor 1979.

583 Manjoo, R., "Gratë, Paqja dhe Siguria - Negocimi në interesat më të mira të grave", 2016, f. 268

584 Asambleja e Përgjithshme e KB, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1979

585 Republika e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008

586 RKSKB 1325, 31 tetor 2000.

587 Po aty;

588 Manjoo, R., "Gratë, Paqja dhe Siguria - Negocimi në interesat më të mira të grave", 2016, f. 268

RKSKB 1820 (2008) ishte rezoluta e parë që njohu dhe dënoi përdorimin e dhunës seksuale si taktikë lufte.[589] Kjo rezolutë riafirmon rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të grave në proceset e paqes dhe sigurisë. Ajo shpreh shqetësim në lidhje me pengesat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në lidhje me dëmshpërblimet. Rezoluta përqendrohet në parandalimin dhe mbrojtjen e grave. E rëndësishme, ajo bën thirrje për përjashtimin e krimeve të dhunës seksuale nga amnistitë. Ajo kërkon që agjencitë përkatëse të KB të zhvillojnë masa efektive mbrojtëse për të shmangur të gjitha format e dhunës ndaj grave, veçanërisht dhunën seksuale. Ajo gjithashtu bën thirrje për komunikim me OShC-të përmes konsultimeve.

## RKSKB për krijimin e Përfaqësuesit Special të KB për dhunën seksuale në konflikt

RKSKB 1888 (2009) ka të bëjë me veprime të dhunës seksuale.[590] Ajo bën thirrje për masa për të mbrojtur të gjithë civilët, veçanërisht gratë dhe fëmijët. Ajo gjithashtu kërkon mbrojtje dhe përfshirje më të madhe të grave në misionet e paqes. Vëmendje e veçantë i kushtohet nevojës për të avokuar dhe ligjëruar në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe hetim më të madh të krimeve në lidhje me dhunën seksuale. Ajo shërben për të forcuar politikat e "tolerancës zero" mbi shfrytëzimin seksual dhe abuzimin në misionet e paqes të KB. Shtetet inkurajohen të përfshijnë më shumë gra në operacionet paqeruajtëse të KB. Subjekteve të KB-së u kërkohet të kenë më shumë kontakte me OShC-të, veçanërisht ato të drejtuara nga gratë.

## RKSKB për avancimin e përfshirjes së grave dhe vajzave në ndërtimin e paqes

RKSKB 1889 (2009) thekson rolin që gratë luajnë në të gjitha fazat e proceseve të paqes, duke shprehur shqetësim në lidhje me mungesën e grave në pjesëmarrje të proceseve të tilla, veçanërisht gjatë fazave të hershme të ndërtimit të paqes pas konfliktit.[591] Ajo vëren se stigmatizimi dhe diskriminimi kulturor paraqesin pengesa për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje. Rezoluta bën thirrje që Sekretari i Përgjithshëm të bashkëpunojë më shumë me shtetet dhe shoqërinë civile për të mbledhur dhe analizuar nevojat e veçanta të grave dhe vajzave. Ajo gjithashtu parashikon promovimin e barazisë gjinore në situata konfliktuale përmes emërimit të këshilltarëve gjinorë në misionet e KB.

## RKSKB për luftimin e mosndëshkimit për krimet e dhunës seksuale

RKSKB 1960 (2010) shpreh shqetësim në lidhje me dhunën seksuale ndaj grave dhe fëmijëve.[592] Përsërit "se është e domosdoshme që të gjitha shtetet dhe palët jo-shtetërore në konflikte të respektojnë plotësisht detyrimet e tyre sipas ligjit të zbatueshëm ndërkombëtar, duke përfshirë ndalimin e të gjitha formave të dhunës seksuale", si dhe nevojën për të treguar angazhim dhe vullnet politik për parandalimin dhe përfundimin e mosndëshkimit. Ajo vëzhgon përpjekjet e Sekretarit të Përgjithshëm të KB për të përfshirë gratë në "proceset zyrtare të paqes" dhe njohjen nga ana e tij të potencialit të grave për të adresuar dhunën seksuale. Prandaj, ajo bën thirrje për pjesëmarrje të shtuar të grave në negociatat e paqes dhe operacionet paqeruajtëse. Për më tepër, rezoluta inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm të përfshijë në raportet e tij vjetore informacion mbi pajtueshmërinë e palëve të ndryshme me rezolutat 1820 dhe 1888 dhe progresin e zbatimit në situata konfliktuoze. Në mënyrë të ngjashme, ajo synon të forcojë më tej

---

589 RKSKB 1820, 19 qershor 2008

590 RKSKB 1888, 30 shtator 2009.

591 RKSKB 1889, 5 tetor 2009.

592 RKSKB 1960, 16 dhjetor 2010.

politikat e “tolerancës zero” dhe të zbatojë masa të tjera, të tilla si trajnimi mbi shfrytëzimin seksual dhe abuzimin.

## RKSKB për forcimin e përpjekjeve për të luftuar dhunën seksuale

RKSKB 2106 (2013) riafirmon rëndësinë e zbatimit të të gjitha rezolutave të tjera në lidhje me dhunën seksuale, por gjithashtu shpreh shqetësim të thellë në lidhje me progresin e kufizuar drejt adresimit të dhunës seksuale dhe zbatimin e dobët të rezolutës 1960.[593] Më tej, ajo thekson njohjen e përgjegjësisë kombëtare në adresimin e shkaqeve kryesore të dhunës seksuale në konfliktin e armatosur. Ajo thekson rëndësinë e fuqizimit politik, shoqëror, ekonomik dhe politik të grave, si dhe burrave dhe djemve, për të “luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave” dhe për të “parandaluar dhunën seksuale në konflikte të armatosura dhe situata pas konfliktit”.[594] Ashtu si në RKSKB 1820, aty thuhet se dhuna seksuale është përdorur në mënyrë sistematike ose si një taktikë lufte kundër popullatës civile. Prandaj, ajo kërkon masa në të cilat përfshihen gratë, duke kontribuar kështu në paqeruajtjen dhe sigurinë ndërkombëtare. Rezoluta gjithashtu njeh hetimin dhe dokumentimin si mënyra për të ndjekur penalisht autorët e dhunës seksuale dhe për të siguruar drejtësi për viktimat.

Lidhur me misionet e KB, ajo bën thirrje për “vendosjen e mëtejshme të Këshilltarëve për Mbrojtjen e Grave” siç parashikohet në RKSKB 1888. Roli i rëndësishëm i këshilltarëve gjinorë njihet. Sekretarit të Përgjithshëm dhe agjencive të tjera të KB u kërkohet të “ndihmojnë autoritetet kombëtare, me pjesëmarrjen efektive të grave, në adresimin e shqetësimeve të dhunës seksuale” në fushat e çarmatosjes, çmobilizimit dhe proceseve të riintegrimit, si dhe iniciativat e sektorit të sigurisë dhe drejtësisë. Së fundmi, aludon në nevojën për të forcuar sistemet shëndetësore, duke njohur lidhjen midis dhunës seksuale në konflikt të armatosur dhe situatave pas konfliktit dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, të cilat prekin në mënyrë proporcionale gratë dhe vajzat.[595]

## RKSKB për zgjerimin e lidershipit të grave në zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes

RKSKB 2122 (2013) riafirmon të gjitha rezolutat e mëparshme mbi GPS dhe njeh përparimin në monitorimin, parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale të dhunës.[596] Përkundër këtij progresi, ajo vë në dukje se agjenda e GPS nuk ka zbatim në disa aspekte të tjera të tilla si “mbrojtja e abuzimeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut” ose sigurimi i pjesëmarrjes së grave në pozitat udhëheqëse, si dhe angazhimi i përgjithshëm i aktorëve të ndryshëm për të zbatuar RKSKB 1325. Kështu, kjo rezolutë përqendrohet në zgjerimin e “lidershipit dhe pjesëmarrjes së grave në zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes”,[597] si dhe monitorimin e progresit në zbatimin e agjendës së GPS dhe analizës së informacionit. Për këtë qëllim, rezoluta kërkon që Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse dhe Departamenti i Çështjeve Politike, Sekretari i Përgjithshëm, Përfaqësuesit Specialë në Misionet e KB dhe zyrtarë të tjerë të lartë “të informojnë Këshillin mbi përparimin në ftesën e grave për të marrë pjesë, përfshirë përmes konsultimeve me shoqërinë civile, përfshirë organizatat e grave, në diskutimet që kanë të bëjnë me parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit, ruajtjen e paqes dhe sigurisë dhe ndërtimin e paqes pas konfliktit”.[598]

[593] RKSKB 2106, 24 qershor 2013
[594] Po aty.
[595] Po aty.
[596] RKSKB 2122, 18 tetor 2013.
[597] Po aty.
[598] Po aty.

## RKSKB për rritjen e përpjekjeve për përfaqësimin e grave dhe luftimin e ekstremizmit

RKSKB 2242 (2015) riafirmon të gjitha rezolutat e mëparshme mbi GPS dhe mirëpret përfshirjen e barazisë gjinore në Agjendën e KB 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm,[599] që synon të kontribuojë në parandalimin e konfliktit, paqeruajtjen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ajo përmend Studimin Global mbi Zbatimin e RKSKB 1325, duke vërejtur nevojën për të investuar më shumë në parandalimin e konflikteve dhe fuqizimin e grave.[600] Pavarësisht progresit, Këshilli i Sigurimit shpreh shqetësim të thellë në lidhje me "nën-përfaqësimin e grave në pozita të larta në shumë procese zyrtare dhe organe që lidhen me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare". Prandaj, kjo rezolutë rithekson nevojën për përfaqësim më të madh të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, sigurimin e mbështetjes financiare dhe teknike dhe pjesëmarrjen e OShC-ve. Gjithashtu, ajo kërkon një dyfishim të përpjekjeve për të integruar gjininë në departamente të ndryshme të KB dhe punën e tyre, siç thuhet në RKSKB 2122, si dhe për të siguruar analiza gjinore dhe ekspertizë teknike "përgjatë të gjitha fazave të planifikimit të misionit".[601]Ajo bën thirrje për përfshirjen e aspekteve të agjendës së GPS në situata specifike të vendit, duke marrë parasysh kontekstet e tyre unike. Për këtë qëllim, interesat e grave duhet të merren parasysh, veçanërisht në situata të konfliktit të armatosur, përmes konsultimeve me grupe lokale dhe ndërkombëtare të grave. Gjithashtu, ajo shpreh shqetësim në lidhje me pretendimet e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit të kryera nga paqeruajtësit e KB, duke bërë thirrje për trajnim para-vendosjes mbi këtë çështje, hetime dhe ndjekje penale, kur është e nevojshme. Përmenden çështje të tjera të rëndësishme, të tilla si pjesëmarrja e grave në "strategjitë për të luftuar terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm", forcimin e qasjes në drejtësi për gratë, ndikimin dhe rreziqet e armëve të vogla dhe armëve të lehta në sigurinë e grave dhe integrimin e gjinisë në kornizat humanitare.[602]

## RKSKB për rininë, paqen dhe sigurinë

RKSKB 2250 (2015) riafirmon rezolutat e mëparshme për GPS, përfshirë RKSKB 1325. Konsiderohet si rezoluta kryesore për RPS.[603] Duke pasur parasysh që të rinjtë tani përbëjnë gjeneratën më të madhe në histori, si dhe një brez që ka jetuar në disa konflikte të armatosura, kjo thekson nevojën për të njohur agjencinë dhe kontributet e të rinjve në konsolidimin e paqes së qëndrueshme. Ajo ngre shqetësime në lidhje me radikalizimin e rinisë dhe vëren se përfshirja e të rinjve në procesin e paqes mund të ndihmojë në uljen e këtij fenomeni. Për ta arritur këtë, janë përcaktuar pesë kategori: pjesëmarrja, mbrojtja, parandalimi, partneriteti dhe shkëputja, dhe ri-integrimi. Lidhur me këto shtylla, vendet anëtare pritet të zbatojnë politika që marrin parasysh nevojat e të rinjve, si dhe të nxisin bashkëpunimin me komunitetet lokale, OShC-të dhe organizatat rinore; ato gjithashtu duhet të lehtësojnë një mjedis gjithëpërfshirës përmes punësimit, arsimit dhe trajnimit, duke parandaluar margjinalizimin. Rezoluta njeh që vendosja dhe ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare kërkon mbrojtjen dhe përfshirjen e të rinjve në proceset e paqes në konflikt dhe pas konfliktit. Drejt rritjes së pjesëmarrjes së tyre, ajo propozon mbështetjen e nismave lokale. Ajo gjithashtu rekomandon hartimin e politikave për të rinjtë, nxitjen e arsimimit të tyre dhe promovimin

---

[599] Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm është një plan veprimi i miratuar nga të gjithë shtetet anëtare të KB, që "kërkon të forcojë paqen universale", dhe që synon të zbatohet plotësisht deri në 2030. Ajo përfshin Objektivin 5, i cili synon të "arrijë barazinë gjinore dhe të fuqizojë të gjitha gratë dhe vajzat". Për më shumë informacion, shihni "Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm"

[600] RKSKB 2242, 13 Tetor 2015

[601] Po aty.

[602] Po aty.

[603] RKSKB 2250, 9 dhjetor 2015

e një “kulture paqeje, tolerance, dialogu ndërkulturor dhe ndërfetar”.[604] Drejt adresimit të radikalizimit, ajo u bën thirrje shteteve të zhvillojnë strategji. Rekomandon rehabilitimin e të rinjve përmes politikave të punës, si dhe mbështetje më të madhe për organizatat e drejtuara nga të rinjtë. Nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse gjinore përmendet shkurtimisht.

### RKSKB për rritjen e rolit të të rinjve në negocimin, zbatimin e marrëveshjeve të paqes

RKSKB 2419 (2018) njeh rolin pozitiv që të rinjtë mund të luajnë në proceset e ndërtimit të paqes, duke riafirmuar RKSKB 2250.[605] Ajo thekson kujdesin ndaj rreziqeve të veçanta me të cilat përballen gratë e reja, duke afirmuar angazhimin e KB për të fuqizuar të rinjtë dhe gratë për shkak të agjencisë së tyre dhe drejt konsolidimit të paqes. Kjo rezolutë i kushton vëmendje të veçantë grupeve të shoqërisë civile të drejtuara nga të rinjtë.

### RKSKB për një qasje të përqendruar në të mbijetuarit në zonat pas konfliktit

RKSKB 2467 (2019) njeh rreziqet disproporcionale me të cilat përballen gratë dhe vajzat në zonat e konfliktit dhe pas konfliktit për shkak të dhunës seksuale.[606] Ajo vëren se pothuajse 20 vjet pas miratimit të RKSKB 1325, ligjet diskriminuese, mungesa e një përgjigje humanitare të ndjeshme ndaj gjinisë dhe mungesa e përfaqësimit në organet vendimmarrëse vazhdojnë. Ajo njeh mungesën e shërbimeve për të mbijetuarit, duke theksuar rëndësinë e përqendrimit në nevojat e tyre dhe përfshirjen e tyre në proceset kalimtare të drejtësisë dhe organet vendimmarrëse. Shtetet janë thirrur të zbatojnë procedurat që zbatojnë ligjin dhe sigurojnë përgjegjësi, si dhe forcojnë legjislacionin dhe qasjen në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale, duke përfshirë hetimin e duhur dhe ndjekjen penale të çështjeve. Ajo gjithashtu thekson nevojën për dokumentimin dhe monitorimin e dhunës seksuale në zonat e konfliktit dhe pas konfliktit, duke përfshirë mbajtjen e të dhënave të ndara sipas seksit. RKSKB 2467 vëren se sëmundjet seksualisht të transmetueshme që vijnë nga dhuna seksuale në konflikt të armatosur mund të jenë një pengesë e vazhdueshme dhe sfidë ndaj barazisë gjinore. Ajo gjithashtu thekson nevojat specifike të grave që mbeten shtatzënë për shkak të dhunës seksuale, duke u bërë thirrje shteteve t'i përfshijnë ato dhe fëmijët e tyre në legjislacionin kombëtar në përputhje me mekanizmat ndërkombëtarë.

Rezoluta pranon punën e shoqërisë civile dhe organizatave të grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Vëzhgon rëndësinë e nismave bazë dhe organizatave lokale për parandalimin. Ndërkohë, ajo njeh problemet që përjetojnë këto organizata si rezultat i diskriminimit, ngacmimit dhe dhunës ndaj shoqërisë civile. Ajo tregon për një korrelacion midis barazisë gjinore dhe fuqizimit politik, social dhe ekonomik të grave, veçanërisht lidhur me parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale në situata konfliktuale dhe pas konfliktit.

Rezoluta thekson se nevojat e të mbijetuarve duhet të merren parasysh nga organet përkatëse të KB dhe se dhuna seksuale duhet të dokumentohet me konfidencialitet. Ajo kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të vendosë këshilltarë për mbrojtjen e grave në operacionet e paqes, si dhe të vendosë integrimin gjinor në këto operacione. Së fundmi, ajo njeh rolin e grave jo vetëm si viktima, por si pjesëmarrëse aktive në grupe të armatosura dhe konflikte, duke përmendur çarmatimin, çmobilizimin dhe ri-integrimin e grave luftëtare.

[604] Po aty.

[605] RKSKB 2419, 6 qershor 2018

[606] RKSKB 2467, 23 prill 2019.

## RKSKB për "zbatimin e plotë" të agjendës së grave, paqes dhe sigurisë

RKSKB 2493 (2019) pranon progresin e bërë nga RKSKB 1325, por gjithashtu i referohet mangësive në zbatimin e saj.[607] Ajo shpreh rolin dhe përgjegjësinë e rëndësishme që kanë shtetet anëtare dhe agjencitë e KB në sigurimin e të drejtave të njeriut. Ajo bën thirrje për rritje të fondeve në fushën e GPS, duke përfshirë rritjen e mbështetjes dhe mbrojtjes së OShC-ve, të tilla si përmes bashkëpunimit të zhvillimit në lidhje me fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore.

## RKSKB 2535 për rolin e të rinjve në zgjidhjen e konflikteve, parandalimin dhe ndërtimin e paqes

RKSKB 2535 (2020) riafirmon dhe kujton të gjitha rezolutat e mëparshme mbi agjendat e GPS dhe RPS.[608] Termi "rini" përcaktohet si persona midis moshës 18 dhe 29 vjeç, megjithëse vërehen ndryshime në këtë përkufizim. Duke marrë parasysh që të rinjtë përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë së botës, përfshirë vendet e prekura nga konfliktet, rezoluta thekson potencialin e të rinjve për të "kontribuar në paqen e qëndrueshme dhe prosperitetin ekonomik nëse ekzistojnë politika gjithëpërfshirëse".[609] Për këtë arsye, ajo kërkon që Sekretari i Përgjithshëm dhe të dërguarit e tij të veçantë të përfshijnë zërin e të rinjve në diskutimet përkatëse. Megjithëse kjo rezolutë përqendrohet në rolin aktiv të të rinjve në arritjen e paqes së qëndrueshme ose luftën kundër dhunës, siç është terrorizmi, ajo gjithashtu vëzhgon se si konflikti prek të rinjtë, veçanërisht gratë. Roli i vajzave nënvizohet si kyç "në të gjitha fazat e proceseve të paqes".[610]

Duke pasur parasysh potencialin e të rinjve, ajo bën thirrje për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në parandalimin e konflikteve, zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes, si dhe për t'i mbrojtur ata dhe për të respektuar të drejtat e tyre të njeriut dhe liritë individuale. Në fakt, ajo u kushton vëmendje të veçantë rasteve të dhunës seksuale, dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit njerëzor, duke nxitur shtetet të mbrojnë të rinjtë. Ajo gjithashtu thekson nevojën për t'u dhënë mundësi të rinjve në ndërtimin e paqes, sipërmarrjen, arsimin dhe përfshirjen politike. Rezoluta vë në dukje hapësirat digjitale dhe aftësinë e tyre për të mundësuar pjesëmarrjen, por edhe pabarazitë dhe rreziqet. Së fundmi, rezoluta kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të raportojë çdo dy vjet mbi progresin në zbatimin e rezolutave 2250 dhe 2419.[611]

## Objektivat e KB për zhvillimin e qëndrueshëm

Objektivat e KB për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZhQ) për vitin 2030 deklarojnë se gratë duhet të kenë pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrje.[612] Synimi 5.5 i objektivit për Barazinë Gjinore kërkon pjesëmarrje të plotë dhe efektive të grave dhe mundësi të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike. KB vëren se diskriminimi ndaj grave në punë kontribuon në nën-përfaqësimin e grave në politikë dhe vendimmarrje. Qeveria e Kosovës ka treguar angazhimin e saj për të punuar në drejtim të zbatimit të

---

607 RKSKB 2493, 29 tetor 2019

608 RKSKB 2535, 14 korrik 2020

609 Po aty.

610 Po aty.

611 Po aty.

612 Asambleja e Përgjithshme e KB, *Transformimi i Botës Sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm*, 2015

OZhQ-ve duke miratuar unanimisht rezolutën për OZhQ-të në 2018.[613]

## Plani i veprimit i KB për Ballkanin Perëndimor

Plani i veprimit i Kombeve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor u zhvillua nën platformën e parandalimit të Sekretarit të Përgjithshëm. Ai angazhohet që agjencitë e KB do të mbështesin rajonin në fusha të tilla si dialogu, ndërtimi i besimit dhe pajtimi. Ky plan veprimi identifikon katër fusha në të cilat KB mund të angazhohet:

1) Puna me autoritetet dhe partnerët për dialogun, ndërtimin e besimit dhe pajtimin në rajon përmes konsultimeve dhe identifikimit të fushave ku KB mund të sigurojë një vlerë të shtuar.
2) Eksplorimi i mbështetjes së forcuar programore për të ndihmuar fuqizimin e agjentëve pozitivë të ndryshimit, veçanërisht grave dhe të rinjve, që punojnë drejt ndërtimit të besimit më të madh dhe arritjes së pajtimit në të gjitha nivelet. Kjo do të përfshinte një ekzaminim të nismave ekzistuese të drejtësisë tranzicionale në kuptimin e gjerë dhe mësimeve të tyre të nxjerra.
3) Forcimi i koherencës dhe efektivitetit strategjik midis aktorëve të KB që punojnë në mbështetje të ndërtimit të besimit, dialogut, pajtimit në Ballkanin Perëndimor, me qëllim krijimin e sinergjive më të mëdha dhe një mbështetje më efektive dhe strategjike nga perspektiva rajonale.
4) Sigurimi i një koordinimi dhe bashkëpunimi të fortë me partnerët ndërkombëtarë në rajon në fushat e mbështetjes për ndërtimin e besimit, dialogut dhe pajtimit, veçanërisht të Bashkimit Evropian dhe OSBE.[614]

## Qasja Gjithëpërfshirëse e Bashkimit Evropian ndaj GPS-së

Në vitin 2008, Bashkimi Evropian (BE) miratoi "Qasjen gjithëpërfshirëse për zbatimin në BE të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 dhe 1820 mbi gratë, paqen dhe sigurinë".[615] Siç duket, ky dokument i parapriu tetë nga dhjetë rezolutat aktuale në lidhje me agjendën e GPS, Traktatin e Lisbonës në 2009 dhe krijimin e Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm.[616] Ky dokument siguroi udhëzime drejt formësimit të veprimeve të jashtme të BE-së për të mbrojtur gratë nga dhuna dhe për të kontribuar në rritjen e barazisë midis grave dhe burrave gjatë dhe pas konfliktit të armatosur dhe në situata të brishtësisë. Në të, BE vëren nevojën për të promovuar pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e grave në situata konfliktuale dhe ndërtimin e paqes, si dhe për të siguruar që veprime të tilla të marrin mbështetje përmes konsideratave më të gjera të zhvillimit, të tilla si promovim të sigurisë ekonomike të grave, shërbime shëndetësore dhe arsim. Treguesit që matin progresin në zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse u azhurnuan në vitin 2016.[617] Dokumenti u bën thirrje OShC-ve, grupeve të grave dhe organizatave bazë për të bashkëpunuar në zbatimin dhe vlerësimin e agjendës së GPS. Megjithëse nuk është i zbatueshëm drejtpërdrejt në Kosovë, ai ka udhëhequr punën e institucioneve të BE-së në Kosovë.

[613] UNKT, Parlamenti i Kosovës Njëzëri Miraton Rezolutën e OZhQ, 2018

[614] Korrespondenca me email e RrGK me Cornelia Schneider, Zyrtare e Lartë e KB e Koordinimit të Zhvillimit, 2020.

[615] Këshilli i Bashkimit Evropian, *Qasja Gjithëpërfshirëse për Zbatimin në BE të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 dhe 1820 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë*, 2008

[616] Guerrina, R. dhe Wright, RKM, "Gjinia e Fuqisë Normative në Evropë: Mësimet e Agjendës së Grave, Paqja dhe Siguria", *International Affairs*, 92, 2016, f. 306

[617] Këshilli i Bashkimit Evropian, *Treguesit e rishikuar për Qasjen Gjithëpërfshirëse për zbatimin në BE të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të KB 1325 dhe 1820 mbi gratë, paqen dhe sigurinë*, 2016

## Qasja Strategjike e BE-së për GPS

Në 2018, BE miratoi Qasjen Strategjike të BE ndaj Grave, Paqes dhe Sigurisë.[618] Dokumenti thekson universalitetin e Agjendës së GPS dhe karakterin e tij detyrues për të gjithë aktorët e BE-së dhe Shtetet Anëtare, si dhe në të gjitha ndërveprimet me vendet jo-BE. Ai gjithashtu identifikon fushat specifike ku kërkohet zbatimi i zgjeruar i Agjendës GPS. Qasja është e rëndësishme për institucionet e BE-së që punojnë në Kosovë.

## Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025

Në vitin 2020, BE pohoi se barazia gjinore është një nga vlerat e saj thelbësore, duke pranuar se asnjë vend nuk ka arritur barazinë midis burrave dhe grave. Strategjia e saj e Barazisë Gjinore synon të arrijë barazinë gjinore, të forcojë integrimin gjinor dhe të përdorë një qasje ndër-sektoriale në lidhje me përvojat unike të diskriminimit. Strategjia përcakton katër fusha të punës: dhënia fund e dhunës dhe stereotipave ndaj grave, arritja e barazisë ekonomike, vendosja e barazisë në vendimmarrje dhe përdorimi i integrimit gjinor dhe një qasje ndër-sektoriale në politikat e BE, duke përfshirë veprimet e financimit për të bërë përparim drejt barazisë gjinore dhe adresimin e gjinisë barazia dhe fuqizimi në të gjithë botën. Si pjesë e kësaj Strategjie, BE kërkon të vazhdojë zbatimin e qasjes së saj strategjike ndaj GPS.[619] Strategjia referon Objektivin 5 të OZhQ të KB për barazinë gjinore dhe bën thirrje për ndarjen e të dhënave sipas moshës dhe faktorëve të tjerë. Ajo ka zbatueshmëri për politikat dhe financimet e brendshme dhe të jashtme të BE-së, dhe për këtë arsye ka rëndësi për punën e BE-së në Kosovë.

## Plani i veprimit gjinor i BE-së II dhe III

Gjatë periudhës 2016 - 2020, BE kishte Planin e saj të dytë të Veprimit Gjinor (PVGJ II), i cili u përqendrua në "dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave, promovimin e fuqizimit ekonomik dhe social të grave dhe sigurimin e përmbushjes së të drejtave njerëzore, politike dhe civile" .[620] Kjo përfshinte kërkesat që delegacionet e BE-së dhe shtetet anëtare të raportojnë çdo vit mbi zbatimin e tij, duke përfshirë kryqëzimet midis tij dhe agjendës së BE për GPS. Më 25 nëntor 2020, BE filloi PVGJ III, i cili ofron një qasje gjithëpërfshirëse të lidhur me Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025.[621] Një nga pesë shtyllat e PVGJ III përqendrohet në zbatimin e agjendës GPS, dhe monitorimi dhe raportimi për GPS do të harmonizohen me raportimin për PVGJ III.[622] BE dhe shtetet e saj anëtare duhet të zbatojnë PVGJ III në marrëdhëniet e tyre të jashtme, përfshirë punën e tyre në Kosovë.

## Kushtetuta e Kosovës

Kushtetuta e Kosovës parashikon bashkëpunimin ndërkombëtar në promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut.[623] Në mënyrë të veçantë, përmes nenit 22, Kushtetuta miraton marrëveshje ndërkombëtare

---

[618] Shërbimi Evropian i veprimit të jashtëm, *Qasja Strategjike e BE-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë*, 2018

[619] Komunikatë e Komisionit Evropian, *Një Bashkim i Barazisë: Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025*, 5 mars 2020

[620] Po aty. Shih gjithashtu Dokumenti i përbashkët i punës së stafit mbi barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave: Transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE 2016-2020.

[621] Komunikatë e Komisionit Evropian, *Një Bashkim i Barazisë: Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025*, 5 mars 2020

[622] Komisioni Evropian, Plani i veprimit gjinor i BE (PVGJ) III - Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në veprimin e jashtëm të BE, 2020

[623] Republika e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008

të tilla si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe CEDAW, ndër të tjera. Qeveria nuk mund ta ratifikojë plotësisht CEDAW sepse Kosova nuk është anëtare e KB për shkak të statusit të saj ende të pazgjidhur ndërkombëtarisht. Megjithëse Kosova ka integruar në Kushtetutën e saj garanci të mjaftueshme për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, fakti që Kosova nuk është anëtare e KB ose Këshillit të Evropës pengon aftësinë zbatuese të këtyre dispozitave, të tilla si monitorimi i shtetit nga organet e KB dhe zbatimi i mekanizmave mbikëqyrës dhe gjyqësorë.

Sipas Kushtetutës, Kuvendi i Kosovës, shërbimi civil, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe Gjykata Kushtetuese do të respektojnë parimet e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore. Neni 7.2 i Kushtetutës garanton mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në jetën politike. Këto dispozita kanë rëndësi për pjesëmarrjen e barabartë të grave në proceset e paqes, duke përfshirë negociatat dhe dialogun me Serbinë.

Ndërkohë, në lidhje me zbatueshmërinë, neni 53 thotë se "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Sidoqoftë, përsëri, duke pasur parasysh statusin e saj politik, Kosova gjithashtu ende nuk ka qasje në këtë Gjykatë drejtpërdrejt. Kështu, siç kanë vërejtur Istrefi dhe Morina, "vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nuk i nënshtrohen Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut".[624]

Që kur Kosova deklaroi pavarësinë e saj në 2008, Kushtetuta gjithashtu ka rregulluar sektorin e sigurisë. Ajo përcakton institucionet e sigurisë si Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës (PK), Agjencia e Inteligjencës e Kosovës dhe Autoriteti i Aviacionit Civil.[625] Sipas Kushtetutës, këto institucione të sigurisë do të pasqyrojë diversitetin etnik të popullsisë së Kosovës.[626] Sidoqoftë, në kontekstin specifik të institucioneve të sigurisë, Kushtetuta si akti më i lartë ligjor dhe rregullator në Kosovë nuk kërkon në mënyrë të qartë diversitetin gjinor në sektorin e sigurisë.

## Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, rregulloret dhe strategjitë përkatëse

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) rregullohet me Ligjin Nr. 06/L-123, aprovuar në Kuvend në mars 2008.[627] Neni 18 mandaton Qeverinë të miratojë Strategjinë e Mbrojtjes sipas rekomandimeve të Ministrit të Mbrojtjes. Ligji i jep kompetenca Këshillit të Sigurimit, të kryesuar nga Kryeministri, i cili në bashkëpunim me Presidentin dhe Qeverinë, përgatit Strategjinë e Sigurisë për Kosovën.[628] Në vitin 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi Strategjinë e parë të Sigurisë, e cila nuk e përcaktonte qartë periudhën e zbatimit të saj.[629] Strategjia e Sigurisë identifikoi objektivat, sfidat dhe mjetet për t'i adresuar sfidat, por nuk kishte konsideratë të mjaftushme lidhur me barazinë gjinore. I'u referua gjinisë vetëm në aspekt të politikave të rekrutimit, mbajtjes dhe promovimit ne sektorin e sigurisë.[630] Sipas Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), kjo Strategji iu imponua institucioneve të Kosovës nga ndërkombëtarët, "duke mos adresuar sfidat reale të sigurisë me të cilat përballet Kosova".[631] Për më tepër, sipas Institutit GAP, procesit të hartimit i mungonte transparenca dhe gjithëpërfshirja, pasi institucionet përkatëse të sigurisë nuk ishin kon-

---

624 Istrefi, K., dhe Morina, V., "Zbatimi Gjyqësor i së Drejtës Ndërkombëtare në Kosovë", në Rodin, S. & Perišin, T., *Zbatimi gjyqësor i së drejtës ndërkombëtare në Evropën Juglindore*, Springer, 2015, f. 169-170.

625 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Nenet 126, 127, 128, 129, 130.

626 Po aty. Neni 125.

627 Ligji Nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Neni 18, 19.

628 Po aty, neni 19 dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 127.

629 Strategjia e Sigurisë së Kosovës, 2010

630 Ministria e Forcës së Sigurisë, Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës, 2010, Neni 2.3, f. 6

631 QKSS, Përmbledhje e politikave, *Konteksti i zhvillimit të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë - perspektiva e shoqërisë civile*, 2013, f. 4

sultuar në këtë proces.[632] Strategjia e Sigurisë 2021-2030 ishte nën konsultim publik në vitin 2020. Versioni i ofruar për konsultim publik poashtu kishte mungesë të një perspektike gjinore.

Sipas rregullores Nr. 09/2019 për Planifikim në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, Strategjia e Mbrojtjes do të jetë dokumenti më i lartë strategjik në hierarkinë e dokumenteve të Ministrisë së Mbrojtjes, duke përcaktuar parimet kryesore, drejtimet dhe aftësitë e mbrojtjes.[633] Në dhjetor 2020, Ministria e Mbrojtjes hartoi këtë Strategji, por Asambleja nuk e kishte miratuar atë ende në kohën e hartimit. Në seksionin për burimet njerëzore, drafti i Strategjisë thotë se ata do të aplikojnë politika jodiskriminuese: "Forca e Sigurisë së Kosovës është një forcë multietnike, kështu që në këtë drejtim përparësi do t'i jepet përfaqësimit gjinor, integrimit dhe përfaqësimit të të gjitha komuniteteve pa dallim, si dhe mundësi të barabarta për zhvillimin e karrierës."[634]

Ndërkohë, Ministria e Mbrojtjes ka dy dokumente në lidhje me integrimin e gjinisë në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe brenda Ministrisë së Mbrojtjes. Së pari, politika për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe FSK-në u aprovua në vitin 2011, duke shërbyer si një udhëzues për respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, duke respektuar RKSKB 1325, dhe legjislacionin në fuqi.[635] Përmes kësaj politike, FSK dhe MFSK (tani Ministria e Mbrojtjes) zotohen të sigurojnë procedura të hapura, transparente dhe inkurajuese gjatë rekrutimit; kushte të barabarta pune; pagë të barabartë për burrat dhe gratë për të njëjtën punë dhe gradë; një mjedis pune të sigurt dhe pa ngacmime; dhe ndërgjegjësim gjinor në mesin e të gjithë stafit. Ajo gjithashtu parashikon mundësi të barabarta për promovim në vendimmarrje dhe menaxhim në MFSK dhe FSK, si dhe procese të hapura dhe transparente.[636]

Në vitin 2019, Ministria e Mbrojtjes miratoi politikën e dytë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.[637] Kjo politikë thekson arritjet e bëra deri më tani në Forcën e Sigurisë dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, duke siguruar të dhëna për gratë në uniformë dhe pozicione të tjera vendimmarrëse që nga viti 2018.[638]

## Ligji për Policinë dhe legjislacioni sekondar përkatës

Që nga viti 2012, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë ka rregulluar punën e Policisë së Kosovës (PK).[639] Sipas nenit 1, PK do të respektojë parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut siç parashikohen nga Kushtetuta në punësimin, avancimin dhe caktimin e detyrave. Ai thekson përdorimin e një procesi të bazuar në merita dhe jo-diskriminues për rekrutimin dhe ngritjen në detyrë, por nuk i referohet në mënyrë të qartë mundësisë së përdorimit të masave pohuese për rekrutimin ose promovimin e grave, përfshirë ato nga grupet etnike të pakicave, siç parashikohet nga Ligji për Barazi Gjinore.

Rregullorja Nr. 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Policisë së Kosovës përcakton organizimin e brendshëm të policisë në nivelin qendror dhe lokal. Burimet njerëzore gjithashtu rregullohen me akte nënligjore, siç është Rregullorja për Personelin dhe Administratën në Policinë e Kosovës.[640]

[632] Instituti GAP, *Procesi i ri i formulimit të Strategjisë së Sigurisë së Kosovës - Përfshirja dhe transparenca*, Prishtinë, maj 2013.

[633] Ministria e Mbrojtjes, rregullorja nr. 09/2019 për Planifikim në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, 2019

[634] Projekt Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës, faqja zyrtare e Ministrisë së Mbrojtjes.

[635] MFSK dhe FSK, Politika për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore në MFSK dhe FSK, 2011

[636] Po aty.

[637] Politika për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, 2019

[638] Po aty, f. 8

[639] Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

[640] QKSS, Gjendja e lojës së politikave të integritetit në Policinë e Kosovës, 2020, f. 15

Kapitulli VII i kësaj Rregulloreje për të Drejtat e Njeriut, Diversitetin dhe Barazinë Gjinore përshkruan fushëveprimin e Zyrës për të Drejtat e Njeriut në PK, që përfshin zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e dispozitat ligjore të policisë në lidhje me të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe diversitetin. Zyra duhet të ndërmarrë programe, strategji dhe projekte, si dhe zbatimin e mëtejshëm të Konventave Ndërkombëtare.[641] Ky kapitull gjithashtu kërkon bashkëpunim me institucionet dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare.[642] Që nga themelimi i ABGJ, PK gjithashtu zbaton strategji dhe programe të iniciuara nga ABGJ.[643]

Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2019 për Procedurën e Gradimit për Zyrtarët e Policisë thotë se procesi i ngritjes në detyrë bazohet në nevojat e PK-së (vendet e lira të punës), si dhe zgjedhja e personave më të kualifikuar përmes një procesi të drejtë dhe konkurrues.[644] Dokumenti nuk përfshin referencën ndaj ndonjë mase pohuese për avancimin e barazisë gjinore, siç parashikohet të jetë e mundur nga LBGJ,[645] por përkundrazi parashikon ngritjen në detyrë vetëm bazuar në merita. Kështu, PK nuk ka një qasje të qartë, të shkruar strategjike për promovimin e grave brenda forcës. Ndërkohë, anëtarët e Shoqatës së Grave në PK janë takuar dhe janë përpjekur të inkurajojnë gratë të kërkojnë ngritje në detyrë.[646]

## Ligji për Barazinë Gjinore

Ligji për Barazinë Gjinore (LBGJ), i miratuar në 2015, shfuqizoi Ligjin e mëparshëm për Barazinë Gjinore.[647] Ai siguron barazinë gjinore si një "vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fusha të tjera të jetës shoqërore".[648] Sipas LBGJ, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i barabartë arrihet kur një minimum prej 50% të secilës gjini sigurohet në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të të gjitha institucioneve legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe institucione të tjera publike. Neni 6 parashikon gjithashtu që institucionet të marrin masa të posaçme të përkohshme për të përshpejtuar barazinë gjinore. Këto masa mund të përfshijnë kuota për përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave, programe mbështetëse për të rritur pjesëmarrjen e seksit më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe jetën publike, fuqizimin ekonomik të grave dhe burrave, dhe masa për të adresuar pabarazitë në fusha të tjera.[649]

Veçanërisht, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (2008) dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale (2008) nuk janë në përputhje me LBGJ, pjesërisht sepse ato ishin miratuar para Ligjit për Barazinë Gjinore (2015).[650] Të dy ligjet zgjedhore kërkojnë një kuotë gjinore prej 30% të secilës gjini në listat e kandidatëve të partive politike, ndërsa LBGJ përcakton pjesëmarrjen e barabartë si pjesëmarrje 50% të secilës gjini në të gjitha pozitat vendimmarrëse në jetën politike dhe publike. Ndërsa LBGJ u miratua pas ligjeve zgjedhore, ai duhet të ketë përparësi mbi to. Para zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2019, Avokati i Popullit u bëri thirrje të gjitha partive politike "të zbatojnë dispozitat e Ligjit

[641] Rregullore për Personelin dhe Administratën në Policinë e Kosovës.

[642] Po aty, f. 37

[643] Intervistë e RrGK me Hysni Shala, Prishtinë, 2020

[644] Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2019 për Procedurën e Gradimit të Zyrtarëve të Policisë.

[645] Ligji për Barazinë Gjinore, Neni 6, 2.4.

[646] Intervistë e RrGK me një grua Kapitene në Polici, Prishtinë, 2020

[647] Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L -020 shfuqizoi të vjetrin Ligj për Barazinë Gjinore 2004/2.

[648] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazinë Gjinore Nr. 05/L-020.

[649] Po aty.

[650] Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Ligji për Zgjedhjet Lokale në Kosovë.

për Barazinë Gjinore në listat e kandidatëve për anëtarë të parlamentit", duke iu kujtuar atyre këtë detyrim.[651]

Sidoqoftë, pjesëmarrja 50% e grave dhe burrave nuk është zbatuar në praktikë në Kuvend ose në qeveri. Përkundrazi, partitë politike tentojnë të zbatojnë vetëm ligjet zgjedhore duke siguruar që minimumi 30% i listave të tyre zgjedhore të jenë gra (dhe burra). Nëse ligjet zgjedhore do të ndryshohen për të kërkuar përfaqësimin 50% të grave dhe burrave në listat zgjedhore, kjo do të kontribuojë në zbatimin e LBGJ, si dhe drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e barabartë të grave në asamblenë kombëtare dhe ato komunale. Kjo mund të kontribuojë në pjesëmarrjen e tyre më të barabartë në lidhje me proceset e paqes, mbikëqyrjen e institucioneve të sigurisë dhe alokimin e financimit të shtetit për programimin drejt paqes dhe sigurisë. Pjesëmarrja 50% e grave në qeveri nuk është zbatuar as siç është diskutuar në seksionet paraprake të këtij raporti.

LBGJ gjithashtu themeloi Agjencinë për Barazi Gjinore brenda Zyrës së Kryeministrit, si institucion kryesor për avancimin e barazisë gjinore në Kosovë. Përgjegjësitë e saj kryesore lidhen me zbatimin e LBGJ, përfshirë identifikimin dhe monitorimin e politikave që promovojnë barazinë gjinore. Lidhur me GPS, ABGJ është përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të plotë të CEDAW, që siguron bazën për të realizuar barazinë midis grave dhe burrave duke siguruar qasje të barabartë të grave dhe mundësi të barabarta në jetën politike dhe publike.[652] LBGJ gjithashtu themelon zyrtarë të barazisë gjinore në ministri dhe komuna, midis institucioneve të tjera. Këta mekanizma të barazisë gjinore kanë një rol të rëndësishëm në rishikimin e politikave dhe programeve qeveritare në të gjitha nivelet për të siguruar adresimin e nevojave të grave dhe burrave të ndryshëm.

## Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

Kosova miratoi Planin e saj të parë Kombëtar të Veprimit (PKV) për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në 2014, duke mbuluar vitet 2013-2015.[653] PKV synoi të rrisë kapacitetet për të zbatuar RKSKB 1325; të rritet pjesëmarrja e grave në shërbimin e jashtëm, ndërtimin e paqes dhe operacionet paqeruajtëse; të rriten rolet e grave në forcat e sigurisë në të gjitha nivelet dhe të njeh lidhjet e thella midis paqes dhe sigurisë; ndërtimin e kapaciteteve për promovimin dhe udhëheqjen e grave në sektor; dhe zvogëlimin e pengesave për pjesëmarrjen e grave brenda strukturave të sigurisë. Plani përfshiu gjithashtu aktivitete drejt krijimit të një kornize ligjore për "trajtimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të mbijetuarve civilë të konfliktit/dhunës seksuale të luftës, torturës ose formave të tjera të dhunës".[654] Ai parashikoi gjithashtu identifikimin dhe dokumentimin e rasteve, qasjen në drejtësi, mbështetjen psikologjike, rehabilitimin shëndetësor dhe fuqizimin ekonomik.

Sipas ABGJ, "79% e aktiviteteve të këtij dokumenti strategjik u zbatuan, duke treguar një angazhim të institucioneve për të përparuar në fushën e barazisë gjinore. Gjithashtu, në rajon është marrë si shembull si një nga planet e veprimit më të zbatuara."[655] Pas skadimit të PKV në 2015, nuk u hartua asnjë PKV i ri për ta zëvendësuar atë, pasi që objektivat e tij janë përfshirë në Programin e ri të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024.

## Programi i Kosovës për Barazi Gjinore

Programi i ri i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 përmend se përkundër kuotës, përfaqësimi politik i grave

---

[651] Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, *Deklarata e Avokatit të Popullit në lidhje me procesin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 2021* dhe Klan Kosova, *Avokati i Popullit bën thirrje për barazi gjinore në zgjedhjet e 6 tetorit, 2019*

[652] KB, CEDAW, Nju Jork, 18 dhjetor 1979.

[653] Qeveria e Kosovës, Plani i veprimit në zbatim të rezolutës 1325, "Gratë, Paqja dhe Siguria", Kosovë 2013-2015.

[654] Po aty.

[655] Intervistë e RrGK me ABGJ, Prishtinë, 2020.

është ende një sfidë e madhe në asambletë legjislative, pozicionet e vendimmarrjes dhe brenda ekzekutivit si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal.[656] Ndërsa Programi merret me çështje të ndryshme që do të kontribuojnë në sigurinë e grave, siç janë përfshirja e grave në institucionet e sigurisë, negociatat dhe proceset e paqes dhe pajtimit, ai nuk i referohet qartë agjendës së GPS. Sidoqoftë, disa pjesë lidhen me agjendën e GPS. Për shembull, objektivi strategjik 3 synon të sigurojë dhe forcojë qasjen në drejtësi, vendimmarrje, paqe dhe siguri duke promovuar posaçërisht barazinë gjinore në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë.[657]

Programi gjithashtu pranon nën përfaqësimin e grave brenda PK dhe FSK, duke synuar rritjen e angazhimit të grave në sektorin e sigurisë. Kjo është parashikuar të arrihet përmes: hulumtimit mbi diskriminimin dhe mjedisin e sektorit të sigurisë; krijimin e një Bordi Këshillëdhënës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë brenda institucioneve të sigurisë; rishikimin dhe avancimin e kurrikulës së institucioneve të sigurisë nga perspektiva gjinore dhe në përputhje me LBGJ; dhe organizimin e fushatave ndërgjegjësuese për të inkurajuar gratë të bashkohen në sektorin e sigurisë.

## Një qasje ndërthurëse ndaj grave, të rinjve, paqes dhe sigurisë

Në përgjithësi, siç ilustron kjo shtojcë, konceptet në lidhje me gjininë, paqen, rininë dhe sigurinë, historikisht janë trajtuar veçmas brenda rezolutave të KB. RKSKB 1325 dhe 2250 duken të sinkronizuara, por atyre u mungon një perspektivë ndërsektriale; gjinia nuk është e integruar në RKSKB 2250, dhe RKSKB 1325 nuk kërkon një qasje të vëmendshme ndaj moshës. Gjinia përmendet në RKSKB 2250 vetëm dy herë: përforcimi i rëndësisë së përfshirjes së grave në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe në lidhje me mundësitë e punësimit.[658] Ndërsa RKSKB 2250 eksploron rolin transformues të të rinjve dhe rolin e tyre përkatës në proceset e vendimmarrjes, ajo shpërfill mënyrën se si gjinia formon rininë dhe rolet, pozicionet dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave të rinj.

Rezolutat e tjera të Këshillit të Sigurimit të KB forcojnë dhe adresojnë RKSKB 1325 dhe 2250. Për shembull, RKSKB 2419 nënvizon RKSKB 1325 dhe 2250, duke riafirmuar nevojën për të përfshirë të rinjtë, veçanërisht gratë e reja, si agjente të paqes, në vendimmarrje dhe në proceset e negociatave. Në të vërtetë, angazhimi i grave të reja mund të çojë në kuptimin më të mirë të nevojave të tyre, të sjellë përvoja të ndryshme në bisedë dhe të prezantojë një brez të ri të krijuesve të paqes.

Gjatë finalizimit të këtij raporti, Këshilli i Sigurimit miratoi RKSKB 2535 në vitin 2020; ajo njeh rolin e të rinjve në fusha të ndryshme, të tilla si parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve, ndërtimi i paqes, hapësirat digjitale dhe arsimi, si dhe thekson nevojën për të arritur barazinë gjinore.[659] Ajo gjithashtu pranon kërcënimet e veçanta të sigurisë me të cilat përballen gratë e reja. Kështu, RKSKB 2535 siguron lidhjen më të fortë të deritanishme midis agjendave të GPS dhe RPS duke pranuar përvojat e ndryshme të grave të reja kur ato përballen me dhunë dhe diskriminim, por edhe rolin e tyre si agjente të paqes.

Fillimisht, Qasja Gjithëpërfshirëse e BE-së bëri diferencimin midis nevojave të grave dhe grave të reja, veçanërisht në rastet e dhunës seksuale. Sidoqoftë, ajo nuk integroi plotësisht agjendat e GPS dhe RPS. Gratë e reja kryesisht konsideroheshin viktima dhe pak vëmendje i kushtohej veprimit të tyre, siç ishte kontributi për paqen. Qasja më e fundit Strategjike e BE-së ndaj GPS nuk përfshin vetëm gratë si viktima, veçanërisht gratë e reja; gjithashtu njeh rolet e tyre si agjente të ndryshimit që mund të parandalojnë konfliktin dhe të kontribuojnë në paqen e qëndrueshme. Në këtë kuptim, Qasja Strategjike e BE-së ka përmirësuar disa mbikëqyrje në Qasjen Gjithëpërfshirëse

[656] Qeveria e Republikës së Kosovës, "Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024", 2020.

[657] Po aty, f. 60

[658] Weldeab Sebhatu, R., "(En)gendering youth for gender-just peace with UN Security Council Resolution KB " *Gender-Just Peace and Transitional Justice*, 3, 2017, f. 11

[659] RKSKB 2535, 14 korrik 2020

të mëparshme.

Sa i përket kornizës ligjore të Kosovës në lidhje me agjendat e GPS dhe RPS, Kushtetuta dhe LBGJ ofrojnë një kornizë të përgjithshme për avancimin e barazisë gjinore. Sidoqoftë, vetëm Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 adreson nevojat e sigurisë si të grave dhe të grave të reja, të tilla si në lidhje me qasjen në arsim, kujdesin shëndetësor, punësimin dhe përfundimin e dhunës me bazë gjinore. Legjislacioni i Kosovës nuk përmban referenca specifike për gratë e reja në lidhje me vendimmarrjen ose brenda proceseve të paqes dhe sigurisë.

“Nëse nuk i'u ofrojnë një vend në tryezë, sillni një karrige me vete.”

– Shirley Chisholm